REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Gjakovës



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E GJAKOVËS

Draft

Gjakovë 2026

PËRMBAJTJA

THEMELIMI I GRUPIT PUNUES 5

VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS 7

MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË 8

INFRASTRUKTURA LIGJORE 9

KREU I –rë 10

PROFILI I KOMUNËS SË GJAKOVËS 10

1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË KOMUNËS 11

1.1 FUSHA E PËRGJEGJËSISË (PËRKUFIZIMI HAPËSINOR) 11
1.2 SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME (E TERRITORIT) E KOMUNËS SË GJAKOVËS 12
1.3 HIDROGRAFIA -LUMENJTË DHE LIQENET 13
1.4 KARAKTERISTIKAT TJERA GJEORGRAFIKE-GJEOLOGJIKE-KLIMATIKE (reliefi, treguesit tjerë hidrologjik,,gjeologjik, pedologjik dhe meteorologjik 17

KREU II –të 19

2. DEMOGRAFIA 19

2.1. KATEGORITË E BANORËVE TË PLANIFIKUAR PËR EVAKUIM 26
2.2. DENDËSIA E POPULLSISË 26
2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në komunën e Gjakovës 28
2.2.2. Të punësuarit, të papunët dhe pensionistët 29
2.3. ARSIMIMI-IMSTITUCIOET ARSIMORE 33
2.3.1. Institucionet e arsimit parashlkollor 33
2.3.2. Imstitucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët 34
2.3.3. *Institucionet e arsimit të mesëm të lartë 36*
2.3.4. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE 38
2.3.5. REKOMANDIME 38

KREU I III-të 39

3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT 39

3.1. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE 39
3.2. PARQET NACIONALE DHE REZERVATET 46
3.2.1. Parqet natyrore dhe rezervatet 46
3.2.2. Sipërfaqet pyjore dhe biodiversiteti 50
3.2.3. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore 52
3.2.4. Menaxhimi i zonave të mbrojtura 53
3.3. BUJQËSIA 54
3.3.1 Zhvilimi bujqësor dhe rural 54
3.3.2. Kapacitetet e prodhimit bujqësor 54
3.3.3. Zonat e prodhimit bujqësor 55
3.3.4. Kultivimi i bimëve njëvjeëare 56
3.3.5. Kultivimi i kulturave shumvjeëare 57
3.4. AGROBIZNESI 58
3.4.1. Fermat bujqësore 59
3.4.2. Turizmi 59
3.4.3. Komuniteti i biznesit 61
3.4.4. Sektori privat 62
3.5. OBJEKTET 63
3.5.1. Objektet e banimit 63

3.5.2. Kategorizimi i objekteve të banimit 64
3.5.3. *Objektet afariste* 66
3.5.4. *Objektet sportive* 67
3.5.5. *Objektet kulturore* 68
3.6. STREHIMORET DHE OBJEKTET PËR STREHIM 68
3.6.1. *Përcaktimi i lokacioneve (zonave) të grumbullimit në rast fatkeqësie* 68
3.6.2. *Lokacioni,kapaciteti i strehimoreve dhe titullari* 69
3.6.3. *Gjendja estrehimore/objekteve tyre* 70
3.7. KAPACITETET SHËNDETËSORE PUBLIKE DHE PRIVATE 71
3.7.1. *Institucionet Shëndetësore Publike* 71
3.7.2. *Kapacitetet humane shëndetësore* 71
3.7.3. *Kapacitetet teknike reaguese në sektorin publik* 75
3.7.4. *Kapacitetet medicinale private* 76
3.7.5. *Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente:* 76
3.7.6. *Institucionet e Mirëqenies Sociale* 77

KREU I IV-TË 78

4 INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT 78

4.1. RRUGËT (RRJETI RRUGOR DHE QARKULLIMI) 78
4.1.1. *Rrugët e nacionale* 78
4.1.2. *Rrugët rajonale* 78
4.1.3. *Rrugët urbane* 79
4.1.4. *Rrugët në vendbanime lokale* 82
4.1.5. *Siguria në trafik* 83
4.1.6. *Burimet e rreziqeve (Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në infrastrukturën rrugore* 84

4.2. TRANSPORTI HEKURUDHOR 86
4.3. TRANSPORTI AJROR/AEROPORTET 86
4.4. URA DHE TUNELE 87
4.4.1. *Urat* 87
4.4.2. *Tunelet* 87
4.5. SISTEMI ENERGJETIK (OBJEKTET DHE SISTEMET) 87
4.6. LARGPËRÇUESIT DHE TRAFO-STACIONET 88
4.7. SISTEMET E TELEKOMUNIKIMIT 90
4.7.1. *Objektet dhe shërbimet (brenda komunës)* 90
4.7.2. *Personat juridik* 90
4.7.3. *Qendrat telekominikuese transmetuese dhe repetitorët* 92
4.7.4. *TV dhe radiostacionet* 94
4.8. SISTEMET HIDROTEKNIKE 94
4.8.1. *Objektet për furnizim me ujë* 94
4.8.2. *Kompanit rajonale e ujërave (KRU) dhe burimet alternative* 94
4.8.3. *Sistemi i distribuimit të ujit për pije* 95
4.8.4. *Monitorimi i ujërave për pije* 98
4.8.5. *Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor* 99
4.8.6. *Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit* 102
4.8.7. *Rekomandimet* 102
4.9. SISTEMET E SHPËRNDARJES SË GAZIT DHE NAFTËS 102
4.9.1. *Pompat e derivateve;* 102
4.9.2. *Deponitë e derivateve /kapacitetet* 103

KREU I V-TË 105

5. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË 105

5.1. OBJEKTET E SIGURISË 105
5.2. OBJEKTET KOMUNALE DHE QEVERITARE 106
5.3. INSTITUCIONET DHE SHËRBIMET FINANCIARE 106

KREU VI-TË 107

4. LLOJET E FATKEQËSIVE 107

6.1. INTENSITETI, LLOJET DHE NDIKIMET E VEPRIMIT TË FATKEQËSIVE NATYRORE 107
6.2. PRIORITIZIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE BAZUAR NË MATRICËN E RREZIQEVE 109
6.3. MATRICA E GJASAVE 110
6.4. RREZIQET NGA FATKEQËSITË NATYRORE 112
6.4.1. Vërshimet 114
6.4.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet; 115
6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshimeve 118
6.4.4. Kushtet hidrometeorologjike 122
6.4.5. Realizimi i Projekteve mw impakt në parandalimin e vërshimeve 124
6.4.6. Masat Parandaluese dhe rekomandimet 126
6.4.7. Analizë e vlerësimit të venbanimeve më të ndjeshme nga vërshimet (skenarët në aneks) 126
6.5. ZJARRET 135
6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve, ... 136
6.5.2. Kushtet klimatike dhe ndikimi n[shkaktimin e zjarreve 138
6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike 140
6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia, kohëzgjatja e paraqitjes së zjarreve 141
6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga Zjarri 142
6.5.6. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit 143
Masat parandaluese 144
Rekomandimet 145
6.6. TËRMETET 146
6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik 146
6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara , numri dhe struktura e banorëve 147
6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara 147
6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve) 149
6.6.5. Pasojat e tërmeteve 150
6.6.6. Ndikimet sizmike dhe planifikimi sizmik 152
6.6.7. Masat parandaluese 152
Konkluza/rekomandime 153
Skenarët në aneks të vlerësimit
6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET 154
6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve 154
6.7.2. Intensitet dhe shpeshtësinë e paraqitjes 155
6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe erozioni 156
6.7.4. Kushtet klimatike dhe strukturave gjeologjike të tokës 157
6.7.5. Sipërfaqet e përfshira; 158
6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet; 158
Masat parandaluese 159
Skenarët (në shtojcë)
6.8. RESHJET E BORËS,ORTEQET, NGRICAT, MJEGULLAT 160
6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave; 160
6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme 161
6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica; 162
6.8.4. Ngricat dhe mjegullat dezorijentuese 163
6.9. BRESHËRI 164
6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri; 164
6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik; 164
6.9.3. Pasojat nga breshëri; 165
6.9.4. Masat parandaluese 165
6.10. ORTEQËT 166
6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË 166
6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe parametrat e luhatjeve të ajrit 168
6.11.2. Zonat me rrezikshm[ri dhe struktura e goditjes 169
6.11.3 Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e forta dhe stuhitë ; 172

6.11.4. Masat parandaluese; ... 173
Harta e rreziqeve
6.12. THATËSITË ... 174
6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike; ... 174
6.12.2. Dëmet dhe pasojat; ... 175
6.12.3 Rezervat ujore (mbitokësore dhe nëntokësore); ... 176
6.12.4. Masat parandaluese; ... 177
Harta e rreziqeve;
6.13. EPIDEMITË DHE PANDEMITË ... 178
6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale; ... 178
6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve ; ... 179
6.*13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë;* ... 179
6.13.4. *Sëmundjet ngjitëse* ... 180
6.13.5. *Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ;* ... 186
6.13.6. Vlerësimet e bazuara dhe analizat e shërbimeve kompetente ... 187
6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese; ... 187
Harta e rreziqeve;
KREU VII-TË ... 188

7. FATKEQËSITË TJERA ... 188

7.1. VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË TJERA ... 189
7.1.1. Vendi, lloji dhe madhësinë e objekteve për deponimin, përdorimin dhe prodhodhimin e materieve të rrezikshme; ... 189
7.1.2. Cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror; ... 189
7.1.3. Llojet e materieve të rrezikshme; ... 192
7.1.4. Distanca nga zonat e banuara; ... 193
7.1.5. Përqendrimin e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme ... 193
7.1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme/dëmshme në qarkullim; ... 193
7.1.7. Rrjedhja e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë/tubacionet, në rrugët që kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta; ... 194

7.2. FATKEQËSITË NË INFRASTRUKTURËN E FURNIZIMIT ME UJË ... 194
7.2.1. Rreziku nga shpërthimi i pendave hidro-akumuluese, ... 194
7.2.2. Pasojat nga shpërthimi i pendës hidro-akumuluese; ... 195
7.2.3. Raporti vlerësues i matjeve dhe gjendjes së trupit të pendës; ... 197

7.3. VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE RADIOLOGJIKE KIMIKE BIOLOGJIKE ... 198
7.3.1. FATKEQËSITË NUKLEARE DHE RADIOLOGJIKE ... 198
7.3.2. FATKEQËSITË NGA MJETET MINO-EKSPLOZIVE ... 201

7.4. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE ... 203
7.5. VLERËSIMI PËR PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE ... 204
7.6. RREZIQET NË OBJEKTET KOLEKTIVE ... 205

7.7. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË /SMSHN ... 207
7.7.1. SHTABI KOMUNAL PËR EMERGJENCË ... 209
7.7.2. POLICIA E KOSOVËS ... 210
7.7.3. FORCA E SIGURISSË SË KOSOVËS ... 210
7.7.4. DREJTORIA PR MBROJTJE DHE SHPËTIM ... 211
7.7.5. NJËSIA PROFESIONALE PËR ZJARRFIKJE DHE SHPËTIM ... 212
7.7.6. QENDRA OPERATIVE EMERGJENTE-112 ... 212
7.7.7. SHËRBIMET MEDIKALE EMERGJENTE ... 213
7.7.8. SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE ... 213
7.7.9. *KOMUNITETI I BIZNESIT* ... 214
7.7.10. ORGANIZATAT JOQEVERITARE ... 214

KREU I VIII-TË 215
8.1 VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE 215
8.1.1. VLERÊSIMET PËFUNDIMATRE 215
8.1.2. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent 217
8.2.. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT; 217
8.1.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT 220
8.1.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike; 220
8.1.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional; 220
8.1.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre; 220
8.1.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT; 220
9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE 221
10. REKOMANDIME 222
Bibbliografi .....: 222

PARATHËNIE

Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Komunën e Gjakovës, bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.Me këtë dokument identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në në Komunën e Gjakovës si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë. Bazuar në këtë vlerësim, identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin (zbutjen) e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Ky vlerësim shërben si bazament për hsrtimin e Planit Lokal të Reagimit Emergjent (PLRE) si dhe planeve tjera locale, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve, të mirave materiale, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore në Komunën e Gjakovës për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

THEMELIMI I GRUPIT PUNUES

Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, nxjerrë Vendimin për themelimin e Grupit Punues, për hartimin /rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Vendimi i Kryetarit të Komunës për themelimin e grupit punues

Bartës i hartimit të dokumentit:

Komuna e Gjakovës

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me Drejtoritë dhe sektorët tjerë të Komunës

Bashkëpunëtor i Jashtëm Profesional për Shërbime komsulente

Gjakovë, 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01nr 112/2-14739
Dt: 19.09.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e grupit punues për hartimin e dokumentit për vlerësimin e rrezikut, me datë 19.09.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për hartimin e dokumentit për vlerësimin e rrezikut, në këtë përbërje:

1. Pranush Komani – Kryesues
2. Sharr Mullaxhela – anëtar
3. Lekë Stublla – anëtar
4. Kaqun Lima – anëtar
5. Fatos Deda – anëtar
6. Blerta Qelaj – anëtare
7. Përfaqësues i Policisë së Kosovës – anëtar/e
8. Përfaqësues i shoqërisë civile – anëtar/e

2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmerr veprime konform dispozitave ligjore në fuqi, për hartimin e dokumentit për vlerësimin e rrezikut.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Bashkëpunëtor i Jashtëm Profesional
Prof. Msc. Besim F. Meqa

VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS

HYRJE

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT) të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo nga faktori njeri mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore. Dukuritë dhe fenomenet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi, prandaj vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërmarrja e masave, veprimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre është një nga prioritetet e Komunës së Gjakovës.

"Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasiore dhe cilësore të fatkeqësive të shkaktuara nga fenomenet natyrore, proceset teknologjike dhe rrethanat e caktuara tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera [1]

Fatkeqësitë nuk zgjedhin kohen as vendin se ku do të ndodhin. Andaj te gjithë jemi të kërcënuar nga rreziqet e ndryshme që i kërcënojnë interesat e sigurisë në çdo kohë dhe në çdo vend.

Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Gjakovës mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore. Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, në të kaluarën ka pasur shkatërrime dhe humbje të jetës së njerëzve, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë nga **fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.**

Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, Komuna e Gjakovës në të kaluarën ka pasur shkatërrime dhe humbje të konsiderueshme të: jetës së njerëzve, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit, andaj edhe në të ardhmen komuna e jonë mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga proceset teknikо-teknologjike apo faktori njeri. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërë.

Rreziku nga fatkeqësitë natyrore ndër të tjera paraqet një përjetim të humbjes apo dëmit i cili mund të shfaqet në cilin do vend dhe në çdo kohë, intensiteti i të cilit mund të jetë i kufizuar apo me përmasa tragjike, prandaj parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nënkupton zvogëlimin/lehtësimin e rreziqeve, ndërmarrjen e masave lehtësuese, ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe kapaciteteve të nevojshme për të ndërmarrë veprimet e duhura në situata emergjent.

Ky dokument është bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.Komuna e Gjakovës, bazuar në misionin, detyrat, përgjegjësitë si dhe në Rregulloren (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë në bashkëpunim me institucionet lokale dhe ato qendrore, OJQ-të, si dhe palët tjera të interesit, ka hartuar draft/dokumentin: Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë

[1] "Manual profesional për vlerësimin e rrezikut EU CO Founded Project", Bruksel , 2010, faqe 6

Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, përmes të cilës synon identifikimin, vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe zbutjen- zvogëlimin e tyre.

Komuna e Gjakovës është përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë të saj, si përgjegjëse dhe koordinuese e sistemit unik të emergjencave civile lokale, e cila përmban planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha masave dhe aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim brenda juridiksionit komunal.

Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë duhet të rishikohet sipas rregullores në fuqi çdo tri vite e në raste sepcifike edhe më herët. [2]

MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është Vlerësimi, Planifikimi dhe Programimi i veprimit të menduar për menaxhim emergjent, me udhëzime të qarta dhe veprime emergjente të nevojshme dhe me kohë.

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

1. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera përkatëse sipas legjislacioneve në fuqi;
2. Profilizimit dhe standardizimit të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
3. Caktimit të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimit të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente si dhe koordinimit të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente;

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, vlerësimit dhe konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe strategjive afatshkurtra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente me të cilat mund të përballet komuna e Gjakovës.

[2] *Rregullore (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë*

INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE REFERENCAT

Hartimi i "Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera ", në nivel vendi është i bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent dhe planeve tjera**.**

Vlerësimi i Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera është dokument me karakter nacional, hartimii të cilit është i bazuar në:

1. Ligji Nr. 04/L-027 Për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera;
2. Rregullore nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë;
3. Statuti i Komunës së Gjakovës;
4. Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012;
5. Ligji për Pyjet e Kosovës 2003/6), (2004/40) me plotësimet e tij;
6. Ligji për Konservimin e natyrës (2004/41) dhe UA MA-Nr..22/07 për Mbrojtjen e pyjeve nga zjarret;
7. Ligji për transportin tokësorë të mallrave të rrezikshme Nr. 06/L-071;
8. Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor Nr. 02/L-70;
9. Ligji për ndërtim, Nr. 04/L-110;
10. Ligji për pajisjet nën presion Nr. 08/L-031;
11. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-109, për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse" Nr. 08/L-046;
12. Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve" Nr. 04/L-022;
13. Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis"Nr. 03/L-214;
14. Ligji për mbrojtjen e mjedisit" Nr. 03/L-025;
15. Ligji për Konservimin e natyrës (2006/22)
16. Ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore" Nr. 06/L-029;
17. Ligji për rezervat shtetërore të mallrave" Nr. 03/L-244;
18. Ligji për ujrat e Kosovës" Nr. 04/L-147;
19. Udhëzimi Administrativ (MPB)-04/2018-UA, për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategorinë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarri;
20. Rregullore (QRK) Nr. 25/2020 për "Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë"
21. Plani i Reagimit Kombëtar 2010
22. Sistem i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave 2010,
23. Plani Zhvillimor komunal i komunës së Gjakovës
24. Harta Zonale e komunës së Gjakovës
25. Agjencia Kadastrale e Kosovës – Ortofotot e vitit 2018 http://geoportal.rks-gov.net/search
26. Agjencia e Statistikave të Kosovës https://ask.rks-gov.net/
27. Instituti Hidro-meteorologjik i Kosovës , https://ihmk-rks.net/ (https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Vjetari_final_2022-al.pdf)
28. Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Prishtinë Korrik 2016, 24. *Vleresimi i Rreziqeve nga Fatkeqësite Natyrore.pdf (rks-gov.net)*
29. Raportet të ndryshme sektoriale: KRU "Gjakova", KRM "Çabrati", Telekomi i Kosovës, KEDS, Instituti Epidemiologjik i Kosovës, Qendra Rajonale për Punësim, Policia e Kosovës, Spitali Rajonal
30. Softueri Fiks-Kos
31. Manual dhe Udhëzues të ndryshëm.

Kreu I-rë

PROFILI I KOMUNËS SË GJAKOVËS



Harta 1. Teritori i Komunës së Gjakovës

1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës shtrihet në jugperëndim të Kosovës, në pozitën gjeografike 42.39° veri, 20.43° lindje me një sipërfaqe prej 586 km²

Gjakova është qytet me 365 m, lartësi mbidetare, (më e ulëta në Kosovë) ndërsa, në viset malore arrin lartësinë deri në 2305m/lmd, gjë që e bën të kuptojmë se diferenca e reliefit është mjaft e theksuar në një pozitë strategjike në mes të Veriut të Shqipërisë dhe qendrës së Kosovës.

Lidhet me qendrat tjera përmes katër rrugëve magjistrale, ndërsa zënë pjesën qendrore ndërmjet Prizrenit (37 km) ,Pejës (36 km), Bajram Currit (48km) dhe Kukësit (37 km).[3]

Harta 2. Pozita gjeografike e komunës së Gjakovës

Territori i Komunës së Gjakovës përfshinë pjesën Jugperëndimore të territorit të Republikës së Kosovës dhe zë pjesën qendrore të rrafshit të Dukagjinit. E ka formën e vazhduar në drejtim të veriut kah Perëndimi dhe Jugu në drejtim të Juglindjes.[4]

Territori i komunës së Gjakovës ndahet në dy tërësi gjeografike dhe atë:

1. Hapësira e cila shtrihet në drejtim të Jugut, Jugperëndimit dhe Perëndimit nga rruga magjistrale, Ura e Fshenjtë- Gjakovë, Ponoshec-Junik dhe zona kufitare e Shqipërinë.

2. Pjesa e territorit e cila shtrihet në drejtim të Lindjes dhe Veriut nga rruga magjistrale Ura e Fshenjtë-Gjakovë në drejtim të Lumit Drini i Bardhë.



Harta 3. Hapësia në anët e horizontit

1.1 Fusha e përgjegjësisë (përkufizimi hapësinor)

Fusha e përgjegjësisë së territorit të komunës në aspektin e përkufizimit hapësinor në relacion me pjesët tjera të Kosovës

[3] Kosova në vështrim enciklopedik" – Akademia e shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1999 , f. 68,6
[4] " Gjakova" – buletin informativ f.1,2,3, - Kuvendi i Komunës Gjakovë, 2005

dhe jashtë saj, shtrihet me sa vijon: në pjesën veriore kufizohet me Deqanin, Pejën dhe Klinën, në lindje me Rahovecin, dhe në jug me Prizrenin.

Pjesa tjetër e territorit të komunës së Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë në gjatësi prej 57 km, me të cilën ka dy pika kufitare, atë të Qafës së Prushit në Jug - ku lidhet me Regjionin e Hasit (Letaj, Krumë, Kukës, etj.) dhe atë të Qafës së Morinës në Perëndim - që lidhet me Malësinë e Gjakovës (Tropojë, Bajram Curr, etj).

Largësia e territorit të komunës përmes rrugëve magjistrale me shtetet fqinje si Maqedoninë dhe Serbinë është rreth 150 km, me Malin e Zi rreth 60 km, ndërsa, me shtetet tjera të rajonit mbi 250km. Pika më e afërt detare është porti i Shëngjinit (Shqipëri)150 km.

Pasqyra e përkufizimit të komunës së Gjakovës me komunat fqinje të shprehura në km'.

1. Gjakova me Prizrenin 15 km', me relief kodrinoro- malor.
2. Gjakova me Rahovecin 39 km', me relief ujor,
3. Gjakova me Klinën 13km', në relief ujor.
4. Gjakova me Pejën 12km', në relief ujor.
5. Gjakova me Deçanin 25km', në relief malor- ujor (liqeni Radoniqit).
6. Gjakova me Kukësin (RSH) 12 km', në relief malor
7. Gjakova me Bajram Currin (RSH) 45km', në relief malor

Harta 4. Përkufizimi hapësinor me komunat fqinje

1.2. **Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të Komunës së Gjakovës**

Komuna e Gjakovës ka sipërfaqe totale prej 586 km² me 78.669 banorë sipas regjistrimit të fundit të v.2024. Sipas Statutit të Komunës së Gjakovës, territori i saj është i organizuar sipas Rregullores 01 Nr.110/04-46983 të dt.20.12.2019 për "Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat , venbanimet dhe Lagjet Urbane në Teritorin e Komunës së Gjakovës" sipas zonave kadastrale.[5]

[5] Gjakova Municipality – "Local Environmental Action Plan 2009-2015 ", f. 17, Gjakovë 2009

1.3. Lumenjtë dhe liqenet (Hidrografia)[6]



Harta 5. Hidrografia

Territorin e komunës së Gjakovës e përshkon një numër i lumenjve, përrojeve dhe përrockave. Në të shumtën këta janë lumenj malor, të cilët pjesërisht e përkufizojnë këtë hapësirë. Dimrit absorbojnë te reshura të shumta në formë të rrjedhave të shpejta me fuqi të madhe erozive që bartin me vete materiale të shumta.

Numri i burimeve dhe gurrave gjenden në viset malore të cilat kanë rënie të madhe me një shpejtësi dhe forcë erozive duke krijuar kanione, ndërsa në viset e ulëta ato marrin formën e ujërave të qetë dhe kanë të gjitha karakteristikat e lumenjve të rrafshit.

Përkundër rrjedhës mesatarisht të pasur hidrografike sipërfaqësore në disa vise kemi edhe varfëri të ujërave nëntokësore, si psh.: zona e Hasit, gjë që është e kushtëzuar me përbërjen gjeologjike të shkëmbit. Lumi kryesor i këtij territori është Drini i Bardhë.

Përveç se janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të komunës së Gjakovës, resurset ujore duhet trajtuar në kuptimin e fenomenit të vërshimeve të cilat janë relaitivisht të shpeshta gjatë vitit. Është me rëndësi vitale që të shpjegohen nivelet dhe rrëmbyeshmëria e këtyre lumenjëve që përshkrojnë territorin e komunës së Gjakovës në kuadër tyë Pellgut të Drinit të Bardhë.
Lumenjtë që gravitojnë në territorin e komunës së Gjakovës janë:, Ereniku, Krena dhe Llukaci.

[6] Monografi, "Kosova dikur dhe sot", grupi i autorëve, Ekonomska Politika, Beograd ,shkurtë 1973, f. 33,34,

Lumi "Drini i Bardhë"

Lumi "Drini i Bardhë" buron rrëzë malit të Rusolisë nga gurra e shpellës së Radavcit të "Alpet Shqiptare", në 586 m lmd, i cili në pjesën rrafshore të Gjakovës merr formën e një lumi të qetë deri tek gryka e Urës së Fshenjtë, ku kalon nëpër masën gëlqerore duke formuar grykën e Gradishës dhe më tutje del në fushëgropën e Prizrenit (fusha e Anadrinit).

Sipërfaqja e ujëmbledhësit të lumit të Drinit të Bardhë në Kosovë është 4265 km^2, gjarpëron për 122 km në drejtimin veri-jug.

Ai mbledhë me vete edhe ujërat e Lumbardhit të Pejës, Erenikut, e Lumbardhit të Prizrenit me një sipërfaqe prej 4,646 km^2. Baseni i Drinit është më i madhi nga katër basenet ujëmbledhëse të Kosovës.

Drini i Bardhë është lumë që përshkon pjesën më të madhe të Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa territorin e komunës së Gjakovës e përshkon nga Ura e Rakovinës deri në dalje të Rogovës së Hasit.

Ka regjim mesdhetar, me maksimum në mars dhe nëntor, e minimum në maj dhe shtator.

Foto 1. Drini Bardhë

Lumi "Ereniku"

Ereniku është lumi i dytë me madhësi që kalon në territorin e Gjakovës. Buron prej liqenit ukullnajor të Gjeravicës në lartësinë H lmd= 2339, 14 m dhe derdhet në lumin e drinin e bardhë, në lindje tek Ura e Terezive H lmd=309.14m.

Lumi Erenik ka gjatësi L=51.74km' dhe njëherit paraqet pjesën kryesore të pellgut të Drinit të Bardhë me një sipërfaqe prej 519.3 km^2 (në tërë rrjedhën e tij) me prurje të ujit në stacionin hidrometrik tek "Ura e Tabakëve" me Qmes =12.16m^3, në pjesën malore lumi është i gjerë rreth 5 m, gjersa poshtë Junikut në territorin e Gjakovës arrin gjerësinë rreth 10 m, e në viset aluviale deri ne 30 m. Lumi kryesisht është eroziv dhe formon gropa të thella 2-10m. Gjatë tërë vitit ka ujë, por gjatë stinës së Verës sasia e ujit është më e vogël pasi që shfrytëzohet për ujitje në fshatrat e regjionit të Rekës së Keqe kah përshkon ky lumë.

Ky lum për dallim prej degëve të tjera të Drinit të Bardhë më tepër është lumë fushor, meqë 2/3 e pjesës së saj kalojnë në pjesë të ulëta të fushës në lartësi mbidetare 300-500m. Sistemin hidrografik të Erenikut e bëjnë 30 rrjedhje ujore të cilat e begatojnë këtë sistem me sasi më të madhe të ujit (Ereniku i vogël, Gusha, Llabenica, Kapenica, Restusha, Proji i NecTrava, Vogovica, Slepica, Krena, Llukaci dhe Reqica[7].

Foto 2. Burimi i lumit Eremik

[7] http://en.wikipedia.org/wiki/Erenik- *Enciklopedi e shkurtë arsimore*, Third edition (1985); Prosveta; ISBN 86-07-00001-2

Lumi "Krena"

Lumi "Krena" është degë të lumit Erenik dhe vazhdimësi e Bistricës së Lloqanit që rrjedhë nga Bjeshkët e Gjeravicës, i cili emrin Krena e merr në hyrje të fshatit Skivjan të komunë së Gjakovës.Krena është një lumë i cili ka rrjedhë të bujshme me aftësi të bartjes së sasive të mëdha të aluvioneve.
Më poshtë ka një rrjedhë më të qetë me tendencë të ngritjes së nivelit dhe ndryshimit të drejtimit të rrjedhës. Gjatësia e rrjedhës kryesore të lumit Krena është L=36 km' ku një pjesë e madhe e saj përshkon pjesën urbane të qytetit të Gjakovës , duke filluar nga paralarga Dardani, përmes qytetit dhe në dalje poshtë spitalit rajonal "Isa Grezda".

Foto 3. Lumi Krena

Lumi "Llukac"

Lumi "Llukac" buron nga arteriet nëntokësore ujore të Bjeshkëve të Deqanit dhe trajtën e shtratit të lumit e merr në lokacionin në afërsi të liqenit të Radoniqit (përroi i Trakaniqit) duke përshkuar pjesën lindore të komunës së Gjakovës.
Ky lum për nga rrjedha dhe sasia e ujit është dukshëm më i vogël se lumi Drini i Bardhë, Ereniku dhe Krena, por që me rastin e reshjeve masive rrezikon një pjesë të zonës urbane të qytetit dhe fshati Dujakë dhe Skivjan në zonën rurale.
Projektit i rregullimi i shtrtatit të lumit është në fazën e implementimit në tërësinë e saj.

Lumi Llukac derdhet në rrjedhën e lumit Erenik.

Foto 4. Rrjedha e lumit Llukac

Situata aktuale e shtretërve të lumenjve të cekur më lartë është në gjendje jo të mirë, sidomos në rrjedhën e lumit Drini i Bardhë dhe Erenik ku ka nevoj për rehabilitimin e brigjeve të lumenjëve për shmangjen e përmbytjes së tokave bujqësore dhe fenomenit të erozionit dhe humbjes së sipërfaqeve bujqësore. Kohëve të fundit, sidomos gjatë mandatit paraprak, Komuna e Gjakovës ka realizuar punime në rregullimin e shtratit të lumit Krena dhe pjesërisht në segment të lumit Llukac, të cilat më gjasëdo të ndikojnë në parandalimin ose zvogëlimin e pasojave të vërshimeve, rrëshqitjeve të tokës dhe erozionit, veçmas kur bëhet fjalë për zonën urbane.

Liqeni "Radoniqi"

Në territorin e Komunës së Gjakovës shtrihet liqeni akumulues artificial "Radoniqi"i ndërtuar në vitin 1984, me sipërfaqe prej 612 ha të mbuluar me ujë, me kapacitet prej 117 milion m^3 ujë.
Përmes sistemit KRU "Gjakova" bëhet furnizimi me ujë të pijes të pjesës më të madhe të popullatës së komunës së Gjakovës, Rahovecit dhe një pjese të komunës së Prizrenit (paralagja Landovicë) që në total përbën rreth 200.000 banorë, ndërsa sistemi për ujitje përfshinë sipërfaqe 8,070 ha tokë pjellore.
Furnizimi me ujë i liqenit të Radoniqit bëhet nëpërmjet lumit të Bardhë të (Bistrica e Deqanit), nëpërmjet kanalit derivues i cili është ndërtuar prej betoni të armuar në gjatësi L=9,300 m'.

Liqeni akumulues, kryesisht mbushet gjatë muajve: Janar, Shkurt, Mars, Prill dhe Maj kur e arrin edhe kapacitetin më të lartë, ndërsa niveli më i ulët i tij është pas përfundimit të sezonës verore, respektivisht gjatë muajve Shtator dhe Tetor.
Në kuadër të kompleksit të Hidrosistemit të Radoniqit, ekzistojnë objektet vitale si: Diga me kullën kontrolluese dhe portën shkarkuese të ujit, stacionin e filtrave dhe rezervuarët në këto lokalitete: Qerim, Palabardh, Lipovec, Damjan, Dol e Kusar.[8]

Ortofototo 5. Liqeni i Radoniqit/Penda

Pjesa më e madhe e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor në Gjakovës është e mesme me një sipërfaqe prej 23,027.09 ha apo 39.30 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 14,532.63 apo 24.80 % e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore.

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Përqindja %
Ndjeshmëri shumë e ulët e ujërave nëntokësorë	14,532.63	24.80
Ndjeshmëri e ulët e ujërave nëntokësorë	2103.28	3.59
Ndjeshmëri e mesme e ujërave nëntokësore	23,027.09	39.30
Ndjeshmëri e lartë e ujërave nëntokësorë	7817.14	13.34
Ndjeshmëri shumë e lartë e ujërave nëntokësorë	11,109.51	18.96

[8] https//kru-gjakova.com –uplods 2025 Raporti i KRU Gjakova



Harta 6. Hidrologjia e terenit, Burimi: Plani Zhvillomor Komunal 2022-2030

1.4. Karakteristikat tjera gjeografike-gjeologjike-klimatike (reliefi, treguesit hidrologjik, gjeografik, gjeologjik, pedologjik dhe meteorologjik [9]

Hapësira e komunës së Gjakovës i takon pjesës së mesme të Rrafshit të Dukagjinit, kështu që në morfostrukturën e saj kryesisht dominojnë hapësirat e ulëta rrafshore, përveç në pjesën lindore gradualisht rritet në kodrina, respektivisht në vise të ulëta malore. Pjesa e lartë kodrinore përbëhet kryesisht prej shtresave neogjene dhe deluviale të cilat në formë jo të barabartë denodohen, prandaj, kjo paraqet karakteristikë të përgjithshme e cila ndikon që reliefi i komunës të jetë me lartësi jo të barabartë.

<u>Bjeshkët</u> - Rrënjëzat e fundit e malit të Sharrit, shtrihen në jug-perëndim të Gjakovës. Vargu malor në jug-perëndim ka lartësi mesatare në shumë qafa siç janë: Qafa Prushit, Qafa Dobrunës,Qafa e Morinës.

Rrënjëzën jug-perëndimore të fushëgropës së rrafshit të Dukagjinit e përbën Hasi, krahinë kodrinore e cila në drejtim të Gjakovës mbaron me rrafshinën aluviale të lumit Erenik.

Pjesëmarrja e tokës malore me male mbi 1000m/lmd është mjaft e vogël me gjithsej 6.5% të territorit të komunës. Majat më të larta janë në verilindje ku lartësia më e madhe arrin në 2305m/lmd, vargu malor në jugperëndim ka lartësi mesatare.

Në perëndim të Çabratit, vazhdojnë malet e Junikut dhe të Shkëlzenit të cilat i përkasin Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare).

Në veri të Gjakovës shtrihet fusha e "Piskotës" në mes të lumenjve: Krena dhe Llukac.

Vargu malor "Serpentin" (suka e Koznikut, suka e Cermajnit, suka e Baballoqit dhe suka e Hereqit) ndan fushëgropën e Gjakovës nga rrafshi i Dukagjinit. Afër qytetit të Gjakovës gjendet Çabrati e cila është mbeturinë teracës më të ulët të fazës liqenore me lartësi 440 460m/lmd.

Afër grykës së Drinit të Bardhë, ku derdhet Ereniku, shtrihet pëllaja gëlqerore e Gradishës, e cila ndan fushëgropën e

[9] Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Gjakovës 2006-2015+", Kuvendi Komunal Gjakovë, 04/2008

Gjakovës prej asaj të Prizrenit.
Format e krijimit të konfiguracionit gjeomorfologjik dhe periudhat e lëvizjeve epirogjene kanë mundësuar që në territorin e viseve malore të krijohen disa shpella si psh.: shpella e Qiriut, shpella e Bagëtive, shpella e Borës, shpella e Kusarit, shpella e Vodicës etj. Pozita dhe reliefi kanë kushtëzuar që Gjakova me rrethinë të ketë një klimë të mesme kontinentale me elemente mesdhetare. Orografia dhe hidrografia e saj ndikojnë si përcaktues në karakteristikat klimatike, kjo sidomos vërehet në radhitjen e të reshurave, temperaturës dhe erërave.

Komuna e Gjakovës karakterizohet me një klimë kontinentale me verë të nxehtë dhe me dimër mesatarisht të ftoftë, ku muaji më i nxehtë është muaji Gusht dhe muaji më i ftoftë është muaji Janar. Pozita gjeografike e Gjakovës me rrethinë ka kushtëzuar që në këtë regjion të dominojë klima e mesme kontinentale me një ndikim të klimës mediterane, e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë.

Në bazë të shënimeve shumë vjeçare klimatike, lokaliteti i Gjakovës karakterizohet me këto veçanti meteorologjike: Temperatura mesatare vjetore është +11.9 ºC, muaji më i ftohtë i vitit është Janari me temparaturë mesatare -0.1ºC, me akull janë përafërsisht 15 ditë në periudhën e kufizuar Nëntor –Mars, ndërsa numri i ditëve me borë ka rënje dhe viteteve të fundit është max.20 ditë. Ndërsa muajt më të nxehtë të vitit është korrik-gushti me temperatura mesatare +22.2ºC dhe ato maximale deri në 38-40°C e cila njihet si periudha me numrin më të madhe të zjarreve. Temperatura mesatare gjatë vegjetacionit është +18,6ºC ndërsa sasia e reshjeve vjetore 754,8mm por sasia e reshjeve gjatë vegjetacionit është vetëm 342,90mm, derisa në viset malore sasia e reshjeve vjetore arrin 1337 lit/m^2.
Sa i përket erërave, duhet cekur se drejtimin e përcakton vet konfiguracionin i terrenit, kështu që ato janë kryesisht erëra jug-perëndimore.
Marrë në tërësi Gjakova ka klimë të volitshme me lagështi, temperaturë dhe rrezatim mesatar, me erëra të intensitetit mestar që është e volitshme për kultivimin e llojeve të ndryshme të botës bimore, mundëson veprimtari të ndryshme në bujqësi, turizëm, komunikacion etj.[10]

Harta 7. Formacionet pedologjike



5 *Gjeomorfologjia e shkollave të mesme*

2. DEMOGRAFIA

Numri i popullsisë dhe vendbanimet janë indikator i rëndësishëm për demografinë. Për të identifikuar numrin e banorëve janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjensionit të Statistikave të Kosovës të vitit 2024 dhe variablat karahasimore me ato të v.2011. Në këto dy dekadat e para të pasluftës, Komuna e Gjakovës ka trend negativ, /ulje të shtimit natyror, kryesisht për shkak të emigrimit. Me regjistrimin e v.2024 kjo komunë ka 78.669 banor, ose 15.887 banorë më pak se se në vitin 2011 (94.556)[11]. Pasqyrën e banorëve të komunës së Gjakovës, vendbanimet, aspektet gjinore sipas trendeve të zhvillimit të komunës së Gjakovës paraqiten sipas tabela dhe diagrameve më sa vijon:

Tab. 1 Popullsia e Komunës së Gjakovës sipas gjinisë dhe etnive Regj. v. 2024

Gjithsej	Gjinia		Etnia								
Komuna e Gjakovës	Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptas	Goran	Të tjerë dhe të pa deklaruar
78669	39451	39248	72096	15	10	41	536	1074	4708	14	28+147=175

Tab. 2 Popullsia sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe kontingjenteve themelore, regjistr. V 2024

	Popullsia							Popullsia e aftë për punë			
Komuna e Gjakovës	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Foshnje 0 vjeç	Fëmijë 1-6	Fëmijë 7-14	Rinia 15-24	15-64	Meshkuj	Femra	65 +
Gjith.	**78669**	39451	39248	1753	5887	9786	14620	51154	25611	25543	10089
Urban	**41809**	20851	20958	928	3127	5199	7768	27176	13620	13556	5351
Rural	**36890**	18405	18485	825	2760	4587	6852	23978	12006	11972	4738

Numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjare në Komunën e Gjakovës është 4.3 anëtarë për një ekonomi familjare. Gjithsej 18,303 ekonomi familjare janë në komunën e Gjakovës (vt. 2024, ASK).

1. Organizimi teritorial

Komuna e Gjakovës përbëhet nga 91 vendbanime, pjese e 69 zonave kadastrale (sipas agjencionit kadastral të Kosovës), dhe 70 zona kadastrale (sipas ndarjeve praktike të drejtoris së kadastrit Gjakovë) të cilat shtrihen në një territor prej 586 km^2, prej të cilave 2.5 km^2 i takojnë qytetit të Gjakovës brenda në qytet, 23 km^2 Gjakovës jashtë qytetit dhe 3.2 km^2 Zidit të Sadik Agës, duke bërë kështu 28.7 km^2 të zonës urbane.[12]

[11] *Agjensioni Statistikave të Kosovës, Regjistrimi/2024*

[12] *Rregullore nr.01Nr.110/04-46983 Për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në teritorin e Komunës së Gjakjovës, dhjetor/2019*

Tabela 3. Këshillat Lokale Urbane

BL- urbane		Përkufizimi hapësinor
1.	Këshilli Lokal nr. 1	Ish Kombinati Emin Duraku-rr.Gjergj Sokoli-Bardhyl Qaushi-Uçk-Weslesley Clark-Budrumi Verës-Mark Malota-IBT Emin Duraku
2.	Këshilli Lokal nr. 2	Lugu i Balës-Mazllom Myezini-Sabrije Vokshi-Demush Taha-Bajram CurriDërgut Vokshi-Yllka Domi-ana e djatht e lumit "Krena" krahu i djathtë deri në bashkimin me lumin Erenik-Rripe-Kodra Çabratit-Lugu i Balës
3.	Këshilli Lokal nr. 3	Ura e Namazgjasë-Abedin Terbeshi-Nëna Terezë-Musa Zjami-Elton Zherka-Shf. Emin Duraku-Naser Brahimaj-A.P. Tepelena-Ali Pashë Babalia-Avdullah Babalia-Behije Dashi-kryqëzimi Gaspër Karaqi-Ndërmarrja Virxhinia-vendbanimi Ali IBra-Mulliri i Zekës-rr.Skenderbeu-Xhafer Lipoveci-Sadedin Shehu-Haki Taha-Xheladin Hana-lumi Krena-Ura e Namazgjasë
4.	Këshilli Lokal nr. 4	Krahu i djathë: Rr. Uçk- Wesley Clark-Pika e Zezë-Behije Dashi-lumi LLukac-A.P.Tepelena-Naser Brahimaj-Kryqëzimi Nëna Terezë-SH.Emin Duraku-QKMF-Musa Zajmi-NëNa Terezë-Ura Nazagjajasë-lumi "Krena"-Ura Islam Begut"-Ismail Qemali – rr. Uçk.
5.	Këshilli Lokal nr. 5	Veri, në të dy krahët: Fsh. Osek Hylë-rr. Sylejman Abdyli-Dëshmorët e Dujakës-ana përendimore e lumit "Krena"-IMN-rr.Elez Miftari -Gjergj Sokoli-IBT Emin Duraku-Mark Malota-lumi Llukac-Osek Hylë (përfundon te ish fabrika e Lëngjeve)
6.	Këshilli Lokal nr. 6	Pjesa veriore: kryqëzimi Gjergj Sokoli dhe Elez Miftari-krahu i djathtë i rr. Bardhyl Qaushi-Ismail Qemali-Ura Islam Begut-Ismail Qemali-lumi Krena-Yllka Domi-Dërgut Vokshi-Bajram Curri-Demush Taha-Sabrije Bije Vokshi-Mazllom Myezini-Lugu i Balës-Kodra e Çabratit-Varrezat e Martirëve-IMN dhe përmbyllet te kryqëzimi i rrugëve Gjergj Sokoli-Elez Miftari.
7.	Këshilli Lokal nr. 7	Kryqëzimi i rrugëve Skenderbeu-Xhafer Lipoveci, ana e djathtë rr. Skenderbeu-lumi Llukac-Jashar Salihu- Faik Konica-udhëkryqi Esat Stavileci-Pajazit Nushi-kryqëzimi Sadedin Shehu-Xhafer Lipoveci deri tek kryqëzimi rr. Skenderbeu dhe Xhafer Lipoveci.
8.	Këshilli Lokal nr. 8	Ura e Tabhaneve-dy krahët e rr.Xheladin Hana-Haki Taha-krahu i djathë deri te udhëkryqi me rr. Sadedin Shehu-Pajazit Nushi_Esat Stavileci – Ymer Pula duke përfshir krahun e djathtë deri në lumin "Erenik" dhe "Krena deri tek Ura e Tabhaneve.
9.	Këshilli Lokal nr. 9	Ura e Tabakëve mbi lumin Erenik- përrocka Vogovica- rr."5 Prilli 1999"-Domenik Përgegaj- Shf. Z.L.Marku-Ish Koopertaiva Bujqësore-kompleksi i urbanizuar "Lagja Brekoc"-rr. Minatori-kompleksi i varrezave të qytetit-deri në rrjedhën lumit Erenik.
10.	Këshilli Lokal nr. 10	Kryqëzimi Faik Konica-Ymer Pula- vazhdon në lindje të rrugëve Faik Konica-Jashar Salihu deri në anën e djathtë të lumit LLukac-rr.Gaspër Karaçi-Dah Polloshka-Kompleksi Industrial Jugor deri tek lumi Erenik-ura në rr Ymer Pula në kryqëzim me rr.Faik Konica



Harta 8. Përkufizimi hapësinor i Këshillave Lokale Urbane

Tabela 4. Këshillat Lokale Rurale

Këshillat Lokale në pjesën Rurale		Fshatrat që përfshinë
1.	Këshilli Lokal me seli në Molliq	Molliq-Botush-Koshare, Brovinë-Nivokaz
2.	Këshilli Lokal me seli në Ponoshec	Ponoshec-Morinë-Stubëll-Berjahë-Smolicë-Popoc-Shishman-Nec
3.	Këshilli Lokal me seli në Babaj Bokës	Babaj Bokës-Guskë-Devë-Korenicë-Duzhnje
4.	Këshilli Lokal me seli në Brekoc	Brekoc-Vogovë-Zhub-Zylfaj-Firzë-Meje-Orize-Jahoc
5.	Këshilli Lokal me seli në Ramoc	Ramoc-Rrypaj- Madanaj
6.	Këshilli Lokal me seli në Sheremet	Sheremet- Rracaj-Dallashaj-Dobrosh-Pacaj
7.	Këshilli Lokal me seli në Novosell e Ulët	Novosellë e Ulët-Novosellë e Epërme-Palabardh-Trakaniq-Osek Pashë-Janosh-Bitesh
8.	Këshilli Lokal me seli në Skivjan	Skivja-Osek Hilë-Planqor
9.	Këshilli Lokal me seli në Dujakë	Dujakë-Hereq-Dobrixhe-Firaj
10.	Këshilli Lokal me seli në Doblibare	Doblibare-Bordosanë-Vraniq
11.	Këshilli Lokal me seli në Bec	Bec-Lug Bunarë-Qerim

12.	Këshilli Lokal me seli në Cërmjan	Cërmjan-Meqe-Kodrali-Rakovinë-Netic
13.	Këshilli Lokal me seli në Gërgoc	Gërgoc-Rakoc-Zhabel-Bardhaniq
14.	Këshilli Lokal me seli në Jabllanicë	Jabllanicë-Llugaxhi
15.	Këshilli Lokal me seli në Kralan	Kralan
16.	Këshilli Lokal me seli në Bishtazhin	Bishtazhin-Marmull-Kushavec-Smaq-Ujzë-Rezinë
17.	Këshilli Lokal me seli në Rogovë	Rogovë
18.	Këshilli Lokal me seli në Demjan	Demjan
19.	Këshilli Lokal me seli në Lipovec	Lipovec-Gërqin-Goden
20.	Këshilli Lokal me seli në Dol	Dol-Raçë-Moglicë-Kusar-Pjetërshan



Harta 9. Përkufizimi hapësinor i Këshillave Lokale në pjesët rurale

<u>Vendbanimet joformale</u>: Në territorin e Komunës së Gjakovës janë disa venbanime joformale ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyrepër një standard të përshtatshëm të jetesës, si*:*

- Lagja "Kolonia"
- Lagja Brekoci, dhe
- Lagja Piskota

Tabela 5. Numri i banoreve sipas sipas grupmoshave dhe vendbanimeve për komunën e Gjakovës [13]

	2024																		
	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80-84	85+	Gjithsej
GJAKOVË	4 849	5 258	5 622	5 985	6 635	5 672	5 219	4 671	4 714	5 160	5 296	5 030	4 499	3 787	2 818	1 772	1 091	621	78 699
Babaj i Bokës	25	28	33	47	51	38	33	18	30	43	38	23	23	16	18	9	11	3	487
Bardhanio	18	11	17	24	28	23	11	14	11	19	22	16	11	11	5	3	2	2	248
Bardhasan	8	11	12	14	15	16	12	13	9	14	18	20	23	9	8	5	2	6	215
Batushë	35	42	40	49	38	31	46	25	36	34	33	36	37	36	27	17	16	6	584
Bec	70	88	63	71	77	70	68	52	62	58	47	72	64	32	22	16	13	11	956
Beriah	8	11	13	9	9	3	12	9	8	6	11	7	7	7	6	4	2	2	134
Bishtazhin	14	24	20	24	21	22	23	24	24	15	20	16	21	19	11	6	7	6	317
Bitesh	3	6	5	16	13	8	4	4	10	10	10	8	7	3	4	6	3	0	120
Brekoc	209	236	221	223	235	173	157	125	155	149	135	161	140	98	67	37	29	11	2 561
Brovinë	25	33	22	21	23	37	30	25	25	27	27	26	30	21	21	7	9	5	414
Cërmian	55	62	80	66	63	51	62	53	67	48	55	53	49	32	32	27	8	8	871
Dallashaj	15	24	19	17	16	16	14	12	8	12	19	16	9	7	7	6	6	0	223
Damian	404	398	427	385	356	302	302	282	277	248	200	173	135	110	94	54	39	26	4 212
Devë	19	40	29	28	21	17	20	24	19	13	20	24	16	12	16	9	4	4	335
Doblibarë	17	25	35	40	59	35	21	22	20	58	44	41	31	36	15	16	17	6	538
Dobrixhë	7	8	6	6	5	3	6	8	9	6	7	3	4	9	10	3	6	1	107

[13] Agjensioni i Statistikave të Kosovës/2024 - Regjistrimi i Popullatës

Dobrosh	22	27	35	31	29	25	29	27	31	20	20	24	32	21	16	5	5	4	403
Dol	22	34	39	50	60	32	30	24	37	46	60	33	36	30	20	17	11	10	591
Duiakë	25	30	26	45	50	52	33	19	31	21	48	43	26	26	21	10	9	4	519
Duzhnjë	24	28	24	23	36	30	22	18	20	23	21	18	31	14	15	5	2	3	357
Firaië	4	3	4	10	11	8	7	4	10	9	12	12	5	9	6	6	1	1	122
Firzë	11	17	15	34	38	31	16	18	17	35	40	26	22	15	11	11	5	4	366
Fshaj	12	8	9	12	31	28	13	8	12	21	20	30	19	19	5	2	7	4	260
Gërcinë	76	72	99	100	81	58	49	49	61	68	65	44	35	27	17	14	10	2	927
Gërgoc	4	7	20	14	12	11	7	7	8	12	10	16	5	3	7	4	4	2	153
Goden	1	2	4	2	3	3	2	3	1	2	3	1	0	0	0	1	0	0	28
Guskë	3	3	1	1	3	2	4	5	2	2	3	4	5	3	1	1	1	0	44
Gjakovë	2 491	2 662	2 790	3 038	3 323	3 050	2 911	2 678	2 525	2 737	2 692	2 653	2 482	2 255	1 658	1 020	549	295	41 809
Herec	48	56	56	57	64	48	50	48	38	41	59	34	34	17	31	13	10	6	710
Jabllanicë	63	59	59	47	57	61	34	41	44	19	38	31	34	23	16	10	3	2	641
Jahoc	9	11	9	9	23	17	10	8	9	15	14	23	14	14	10	6	3	1	205
Janosh	20	18	20	21	28	13	14	12	18	14	10	20	12	9	8	4	4	3	248
Kodrali	8	12	15	10	9	9	4	9	9	11	8	8	7	6	3	3	2	0	133
Korenicë	18	21	28	22	33	26	33	20	20	26	47	19	30	19	13	15	9	4	403
Koshare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kralan	43	48	76	90	62	33	32	45	58	67	53	35	32	25	22	9	8	9	747
Kusar	6	3	7	7	14	8	8	4	5	3	13	15	9	7	2	2	2	1	116
Kushavec	1	5	6	4	10	4	3	2	7	6	7	13	12	9	3	4	5	0	101
Lipovec	58	54	62	56	74	46	36	39	46	56	54	29	23	16	18	12	6	9	694
Lugbunar	14	11	13	4	11	12	17	12	8	3	11	16	13	14	10	2	2	3	176
Llugaxhi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Madanai	15	14	17	16	17	11	19	18	13	15	9	7	7	14	10	7	0	2	211
Marmull	11	22	31	33	36	31	19	16	21	27	50	28	24	12	12	7	11	5	396
Mejë	26	19	9	15	17	33	24	12	12	14	22	24	17	15	8	7	9	2	285
Mege	5	5	5	10	6	5	4	4	3	8	9	8	11	1	1	5	4	1	95
Moglicë	14	18	18	24	32	26	21	14	17	19	30	27	15	25	19	12	4	4	339
Mollia	42	36	46	39	41	43	26	28	32	40	39	36	18	19	15	18	14	4	536
Morinë	9	9	12	12	8	9	10	7	11	11	12	5	8	7	8	6	3	4	151
Nec	8	10	10	15	19	15	10	11	13	15	17	16	8	7	8	4	2	1	189
Nivokaz	25	27	25	38	42	33	29	17	25	43	37	37	34	19	13	10	11	2	467
Novosellë e Epërme	11	10	14	12	23	26	14	17	5	16	27	34	25	21	18	22	17	4	316
Novosellë e Ulët	19	18	16	21	38	33	17	15	30	24	27	42	23	24	19	11	10	7	394
Orize	2	2	4	10	8	8	5	1	7	10	5	10	6	8	4	1	0	0	91
Osek Hylë	49	67	100	73	92	54	59	55	60	60	61	60	58	43	24	12	5	6	938
Osek Pashë	7	5	7	24	26	17	4	6	10	13	24	18	11	16	8	6	6	6	214

Pacaj	8	10	13	17	15	11	15	10	11	12	11	17	9	10	11	3	5	1	189
Palabardhë	11	8	14	12	20	11	9	7	10	16	15	14	8	14	1	8	4	1	183
Pietërshan	6	9	17	8	5	11	11	6	9	8	10	8	15	6	8	4	3	2	146
Plancor	18	19	23	25	44	33	29	15	8	27	42	50	19	14	14	6	14	1	401
Ponoshec	37	36	40	33	38	31	43	29	25	28	37	28	36	25	21	5	8	5	505
Ponoc	19	16	19	24	32	17	17	11	16	18	23	19	13	3	7	3	3	2	262
Qerim	44	56	46	54	82	56	55	47	46	56	52	52	52	35	32	19	5	13	802
Qerret	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Racë	18	16	15	18	23	31	19	12	14	12	23	25	27	12	7	2	9	3	286
Radonig	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rakoc	0	0	1	3	2	0	1	1	2	2	1	0	2	0	0	0	0	1	16
Rakovinë	23	27	41	36	40	33	22	21	31	27	36	24	8	17	8	4	2	4	404
Ramoc	10	14	13	13	18	15	7	11	14	6	14	12	9	6	3	5	0	0	170
Rashkoc	8	11	18	13	12	9	7	8	7	17	15	5	7	10	4	3	2	0	156
Rogovë	242	262	252	251	336	286	250	234	208	253	260	267	206	137	84	59	37	24	3 648
Rracaj	9	15	11	7	14	10	7	8	11	14	13	8	9	5	4	4	1	1	151
Rrezinë	2	2	9	13	10	3	3	6	5	11	8	9	11	7	11	3	6	3	122
Rrynaj	4	5	4	4	6	11	6	6	2	5	8	11	2	4	2	2	1	0	83
Skivian	96	97	108	115	132	115	105	73	88	106	108	106	90	68	58	36	20	13	1 534
Smaq	6	11	18	25	26	17	8	13	7	26	29	12	22	9	11	8	4	7	259
Smolicë	15	13	25	24	28	21	14	17	13	17	16	9	18	16	11	3	2	4	266
Sopot	3	5	1	4	3	3	1	2	4	6	9	13	7	7	1	5	0	0	74
Stubëll	7	6	5	4	17	16	7	4	4	3	9	6	13	6	6	5	3	2	123
Sheremet	5	4	19	15	12	3	5	6	8	9	13	5	3	2	8	3	3	3	126
Shishman	24	30	26	48	37	28	27	19	27	28	21	24	19	20	8	5	4	2	397
Trakanig	12	13	10	15	30	20	18	6	11	14	28	34	26	21	13	8	7	3	289
Uiz	19	25	24	36	38	16	25	18	21	29	17	9	19	8	7	8	5	1	325
Vogovë	7	10	18	26	29	17	15	13	21	20	27	22	19	23	14	6	4	5	296
Vranig	5	4	7	19	22	13	6	9	9	14	21	10	16	10	4	8	1	5	183
Zvlfai	5	5	3	1	13	6	4	1	3	3	4	3	1	4	3	1	1	0	61
Zhabel	25	20	23	19	22	15	22	15	8	20	12	9	10	10	6	4	2	0	242
Zhdredhë	2	7	21	25	20	11	12	9	17	14	20	18	11	5	4	6	6	3	211
Zhub	1	2	5	9	12	7	3	3	8	7	11	7	2	3	4	7	1	0	92

Burimi: Agjensioni i Statistikave të Kosovës: http//askdata.rks-gov.net/sq/1827ab7a-ebb1-4f73-a6ae-df5

Nga të dhënat e prezantuara më lartë konstatohet se një numër i konsideruar i vendbanimeve rurale, posaçërisht vendbanimet e thella kodrinore – malore kanë depopullim.

2.1. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim

Ndër kategoritë potenciale ndaj të cilave duhet të ketë tretman të veçantë gjatë evakuimit në rast të katastrofave dhe fatkeqësive të mëdha natyrore, veçojmë:

- Nënat me fëmijë foshnje 0 vjeç..... 1.753
- Fëmijë 1-7 vjeç 5.887
- Nxënësit deri në 14 vjeç 9.786
- Të moshuarit mbi 70 vjeç 6.302
- Personat me nevoja të veçanta..... 876
- Personat me çrregullime mendore 2.008
- Persona të verbër dhe shurdhmemec ..... 184 (të verbër 130+54 shurdhmemec)
- Personat me trajtim spitalor 426

Tabela 6. Pasqyra e personave me ç'rregulime mendore

KODI	Diagnoza sipas ICD 10	Numri i pacientëve
F00 – F03	Demenca, Ç'rregullimet mendore organike	1
F10	Çrregullime mendore të sjelljes si pasoj e Alkoolit	/
F11-19	Çrregullime mendore si pasoj e përdorimit të drogave dhe substancave piskoaktive	23
F20- F29	Skizofrenia dhe sëmundjet deluzionale dhe somatoforme	1,841
F30- F39	Çrregullimet e humorit (afektive)	59
F40- F48	Çrregullimet neurotike, të lidhura me stresin apo somatoforme	20
F60- F69	Çrregullimet e personalitetit dhe të sjeljjes	4
F70- F79	Retardime mentale	54
F04-09, 50-59 dhe 80-99	Çrregullimet tjera psiqike dhe çrregullimet e sjelljes	6
	Gjithsejtë:	**2,008**

Burimi: Qendra e Shëndetit Mental, Nëntor/2025

2.2. Dendësia e popullsisë

Komuna e Gjakovës me dendësi mesatare rreth 134.2 banor/km², bënë pjesë në komunat me dendësi relativisht të lartë të banimit në Kosovë. Dendësia e popullsisë në Gjakovë është e ndryshme në vendbanimet e kësaj komune, ku në radhë të parë është e lidhur me kushtet natyrore, shoqërore- ekonomike etj. Pjesët më të banuara janë ato të ulëta fushore, që kanë ndikuar lidhjet e mira gjeokomunikative me komunat tjera, duke përmendur kushtet klimatike, ujërat dhe tokat produktive. Dendësi më të madhe të banorëve për km^2 e kemi në zonat urbane të qytetit respektivisht në segmentet që gravitojnë rreth qendrës së qytetit e cila në përbërjen e saj ka shumë ndërtesa të banimit kolektiv me etazhitete prej 5-10 kate, e cila dendësinë

mesatare arrin deri në 1200-2500 banorë për km^2, gjë që e bën këtë pjesë të territorit më të ndjeshëm ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive të mundshme (Qendra, Blloku i Ri, Qyteti i Vjetër dhe lagjet që shtyrihen në veriperëndim dhe jugpëerendim të qytetit). Pjesët periferike të qytetit janë dukshëm më pak të dendura se pjesa e urbane dhe dendësia sillet maksimum 100-500 banor/m². Ky trend i dendësisë vazhdon duke rënë në fshatrat e komunës së Gjakovës, deri sa në vendbanimet e thella ruarale dendësia mesatrare është 10 banor/m² Nëse analizojmë në përqindje, në dy dekadat e fundit vërehet një trend i shpopullëzimit të fshatrave në radhë të parë për shkak të emigracionit dhe dyndjes së banorëve në pjesën e urbane të komunës. Sipas regjistrimit të v. 2024, nga numri i përgjithshëm i banorëve të Komunës 78.699, në pjesën urbane jetojnë 41,809 ndërsa në atë rurale 36890 banorë. **[14].**

Harta 10.. Dendësia e popullsisë për m^2



[14] PZHK Gjakovë 2022-2030, Kap. 2.2. Zhvillimi Demografik

Tabela 7. Trendi i banorëve në komunë

Popullata e Gjakovës ndër vite 1948-2024								
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
URBAN	*23,335*	*26,173*	*32,310*	*46,002*	*60,783*	*80,584*	*68,702*	41809
RURAL	*16,663*	*18,242*	*20,960*	*25,372*	*31,420*	*34,412*	*25,859*	36890
TOTAL	**39,998**	**44,415**	**53,270**	**71,374**	**92,203**	**114,996**	**94,561**	**78,669**

2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në komunën e *Gjakovës*[15]

Komuna e Gjakovës është njëra ndër komunat që dallohet për strukurë homogjene etnike, ku shumcën dërrmuese e përbëjnë banorët e etnitetit shqiptar.

Tabela 8. Përkatësia etnike e popullsisë në komunën e Gjakovës

Shqiptar	**72,096**
Serb	**15**
Turq	**10**
Boshnjak	**41**
Rom	**536**
Ashkali	**1,074**
Egjiptian	**4,708**
Goran	**14**
Të tjerë dhe të padeklaruar	**175**
Numri i Përgjithshëm	**78,669**

Grafiku 1. Popullatës sipas etnive



[15] *Agjensioni i Statistikave të Kosovës: http//askdata.rks-gov.net/sq/1827ab7a-ebb1-4f73-a6ae-df5*

2.2.2. Të punësuarit, të papunët, pensionistët dhe asistenca sociale

Sipas ATK- së numri i të punësuarve në Komunë të Gjakovës është rreth 4680 biznese me 8856 të punësuar persona.

Numri i të punësuarve në bizneset private është mesatarisht 3 të punësuar për biznes, gjë që tregon se sektori privat dominohet nga biznesi i vogël. Ndërsa, sipas kategorizimit të numrit të punëtorëve, 85% e kompanive kanë nga 0-5 punëtorë, ndërsa vetëm 12.5% e kompanive kane nga 6- 20 punëtorë.[16]

Graiku 2. Kategorizimi i kompanive sipas numrit të të punësuarëve



Ndërmarrjet ekonomike sipas pronësisë, venbanimeve dhe sektorëve ekonomik

Sipas të dhënave të ATK- së, në komunën e Gjakovës kanë qenë aktive 3459 biznese, prej të cilave 80% biznese individuale dhe 17% SH.P.K.



Grafiku 3. Biznese në % sipas llojit të subjektit afarist

[16] Plani Zhvillmor Komunal 2022-2030, f..57,59

Papunësia është një ndër problemet me të cilin më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon, e cila ka shënuar një rënie domethënëse kohëve të fundit, kryesisht të ndikuar nga emigrimi i të rinjëve dhe të politikave të punësimit në nivel vendi. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune.

Punësimi dhe punëkërkuesit (struktura e moshës, gjinisë dhe nivelit shkollor) [17]

Tabela 9. Punëkërkuesit sipas moshës dhe gjinisë - regjistruar AKTIV deri me 30.09.2025 –Bujrimi: Zyra e Punësimit Gjakovë

Grup mosha	Totali	Femër	Mashkull
15 - 24	456	241	215
25 - 29	492	254	238
30 - 39	948	495	453
40 - 54	1,048	519	529
55 +	328	155	173
Totali	**3,272**	**1,664**	**1,608**

Grafiku 4 Punëkërkuesit sipas grup moshës



Tabela 10. Punëkërkuesit sipas nivelit të shkollimit dhe gjinisë (Burimi i të dhënave: Punëkërkuesit të regjistruar – AKTIV -

Niveli i edukimit	Totali	Femër	Mashkull
Pa kualifikuar	1,151	596	555
Klasët I - IX (Shkolla fillore)	939	446	493
Arsim i mesëm profesional	664	276	388
Shkollë e mesme - gjimnaz	239	123	116
Bachelor	253	169	84
Master	26	17	9
PhD	-	-	-
Total	**3,272**	**1,627**	**1,645**

[17] Qendra Rajonale për Punësim, nëntor/2025 – Njësia Gjakovë

Grafiku 5. Pënëkërkuesit sipas nivelit të shkollimit

Tabela 11. Punëkërkuesit sipas përbërjes etnike dhe gjinisë (Burimi i të dhënave: Punëkërkuesit të regjistruar - AKTIV QP/2005

Etniciteti	Totali	Femër	Mashkull
Shqiptar	2,051	1,258	1,243
Serb	0	0	0
Boshnjak	0	0	0
Rom	105	46	59
Ashkali	193	95	98
Egjiptas	338	174	164
Malazez	1	1	0
Turk	1	1	.
Tjetër	95	35	60
Totali	**3,272**	**1,627**	**1,645**

Tabela 12. Numri i të punësuarve sipas gjinisë përmes Zyrës së Punësimit

Gjinia	Numri i të punësuarve	%
Meshkuj	77	46.6 %
Femra	88	53.4 %
Gjithsejtë	**165**	

Grafiku 6. Përkatësia etnike e punëkërkuesëve



Asistenca sociale

Grafiku 7. Numri i përfituesëve të asistencës sociale, periudha 2020-2024



Tabela 13. Tabela e përfitueseve të asistencës 2020/2024 [18]

Viti	Numri i familjeve	Numri i antarëve	Shënim
2020	1001	4060	
2021	1044	4227	
2022	1043	4221	
2023	1057	1057	
2024	978	3918	

Sipas analizës së të dhënave vjetore për periudhën 2020-2024, vërehet një ulje graduale e numrit të familjeve përfituese të skemës së ndihmës sociale në kounën e Gjakovës. Kjo rënje kryesisht lidhet kryesisht me factor strukturorë dhe socio-ekonomik, si:

1. Pilotimi i reformës së asistencës sociale,
2. Migrimi jashtë vendit,
3. Rritja e punësimit dhe përfshirja në tregun e punës,
4. Ndryshimet demografike dhe rishikimet periodike administrative

[18] DSHMS/Komuna Gjakovë, 2025 – Qendra për Punë Sociale

2.3. Arsimi

2.3.1. Institucionet arsimore [19]

2.3.1. Institucione të arsimit parashkollor

Në Komunë aktualisht janë 6 institucione vijuese publike të arsimit parashkollor, prej të cilave 5 shtrihen në zonën urbane dhe 1 në fshat:

1. "Deve" në rrugën "Nena Terezë";
2. "Kosovatrans" në rrugën Rr. "Tivari";
3. "Komoni" në rrugën "Mithat Frashëri";
4. "Orize" në rrugën "Anton Çetta";
5. "Multi-Etnike" në rrugën " Q. P. Multi-Etnike";
6. Fshati Rogovë

Në nstitucionet publike të arsimit parashkollor aktualisht janë

- ✓ Të regjistruar 438 fëmijë;
- ✓ Të punësuar 43 edukatorë;

Në vijim janë paraqitur veçoritë për secilin institucion publik të arsimit parashkollor:

Tabela 14. Veçoritë aktuale për secilin institucion publik të arsimit parashkollor

Vendbanimi	Emri I institucionit	Numri I fëmijëve	Edukatorë (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m^2)	Etazhiteti (P)	Numri i klasave	Vend parkingjet për vizitor	Vend parkingjet për zyrtar
Gjakove - Rr. "Nena Terezë"	01 "Deve"	113	11	0.08	0.04	0.04	470	P	6	0	0
Gjakove - Rr. "Tivari"	02 "Kosovatrans"	90	9	0.64	0.09	0.55	400	P	4	0	0
Gjakove - Rr. "M.Frasheri"	03 "Komoni"	48	6	0.07	0.01	0.06	182	P	3	0	0
Gjakove - Rr "A. Çetta"	04 "Orize"	172	16	0.6	0.06	0.54	565	P	7	0	2
Gjakove - Rr. "Q.P.M.Etnike	05 "Multi-Etnike"	15	1	0.07	0.04	0.03	100	P	1	0	0
Fshati Rogovë				0.593	0.19	0.403	1717.22		21	0	2
Gjithsejtë		**438**	**43**								

[19] Drejtoria për Arsim, Komuna e Gjakovë, nëntor/2025
Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030

2.3.2. Institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët

Në Komunë aktualisht 44 institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 9 paralele të ndara, nga të cilat:

- 32 institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët shtrihen në zonë rurale;
- 2 paralele të ndara shtrihen në zonë rurale;
- 9 institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët shtrihen në zonë urbane;
- Në 43 institucionet publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët aktualisht janë:

Të regjistruar 9,786 nxënës, 5,544 në zonën rurale dhe 4,242 zonën urbane;

Të punësuar 847 mësimdhënës/e, 371 në zonën rurale dhe 476 në zonën urbane;
Në vijim janë paraqitur veçoritë për paralelet e ndara të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonë urbane:

Tabela 15 . Veçoritë aktuale për secilin institucion publik të arsimit fillorë dhe të mesëm të ulët në zonën urbane

Vendbanimi	Emri I institucionit	Numri I nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m^2)	Etazhiteti (P)	Numri i klasave	Vendparkingjet për vizitor	Vendparkingjet për zyrtar
Gjakovë	"Emin Duraku"	494	34	3.00	0.5	2.5	3,194	P+1	17	0	0
Gjakovë	"Fehmi Agani"	511	37	0.95	0.3693	0.5827	3,693	B+P+1	17	0	5
Gjakovë	"Kelmend Rizvanolli"	594	29	0.25	0.1387	0.1113	1,387	2	11	0	0
Gjakovë	"Mazllum Këpuska"	391	28	0.41	0.152	0.258	2,786	P+1	20	0	0
Gjakovë	"Mustafa Bakija"	978	51	0.80	0.24	0.56	2,485	P+1	19	0	1
Gjakovë	"Selman Riza"	488	42	1.60	0.16	1.44	2,940	2	19	0	5
Gjakovë	"Zekeria Rexha"	1314	96	5.51	0.35	5.16	1,575	P+1	21	15	30
Gjakovë	Konvikti "S. Stavileci"	102	2	0.92	0.16	0.76	1,600	P+2		0	1
Gjakovë	Yll Morina	672	52	1.61	0.19	1.42	4,986	P+3	24	1	10
Gjithsejtë		**5544**	**371**	**15.05**	**2.26**	**12.79**	**24,646**		**148**	**16**	**52**

Në vijim janë paraqitur veçoritë për secilin institucion publik të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonë rurale:

Tabela 16. Veçoritë aktuale për secilin institucion publik të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonën rurale

Vendbanimi	Emri I institucionit	Numri I nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m²)	Etazhiteti (P)	Numri i klasave	Vendparkingjet për vizitor	Vendparkingjet për zyrtar
Baba i Bokës	"Zenel Sadiku"	71	13	0.57	0.05	0.52	513	P	5	0	0
Bardhaniq	"Dëshmorët Dushkajës"	85	13	1.80	0.08	1.72	850	P	6	0	0
Bec	"Ahmet Rrustemi"	143	12	0.46	0.07	0.39	955	P+1	8	0	0
Berjah	"Bajram Sadriu"	66	12	0.60	0.05	0.55	565	P+1+NK	10	0	0
Bishtazhin	"Gjergj Fishta"	102	17	0.65	0.07	0.58	1,460	P+1	10	0	0
Brekoc	"Zef Lush Marku"	350	31	1.00	0.13	0.87	2,006	P+1	23	15	3
Cermjan 1	"Ali Hasi"	163	19	1.72	0.05	1.67	812	P+1	8	18	10
Cermjan 2	"Ali Hasi"	45	6	0.41	0.03	0.38	348	P	5	3	5
Demjan 1	"Durak Ahmeti"	309	26	1.34	0.06	1.28	1,032	P+1	8	3	3
Demjan 2	"Pjetër Bogdani"	194	15	0.70	0.07	0.63	1,400	P+2	9	0	10
Demjan 3	"Kongresi Manastirit"	193	14	0.35	0.06	0.29	669	P	7	0	0
Doblibare	"Dëshmorët Lleshi"	84	12	1.59	0.07	1.52	1,349	P+1	7	0	0
Dobrigje	"Rilindja"	25	12	2.70	0.05	2.65	370	P	6	0	4
Dol	"Anton Çeta"	134	14	1.00	0.06	0.94	734	2	8	10	10
Dujakë	"Fan Noli"	85	11	2.22	0.06	2.16	1,200	P+1	8	4	4
Gerçinë	"7 Shtatori"	127	15	0.34	0.06	0.28	1,006	B+P+2	10	0	0
Goden	"Malush Stavileci"	4	4	0.48	0.03	0.45	289	P	4	0	0
Guskë	"Pjetër Muqaj"	41	14	1.84	0.06	1.78	581	P	10	0	7
Hereq	"Dëshmorët e Hereqit"	109	18	1.03	0.06	0.97	996	P+1	12	0	0
Korenicë	"Luigj Gurakuqi"	86	12	0.76	0.11	0.65	445	P	5	0	4
Kralan	"8 Dëshmorët"	106	15	1.40	0.05	1.35	440	P	6	0	0
Lipovec	"Shaban Golaj"	159	12	1.38	0.05	1.333	930	P+1	9	0	0
Molliq	"Jahë Salihu"	178	16	1.27	0.10	1.17	1,763	P + 1	13	0	0
Novosellë e Epërme	"Shtjefën Kurti"	44	9	0.70	0.09	0.61	913	P	6	1	1
Novosellë e poshtme	"Engjëll Gjoni"	78	15	2.00	0.07	1.93	900	P+1	9	2	5
Osek Hilë	"Isa Boletini"	160	14	1.70	0.15	1.55	980	P	6	0	0
Ponoshec	"Ganimete Tërbeshi"	123	12	0.54	0.5	0.04	840	P+1	9	0	0
Ramoc	"Ardhmëria"	85	14	1.58	0.7	0.88	70	1	6	4	6
Rogovë	"Haxhi Hoti"	440	33	1.51	0.106	1.404	1,060	3	12	0	0
Sheremet	"Dy Dëshmorët"	137	14	0.93	0.1	0.83	1,309	P+1	12	0	0

Shqiponjë	"Dëshmorët e Kombit"			0.84	0.05	0.79	540	P	6	3	7
Skivjan	"Ukshin Miftari"	198	15	1.00	0.2	0.8	3,600	2	23	2	2
Smolicë	"Sylejmon Vokshi"	82	12	1.54	0.05	1.49	598	P	6	0	0
Gjithsejtë		**4208**	**470**	**37.95**	**3.50**	**34.46**	**31,522**		**292**	**65**	**81**

Në vijim janë paraqitur veçoritë për paralelet e ndara të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonë rurale:

Tabela 17. Veçoritë aktuale për paralelet e ndara të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonën rurale

Vendbanimi	Emri I institucionit	Numri I nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m^2)	Etazhiteti (P)	Numri i klasave	Vendparkingjet për vizitor	Vendparkingjet për zyrtar
Ujz p. e ndare	"Gjergj Fishta"	18	4	0.65	0.03	0.62	156	P	2	0	0
Vogove p. e ndare	"Zef Lush Marku"	16	2	0.60	0.04	0.56	330	P	5	0	0
Gjithsejtë		**34**	**6**	12	0	12	2,983		29	4	2

2.3.3. Institucione të arsimit të mesëm të lartë

Në Komunë aktualisht janë 6 institucione vijuese publike të arsimit të mesëm të lartë, të cilat shtrihen në zonë urbane:

1. "Hajdar Dushi";
2. "Kadri Kusari";
3. "Nexhmedin Nixha";
4. Shkolla e Muzikës "Prenk Jakova";
5. "Hysni Zajmi";
6. Gjimnazi "Asllan Berisha".

Në Komunë aktualisht janë 3 paralele të ndara të institucione publike të arsimit të mesëm të lartë, të cilat shtrihen në zonat vijuese rurale:

1. Ponoshec;
2. Cermjan;
3. Bishtazhin.

Në 6 institucionet publike të arsimit të mesëm të lartë aktualisht janë:

- Të regjistruar 3,240 nxënës;
- Të punësuar 313 mësimdhënës/e;
- Të pajisura me 131 klasë.

Në vijim janë paraqitur veçoritë për secilin institucion publik të arsimit të mesëm të lartë:

Tabela 18.. Veçoritë aktuale për secilin institucion publik të arsimit të mesëm të lartë-urbane

Vendbanimet	Emri I institucionit	Numri i nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m²)	Etazhiteti (P)	Numri i klasave	Vendparkingjet për vizitor	Vendparkingjet për zyrtar
Gjakovë	"Hajdar Dushi"	766	64	1.07	0.3	0.77	6,777	P+2	21	0	0
Gjakovë	"Kadri Kusari"	517	63	1.18	0.11	1.07	2,577	P+1	20	0	0
Gjakovë	"Nexhmedin Nixha"	536	58	0.90	0.13	0.77	3,002	P+1	24	0	0
Gjakove	Sh.muzikes 'Prenk Jakova'	468	42	0.35	0.1	0.25	1,700	P+2	27	10	2
Gjakovë	"Hysni Zajmi"	884	72	0.65	0.14	0.51	4,191	B+2	15	0	0
Gjithsejtë		**3171**	**209**	4.96	0.87	4.09	19,197		116	26	2

Në vijim janë paraqitur veçoritë për paralelet e ndara të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë në zonë rurale:

Tabela 19.. Veçoritë aktuale për paralelet e ndara të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë

Vendbanimi	Emri I institucionit	Numri i nxënësve	Numri i mësimdhënësv	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (m²)	Etazhiteti (P)	Numri i	Vendparkin gjet për	Vendparkingje t për
Cermjan	Gjimnazi (Paralele e ndarë)	15	2	0.77	0.06	0.71	250	P+1	4	0	0
Rogovë	Gjimnazi"Asllan Berisha"	54	12	0.81	0.09	0.72	950	P+1	9	16	0
Gjithsejtë		**69**	**14**	2	0	2	1,450		15	0	0



Harta 11. Harta e shtrierjes së objekteve shkollore

2.3.4. Identifikimi i rreziqeve

Ekzistojnë mbi 60 objekte shkollore në arsimin parauniversitar të cilave shumica ju mungojnë shkallët emergjente për evakuim të nxënësve, ku në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera, ku mungojnë edhe shenjëzimet themelore informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, në rast të çfaqjes së nevojës për evakuim emergjent, ku mungojnë pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera si dhe edukimi bazik për reagim emergjent.

2.3.5. Rekomandime :

Për zvogëlimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si zjarri, vërshimet etj. në objektet arsimore rekomandohet që të pajisen të gjitha shkollat:

- Daljet emergjente alternative;
- Shkallë evakuimi për të gjitha objektet me 2 ose më tepër etazha;
- Shenjëzimi i kahjeve dhe drejtimeve për evakuim të shpejtë ;
- Pajisja me aparate kundër zjarrit, veshje mbrojtëse dhe vegla tjera për raste të fatkeqësive natyrore;
- Pajisja e objekteve me sinjalistikë për lajmërim të zjarrit dhe fatkeqësi tjera ;
- Hartimi i Planit të evuakimit në shkolla, për përballje me fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera , etj.;
- Mbajtja e ushtrimeve me nxënësit dhe personelin shkollor me qëllim të testimit të aftësive për veprim në situata emergjente;

Kreu i III-të
TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT

3.1. Trashëgimia kulturore

Asetet e trashëgimisë kulturore

Territori i Komunës së Gjakovës është mjedis jetësor historik që karakterizohet me trashëgimi të pasur kulturore material dhe jomateriale të krijuar në harkun kohorë në kontinuitet nga parahistoria dhe deri sot. Kjo trashëgimi kulturore është pjesë integrale e peizazhit në të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale dhe, formëson një mozaik të pasur të kulturës tradicionale të praktikuar ndër breza e mileniume.

Mozaiku i pasur i kulturës tradicionale të Komunës së Gjakovës, në gërshetim me elemente eklektike të shekujve, paraqitet në variacione të pasuar arkeologjike, arkitekturore, peizazhe kulturore, të luajtshme, dhe jomateriale/shpirtërore. Ky sfond në vete ngërthen vlera unike dhe shumë-dimensonale në aspektin e interesit historik, artistik, estetik, kulturor, shoqëror, shkencor, teknologjik, ekologjik, ekonomik, politik, etj. Si potencial cilësohet pasuri e përbashkët e njerëzimit me vlerë dhe rëndësi të interes nacional për identitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Prandaj, ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore përcaktohet si detyrim kushtetues i shoqërisë bashkëkohore për brezat pasardhës që, realizohet përmes detyrave dhe kritereve ligjore të përcaktuar për institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore dhe atyre të planifikimit dhe të zhvillimit territorial, gjithherë në përputhje me standard profesionale bashkëkohore.[20]

Harta 12. Institucionet administrative



[20] Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030
Kultura dhe Arti i Qytetit të Gjakovë ”- http://kk.rks-gov.net/gjakove/City-guide/Culture.aspx,

Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të RKS, MKRS (Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit) me Vendim nr. 69/2016 të dt. 10.10.2016, dhe Vendim nr. 110/2018, dt. 03.10.2018, në Lista e Trashëgimisë Kulturore të RKS, nga sfondi trashëgimisë kulturore të Komunës së Gjakovës vendosi në mbrojtje 195 asete, duke përfshirë kategoritë:

1. Trashëgimi arkitekturore, 149 asete, në përbërje sipas tabelës me poshtme;
2. Trashëgimi arkeologjike, 35 asete, në përbërje sipas tabelës me poshtme;
1. Trashëgimi të luajtshme,10 asete, në përbërje sipas tabelës me poshtme;
2. Trashëgimi shpirtërore, 2 asete në përbërje sipas tabelës me poshtme;

Tabela 20. Trashëgimia kulturore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore

Trashëgimia kulturore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore		
Kategoritë	Numri	Sipërfaqja (ha)
Trashëgimia arkitekturale	138	43.08
Trashëgimia arkeologjike	42	9.57
Pejzazhet kulturore		/
Zonat e veçanta te mbrojtura		/
Gjithsej	**180**	**52.65**

Tabela 21. Trashëgimia arkitekturale- Monumentet arkitekturale, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore.

Trashëgimia arkitekturale- Monumentet arkitekturale, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore,			
Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Shtëpi e familjes Bakija		x	0.03
Tersija Urbanistike " Çarshija e Madhe"		x	34.00
Muzeu Etnografik		x	0.10
Shtepia e vjeter e Jelen a Jakiqit		x	0.02
Ura e Tabakeve		x	0.10
Ura e Taliqit		x	0.12
Kisha e te Ngjitur it e Zonjes ne Qiell		x	0.05
Shtepia e Naim Zajmit *		x	0.02
Kulla e Hysni Koshit		x	0.03
Kulla e Sylejman Vokshi		x	0.03
Ura e Fshejt		x	0.25
Muzeu i muzikes Tophanja		x	0.15
Kompleksi 'Hani I Haraqise'		x	0.20
Kulla e Sahatit		x	0.02
Kulla e Abdullah Pashe Drenit		x	0.03
Kulla e Mehmet Hanes		x	0.03
Shtepia e Ali Vokshit		x	0.04
Kulla e Ibrahim Dyles		x	0.02
Kulla e Astrit Kryeziut		x	0.03

Kulla e Currit		x	0.03
Kompleksi"Qarshia e Jupave		x	0.20
Shtepia Beqir (Avdush) Haxhibeqiri		x	0.04
Shtepia e Dobrunave- Polloshka		x	0.02
Shtepia tradicionale e Abaz Manxhukes *		x	0.03
Shtepia tradicionale e Rex hep Qarrit		x	0.02
Shtepia tradicionale e Mazllom Zherkes		x	0.03

Shtepia tradicionale e Xhafer Grezdes		x	0.04
Shtepia tradicionale e Basri Kryeziut		x	0.05
Lidhjes se Prizrenit		x	0.10
Kisha katolike e Shen Andonit		x	0.10
Kisha e Shen Palit dhe Shen Pjetrit		x	0.30
Teqja e Sheh Nakise		x	0.05
Teqja e Babes Ali		x	0.03
Teqja e Sheh Lites		x	0.05
Teqja e Madhe		x	0.05
Teqja e Sheh Banit		x	0.03
Tyrbja e Sheh Qylit		x	0.03
Tyrbja e Sheh Fetahut me varreza		x	0.15
Tyrbja e Sheh Shpetimit		x	0.03
Tyrbja e Tahir Efendis me varreza		x	0.05
Teqes Bektashive		x	0.05
Tyrbja e Shtate Qikave (varrezat e motrave Bejtullahu)		x	0.10
Tyrbja e Babes Hasan		x	0.03
Mejtepi i Halil Efendise		x	0.05
Mejtepi Ruzhdije - Shkolla e pare shqipe		x	0.03
Mejtepi i Haxhi Ymerit		x	0.05
Medresa e Madhe		x	0.10
Medresa e Vogel		x	0.10
Xhamia e Gerqarve		x	0.06
Xhamia e Mulla Jusufit		x	0.01
Xhamia e Kusarit		x	0.07
Xhamia e Haxhi Ymerit		x	0.08
Xhamia e Mahmut Pashes		x	0.09
Xhamia e Sefes		x	0.08
Normalja e Gjakoves- Fakulteti i Edukimit ne Kompleksin e Carshise se Madhe		x	0.20
Kompleksi dhe Shtatorja e Sylejman Vokshit		x	0.10
Hamami		x	0.30
Tyrbe Qabrat		x	0.10
Shtepia e Tahir Bakallit		x	0.06

Shtepia e lsmet Zhaveli		x	0.02
Shtepia tradicionale e Osman (Hysen) Ponoshecit		x	0.03
Shtepia tradicionale e familjes Hoxha *		x	0.02
Shtepia tradicionale e Bedri Shytit		x	0.03
Shtepia tradicionale e Bashkesise lslame ne Rr. Mithat Frasherit P+1		x	0.05
Shtepia tradicionale e Bashkesise lslame		x	0.03

Xhamia e Hankes		x	0.05
Shtepia tradicionale e Rushit Kpuskes		x	0.03
Shtepia e Familjes Qerkezi- Muzeu historik '99		x	0.05
Shtepia tradicionale e Avdramon Domi *		x	0.06
Tyrbja e Babes Ramadan		x	0.02
Tyrbja e Sheh Rames		x	0.03
Shtepija Tradic i onale e Nimon Ferizit		x	0.06
Shkolla e vjeter e muzikes		x	0.10
Xhamia e Re		x	0.20
Kulla e Shain Dules		x	0.02
Varri i Sylejman Vokshit		x	0.03
Varri i Maxhar Pashes		x	0.05
Shtepia e Flamur Bakise		x	0.04
Shtepia e Avdyrrahmon Zhubit		x	0.07
Minarja e Xhamise Gece		x	0.02
Tyrbja e Familjes Mulliqi		x	0.03
Shtepia e familjes Buza *		x	0.05
Shtepia e familjes Nuka *		x	0.03
Tyrbja e Thait		x	0.03
Tyrbja e Sheh Beqirit		x	0.02
Kisha e Shen Jozefit		x	0.15
Kulla e Hazir Sadikut		x	0.03
Teqja e Sheh Eminit		x	0.05
Teqja e Sheh Danjollit		x	0.06
Ura e Terzive		x	0.10
Kisha e Zonjes Rruzare		x	0.30
Xhamia e Hasan Ages		x	0.15
Kulla e Bajram Selmanit		x	0.10
Kulla e Ymer Poges		x	0.03
Kisha e Shen Markut		x	0.02
Kulla e Ethem Godenit		x	0.05
Kulla e lbish Alise *		x	0.06
Kulla e Rame Zeqe Brovines		x	0.02
Kulla e Gani (Elez) Mehmetit		x	0.03
Tyrbja Pule		x	0.06
Kisha e Zonjes Mari		x	0.10
Kisha katolike e Shen Bumit		x	0.04
Mulliri i Cermjanit		x	0.03
Kulla e Ages		x	0.05
Tyrbja dhe Xhamia e Sukes se Cermjanit		x	0.15
Kulla e lsa Zymber Binakaj		x	0.03
Kulla e Ahmet Islamit		x	0.02

Kulla e Arif Muses		x	0.02
Kulla e Sahit Avdylit		x	0.03
Tyrbja e Dervish Danes		x	0.02
Kulla e Osman Bajramit		x	0.01
Kulla e Kaqel Rames		x	0.03
Kulla e Tal Belit		x	0.03
Kulla e Sadik Selmanit*		x	0.02
Kulla e Hamez Rrustemit (Bajraktareve) *		x	0.03
Xhamia e fshatit		x	0.01
Mulliri i fshatit Mulliq		x	0.02
Kulla e Sadik Nivokazit		x	0.03
Kulla e Hysen Hajdarit		x	0.02
Kulla e lsuf Sadiku		x	0.03
Xhamia e fshatit Ponoshec		x	0.20
Kulla e Arif Miftari		x	0.05
Xhamia e fshatit		x	0.05
Varrezat e Heronjeve		x	0.06
Kulla e Osman Jakupit		x	0.03
Kulla e Haxhi Mustafes (Met Brahimi) *		x	0.03
Xhamia e fshatit		x	0.03
Kulla e Adem Ademajt		x	0.02
Kulla e Brahim Metes		x	0.03
Kulla e Rexhep Ukes *		x	0.02
Xhamia e fshatit Dobrosh		x	0.20
Kulla e Muse Rexhepaj		x	0.01
Kulla e Syl (Arif) Aliaj		x	0.02
Kisha e Shen Rrokut		x	0.30
Kisha e Shen Mehillit		x	0.20
Shtëpia e Gjon Lesh Dedaj		x	0.15
Përmendorja e LNQ		x	0.10
Çerdhja e Komanit		x	0.03
Gjithsejtë			**42.99**

Tabela 22. Trashëgimia arkeologjike, sipas nen-kategorive kryesore dhe shtrirjes hapësinore

Trashëgimia arkeologjike, sipas nen-kategorive kryesore dhe shtrirjes hapësinore	
Nen- kategoritë	Sipërfaqja (ha)
Monumente arkeologjike	0.25
Vendbanim arkeologjik	4.15
Strukture e ndërtuar nga dora e njeriut	0.09
Rezervat arkeologjik	5.08
Gjithsejtë	**9.57**

Tabela 23. Trashëgimia arkeologjike- Struk. e ndert. nga dora e njeriut, sipas njësive kad. dhe emërtimeve

Trashëgimia arkeologjike- Struk. e ndert. nga dora e njeriut, sipas njësive kad. dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Kroni i lslom Beut		x	0.02
Kroni i Xhamise Mulla Jusuf *		x	0.02
Bunari i Kryepazarit		x	0.01
Kroni i Sylejman Vokshit		x	0.02
Kroni i Pangjalles		x	0.01
Kroni i Rexhep- Ages		x	0.01
Gjithsejtë			**0.09**

Tabela 24. Trashëgimia arkeologjike- Rezervatet arkeologjike, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Trashëgimia arkeologjike- Rezervatet arkeologjike, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Lokalitetet arkeologjik ne fshatin Doblibare		x	0.25
Tumat ilire te ura e Fshejt ne Ujze		x	0.10
Germadhat e kishes Paleokristiane ne Raqe		x	0.03
Lokaliteti Arkeologjik i Sukes se Cermjanit		x	0.60
Gjurmet e kishes se vjeter ne Cermjan		x	0.04
Tuma parahistorike dhe vendbanim mesjetar		x	0.10
Lokalitet arkeologjik romak		x	0.15
Lokalitet i Arkeologjik- varret e vjetra ne Damjan		x	0.30
Lokaliteti Arkeologjik mesjetar ne Dujake		x	0.20
Lokaliteti arkeologjik romak		x	0.15
Varreze mesjetare		x	0.30
Gjurmet e nje vendbanimi mesjetar ne Jabllanice te Gjakoves		x	0.50
Lokaliteti Arkeologjik romak dhe Kisha mesjetare ne Jahoc		x	0.05
Fortifikimi ne Koshare		x	0.80
Tume prehistorike, Kishe dhe Varreze mesjetare		x	0.08
Fortifikim i antikitetit tevo ne ne Kusare		x	0.06
Rrenojat e nje kishe paleokristiane		x	0.05
Tume Ilire		x	0.20
Lokaliteti arkeologjik romak		x	0.30
Varreza mesjetare ne Patan te Eperm		x	0.25
Kisha mesjetare ne Pjetershan		x	0.05

Gjurmet e vendbanimit mesjetar ne Popoc		x	0.20
Vendbanimi romak ne Qerim		x	0.30
Varreze mesjetare ne Racaj		x	0.15
Gjurmet e kishes dhe varrezes mesjetare		x	0.04
Varrez e mesjetare ne Smolice		x	0.10
Varreze mesjetare ne Vogove		x	0.15
Varreze mesjetare ne Zhdrelle		x	0.30
Gjithsejtë			**5.80**

Tabela 25. Asetet e trashëgimisë së luajtshme

Vendbanimi	Emri	Periudha	Statusi
Ponoshec Gjakovë	Tas njevegjak	1500-1100 p.kr	Mbrojtur përkohshëm
Ponoshec Gjakovë	Tas njevegjak	1500-1100 p.kr	Mbrojtur përkohshëm
Rogove, Gjakovë	Tas njevegjak	2500-1800 p.kr	Mbrojtur përkohshëm
Fshaj, Gjakovë	Tas nje vegjak	850-600 p.Kr	Mbrojtur përkohshëm
Fshaj, Gjakovë	Tas dy vegjak	850-600 p.Kr	Mbrojtur përkohshëm
Fshaj, Gjakovë	Tas dy vegjak	850-600 p.Kr	Mbrojtur përkohshëm
Ponoshec, Gjakovë	Maje heshte	1500-1100 p.kr	Mbrojtur përkohshëm
Ponoshec, Gjakovë	Tokez rrypi	1500-1100 p.kr	Mbrojtur përkohshëm
Ponoshec, Gjakovë	Skifos	Periudha klasike	Mbrojtur përkohshëm
Ponoshec, Gjakovë	Objekt metali-Amulet	Shek V-IV p.kr	Mbrojtur përkohshëm

3.2. PARQET NATYORE, REZERVATET,PEJSAZHET E MBROJTURA DHE MOMUMENTET E NATYRËS

3.2.1. Parqet natyrore dhe rezervatet

Mbrojtja e karakteristikave natyrore ose gjysmë-natyrore, pyjet, lumenjtë, liqenet, parqet edhe në qytet përbëjnë elemente kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik

.

Trendi i rënies së biodiversitetit është trend në gjithë botën. Fragmentarizimi dhe shpërndarja e vendbanimeve, ndotja e ajrit, mbipërdorimi i zonave natyrore dhe krijimi i peizazheve artificiale rrisin shkallën e erozionit, duke reduktuar mundësinë e specieve për shpërndarje, migracion dhe shkëmbim. Rrjetet ekologjike mund të ndikojnë pozitivisht në kushtet për mbijetesën e specieve në zonat e fragmentuara dhe peizazheve natyrore njerëzore të dominuara. Përveç kësaj, ato lejojnë një përdorim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes lidhjes së brendshme të elementeve të tyre fizike me peizazhin dhe strukturat ekzistuese sociale/institucionale

.

Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë natyrore ministria e EA konkretisht AMMK ka hartuar listen për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në baze të kësaj liste në komunën e Gjakovës janë të mbrojtura 37 asete të kategorizuara sipas kategorive të listuara në tabelën e më poshtme.

- Monument i Natyrës – 1 Kanioni i Drinit të Bardhë;
- Pejsazh Natyror – 1 Shkugëz;
- Park Kombëtar – 1 Bjeshkët e Nemuna;
- Park i Natyrës – 1 Malet e Pashtrikut

Asetet natyrore të përmbledhura:

- Monument i Natyrës – karakter botanik, 27 asete;
- Monument i Natyrës – karakter hidrologjik, 6 asete;
- Monument i Natyrës – speologjik, 4 asete.

Përveç listës së monumenteve natyrore të mbrojtura komuna e Gjakovës ka edhe disa lokalitete tjera te cilat kane potencial qe të trajtohen si zona të mbrojtura në nivel komunale dhe ne të ardhmen të shiqohet mundësia e vendosjes se këtyre lokaliteteve ne liste të mbrojtur të trashëgimisë kulturore.

1. Shpella e Kukës;
2. Gurra e Thatë;
3. Gurra e Kusarit;
4. Ujëvara e Currelit

Tabela 26. Kategorizimi i aseteve të trashëgimisë natyrore të mbrojtur

Trashëgimia natyrore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinorë		
Kategoritë	Numri	Sipërfaqja (ha)
Rezervat i natyrës	/	/
Park kombëtar	1	3000.00
Zone e veçanta e mbrojtur e natyrës	/	/
Park i natyrës	1	1470
Monument i natyrës	34	202.40
Pejzash i mbrojtur	1	78
Monoment i Natyrës	1	170
Monument i arkitekturës se parkut	/	/
Gjithsej	**37**	**4,750.40**

Burimi: *DUMM dhe AMMK*

Parqet kombëtare

Tabela 27. Pejzazhet i mbrojtura, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve

Pejzazhet i mbrojtura, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Firzë, Shkugëz	x		78.00
Gjithsej			**78.00**

Tabela 28. Parqet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve

Parqet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Goden, Greçinë, Malet e Pashtrikut	x		1470
Gjithsej			**1470**

Tabela 29. Monumentet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve i mbrojtur nivel nacional

Monument i natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore		
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor	Sipërfaqja (ha)

	I mbrojtur	I propozuar	
Bistrazhin, Ujz, Kanjoni i Drinit Bardhë	x		170

Tabela 30. Monumentet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve

Monumentet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Bec, Trungjet e bungut	x		0.02
Berjah, Trungjet e blirit	x		0.06
Demjan, Gurra e Demjanit	x		0.1
Dobrosh, Trungu i qarrit	x		0.07
Dobrosh, Trungungjet e blirit	x		0.35
Gërçinë, Shpella e Xhytezes	x		1.2
Gërçinë, Trungu I qarrit	x		0.02
Gërgocë, Kompleksi I trungjeve	x		0.85
Gjakovë, Cabrati	x		15
Hereq, Trungu I qarrit	x		0.03
Kusar, Burimi I ujit	x		0.1
Kusar, Shpella kusarit	x		0.1
Kusar, Shpella Qirave	x		0.1

Madanaj, Trungu I qarrit	x		0.05
Madanaj, Trungu I shkozes	x		0.02
Marmull, Bashkësia e Brukës	x		0.5
Molliq, Shpella Arushes	x		0.3
Molliq, Burimi Ujit	x		0.02
Molliq, Kompleksi I trungjeve	x		7.2
Palabardh, Trungu I qarrit	x		0.02
Morine, Burimi I Ujit	x		0.1
Morine, Burimi I Ujit	x		0.05
Qerim, Trungu qarrit	x		0.03
Rracaj, Trungu I blirit dhe qarrit	x		0.3
Shqiponjë, Zabeli I Gojanit	x		4.5
Stubëll, Trungu I blirit	x		0.02
Vogovë, Trungjet e qarrit	x		0.5
Zhabel, Kompleksi I trungjeve	x		0.45
Zhdredhe, Trungu I qarrit	x		0.02
Shpella e Kukës	x		0.10
Gurra e thatë	x		0.05
Kusar, Gurra e Kusarit	x		0.07
Ujëvara e Currelit	x		0.10
Gjithsej			**202.40**

Harta 13. Asetet e tragëmisë natyrore



Tabela 31. Kategoritë e aseteve të trashëgimisë kulturore

Kategoria	Asete	Zona		Perimetri Zona mbrojtur		Siperfaqja e mbrojtur		Statusi ligjor i mbrojtjes		Autenticiteti Kushtet e mbrojtjes & konservimit
		urbane	rurale	percaktuar	pa përcaktuar	përcaktuar	pa përcaktuar	përhershme	perkohshme	pa përcaktuar
T. arkeologjike	35	0	35	0	35	0	35	0	35	35
T. Arkitekturore	145	96	49	1	144	1	144	1	144	145
T. Luajtshme	10	0	10	0	0	0	0	0	10	10
T. Shpirterore	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2
Peiz. kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
ZV	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	192	98	94	1	179	1	179	1	189	192

3.2.2. Sipërfaqet pyjore/biodiversiteti

Sipërfaqet pyjore përbëjnë 43% të territorit të komunës së Gjakovës, pjesa më e madhe e tyre shtrihet në jug-perëndim të komunës dhe vazhdon përgjatë kufirit me Shqipërinë.
Territori i komunës së Gjakovës përfshinë gjithsej 23.264 ha sipërfaqe pyjore, prej të cilave 17,435 ha në sektorin publik dhe 8,829 ha në atë privat. Drurët më të përhapur në këto pyje janë pisha, ahu, dushku, shkoza, qarri dhe bungu. Sa i përket kategorizimit të pyjeve, pyje halore janë 541.12 ha dhe pyje gjeth mbajtëse 25,722.88 ha.[21] Masa drunore në pyjet ekzistuese në territorin e komunës për nga përbërja është kryesisht fletore gjetherënëse e përdorshme për ngrohje, dhe masa tjetër drunore më e vogël përbën drunjtë halor për qëllime tekniko - industriale (Pisha).

Sipërfaqet pyjore në shtrihen në disa zona kompakte të cilat njihen si :

1. Zona e majës së lartë, e cila përfshinë territorin Koshare – Popoc,
2. Zona e Qerretit, përfshinë territorin Popoc-Qafë Prush,
3. Zona e Pashtrikut, përfshinë territorin Qafë Prush- Damjan
4. Zona e Dushkajës, përfshinë Lugun e Carragojës dhe sipërfaqet pyjore Bec-Jabllanicë.

Zonat në nr. 1, 2 dhe 3 janë zona me sipërfaqe pyjore me drunjë të lartësisë mesatare që kryesisht lidhen me masivin pyjor rreth brezit kufitar me Shqipërinë në tërë gjatësinë e saj, ndërsa në kuptimin e rrezikut të gjitha zonat janë vatra potenciale të zjarreve,gjë që është dëshmuar me rastin e zjarreve intensive gjatë verës së vitit 2007 ku vetëm gjatë sezonës verore janë shënuar rreth 458 intervenime në pyje. Zjarri si fatkeqësi elementare apo i shkaktuar nga dora e njeriut, në raport me dukurit tjera, paraqet faktorin më dominant të dëmtimit të pyjeve i cili për një kohë shumë të shkurtë mund të shkatërroj sipërfaqe të tejet të mëdha duke shkaktuar dëme katastrofale në masën drunore,në ambient,shëndetin e njeriut etj. Në këtë kontekst duhet veçuar zonën e Qerretit dhe sipërfaqet pyjore në Koshare si masiv drunor shumë i dendur dhe kualitativ të cilat duhet të kenë një trajtim të posaçëm, ndërsa me aprovimin e "Ligjit mbi mbrojtjen e pyjeve" të cilësohen si rezervate.

[21] *http://www.mbpzhr-ks.net/advCms/?id=4,721,0,728,a- Agjensioni Pyjor i Kosovës-MBPZHR, Prishtinë*

Tabela 32. Sipërfaqet pyjore

#	Sipërfaqe Pyjore/sektori publik/privat	Sipërfaqja në ha	Llogaritja
1	Pyje të larta	2,544.	1
2	Kultura pyjore	532,26	2
3	Pyje të ulëta	8,514.59	3
4	Pyje të degraduara (shkurre)	2,662.34	4
5	Sipërfaqe të mbuluara me pyje	14,253.19	1+2+3+4
6	Sipërfaqe të zhveshura	3,182.08	5
7	**Sipërfaqja pyjore publike**	17,435.27	1+2+3+4+5
8.	**Sipërfaqe pyjore private**	5,829	7+8
	Totali:	**23,264.27**	

Harta 14. Sipërfaqet pyjore



Biodiversiteti

Edhe pse jo i hulumtuar në detaje, bazuar në të dhënat nga hulumtimet e deritanishme si dhe nga hulumtimi i realizuar në këtë rast, mendojmë se territori i komunës së Gjakovës ka biodiversitet mjaft të larmishëm dhe të pasur. Ky diversitet i larmishëm i botës së gjallë është si rezultat i larmisë së ekosistemeve prezentë në këto hapësira. Në shtrirje horizontale dhe vertikale, diversiteti është i larmishëm duke filluar që nga ultësirat deri te lartësitë më të mëdha në malet e larta të territorit të hulumtuar.

Llojet bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Gjakovës janë të përhapura në ekosisteme të ndryshme, si në lumenjë e përgjatë tyre (Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Llukaci PLVB të komunës së Gjakovës 2019-2024 31 dhe disa lumenjë të vegjël por të rëndësishëm), në liqen (Liqeni i Radoniqit), në toka pjellore, livadhe e kullosa, male e bjeshkë të larta. Ky diversiteti biologjik zhvillohet si rezultat i kësaj larmie territoriale me gjeologji, respektivisht me pedologji të ndryshme, duke filluar nga luginat fushat aluviale rreth lumenjëve, fushëgropa e Gjakovës, krahinat-hapësirat kodrinore si ajo e Hasit,

Dushkajës etj., masivin malor në relacionin Qafë e Morinës-Qafë e Prushit, pjesët malore rrëzë Pashtrikut dhe deri te pjesët malore të Bjeshkëve të Namuna apo thënë ndryshe Alpeve Shqiptare - pjesa e Kosovës. Për shkak të vlerave të trashëgimisë natyrore rreth 5% (afro 3000 ha) të Parkut Nacional "Bjeshkët e Namuna" shtrihen në territorin e komunës së Gjakovës.

3.2.3. Zonat e mbrojtura të trashëgëmisë natyore

Poashtu në kuadër të territorit të KK të Gjakovës, në kuadër të diversitetit biologjik ka vlera të trashëgimisë natyrore të cilat janë të mbrojtura me ligj por edhe të propozuara për mbrojtje me ligj (AKMM - IKMN 2008, 2010). Nga numri i gjithmbarshëm prej 3 Zona të Mbrojtura me Ligj ("Çabrati", "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë" dhe "Shkugëza"), respektivisht 28 zona të propozuara për marrje nën mbrojtje ligjore të propozuara në vitin 2003; në mënyrë direkët apo indirekte është fjala edhe për vlera të biodiversitetit. Në kuadër PLVB në komunën e Gjakovës janë realizuar dhjetë ekspedita hulumtuese në terren (EK & DR / 07-17.09.2018) të cilat nxorën në shesh rezultate relevante të cilat do të paraqiten në këtë rast.[22]
Në këto terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegjetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me shelg e plep por edhe me verr e marinë (brukë) të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjëve, ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve QuercoFagetea e Alnetea glutinosae, rendeve Alnetalia glutinosae dhe Populetalia albae si dhe alencave Alnion glutinosae, Salicion albae dhe Populion albae. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet Salix alba (dominon), Populus nigra, Ulmus effusa, Alnus glutinosa, Salix fragilis. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore Salix purpurea, Frangula alnus, Cornus sanguinea, Tamarix tetrandra ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore Galium palustre, Alisma plantago aquatica, Veronica anagallis, Mentha aquatica, Agrostis alba, etj.

Deri më tani lloje shtazore të mbrojtura me ligj në Republikën e Kosovës dhe që gjenden edhe në territorin e komunës së Gjakovës janë llojet: Ursus arctos (Ariu i murrmë), Sciurus vulgaris (Ketri), Martes foina (Sqarthi, Kunadhja gushbardhë), Capreolus capreolus (Kaprolli) dhe Felis silvestris (Macja e egër).

Duke konsideruar ruajtjen e resurseve dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si qëllim të zhvillimit dhe mirëqenies së komunitetit, ky aspekt ka për qëllim arritjen e një standardi të qëndrueshëm mjedisor, mbrojtjen dhe respektimin e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe duke u bazuar në gjendjen ekzistuese e cila thekson çështjet e:

- humbjes së tokës kualitative bujqësore;
- shkallën e lartë të ndotjes mjedisore;
- shfrytëzimin jo-racional i resurseve, në veprimet e dëmshme ndaj aseteve natyrore ;
- Çasja ndaj zgjidhjeve të ardhshme duhet të përbëhet nga veprimet e koncentruara e të koordinuara të institucioneve kompetente të të dy niveleveppushtetit, gjithnjë për ruajtjen e aseteve natyrore dhe ambientale.

[22] *Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030*

Harta 15. Vlerat e biodiversitetit



3.2.4. Menaxhimi i zonave të mbrojtura

Menaxhimi i Parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe 3 zona të mbrojtura me ligj Kodra e Çabratit, Kanjoni i Drinit të Bardh Shkugëza, të cilat gravitojnë në komunën e Gjakovës, është një proces kompleks që ka si qëllim ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e ekosistemeve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit. Menaxhimi i këtyre zonave është thelbësor për ruajtjen e biodiversitetit dhe për zhvillimin e një kulture që e Përmes një qasjeje të koordinuar respekton natyrën dhe gjithëpërfshirëse, mund të sigurohet një balancim mes mbrojtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Disa nga aspektet kryesore të menaxhimit të këtij parku përfshijnë:

1. Planifikimi i Menaxhimit – Me planin zhvillimor komunal në mënyrë të detajuar janë përcaktuar objektivat e ruajtjes dhe përdorimit të burimeve, si dhe identifikimi i zonave me rëndësi të veçantë ekologjike dhe kulturore.

2. Monitorimi i Biodiversitetit- Vlerësimi i llojeve të florës dhe faunës, si dhe mbrojtja e specieve të rrezikuara. Kryerja e studimeve për të përcaktuar shëndetin e ekosistemeve.

3. Edukimi dhe Angazhimi i Komunitetit - Organizimi i aktiviteteve edukative për vizitorët dhe komunitetet lokale mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete të menaxhimit dhe mbrojtjes së saj.

4. Zhvillimi i Qëndrueshëm - Promovimi i turizmit të qëndrueshëm që respekton natyrën dhe ndihmon ekonominë lokale. Rregullimi i aktiviteteve si ndërtimi, bujqësia dhe djegia e pyjeve për të minimizuar ndikimet negative.

5. Politikat dhe Ligjet - Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës dhe monitorimi i respektimit të këtyre rregullave.Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit.

3.3. Bujqësia[23]

3.3.1. Zhvillimi bujqësor dhe rural

Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë dhe si e tillë luan rrol të rëndësishëm në zhvillimin e komunës së Gjakovës. Pothuaj se 40% e teritorit të përgjithshëm të komunës së Gjakovës është tokë bujqësore.

Luginat e lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Trava dhe Trakaniqi, si dhe te disa përroskave, krijojnë në Komunën e Gjakovës rrafshina, shumica e të cilave me tokë të punueshme e shumë pjellore. Nisur nga këta faktorë dhe nga kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial te madh zhvillimi për ekonominë e komunës.

Mirëpo, edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Gjakovës, vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël i prodhuesve janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore. Sipas regjistrimit të ekonomive familjare (2024), me pak se 5 % të të punësuarve janë të punësuar në sektorin e bujqësisë. Bujqësia, në sektorin privat është e zhvilluar kryesisht në formë të bujqësisë familjare, fermave për jetesë dhe tokave të vogla private bujqësore, ku viteve të fundit sektorit të bujqësisë është duke iu kushtuar vëmendje më e shtuar si nga institucionet dhe komunale, përmes subvencionimit të aktiviteteve bujqësore, ndërtimit të kanaleve për ujitje si dhe aplikimit të masave intensive agro-teknike. Pjesa më e madhe e koncentrimit bujqësorë-agrar është në zonat e tokës bujqësore me shtrierje lindje-përendim të komunës së Gjakovës gjegjësisht në sipërfaqet e rrafshëta mes lumit Drini i Bardhë dhe Erenik duke rritur prodhimtarin e produkteve të pemëve dhe perimeve, grurit,misrit dhe kulturave tjeta bujqësore..

Gjithashtu, Komuna e Gjakovës është e njohur me prodhimin e qumështit si dhe përpunimin dhe prodhimin e produkteve të qumështit.

3.3.2. Kapacitetet e prodhimit bujqësor

Në zonat rurale, bujqësia është 70% si burim i jetesës. Gjithsej janë 55 684 ha tokë, prej të cilës 29 445 ha në sektorin shoqërorë dhe 26 239 në atë privat. Vlen të theksohet se tokat e pronësisë shoqërore i menaxhon AKP

Kulturat bujqësore	Gjithsej
Ara - kopshte	15.013 ha
Pemë	670 ha
Vreshta	40 ha
Kullosa	7.154 ha
Livadhe	6.716 ha
Male	26.264 ha
Gjithsej	15.013 ha

Tabela 33. Struktura e prodhimit bujqësor

[23] Burimi: Drejtoria për Bujqësi ,Pylltari dhe Zvillim Rural 2025

Me rreth 14, 741 ha toke të punueshme, Komuna e Gjakovës ka kushte shumë të volitshme për të zhvilluar një bujqësi intensive. Aktualisht struktura e prodhimit bujqësor dominohet nga kultura e misrit dhe e grurit, qe së bashku zënë rreth 57% të sipërfaqes së tokës së punueshme:

Nr.	Kultura	Sipërfaqja (Ha)	Rendimenti (kg/Ha)
1.	Grurë	3500	3000-4000
2.	Misër	3000	4000
3.	Perime	250	-
4.	Peme	150	-
5.	Vreshta	40	8000

Tabela 34. Struktura e prodhimit bujqësor

Rendimentet e kulturave bujqësore për rrethanat e Kosovës janë relativisht të larta, këtë e mundëson infrastruktura e sistemit të ujitjes nga KRU ”Gjakova”, dhe sistemeve tjera përmes kanaleve të ujitjes me ndërtimin e pendave në rrjedhat e lumenjve të komunës.

Gjatë vitit 2025, në territorin e komunës së Gjakovës përmes sistemit të ujitjes nga KRU “Gjakova” janë ujitor 1.407 ha, ndërsa ndërsa në zonat ku mungon ky sistem ujitja e sipërfaqeve bujqësore është bërë përmes kanaleve të standardizuara të ujitjes që në total përbëjnë 17,622 m/gjatësi[24]**.** Këto kanale janë të ndërtuara përgjatë rrjedhave të lumenjve në fshatrat: Ponoshec, Jahoc, Kralan, Shishmon, Jabllanicë dhe në projekt është sistemi në fshatin Smolicë dhe disa projekte të kësaj natyrore pritet të financohen nga Komuna dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Vetëm gjatë vitit 2025 Komuna e Gjakovës ka ndërtuar 2860 m kanale të ujitjes Ekzistojnë edhe kanale tjera tokësore primitive por që kanë 39 kanë humbje 30 -40% të sasisë së ujit gjatë rrugëtimit, për shkak të qarjeve, thithjes së ujit, etj.

3.3.3. Zonat e prodhimit bujqësorë

Sipas përbërjes pedologjike të tokës territori i komunës së Gjakovës ofron mundësi të prodhimtarisë së llojllojshme të kulturave bujqësore, të cilat shtrihet në këto zona:

1. Zonat Humusore – të përshtatshme për kultivimin e bimëve të lavërtarisë (grurë, misër etj) dhe bimëve industriale (pangjari i sheqerit, luledielli, duhani etj.)
2. Zonat Aluviale – të përshtatshme për kulturat e perimtarisë,
3. Zonat e tokës së kuqe – të përshtatshme për kultivimin e vreshtarisë dhe pemëtarisë,
4. Zonat Gëlqerore-kodrinore (smonicë)– të përshtatshme kultivimin e hardhisë së rrushit.

Bujqësia e komunës së Gjakovës ka një perspektiv të madhe për zhvillimin e saj duke marrë parasysh kushtet klimatike, të përbërjes tokësore dhe kushteve hidrografike, sistemin e ujitjes dhe traditën e popullatës që merret me bujqësi.

Të gjitha degët e bujqësisë në komunë, aktualisht janë më të avancuara në sektorin privat – individual,ndërsa funksionimi i saj në sektorin publik ka shënuar një rënie të konsiderueshme si pasoj e shndërrimit të tokave bujqësore në tokë ndërtimore,dhe mungesa e politikave të qëndrueshme zhvillimore dhe fiskale në sferën e bujqësisë.

[24] DBPZHR, Raporti Vjetor për v. 2025

3.3.4. Kultivimi i bimëve një-vjeçare

Siperfaqe e punueshme me kultura bujqësore njëvjeqare(ara) në Komunen e Gjakovës për v.2025 anë 6,818 hektarë, Siperfaqe me drithëra të bardha janë 6,150 hektar.

Egziston infrastruktura pjesërisht në kuadër të industrisë përpunuese të ktyre produkteve agrare e cila mundëson: grumbullim, vendosjen dhe ruajtjen/deponimin dhe përpunimin e drithërave në komunën tonë e cila bënë pjesë në segmentin e biznesit agro-industrial. Komuna e jonë është e përfshirë në kuadër të sistemit të ujitjes "Radoniqi". Aktualisht ujiten 1,407.28 hektare të tokës punuese nga sistemi i Radoniqit Problemi me pamjaftueshmërinë e sistemit të ujitjes është i theksuar më së shumti në fshatra që kanë prodhimin e kulturave njëvjeçare. Ujitja është një çështje shumë e rëndësishme dhe vitale për kultivimin e produkteve bujqësore.

Tabela nr 36. Sipërfaqet e planifikuar/realizuara me kulturat një veçare

Nr.	Kultura:	Fermer /numri	Sipërfaqja e planifikuar /ha			Sipërfaqja e realizuar/ ha		
			2023	2024	2025	2023	2024	2025
1.	Misër	664			2440.2			2440.2
2.	Grurë	830			3938.6			3938.6
3.	Elb	7			15.4			15.4
4.	Thekër	8			20.77			20.77
5.	Tërshër	47			117.11			117.11
7.	Luledielli	3			23.4			23.4
8.	Farë gruri	1			21.32			21.32
9.	Perime	228			288.58			288.58
	GJITHSEJTË :	**1.117**			**6,844.06**			**6,844.06**



Grafiku 9. Trendi i kultivimit të drithërave



Grafiku 10. Trendi i kultivimit të perimeve

Databaza e sipërfaqeve bujqësore, kapaciteteve dhe fermerëve aplikant në v.2025

Tëna dhëna të përgjithshme të Sektorit të bujqësisë për vitin 2025																									
	Vreshta	Grure	Fare Gru	Miser	Elbi	Theker	Tershere	Luledielli	Perime	Peme	Pula	Lope	Meshqerra	Dosa	Dele	Dhi	Vere	Material Fidanor	Blete	Litra qumeshti	Brojler	Therje	Viqa per majmeri	KG Gruri
	13.64	665.95	0	415.06	1.82	3.45	16.55	0	40.51	21.08	266975	897	105	25	1771	0	1600	33500	2953	369698	52013	0	0	947055
	6.19	927.29	0	497.32	7.3	7.09	17.5	1.25	97.37	27.01	20500	941	61	16	1391	0	0	0	2008	1099867	0	135	0	3794233
	3.03	521.56	0	310.82	1.2	2.04	45.49	0	50.67	10.27	0	585	64	0	816	0	0	0	1293	110647	0	0	14	565257
	5.79	532.88	0	378.89	2.6	1.67	5.16	0	38.49	12.21	146780	776	100	40	2133	0	0	0	1574	340179	0	66	79	1062230
	6.36	1290.91	21.32	838.11	2.5	6.52	32.41	22.15	61.54	37.39	90000	1357	160	21	2394	580	0	0	3967	1752033	0	88	330	4215123
TOTALI i sip,nr.krereve koshereve,fid	35.01	3938.59	21.32	2440.2	15.4	20.77	117.11	23.4	288.58	107.96	524255	1556	490	102	8505	580	1600	33500	11795	3672424	52013	289	423	10583898
TOTALI I Nr. Aplikuesve	61	830	1	664	7	8	47	3	228	110	11	443	232	8	66	5	1	1	187	122	1	11	19	485

3.3.5. Kultivimi i kulturave bujqësore shumë-vjeçare

Sipas evidencës së DBPZH, gjatë v. 2025 në komunën e Gjakovës kanë aplikuar gjithsejtë 171 ekonomi familjare me veprimtarinë e kulturave shumë-vjeqare, kryesisht me pemëtari dhe vreshtari me një sipërfaqe bujqesore rreth 142.97 hektar. Në nivel vendi, me kultura shumë- vjeqare, sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 23.27 %, me mjedër 7.20 % , me arrë 28.18 %, dardhë 6.88%. Sa i përket sasisë së prodhimit, analizat e statistikave për periudhën në nivel vendi 2021 – 2024 tregojnë një trend të rritjes së prodhimit të të gjitha pemëve.

Nr.	Struktura e mbjelljeve	Fermer / numri	Sipërfaqja e planifikuar /ha			Sipërfaqja e realizuar /ha		
			2023	2024	2025	2023	2024	2025
1.	Pemë	110			107.96			107,96
2	Vreshta	61			35.01			35.01
	Gjithsejtë:	**171**			**142.97**			**142.97**

Tabela 37. Sipërfaqet e planifikuara/realizuara me kulturat shumë-vjeqare



Grafiku 11. Trendi i kultivimit të pemëve

3.4. Agrobiznesi

Ekonomia e komunës së Gjakovës është kryesisht bazuar biznesin individual në sektorin e bujqësisë, tregtisë, ndërtimtarisë dhe përpunimit të ushqimit. Në komunën e Gjakovës aktualisht janë gjithsejtë 4,334 biznese private aktive të cilat që operojnë brenda juridiksionit komunal.[25]. Derisa në sektorin e bujqësisë, sipas evidencës së DBPZHR fushën e bujqësisë sipas NIF janë evidentuar 4029 fermer prej të cilëve 1449 janë aktiv[26]**.** Bujqësia është një ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe të sigurisë së ushqimit. Sektorët të cilët vazhdojnë të kenë kushte të favorshme dhe me rendimente në rritje janë: Sektori i pemëtarisë, blegtorisë, drithërat si dhe kultivimi i frutave dhe perimeve dhe përpunimi i tyre në produkte finale. Përkundër potencialeve për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet pak i përfaqësuar nga se zhvillimet e hovshme në sektorët e tjerë, sidomos migrimi dhe emigrimi i popullatës një pjesë e madhe e tokës ka mbetur e pa punuar, ndikim negativ ka edhe ndërtimi i objekteve të ndryshme në toka bujqësore, siç janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzinës dhe objektet e ndryshme industriale, kjo ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shëndërruar në tokë ndërtimore

[25] Burimi: Drejtorisë për Zvillim Ekonomik/.2025
[26] Burimi: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural/2026

3.4.1. Fermat bujqësore

Kultivimi i shtazëve, shpezëve dhe përpunimit të mishit ka të bëjë me biznesin privat andaj bartës ekskluziv të kësaj sfere janë subjektet private dhe fermerët individual të cilët merren me këtë veprimtari. Ne komunen e Gjakovës gjatë v.2025 për kategori të ndryshme të fondit blegtorial, të shpezëtarisë dhe bletarisë kanë aplikuar gjithsejtë 1,076 fermer individual të kësaj kategorire, të cilët zotërojnë sipërfaqe prej 90 hektar. (Tab. nr.40)

Tabela 40. Pasqyra e fermerëve në komunën e Gjakovës[27]

Nr.	Kategoria e fermave	Nr. i Fermerëve aplikues	Njësia në Krerë/copë/lit	Lokacioni	Vërejtje
1	Lopë	443	4556	Në të gjitha fshatrat e komunës së Gjakovës	Qumështore/ Reprodukim
2	*Mëshqerra*	*232*	*490*	Në të gjitha zonat komunës së Gjakovës	*Për majmëri*
3	Dele	66	8505	Në të gjitha fshatrat e komunës së Gjakovës	
4	Dhi	5	580	Në të gjitha zonat komunës së Gjakovës	
5	Dosa	8	102	Në të gjitha zonat e komunës së Gjakovës	
6	Pula	11	524,255	Në të gjitha zonat komunës së Gjakovës	
7	Brojler	1	52.013	Fsh. Rezine	
8	Qumështi	112		Në të gjitha zonat komunës së Gjakovës	
9	Therrje të gjëve	11	289	Në disa lokacione mbrenda zonës urbane dhe periferike	
10	Bletë	187	11.795 koshere	Në të gjitha zonat e komunës së Gjakovës	

3.4.2. Turizmi

Turizmi është një nga shumë kompetencat e komunës dhe luan një rol të rëndësishëm në bërjen e politikave dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Komuna e Gjakovës shtrihet ndërmjet lumenjve Ereniku, Krena e Llukaci, dhe është e pasur me shumë burime natyrore dhe njerëzore, si dhe është e vendosur në mes të maleve të Nemuna dhe Pashtriku të gjitha këto pasuri natyrore e bëjnë Gjakovën një rajon shumë të ndryshëm dhe të pasur.

Bjeshkët e Nemuna janë rajoni potencialisht më i rëndësishëm turistik i Kosovës por edhe Gjakovës. Hapësirat natyrore jashtëzakonisht cilësore, mundësitë e mëdha të pranimit të vizitorëve dhe monumentet kulturore-turistike krijojnë mundësi të pakufizuara të zhvillimit turistik. Bjeshkët e Nemuna, pa dyshim, janë masivi me unik malor në Ballkanin Perëndimor.

Në Gjakovë janë të zhvilluar më së shumti këto lloje të turizmit: turizmi kulturor, turizmi shpirtëror dhe gastronomia,

[27] DBPZHR- Data baza e fondit bujqësor dhe blegtoria për v. 2025

gjegjësisht turizëm i bazuar në trashëgiminë kulturore, por që viteve të fundit i është kushtuar rëndësi të madhe edhe turizmit natyror, duke krijuar qasje në disa atraksione natyrore të cilat gjenden në Komunën e Gjakovës.

Vizitorë dhe njësi akomodimi

Sipas disa statistikave, Gjakovën me rrethinë viteve të fundit e vizitojnë mesatarisht 8,000-10,000 vizitor Vizitorët nuk qëndrojnë gjatë, afërsisht me 1.5 natë në mesatare. Shumica e tyre, mbi 83%, janë ndërkombëtarë. Sipas numrit të vizitorëve, burimet kryesore të turizmit janë Shqipëria (19%), Gjermania (9%) dhe Turqia (8%), Zvicra (7%), etj.
Të dhënat gjithashtu tregojnë se regjioni Gjakovës paraqet destinacion të rëndësishëm të turizmit në Kosovë, por me ofertë jo të kënaqshme.

Sipas evidencës së Drejtorisë së Zhvillimit ekonomik, në komunën e Gjakovës, tregojnë për gjithsej 164 njësi akomodimi (hotele, motele, hostele, bungallou etj), me kapacitet prej 404 dhoma dhe 768 shtretër. Shfrytëzimi i këtyre njësive akomodimi nuk duket i kënaqshëm – afër 8,6% në mesatare gjatë vitit 2024 në rajonin e Gjakovës.
Sipas evidencës së Zyrës së Turizmit (2025) lidhur me njësitë akomoduese në Komunën e Gjakovës, bazuar në të dhënat e saj, mund të konkludohet se kapaciteti i përafërt për Komunën e Gjakovës është si vijon: 404 Dhoma me gjithsej 768 shtretër, ku mesatarja e qëndrimit ishte 2.5 netë.

Grafiku 13. Vizitorët sipas shteteve



Tabela 41. Kapacitetet hoteliere në regjionin e Gjakovës

Vitet	Njësi akomoduese	Dhoma	Shtretër
Viti 2024	30	404	768
Viti 2023	30	404	768
Viti 2022	29	374	513
Viti 2021	29	358	513
Viti 2020	28	358	494

Tabela 42. Shfrytëzimi i kapaciteteve

Vitet	Shfrytëzimi i kapaciteteve %
Viti 2024	8.6 %
Viti 2023	9.8%
Viti 2022	5.2%
Viti 2021	4.5%
Viti 2020	1.6%

Asetet turistike

Qyteti përmban një sërë monumentesh nga e kaluara e pasur kulturore. Gjakova ka numër të konsiderueshëm të liqeneve dhe lumenjve si: Liqeni i Radoniqit, Lumi Erenik, Lumi i Drinit të Bardhë, Lumi Krena, Lumi Trava dhe Llukaci, dhe Urave si: Tërzive, Tabakëve, Taliqit dhe Ura e Fshajtë. Degët e turizmit të identifikuara janë turizmi malor (Maja e Kunorës, Shpellat e Kusarëve, Shpella e Qirinjve, Shpella e Gurra e Thatë, Shpella e Kukës, Curreli, Pusi i Grazhdit afër shpellave) dhe turizmi kulturor.[28]

Pjesa më atraktive dhe më e vizituar e Gjakovës është Çarshia e Madhe, e cila është ndër çarshitë më të mëdha të rajonit me një shtrirje mbi 34.000 m^2 dhe me mbi 500 dyqane, në të cilën përveç zanateve të vjetra mund të gjinden edhe dyqane nga fusha e hotelerisë dhe turizmit. Në komunën e Gjakovës aktualisht gjenden 4 muze: Muzeu Historik, Muzeu Etnografik, Muzeu i Muzikës dhe Muzeu i Familjes Qerkezi nga lufta e vitit 1999, duke mos lënë anash as numrin e madh të shtëpive të vjetra tradicionale dhe urave.

Po ashtu, Gjakova është e pasur me një numër të madh të objekteve të vjetra të kultit. Ndër to veçohen: Xhamia e Hadumit, Xhamia e Mahmut Pashës, Xhamia e Kusarëve, Kisha e Shën Palit dhe e Shën Pjetrit, Kisha e Shën Ndout, Kisha e Becit, Teqja e Madhe Autoqefale, Teqja e Shejh Eminit, Teqja e Bektashinjëve. Ndërsa si pjesë e trashëgimisë natyrore janë: Kodra e Çabratit, Parku i mbrojtur Shkugëza, Liqeni i Radoniqit, Kanioni i Drinit të Bardhë dhe Shpellat e Kusarit, Maja e Kurorës, Shpella e Qirave në Gërqinë, etj.

3.4.3. Komuniteti i biznesit

Qyteti i Gjakovës ka një traditë të hershme manifakturale dhe për përpunimin e materialeve të ndryshme nga : guri, druri, për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare si dhe veprimtari hoteliere. Komuna e Gjakovës ka kushte mjaftë të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtesë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik e cila ka potencial ende të pa shfrytëzuar nga aspekti i pasurisë mbitokësore, nëntokësore , burimet e ujit, malore , bujqësia , energjia, etj. Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Prizrenit janë: ekonomitë e vogla familjare, shërbimet, bujqësia, tregtia dhe remitencat nga Diaspora. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e bizneseve makro, ende mbetet i pafavorshëm dhe kërkon mbështetje institucionale të fuqishme.Sipas të dhënave nga Drejtoria Komunale për Zhvillim ekonomik, në sektorin privat janë aktive gjithsejtë 4,337 biznese aktive me 8856 punëtor

[28] *Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim 2020-2022*

3.4.4. Sektori privat [29]

Tabela 43. Ndërmarrjet sipas sektorëve në komunën e Gjakovës

Sektori		Subjekte
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	96
B	Xehetari dhe gurëthyes	14
C	Prodhim	592
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	13
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	13
F	Ndërtimtari	365
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	1376
H	Transport dhe ruajtje	88
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	441
J	Informacion dhe komunikim	94
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	26
L	Aktivitete të patundshmërisë	11
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	253
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	116
O	Administratë publike dhe mbrojtje	7
P	Arsim	36
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	155
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	163
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	403
T	Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës	75
U	Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale	-
Totali		**4.337**

[29] Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Gjakovë/2025

3.5. OBJEKTET

3.5.1. Objektet e banimit[30]

Objektet e banimit në të kaluarën jo të largt, ndërtoheshin kryesisht në kate përdhese, në raste të veqanta , në disa vise edhe të ashtuquajtura kulla guri, të ngritura deri në tri kate, nga materiale të dobëta (guri, qerpiçi-tjegulla dhe druri). Në dekadat e fundit, ndërtimi i objekteve të banimit ka ndryshuar tërësisht, si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor, si: tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri dhe materiale izoluese. Edhe pse organizimi i jetës dhe hapësirës në fshat ka një dallim nga pjesa urbane e qytetit, objektet e banimit të ndërtuara në fshat, fare pak dallojnë me ato në qytet nga se nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Zona urbane e qytetit të Gjakovës karakterizohet me dendësi më të lartë e cila mesatarisht shkonë nga 1200-2500 banorë për km^2, që është dukshëm më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane, ku shtrihen kryesisht njësi të banimit. Sa përket numrit të strukturave të ndërtuara, në nivel komune numri më i madh i ndërtesave i përkasin shtëpive të banimit në pjesën urbane përbëjnë 68,02% , ndërsa në zonat rurale 99,01% . Me miratimin e Hartës Zonale përqindja e shtëpive të banimit është duke u zvogëluar për shkak të rritjes së kërkesave për ndërtime të larta kolektive, sidomos në zonën urbane të Komunës.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë natyrore, zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga fatkeqësitë(tërmetet, vërshimet, erozionet etj.) si dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit. Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat për Efiçencë të Energjisë sipas kërkesave, bazuar në rregulloren për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MEA Nr. 04/18). Të gjitha këto veprime do të mundësojnë që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit në komunë, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit.

Në vendbanimet rurale, që gjenden me pozita hapësinore atraktive dhe distanca të afërta me vendet urbane si dhe pranë akseve rrugore që lidhin qytetet më kryesore në vend, dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës. Ndërsa në vendbanimet më periferike, sidomos ato afër brezit kufitarë, dekadave të fundit ka ndodhimigrim i pa kontrolluar drejt venbanimeve urbane. Vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit janë të ndërtuara edhe edhe një numër të konsiderueshëm të objekteve përcjellëse (ekonomike). Në dy dekadat e fundit në Komunën e Gjakovës ka ndodhur një zhvillim dinamik urban, i përcjellur edhe me infrastructure kritike në vendbanime urbane dhe rurale, duke ndërtuar objekte të cilat i plotësojnë standard të afirmuara dhe kushte më të mira për banim. Në komunën e Gjakovës numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 25,510, ku pjesa më e madhe e njësive të banimit gjendet në zonën urbane të komunës së Gjakovës me 14,975 , ndërsa në atë rural 10535 njësi banimi.

[30] *Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030*

Tabela 44. Të dhënat për numër dhe sipërfaqe të banimit

Zona Kadastrale	Kategoria e shfrytëzimit	Numri	Sipërfaqja (m^2)	Përqindja
Zona Urbane	Apartament	4796	388644	32.02%
	Shtëpi	10179	1434709	67.97%
Zona Rurale	Apartament	9	1107	0.01%
	Shtëpi	10526	1641449	99.91%
Total		25510	3465909	

Burimi: Lista e tatimpagueseve te TP VITI 2020



Graf. 15 Ndërtesat e banuara sipas viteve të ndërtimit (burimi: ASK, Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave).

3.5.2. Kategorizimi i vendbanimeve sipas madhësisë dhe numrit të banorëve

Në bazë të të dhënave demografike dhe sipas udhëzimit administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor, klasifikimi i vendbanimeve është bërë në bazë të numrit të banorëve

Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit	Përshkrimi	Vendbanimet	Numri i vendbanimeve	% në raport me vendbanimet në tërësi
25,000-50,000 banorë	Vendbanim i mesëm i vogël urban	Gjakovë, Gjakovë jashtë qytetit, Zidi Sadik Agës	1*	1.12%
5,000-10,000 banorë	Vendbanim shumë i vogël urban	Damjan	1	1.12%
2,500 – 5,000 banorë	Vendbanim rural i madh	Jahoc, Rogovë I, Brekoc	3	3.37%
1,000-2,500 banorë	Vendbanim i mesëm i madh rural	Skivjan, Gërçinë, Bec, Kralan, Osek hilë, Cermjan	6	6.74%
500-1,000 banorë	Vendbanim i mesëm rural	Batushë, Doblibare, Dol, Lipovec, Hereç, Qerim, Dujakë, Novosellë e epërme, Nivokaz, Marmull, Molliq, Plançor, Babaj bokës, Ponoshec, Dobrosh, Brovinë, Rakovinë, Meje, Devë, Novosellë e poshtme, Shishman i bokës	21	23.60%
200-500 banorë	Vendbanim i vogël rural	Bardhaniq, Smolicë, Duzhnjë, Korenicë, Vogovë, Firzë, Jabllanicë, Smaç, Bishtazhin, Llugaxhi, Ujz, Fshaj, Zhabel, Raqë, Trakaniq, Moglicë, Dallashaj, Gërgoc, Janosh, Berdosanë, Popovc, Zhdrellë, Vraniq, Pacaj, Rashkoc, Osek pashë, Palabardhë, Nec, Madanaj, Bitesh, Pjetërshan,	31	34.83%
<200 banorë	Vendbanim shumë i vogël rural	Kusar, Rracaj, Rrezinë, Kushavec, Ramoc, Lugbunar, Morinë, Stubëll, Meçe, Sheremet, Dobrixhë, Firajë, Rrypaj, Berjah, Kodrali becit, Guskë, Zhub, Sopot, Orize, Goden, Zylfaj, Rakoc, Çerret, Koshare, Radoniq, Rugove II	26	29.21%



Harta nr.___ e vendbanimeve formale sipas madhësisë

3.5.3. Objektet afariste

Objektet afariste - strukturë heterogjene e ndërtimeve në Komunën e Gjakovës ku dominon në vendbanimet urbane dhe rreth akseve rrugore, ku ka qasje dhe frekuentim më të madh të njerëzve dhe automjeteve. Këto objekte ku zhvillohen veprimtari të ndryshme ndahen në dy grupe: objekte të ndërtuara urbane, me destinime të përbashkëta, me banim kolektiv në katet më të larta, ndërsa me destinacion të veprimtarisë në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme afariste: tregtare, shërbyese, zejtare, kulturore, shëndetësore, etj. Brenda hapësirave urbane afarojnë edhe biznese me objekte të cilat disponojnë sipërfaqe të mëdha të cilat merren me shërbime, si : qendrat tregtare, bao-marketet, stacionet e derivateve, objekte prodhimi etj. Bizneset që afarojnë me objekte prodhuese, deponime të materialeve të ndryshme, materialeve lehtë-ndezëse apo materiale të rrezikshme janë të ndërtuara në zona/park biznesi me destinacion dhe planifikim hapësinorë dhe urbanistik, në pajtueshmëri me PZHK dhe normat ligjore në fuqi. Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë komunale mund të jenë:

- ✓ Industria dhe bizneset me ndotje të vogël;
- ✓ Industritë/bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore dhe të importuara, (me materie të rrezikshme, lehtëndezëse, shpërthyese, etj);
- ✓ Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produkte bujqësore.

Objektet më të mëdha biznesore kanë një shtrierje dhe kryesisht janë të koncentruara përgjatë akseve kryesore të qytetit, konkretisht përgjatë rrugës tranzite duke vazhduar në drejtimin e Prizrenit, pastaj drejtimi Gjakovë-Deçan, Gjakovë-Prishtinë dhe në drejtim të Rekës së Keqe. Derisa bizneset e mesme e të vogla kryesisht kan shtrierje në zonën urbane dhe disa zona më periferike të qytetit.[31]

[31] Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2020-2022

3.5.4. Objektet sportive

Në përgjithësi infrastruktura sportive në komunën e Gjakovës është ka shënuar përparim për shkak të investimeve që janë bërë në infrastrukturën për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Sidomos ndërtimi i Stadiumit të ri të qytetit i cili është në fazën finale të punimeve sipas kritereve ndërkombëtare. Aktivitetet sportive zhvillohen në kuadër të objekteve sportive që janë të shpërndara si në zonën urbane po ashtu edhe në atë rurale. Përveç ndërtimit të stadiumit të futbollit i cili është në fazën finale, është ekziston Qendra Sportive "Shani Nushi" me fushën e futbollit në aneks të saj, pastaj tereni sportiv në Dardani, objektet e hapura sportive në lokacionin e Shkugëzës e cila disponon fushën e hapur dhe me palestrën sportive, si dhe 6 salla të edukatës fizike në kuadër të shkollave fillore dhe 2 salla të edukatës fizike në kuadër të shkollave të mesme, 4 pishina të notit, të cilat shfrytëzohen për aktivitete rekreative-sportive verore. Mungesa e infrastrukturës për të gjitha disiplinat e sportit dhe financimi i kufizuar janë disa nga faktorët kryesorë sfidues në nivelin komunal.

3.5.5. Objektet kulturore

Tabela 45. Lista e objekteve kulturore

#	Institucioni	Veprimtaria dhe lokacioni
1	Pallati i Kulturës Teatri kombëtar	Është themeluar më 1977. Aktivitetin e saj e zhvillon në teatrin e kulturës "Asim Vokshi".
2	Muzeu i qytetit	Ky institucion prezanton vlerat me rëndësi historike dhe artistike të qytetit të Gjakovës ndër vite. Aktiviteti i saj zhvillohet në objektin e saj përballë objektit të Kuvendit Komunal.
3	Enti për mbrojtjen e monumenteve historike	Enti ka për synim ruajtjen dhe konservimin e monumenteve me vlera historike dhe shpirtërore. Ndërtesa e këtij instituti gjendet në "Çarshinë e Vjetër".
4	Biblioteka rajonale "Ibrahim Rugova"	Objekti i Bibliotekës rajonale është inauguruar në Qershor 2009, gjendet afër objektit të pallatit të kulturës.
5	Arkivi i qytetit	Ky institucion me rëndësi të veçantë për arkivimin e dokumenteve gjendet në afërsi të qendrës së qytetit (Kulla e Kryezive).
6	Pallati i Kulturës "Asim Vokshi"	Pallati i kulturës " Asim Vokshi " i ndërtuar me vetëkontributin e qytetarëve të Gjakovës ka filluar punën me 7 Korrik të viti 1977. Objekti është i lokalizuar në qendër të qytetit të Gjakovës ka afro 6000 metra katrorë.
7	Pallati i Sporteve "Shani Nushi"	Është i vetmi objekt sportiv i tipit të mbyllur, i ndërtuar sipas standardeve më të larta, me një kapacitet prej 450 m^2 , dhe 1.800 ulëse. Objekti gjendet në pjesën lindore të qytetit përgjatë së cilës shtrihet rruga transite Prizren-Pejë.

3.6. STREHIMORET DHE OBJEKTET PËR STREHIM

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë fenomene apo incidente të papritura dhe me pasoja të mëdha në njerëz dhe të mira materiale, që për pasoj mund të ketë humbje të jetës së njerëzve dhe dëme materiale në përmasa të pa parashikuara. Në situata të tilla paraqitet nevoja për evakuim dhe strehim të popullatës dhe përkujdesjen dhe mirëqënien e saj. Bazuar në Dokumenntin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga FNFT si dhe planeve reaguese emergjente lokale, krahas evakuimit dhe strehimit, paraprakisht duhet planifikuar evakuimi, strehimi dhe përkujdesja, duke pasur në konsideratë, kushtet e nevojshme për jetë, ushqim, veshmbathje, sigurimin e mjete materiale të domosdoshme për furnizimin, mjetet higjienike, sigurinë dhe qështje të tjera sipas planeve paraprake, për të gjithë të evakuuarit nga vendbanimet e përhershme. Është përgjegjësi dhe detyrim ligjor që komuna e Gjakovës të bëjë zhvendosjen e përkohshme (evakuimin) e banorëve nga zonat e rrezikuara në lokacione të sigurta, duke ndërmarr të gjitha veprimet e duhura për sistemimin e tyre.

3.6.1. Përcaktimi i lokacioneve (zonave) të grumbullimit në rast fatkeqësie

Në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (në tekstin e mëtejmë FFNT), kur nevojitet zhvendosje masive e komunitetit nga një zonë e caktuar, janë paraparë zona në të cilat ofrohet një ambient i sigurtë dhe që nuk i ekspozohet rrezikut. Planifikimi për evakuim të qytetarëve brenda juridiksionit komunal bëhet paraprakisht nga organi kompetent lokal, respektivisht nga strukturat komunale përgjegjëse për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë bazuar në Planin lokal për evakuim.[32] Varësisht nga lloji i fatkeqësisë dhe vlerësimi paraprak i rrezikut, përcaktohen lokacionet e caktuara që plotësojnë kushtet elementare për strehim dhe të jenë të mbrojtur nga efektet anësore të fatkeqësisë, kurse në raste të nevojës së qëndrimit afatgjatë mund të ndërtohen edhe kampe të përkoshme, me ç'rast paraprakisht duhet të bëhet:

[32] *Sistemi i Integruar për Menaxhimiin e Emergjencave QRK/2010*

Përcaktimi i lokacioneve (zonave) të grumbullimit të qytetarëve në rast fatkeqësie;

- ✓ Udhëzimet e detajuara për qytetarët mbi mënyrën dhe kohën e evakuimit;
- ✓ Evidentimi e familjeve/personave për evakuim;
- ✓ Organzimin i transportit për personat e evakuuar;
- ✓ Shenjëzimet informuese dhe përcaktimi i rrugëve të evakuimit / drejtimet e evakuimit;
- ✓ Akomodimi

Gjatë fazës së hartimit të planit të evakuimit duhet pasur kujdes në prioritizimin e kategorive të veqanta të komunitetit, bazuar në profilin e komunitetit. Zonat e grumbullimit dhe akomodimit mund të jenë: strehimoret klasike, të adoptuara,
Në territorin e Komunës së Gjakovës ekzistojnë gjashtë (6) strehimore nëntokësore. Aktualisht këto strehimore nëntokësore nuk janë të mirëmbajtura dhe janë jashtë funksionit, pasi që me aplikimin e privatizimit dhe mosdefinimit të statusit të ndërmarrjeve shoqërore, ato ose janë të braktisura dhe pa kompletuara, ose kanë ndërruar destinacionin duke u shëndërruar në objekte komerciale-biznesi,etj. Andaj, në këto strehimore mund të llogaritet vetëm nëse plotësohen kriteret e përcaktuara dhe me marrëveshje përkatëse të definohet qartë menaxhimi i tyre, respektivisht duke bërë transformimin e tyre të shpejtë për qëllime të strehimit.

3.6.2. Lokacionet, kapaciteti dhe titullari

Përveç strehimoreve nëntokësore ekzistojnë edhe objekte të ndryshme të cilat mund të shfrytëzohen për strehim të popullatës.
Momentalisht Gjakova nuk posedon me objekte të dedikuara enkas për strehimore kolektive, mirëpo, ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i objekteve të cilat për një kohë relativisht të shkurtë dhe me pajisje e përgatisje përkatëse mund të shfrytëzohen si objekte për strehim të përkohshëm, e ato i paraqesim në:

Tabela 46. Lokacionet dhe kapacitetet për strehimin e banorëve

	Lloji i strehimores/ Objektet për S	**Lokacioni**	**Agjensioni menaxhues**	**Kapaciteti në individ**	Koha e qëndrimit në orë		
					Afatshu rtë (48)	Afatme sëm (15diitë)	Afatshg jatë (deri në60 dt)
1	Nëntokësore	N.Tereza	Viva Fresh (ish NT"Agimi"	130 JF	X		
2	Nëntokësore	UÇK	Bankkosi	85 JF	X		
3	Nëntokësore	N.Tereza	Hotel Pashtriku	100 JF	X		
4	Nëntokësore	UÇK	Post Telekomi i Kosovës	70 JF	X		
5	Nëntokësore	Skendërbeu	Banesë kolektive-Orize	50 JF	X		
6	Nëntokësore	Skendërbeu	Banesë kolektive-Orize	50 JF	X		
7	Konvikt banimi	M.Teuta	Komuna e Gjaokvës	120 F			X
8	Aeroporti ushtarak	Fsh.Lugbunar	Ministria e Mbrojtjes	150 F			X
9	Pallati sporteve	Tirana	Kuvendi Komunal	200 F		X	
10	Pallati kulturës	UÇK	Kuvendi Komunal	150 F		X	
11	25 objekte shkollore	Në tërë komunën	Kuvendi Komunal	625 F		X	
			Gjithsejtë:	**1,730**			
12	Kapacitete Hoteliere	Njësi akomoduese	Dhoma	Shtretër			
		30	404	**768**			X
			Gjithsejtë kapaciteti për strehim	**2,498**			

Në situata emergjente, në rrethana kur është e domosdoshme evakuimi dhe strehimi i përkohshëm i banorëve, institucioneve dhe subjekteve private e publike, në kuadër të shfrytëzimit të lokacioneve/objekteve për strehim, për objektet që janë jashtë juridiksionit të saj, Komuna e Gjakovës duhet të ketë marrëveshje përmes memorandumeve të mirëkuptimit me:

- ✓ Subjektet afariste hoteliere;
- ✓ Komunitetin e biznesit-sektorin e ndërtimit, prodhimit e të ngjajshme;
- ✓ Ministrinë e Industrisë dhe Inovacionit për shfrytëzimin e kapaciteteve strehuese në aeroportin e Gjakovës, dhe
- ✓ Titullarët e objekteve në pronësi publike jashtë juridiksionit të komunës.

3.6.3. Gjendja e strehimoreve/objekteve

Përgjegjësitë e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera janë të rregulluara me Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Nr.04/L-027. Ato kategorizohen si strehimore për mbrojtje elemnetare që siguron mbrojtje nga mbipresioni, rrënojat, radioaktiviteti, zjarri dhe materiet kimike-biologjike, ndërsa ato plotësuese mbrojtje nga rrënojat. dhe plotësuese.[33]

Strehimoret mund të kenë destinim të dyfisht dhe gjithë titullarët në raste emergjente ato duhet të jenëtë gatshme për përdorim mbrenda 24 orëve.

Pronarët janë të obliguar të mirëmbajnë strehimoret në përputhje me qëllimin që kanë dhe nuk lejohen të që bëhen ndryshime të cilat dobësojnë strukturën e saj.

Financimi i ndërtimit të strehimoreve në sektorin privat bëhet nga investitori, ndërsa me qëllim të përkrahjes së tyre, shteti mund të ofroj garanci dhe subvencione.

Sipas konceptit të athershëm të mbrojtjes popullore dhe plotësimit të kritereve tekniko-ndërtimore, në Komunën së Gjakovës kanë ekzistuar gjashtë (6) strehimore nëntokësore të ndërtuara në kohën e ish sistemit. Aktualisht këto strehimore nëntokësore nuk janë të mirëmbajtura dhe janë jashtë funksionit, pasi që me aplikimin e privatizimit dhe mosdefinimit të statusit të ndërmarrjeve shoqërore, ato ose janë të braktisura dhe pa kompletuara, ose kanë ndërruar destinacionin duke u shëndërruar në objekte komerciale-biznesi,etj. Andaj, në këto strehimore mund të llogaritet vetëm nëse plotësohen kriteret e përcaktuara dhe me marrëveshje përkatëse të definohet qartë destinimi dhe menaxhimi i tyre, respektivisht duke bërë transformimin e tyre të shpejtë për qëllime të strehimit konformë ligjit në fuqi.

***Historiku*:** Strehimoret publike në të kaluarën kanë qenë në përkujdesje të ish Sekretariatit për Urbanizëm si organ përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e tyre. Për faktin se bëhej fjalë për hapësira në kuadër të ish ndërtesave kolektive të karakterit shoqëror, kjo Drejtori është marr me menaxhimin e strehimoreve dhe në mënyrë sistematike ka raportuar për gjendjen e tyre në funksionale në Drejtorinë përkatëse për Mbrojtje dhe Shpëtim (ish Sekretariati për Mbrojtje Popullore). Ndërsa entet dhe institucionet publike, ndërmarrjet shoqërurore etj., të cilat kanë poseduar strehimore, kryesisht për nevojat vetanake janë menaxhuar nga vet ato, njëherit duke raportuar mbi gjendjen e tyre në institucionet përkatëse komunale. Me këto procedura ka ekzistuar një pasqyrë komplete për kapacitetet dhe gjendjen funksionale të tyre.

Me privatizimin e banesave kolektive dhe kalimin e tyre në pronësi private dhe me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve tjera publike, janë krijuar rrethana krejtë tjera, të shoqëruara me një sërë kontestesh e paqartësish pronësore-

[33] Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nr.04/L-027 (Përgjegjësitë e nivelit lokal, f.18,19)

juridike, të cilat sot jo vetëm që krijojnë vështirësi por edhe pamundësojnë çasjen e autoriteteve komunale për vënjen e këtyre ish strehimoreve nën kompetencën e saj.
Bazuar në rrethanat e krijuara, ato strehimore janë plotësisht jashtë funskionit, ndërsa sot as që bëhet fjalë për ndërtimin e tyre qoft nga institucionet publike-private.

3.7. KAPACITETET SHËNDETËSORE PUBLIKE E PRIVATE

3.7.1. Institucionet Shëndetësore Publike

Organizimi, funksionimi, dhe cilësia e shërbimeve të institucioneve publike dhe private shëndetësore, ka avansuar dukshëm në të dy nivelet, atë parësor dhe dytësorë. Shëndetësia e komunës së Gjakovës funkcionon si pjesë integrale e sistemit shëndetësor të Kosovës me një struktur kompakte në kuptimin e ofrimit të shërbimeve të përgjithshme dhe specialistike medicinale. Në situata të Deklarimit të gjendjes emergjente, komuna e Gjakovës mobilizon të gjitha kapacitetet shëndetësore të të dy niveleve vëhen me qëllim të ofrimit të shërbimeve medicinale dhe mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve.



3.7.2. Kapacitetet humane shëndetësore

- ***Spitali Regjional "Isa Grezda"***

Kujdesi shëndetësor sekondar i referohet një niveli më të lartë të sistemit të kujdesit shëndetësor, në të cilin pacientët nga kujdesi shëndetësor parësor udhëzohen për trajtime më të specializuara. Niveli i kujdesit shëndetësor sekondar ofron shërbime specialistike mjekësore për dallim nga niveli i kujdesit parësor. Kujdesi

shëndetësor sekondar ofrohet nga:

Spitali regjional me gjithsejt 426 shtretër dhe personel prej 529 veta, prej të cilëve 426 personel dhëndetësor dhe 103 personel joshëndetësor specialist të profileve të ndryshme ofron shërbime specialistike medicinale, me repartet:

Struktura e Personelit

Kategoria e Personelit	Nënkategoria	Numri i Punonjësve
PERSONELI SHËNDETËSOR		**426**
	Kuadri Mjeksor	**94**
	• Mjekë specialistë	93
	• Kuadër superior mjekësor	1
	Kuadri Medicinal i Lartë & i Mesëm	**332**
	• Motra/teknik i lartë medicinal	111
	• Motra/teknik i mesëm medicinal	221
PERSONELI JOSHËNDETËSOR		**103**
	Personeli Administrativ	**18**
	• Kuadër superior administrativ	18
	Personeli i Shërbimeve Ndihmëse	**85**
	• Kuadër tjetër superior	4
	• Kuadër tjetër i mesëm	47
	• Kuadër i ultë	16
TOTAL I PËRGJITHSHËM		**529**

Burimi: Siptali Rajonal Gjakovë (2025)

DEPARTAMENTET-REPARTET

1.1.Departamenti për Nëna dhe Fëmijë;

1.1.1 Reparti i Obstetrikës (Salla e lindjes),
1.1.2 Reparti i Gjinekologjisë,
1.1.3 Reparti i Pediatrisë,
1.1.4 Reparti i Neonatologjisë.

2. ***Departamenti i degëve Kirurgjike:***

2.1 Reparti i Kirurgjisë,
2.1.1 Reparti i Urologjisë,
2.1.2 Reparti i Ortopedisë,
2.1.3 Reparti i Oftalmologjisë,
2.1.4 Reparti i Otorinolaringologjisë .

3. ***Departamenti i Anestezionit me mjekësi emergjente:***

3.1 Shërbimi i Anestezionit:
- 3.1.1 Shërbimi i Kujdesit Intenziv,
- 3.1.2 Shërbimet e Emergjencës,
- 3.1.3 Trakti operativ me dhomën e zgjimit.

4. ***Departamenti i sëmundjeve të brendshme:***

4.1 Reparti i Sëmundjeve të brendshme,
4.1.1 Reparti Koronar me Kujdesin Intenziv,
4.1.2 Reparti i Sëmundjeve të Kraharorit,
4.1.3 Reparti i Sëmundjeve të Lëkurës,
4.1.4 Reparti i Sëmundjeve ngjitëse,
4.1.5 Reparti i Hemodializes,
4.1.6 Reparti i Neurologjisë.

5. ***Departamenti i Psikiatrisë:***

5.1 Reparti i Psikiatrisë së përgjithshme,
5.2 Reparti i Psikiatrisë së Fëmijëve,
5.3 Reparti i Psikiatrisë Forenzike,
5.4 Reparti i Sëmundjeve të Varësisë.

6. ***Departamenti i Diagnostikës:***

6.1 Shërbimi i Biokimis
6.2. Shërbimet e Diagnostifikimit Radiologjik,
6.3 Shërbimet e Terapisë fizikale,
6.4. Shërbimet për pacientet jashtëspitalor,
6.5 Barnatorja,
6.6 Patologjia me Morgun.+

7 Departamenti i administratës dhe shërbimeve të përbashkëta

#	***Kapacitetet e Spitalit***	
1.	Shtretër stacionar	426
2.	Shtretër portativ/barela	15
3.	Shtretër me rrota	52
4.	Autoambulanca	7
5.	Kapac.transport. në QKUK 24/h	20

Burimi: Spitali Rajonal Gjakovë (2025)

Mjekësisa Familjare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë aktualisht ka 348 punonjës, përkatësisht:

- 34 punonjës udhëheqës;
- 122 punonjës mjekësor me specializim;
- 197 punonjës mjekësor teknik;
- 26 punonjës jo-medicial

Qendra e Mjekësisë Familjare

Emri I institucionit	Vendbanimi	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Mjek të përgjithshëm (nr.)	Mjek në specializim (nr.)	Mjek te specializuar (nr.)	Sipërfaqja e ndërtesës (m^2)
QMF Ereniku nr 5	Gjakove	0.3	0.05	0.25			4	552.00
QMF Dardani nr 10	Dardani	0.15	0.02	0.13		2	2	215.00
QMF Rogovë nr 9	Rogovë	0.14	0.03	0.11	1		1	346.00
QMF Skivjani nr 8	Skivjan	0.13	0.03	0.1	4		1	243.00
QMF Cermjani nr 7	Cermjan	0.16	0.03	0.13	1		1	210.00
QMF Ponoshecinr 6	Ponoshec	0.17	0.03	0.14	1	1	1	224.00
QMF Brekoc nr 3	Brekoc	0.07	0.02	0.05	2		1	191.00
QMF Qabrati nr 1	Gjakove	0.06	0.03	0.03	1		4	180.00
QMF Emin Duraku nr 2	Gjakove	0.06	0.02	0.04			4	197.00
QMF Orize nr 4	Orize	0.45	0.08	0.37			7	197.00
Gjithsejtë	**11**	**3.45**	**0.71**	**2.47**	**27**	**3**	**28**	**4,563.00**

Ambulantat e Mjekësisë Familjare

Në vijim janë paraqitur veçoritë e Ambulantave e Mjekësisë Familjare[34]**:**

Emri I institucionit	Vendbanimi	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Mjek të përgjithshëm (nr.)	Mjek në specializim (nr.)	Mjek te specializuar (nr.)	Sipërfaqja e ndërtesës (m^2)
AMF Damjan nr 16	Damjan	0.1	0.02	0.08	1			186.00
AMF Bishtazhin nr 15	Bishtazhin	0.2	0.06	0.14	1			90.00
AMF Lipovec nr 14	Lipovec	0.12	0.02	0.1	1			190.00
AMF Novoselle nr 13	Novoselle e Eperme	0.15	0.02	0.13	1			160.00
AMF Shqiponje	Shqiponje	0.1	0.02	0.08	1			75.00
AMF Molliq nr 6	Molliq	0.07	0.02	0.05	1			90.00
AMF Sheramet nr 5	Sheremet	0.1	0.02	0.08	1			200.00
AMF Babaj Bokes nr 4	Babaj Bokes	0.07	0.02	0.05	1			76.00
AMF Guske nr 3	Guske	0.06	0.02	0.04	1			120.00
AMF Koronic nr 2	Koronice	0.08	0.02	0.06	1			68.00

[34] *Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2024*

AMF Dol nr 1	Dol	0.1	0.02	0.08	1			140.00
AMF Doblibare	Doblibare	0.1	0.03	0.07	1			120.00
AMF Krelan	Krelan	0.05	0.02	0.03	1			83.00
AMF Gergoc	Gergoc	0.14	0.02	0.12	1			100.00
AMF Bec nr 7	Bec	0.09	0.01	0.08	1		1	60.00
Gjithsejtë	**15**	**1.53**	**0.34**	**1.19**	**15**	**0**	**1**	**1,758.00**

Burimi: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale (2025)

Harta 16. Mbulueshmëria e Komunës me shërbime të shëndet parësor



3.7.3. Kapacitetet teknike reaguese në sektorin publik

Kapacitetet reaguese në sektorin publik, shërbimet e ofruara dhe pajisjet e disponuara në rast të mobilizimit emergjent/ mjetet dhe pajisjet:

Tabela 47. Kapacitetet shëndetësore reaguese publike

Nr.	*Kapacitetet shëndetësore reaguese publike*	Dinamika
1.	Dhënja e ndihmës së parë nga personeli profesional/numri	**20/1 orë**
2.	Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (transporti me AMF)	**106/24 orë**
3.	Kapaciteti i transportit të pacientëve me trajtim medicinal në QKUK	**20/24 orë**
4.	Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë(24 h)	**12**
5.	Numri i shtretërve në Spitalin Rajonal "Isa Grezda"	**426**
6.	Numri i shtretërve në QKMF	**0**
8.	Numri i shtretërve mobil në QMF/AMF	**105**
9.	Numri i barelave/leseve për të lënduar	**70**
10.	Autoambulanca	**11 (QKMF 4, Spitali 7)**
12.	Automjetet e QKMF/QMF për realizim të detyrave dhe shërbimeve	**8**

3.7.4. Kapacitetet medicinale private

Komuna e Gjakovës ka një shtrierje mjaftë të avancuar të kapaciteteve private medicinale dhe aktualisht janë 179 subjekteve që ofrojnë shërbime pothuaj se të të gjitha profileve.

Tabela 48. Numri i klinikave dhe ordinancave Specialistike

#	Lloji i ordinancave/klinikave private dhe barnatoreve	*Numri i farmacive aktive ne komunën e Gjakovës*
1.	*Klinika dhe Ordinanca specialistike*	*74*
2.	*Barnatore*	*40*
3.	*Aktivitetet e praktikes dentale*	*65*
	Gjithsejtë	***179***

Burimi: Drejtoria për Zhvillim ekonomik (20025)

3.7.5. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente

Ekipet Emergjente Medikale (ekipet mobile) në raste të fatkeqësive/incidenteve të mëdha kryejnë shërbime mjekësore emergjente dhe koordinojnë aktivitetet me institucionet relevante. Ekipet e ndihmës së parë i bashkëngjiten shërbimit mjekësorë emergjent dhe i nënshtrohen urdhrave të zyrtarit të këtij shërbimi. Detyrat dhe obligimet e shërbimeve emergjente mjekësore në raste të ngritjes së gatishmërisë emergjente respektivisht reagimit emergjent janë:

- ✓ Ofrimi i ndihmës së parë nga ekipet medicinale në vendin e incidentit,
- ✓ Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacijentit dhe mbajtja e evidencës,
- ✓ Evakuimi dhe transportimi i personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale,
- ✓ Ndërmarrja e masave parandaluese anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,

- ✓ Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive, etj.
- ✓ Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve- këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,
- ✓ Asanimi i terenit në zonën e incidentit
- ✓ Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funkcionim adekuat në situata emergjente, si dhe
- ✓ Detyra tjera, bazuar në specifikat dhe nevojat lokale.

3.7.6. Institucionet e mirëqenies sociale

Në Komunë ka gjithsejtë 4 hapësira të mirëqenies sociale si vijon:

- Qendra për Pune Sociale;
- Shoqata e paraplegjikeve dhe paralizës se fëmijëve të Gjakovës "Handikos";
- Shoqata e shurdhmemecëve;
- Shoqata e te verbërve

Kreu i IV-të

4. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT

4.1. Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)[35]

Territori i komunës së Gjakovës është i mbuluar mirë me rrjetin rrugor. Sipas kërkesave për lëvizje, infrastruktura rrugore përgjithësisht është përmirësuar në aspektin e përmbushjes se kritereve teknike. Sfiduese mbetet një pjesë e rrugës nacionale N-9.1 e cila kalon nëpër zonën urbane dhe nuk ofron nivel të mjaftueshëm të shërbimit në përmbushje të kërkesave të kapacitetit dhe të sigurisë për lëvizjen e mjeteve. Kjo pjesë e rrugës kalon nëpër zona atraktive në të cilën zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe lëvizje të pamotorizuara që ndikojnë në zvogëlimin e kapacitetit të rrugës dhe sigurinë në trafik. Duke iu referuar ligjit mbi rrugët, rrugët publike, kategorizohen në:

- Autoudhë;
- Rrugë nacionale;
- Rrugë rajonale dhe
- Rrugë lokale.

Nëpër territorin e Komunës së Gjakovës nuk kalojnë autoudhë. Lidhja më e afërt e Gjakovës është në autoudhën "Ibrahim Rugova" (afërsisht 30 km) në Prizren.

Përveç autoudhëve të cila nuk përfshihet në kuadër të rrjetit rrugor të komunës së Gjakovës, të gjitha rrugët tjera (sipas kategorive të mësipërme) kalojnë nëpërmjet territorin e Komunës së Gjakovës.

Në territorin e komunës gravitojnë 3 kategori të rrugëve publike të tri kategorive: Nacionale N-9.1, Rajonale R-10 dhe R-203 dhe R-109 dhe Lokale. Në kuptimin administrativ, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve magjistrale dhe Rajonale është nën autoritetin përgjegjës të Ministrisë së Infrastrukturës, ndërsa, rrugët lokale menaxhohen nga pushteti lokal. Vlen të theksohet se Komuna e Gjakova ka dy pika kufitare me R.Shqipërisë dhe atë në : Qafë Prush (është pjesë e rrugës regjionale R-203) dhe Qafë Morinë (është pjesë e magjistrales M.9.1).

4.1.1. Rrugët nacionale

Ruga Nacionale N-9.1 e cila vjen nga Prishtina dhe kalon në pjesën lindore të qytetit me dalje në pjesën veriore të Shqipërisë,vendëkalimi në pikën kufitare Qafë Morinë. Segmenti i kësaj rruge nacionale që kalon nëpër territorin e komunës së Gjakovës ka gjatësi prej 38 km duke lëto vendbanime të saj:
Rakovinë – Meqe – Qerim – Gjakovë – Meje – Korenicë – Duzhnje – Shishman – Popoc – Ponoshec – Morinë

4.1.2. Rrugët rajonale

Katër rrugë rajonale e lidhin Gjakovën me qytetet dhe fshatrat tjera në Kosovën perëndimore. Një ndër rrugët më të rëndësishme rajonale është rruga rajonale R-107 e cila e lidhë Gjakovën me Pejën dhe Prizrenin.
Rruga tjetër, gjithashtu mjaft e rëndësishme e cila ndërlidhet me rrugën nacionale N9-1, është rruga rajonale R-203 e cila kalon nëpër neper qytetin e Gjakovës dhe mundëson lidhjen me qytetin e Kukësit në Shqipëri. Ndërsa, përmes rrugës

[35] Infrastruktura e Transportit dhe Transporti Rrugor- Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030, f.102,274

rajonale R-109, Komuna e Gjakovës lidhet me Junikun Deçanin dhe Pejën.
Përgjithësisht rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike. Pjesa më e madhe e tyre janë të asfaltuara, por kanë nevoje për mirëmbajte, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese më qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete.

1	Gjakovë- Pejë (R-107)	Me gjatësi ~12 km në territorin e komunës, përshkon këto vendbanime: Hereq-Dujakë-Planqor-Skivjan-Osek Hylë-Gjakovë.
2	Gjakovë- Prizren (R-107)	Me gjatësi ~10.5km në territorin e komunës, përshkon vendbanimin Bishtazhin.
3	Gjakovë – Qafë Prush (R.203)	Me gjatësi ~9.5km në territorin e komunës, përshkon këto vendbanime: Brekoc-Zhub-Qafë Prush
4	Bishtazhin-Damjan (R.112) Kufiri administrativ i Komunës	Me gjatësi ~14.5km përfshinë: Bishtazhin-Smaq-Lipovec-Gërqinë-Damjan.
5	Ponoshec-Botushë- (R.109) Kufiri administrativ i Komunës	Me gjatësi ~6.5km përfshinë: Ponoshec-Brovinë-Molliq-Botushë.

4.1.3. Rrugët urbane

Rrugët në qytetin e Gjakovës, kryesisht janë me nga dy korsi trafiku (2x1), përveç rrugës "Tirana",pastaj Qendra rr"Bardhyl Qaushi-Pashko Vasa (Dardani) -Dardani dhe nga rrethi në rr "Skenderbeu-Gaspër Karaqi në dalje për Prizren e cilat kanë nga dy korsi trafiku për kahe, nga qendra dhe rruga "Nënë Tereza" e cila është rrugë një kahore me dy korsi për kahje (1x2).

Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda qytetit të Gjakovës kanë karakter të ndryshëm. Rrugët e karakterit më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të karakterit më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklist.

Qyteti i Gjakovës disponon me rrjetin e rrugëve kryesore në brendi të qytetit. Në zonën më të re, "Blloku i ri", rrugët kryesore janë të gjëra, shumica të asfaltuara, dhe pjesërisht të furnizuara me trotuare. Në pjesët tjera të qytetit, rrjeti është më pak i ngarkuar. Rrugët kryesore në pjesët tjera të qytetit janë të ngushta, dhe kanë standard të ulët. Si rezultat, pengesat e trafikut, dhe bllokimet e rrugëve janë të zakonshme. Në veçanti qyteti i vjetër ka probleme rreth të qasjes brenda tij.

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030

Mënyra e udhëtimit në brenda Komunës së Gjakovës	
Ecje në këmbë	58,5%
Udhëtimi me veturë	16,0%
Udhëtimi me autobus	13,5%
Biçikletë	12,0%

Harta 17. Ttrafiku dhe infrastruktur teknike në qytet





Figura 18. Rrugët njëkahëshe, rreth rrotullimet dhe udhëkryqet

Pas analizës së kapacitetit në hyrje të udhëkryqeve në qytetin e Gjakovës, është vlerësuar se, problemi i cili ndërlidhet me kapacitetin ka të bëjë kryesisht me qarkullimin në udhëkryqe, respektivisht elementet gjeometrike të udhëkryqeve, numrin e korsive të trafikut dhe rregullimin e qarkullimit në hyrje të udhëkryqeve. Në rrethrrotullimin ku kryqëzohen rrugët "Skenderbeu", "Tirana" dhe rruga rajonale "R107" (Gaspër Karaqi) dhe rrethrrotullimin ku kryqëzohen rrugët "Hysni Dobruna", "Mitat Frashëri" dhe rruga "Sylejman Hadum Aga", gjatë orëve kulmore kapaciteti i shfrytëzimit të rrethrrotullimeve është afër shkallës së ngopjes. Ndaj, në situata fatkeqësie, krize apo incidenti, njësitë për reagim emergjente mund të ballafaqohen me vonesa apo ngecje të theksuara në këto segmente dhe akse rrugore, sidomos gjatë muajit korrik dhe gusht kur fluksi i qarkullimit është dukshëm më i madhe se gjatë periudhave të tjera të vitit.
Prandaj, në këto udhëkryqe duhet të ndërmerren masat adekuate për rritjen e kapacitetit. Ndërsa në udhëkryqet dhe rrugët periferike kapacitetei i shfrytëzimit është në nivel më të mirë.
Komuna e Gjakovës është në fazën e hartimit të Planit të mobilitetit për të pasur të dhëna më të detajuara.

Grafiku 16. Intensiteti i trafikut brenda 24 orëve në rr.Tranzite N-9.1





Harta 19. Linja urban

4.1.4. Rrugët në vendbanimet lokale

Komuna e Gjakovës, gjatë dekadës së fundit ka bërë investime të mëdha në infrastrukturën rrugore në të gjithë territorin e saj, është bërë një rrjetizim i qytetit dhe të vendbanimeve me njëra-tjetrën. Gjendja e përgjithshme e rrugëve mund të konsiderohet të jetë e mirë për faktin se tani më është në fazën finale të përmbylljes së infrastrukturës rrugore në pjesën urbane e rurale. Rrugët lokale që lidhin qytetin dhe fshatrat shumica janë të asfaltuara, sikur edhe rrugët në brendi të fshatrave, përveç në disa lagje të veçuara. Në disa zona ka nevojë për përmirësim dhe zgjerim të rrugëve (sidomos ne vendbanimet e zonave kodrinore- malore). Prej rrugëve të asfaltuara, vetëm disa prej tyre kanë trotuare ndërsa përmirësimi i hapësirave për këmbësorë mbetet që të trajtohen.

Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore të karakterit lokal menaxhohet nga komuna së Gjakovës konform Ligjit për për Prokurim Publik, ndërsa në situata të gjendje së jashtëzakonshmem kur kemi të bëjmë me fenomene natyrore dhe fatkeqësi të tjera të mëdha që tejkalojnë kapacitetet e rregullta të mirëmbajtjes, komuna bënë mobilizimin e e të gjitha kapaciteteve teknike ndërtimore për sanimin e gjendjes siç është paraparë me dispozitat e Ligjit për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësive tjera.

Tabela 49. Rrugët lokale-rurale[36]

Nr.	Relacioni	Distanca në Km
01.	Gjakovë - Ura e Tabakut – Meje - Ramoc – Madanaj – Rracaj – Sheremetaj – Dobrosh - Nivokaz	24
02.	Gjakovë – Bishtazhin – Smaq - Rruga Dem. – Lipovec – Gëqinë - Demjan 2 - Demjan	21
03.	Gjakovë - Parku i Lirisë – Moglicë – Raçë – Pjetershan - Dol	08
04.	Gjakovë – Bishtazhin – Smaq – Lipovec – Gërqinë – Prroni – Damjan – Lagja e Shehut Damjan	20
05.	Gjakovë - Ura e Tabakut – Orize - Korenicë- Duzhnje - Babaj Bokës – Shishmon i Bokës	18
06.	Gjakovë – Smolic – Korenicë – Stubëll – Berjahë - Nivokaz	20
07	Gjakovë – Lugbunar – Kodra e Becit – Bec – Kodrali - Cërmjan	12
08.	Gjakovë – Osekë Pashë – Trakaniq – Novosellë e Poshtme - Novosellë e Epërme - Dobrigje	12
09.	Gjakovë – Lugbunar - Kodra e Becit – Bec – Kodrali – Cërmjan – Q. Sukes – Rruga e Alisë – Gërgoc – Bardhaniq – Zhabel - Shqiponjë	28
10.	Gjakovë – Lugbunar - Bec - K. e Becit - Bec - Bec 1 - Zhdrellë	12
11.	Gjakovë - Lugbunar - K. e Becit – Sopot – Janosh - Palabardh - Bitesh	12
12.	Gjakovë – Vraniq – Doblibare - Berdosan	15
13.	Gjakovë – Orize – Korenicë – Duzhnje – Nec - Rr. Babaj Bokës –Shishman – Smolicë – Popoc – Ponoshec – Brovinë – Molliq -Batushë	22
14.	Gjakovë- Qerim – Lugbunar – Kodra e Becit – Vraniq – Kodra Meqë – Meqë – Gjekaj – Rakovinë - Kralan	23

[36] "Plani i Mirëmbajtjes së rrugëve lokale "- Drejtoria komunale për Shërbime Publike, Gjakovë

Harta 17. Rrugët lokale-rurale



4.1.5. Siguria në trafik

Vlerësimi i sigurisë në trafik në rrugët kryesore në Komunën e Gjakovës është e bazuar në analizën nga të dhënat analitike të ofruara nga sektori i sigurisë,për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Gjakovës Të dhënat janë paraqitura ndër vite kanë për qëllim vlerësimin dhe trendin e ngjarjeve/aksidenteve rrugore si dhe pasojave sipas metodës krahasuese[37];

Tabela 50. Struktura e aksidenteve në trafik 2020-2024, Burimi:PK/2025

AKSIDENTET NË TRAFIK-Vetëm për NJRTRR-DRP Gjakovë					
Viti	**Aksidente fatale**	**Persona të vdekur**	**Aksidente me lëndime**	**Persona të lënduar**	**Aksidente me dëme materiale**
2020	2	2	238	432	73
2021	7	10	349	704	97

37

2022	4	5	356	716	76
2023	7	7	389	772	107
2024	2	2	371	750	81
Gjithsejtë:	22	26	1703	3374	434

Analizat e statistikave nga aksidentet dhe trendet e tyre korresponduese mbeten njëra nga sfidat kryesore në zhvillimin e një programi të për sigurinë rrugore në Komunën e Gjakovës. Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës- Njësia e Trafikut Rajonal në Gjakovë lidhur me numrin e aksidenteve në Gjakovë vërehet se gjendja në komunikacionin rrugor gjatë periudhës së regjistruar 2020 deri 2024 flet për një rritje të lehtë të aksidenteteve me lëndime dhe persona të lënduar dhe të sipas burimeve të trafikut rrugor.

4.1.6. Burimet e rreziqeve në infrastrukturën rrugore (identifikimi dhe vlerësimi)

Identifikimi dhe vlerësimi i burimeve të rreziqeve në infrastrukturën rrugore përfshin analizimin e faktorëve që mund të shkaktojnë probleme në sistemin e trafikut. Disa nga burimet kryesore të rreziqeve janë:

Faktorët Natyrorë- Moti ekstrem: përmbytje, dëborë e madhe, ngricat dhe acari, shtrëngatë shiu, dhe erëra të forta mund të dëmtojnë rrugët dhe të shkaktojnë aksidente.

Toka e paqëndrueshme: Rrëshqitjet e tokës mund të shkaktojnë bllokime dhe dëmtime të infrastrukturës.

Faktori njëri: mospërshtatja e shpejtësisë, përdorimi i celularëve, alkooli dhe ndikuar nga lodhja janë shkaktarë të rëndësishëm të aksidenteve.

Këmbësorët dhe përdoruesit e tjerë: Mosrespektimi i rregullave të qarkullimit nga këmbësorët, çiklistët ose përdoruesit e mjeteve motorike.

Faktorët Teknikë- Dizajni i infrastrukturës: Rrugë të ngushta, kthesa të rrezikshme dhe ndriçim i pamjaftueshëm.

Dëmtimi i materialeve ndërtimore, si asfalti i degraduar ose rrugët e papërshtatshme.

Faktorët Organizativë - Mungesa e mirëmbajtjes: Rrugët që nuk mbahen në gjendje të mirë mund të krijojnë kushte të rrezikshme për trafik.

Planifikimi dhe menaxhimi i trafikimit: Mungesa e planifikimit të mirë të trafikut dhe lëvizjes mund të çojë në rritjen e aksidenteve.

Faktorët Ekonomikë - Investimet e pamjaftueshme: Mungesa e fondeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mund të rrisë rrezikun.

Kostot e sigurisë: Mungesa e investimeve në teknologjitë e sigurisë, si semaforët inteligjentë dhe sistemet e monitorimit.

Masat parandaluese me qëllim të zvoglimit-zbutjes së rreziqeve në trafik dhe rekomandime:

Masa parandaluese për zvoglimin e rreziqeve në trafik janë të rëndësishme për të siguruar një ambient të sigurt për të gjithë. Ja disa nga këto masa:

Fushata edukative: Organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit mbi sigurinë në trafik, përfshirë rregullat e qarkullimit dhe sjelljen e përgjegjshme.

Trajnime për shoferët: Ofrimi i kurseve të trajnimit për shoferët për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe njohuritë mbi sigurinë.

Infrastrukturë e Sigurt- Rrugë dhe kalime të sigurta: Projektimi i rrugëve dhe kalimeve për këmbësorë që të jenë të dukshme dhe të lehta për t'u përdorur.

Sinjalistika e qartë: Vendosja e shenjave të qarta dhe të dukshme, si dhe ndriçimi i mjaftueshëm në zonat me rrezik.

Rregullat e qarkullimit - Zbatimi dhe forcimi i rregullave të qarkullimit, si kufizimet e shpejtësisë dhe ndalimi i përdorimit të celularëve gjatë drejtimit.

Sanksionet për shkelësit: Aplikimi i sanksioneve për ata që shkelin rregullat e qarkullimit, për të rritur ndjeshmërinë ndaj ligjit.

Përdorimi i teknologjisë

- Integrimi i sistemeve të menaxhimit të trafikut, si semaforët inteligjentë dhe monitorimi në kohë reale,
- Automjetet e mençura: Nxitja e përdorimit të automjeteve me teknologji të avancuar që ndihmojnë në parandalimin e aksidenteve.

Pjesëmarrja e Komunitetit - Bashkëpunimi me organizatat lokale: Angazhimi i organizatave lokale dhe komunitetit për të promovuar sigurinë në trafik.

- Iniciativa për ruajtjen e sigurisë: Krijimi i grupeve të punës për të identifikuar problemet dhe për të zbatuar zgjidhje të efektshme.
- Monitorimi dhe Rishikimi - Analiza e aksidenteve: Vlerësimi i statistikave të aksidenteve për të identifikuar zonat e rrezikshme dhe për të zhvilluar masa specifike.

Implementimi i këtyre masave mund të ndihmojë në uljen e numrit të aksidenteve dhe të rrisë sigurinë për të gjithë përdoruesit e rrugës. Këto burime rreziku duhet të merren parasysh në çdo fazë të planifikimit dhe menaxhimit të infrastrukturës rrugore për të minimizuar rreziqet dhe për të rritur sigurinë e trafikimit.

4.2. Hekurudhat

Nuk ekziston linjë e drejtpërdrejtë hekurudhore deri në Gjakovë, por në afërsi të saj kalon linja hekurudhore Prizren-Klinë në gjatësi 58 km me dy tunele.

Kjo linjë hekurudhore në dy lokacione kalon afër Gjakovës, dhe atë në Xërxe 12 km, dhe në Kramovik 19 km.

Me planin Zhvillimor Komunal 2022-2030 është planifikuar lidhja Komunën e Gjakovës me rrjetin hekurudhor të Kosovës i cili rrjet do të shtrihet edhe në drejtim të Republikës së Shqipërsisë, në pjesën veriore të saj, me destinacion Shkodrën.

Harta 20. Rrjeti hekurudhor

4.3. Transporti ajror/aeroporti

Në territorin e Komunës së Gjakovës, respektivisht në lokacionin Lugbunar gjendet ish aeroporti ushtarak i ndërtuar nga Qeveria e Italisë si logjistikë ushtarake për nevojat e KFOR-it në Kosovë. Aeroporti gjendet 7 km në veri të Qytetit të Gjakovës me koordinata DM-537-965 i ndërtuar menjëherë pas luftës së vitit 1999. Me përfundimin të mandatit të saj, Qeveria e Italisë ia kalon këtë infrastrukturë të transportit ajror Qeverisë së Republikës së Kosovës për nevojat e saj. Kapacitetet logjistike të këtij aeroporti disa herë janë shfrytëzuar nga Komuna e Gjakovës për strehimin dhe akomodimin e përkohshëm të banorëve të evakuuar nga vërshimet, sidmos gjatë vitit 2021 dhe 2022, me pëlqimin e autoriteteve qendrore.

Foto 6. Aeroporti ushtarak - Lug Bunar



Nga të dhënat e deritanishme rezulton se zona e aeroportit të Gjakovës dallohet me faktin se kjo pjesë e territorit karakterizohet me më pak pengesa atmosferike si mjegull, erëra të forta, ngrica me kohëzgjatje të madhe etj., dhe se në afërsi të drejtpërdrejt të tij nuk ekzistojnë objekte të rrezikshmërisë së lartë, gjë që e klasifikojnë këtë aeroport ndër më të sigurt në këtë drejtim. Rrugët komunikuese nga aeroporti në relacion me qytetin e Gjakovës dhe vendbanimet tjera në rajon janë të natyrshme,të ndërtuara sipas standardeve të kërkuara. Gjithashtu edhe afërsia me nyjet hekurudhore (Ratkoc dhe Xërxe të komunës së Rahovecit) i jep rëndësinë e veçantë kësaj infrastrukture aeroportuale.

4.4. Urat dhe tunelet

4.4.1. Urat

Është me rëndësi të potencohet fakti se në kuadër të infrastrukturës rrugore të kategorive nacionale dhe rajonale, ekziston një numër i urave me interes vital qarkullimin dhe transportin në drejtim të Gjakovës dhe anasjelltas, të cilat duhet trajtohen si asete të rëndësisë së veçant.

Tabela 51. Urave përgjatë rrugëve nacionale dhe rajonale[38]

	Lokacioni	GPS	Karakteristikat			Fizibiliteti i qarkullimit		
			Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Të gjitha llojet e automjeteve ushtarako – civile (rënda)	Të gjitha llojet e automjetev e civile	Automjet et e lehta motorike
1	Ura te Rrethi rr,Wesley Clark		72	10	7	X		
2	Ura e Becit		62	9.5	7	X		
3	Ura e Meqës		95	9.5	12	X		
4.	Ura e Kramovikut		97	9.5	10	X		
5.	Ura te rrethi N.Bakija		36	9.5	7	X		
6.	Ura e Terzive		198	9.5	8	X		
7.	Ura e Fshejtë		63	7	18	X		
8.	Ura e Tabakëve		112	8	8	X		
9.	Ura e Musë Ymerit		54	8	5	X		

4.4.2. Tunelet

Në territorin e komunës së Gjakovës nuk ka tunele.

4.5. SISTEMI ENERGJETIK [39] (objektet dhe sistemet)

Distrikti në Gjakovë si organizatë me karakter të veçantë në komunë paraqet pjesë integrale e Koorporatës elektroenergjetike të Kosovës i cili bënë distribuimin e energjisë deri tek konsumatorët në kuadër të konsumit të Qytetit dhe 91 fshatrave-vendbanimeve.

Gjendja e furnizim me energji elektrike është kryesisht e mirë dhe stabil. Furnizimi i konsumatorëve të qytetit të Gjakovës dhe fshatrave të kësaj komune bëhet nëpërmjet nënstacioneve elektrike ekzistuese te rrjetit transmetues te republikës se Kosovës

Në nivelet e tensionit 110 kV janë te instaluara dy nënstacione energjetike NS 110/35/10 kV Gjakova 1, dhe NS 110/35/10(20) Gjakova 2 të cilët së bashku kane një fuqi te instaluar prej 103 MVA.

Këta dy nënstacione furnizohen me energji nëpërmjet rrjetit transmetues të lartpërmendur i cili përbehet nga gjashte (6) linja transmetuese 110 kV.

[38] "Përmasat e urave dhe kategoritë e automjeteve për qarkullim" – Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (2012)

[39] *Burimi i të dhënave KEK-KEDS*

Ne skemën e me poshtëm është paraqitur ndërlidhja e ndërmjet nënstacioneve dhe linjave qe furnizojnë Gjakovën me pjesën tjetër te SEE te R se Kosovës, dhe ku shihet se furnizimi vjen nga NS 400/110 kV Peja 3 si dhe nga NS 220/110 kV Prizreni 2 e qe paraqet një rrjet te konsoliduar, nga aspekti i sigurisë se furnizimit.



Skema 1 - Paraqitja skematike e ndërlidhjes se infrastrukturës energjetike te komunës se Gjakovës me rrjetin e SEE te R. së Kosovës

4.6. Largëpërçuesit dhe trafostacionet

E- 1 Rrjeti transmetuese që kalon neper komunën e Gjakovës

Nëpër territorin e komunës së Gjakovës kalojnë dy linja ndër më të rëndësishmet për sistemin energjetik të R. Së Kosovës me sistemin energjetik të R s R së Shqipërisë.

- Linja 400 kV nr. L408 NS Kosova B-NS Koman.....91.15 (29.145) km
- Linja 220 kV nr. 2303 NS Prizreni 2-NS Fierza .....45.049 (33.025) km

E- 1.1 Rrjeti i niveli të tensionit 110kV-Nenstacionet dhe Linjat

Në nivelin e tensionit 110 kV siç u cekë me lartë janë te instaluar dy nënstacione :

- ✓ NS 110/35/10(20) kV **Gjakova 1** me fuqi të instaluar prej 40 MVA.
- ✓ NS 110/35/10(20) kV **Gjakova 2** me fuqi te instaluar prej 63 MVA.
- ✓ Linja 110 kV nr. 126/1 NS Gjakova 1 - NS Deçani.
- ✓ Linja 110 kV nr. 164/1 NS Gjakova 1 - NS Gjakova 2.
- ✓ Linja 110 kV nr. 164/2 NS Prizreni 2 - NS Gjakova 1.
- ✓ Linja 110 kV nr. 1805 NS Prizreni 2 - NS Gjakova 1.
- ✓ Linja 110 kV nr. 1806/1 NS Gjakova 1 - NS Gjakova 2
- ✓ Linja 110 kV nr. 1806/2 NS Gjakova 1 - NS Klina

Në komunë ekzistojnë 5 objekte strategjike-trafostacione me nënstacionet dhe rrjeti i përçuesëve dhe largëpërçuesëve, shpërndarja e së cilës është prezantuar në Skemën Njëpolëshe të Konzumit 35 KV me daljet-drejtimet e energjisë elektrike dhe lidhjet unazore.

Tabela 52. Burimet kryesore - trafostacionet

#	Trafostacioni	Lokacioni	Rendi	LP-daljet	Furnizimi kw
1	Gjakova - 1	"Fehmi Agani"	110/35 Kw	10 Kw	10/04 Kw
2	Gjakova - 1	"Skenderbeu" – Fonderia	110/10 Kw	10 Kw	10/04 Kw
3	Gjakova - 1	"Mark Malota"-Metal.vjet.	35/10 Kw	10 Kw	10/04 Kw
4	Gjakova - 2	"Skenderbeu" – Z.S.Agës	35/10 Kw	10 Kw	10/04 Kw
5	Gjakova - 3	"Tirana"- Ngroht.qytetit	35/10 Kw	35/10 w	10/04 Kw

Harta 20. Rrjeti energjetik



4.7. Sistemet e telekomunikimit[40]

Sistemi telekomunikues në Komunë është mjaftë i zhvilluar si rrjedhojë e teknologjisë së sofistikuar informative, duke mbuluar pothuaj gjithë territorin e komunës me të gjitha segmentet komunikuese dhe informative. Ky sistem është mjaft kompleks që në përbërjen e saj përmbledh: telefonia fikse (telekomi), telefonia mobile, radiot dhe TV stacionet, shërbime të internetit, sistemet e radiolidhjeve UHV dhe Simplex, sistemet e vëzhgimit (kamerat) në pikat më të rëndësishme të qytetit (Smart city).
Në kuadër të sistemit të përgjithshëm të telekomunikimit, komuna disponon me numra të veçantë për lajmërimin dhe menaxhimin e situatave emergjente në territorin e saj dhe jashtë në të dy sistemet telefonike (fikse dhe mobile) siç janë: 112- Numri unik nacional emergjent, 192 Policia, 193 Zjarrfikësit dhe 194 urgjenca ambulantore.

4.7.1. Objektet dhe shërbimet (brenda komunës)

Telefonia Fikse

Lidhjet kryesore të telekomunikacionit për Komunën e Gjakovës me qytetet tjera dhe jashtë komunës janë kabllot optike të PTK dhe të operatorëve privat të telekomunikimeve. Rrjeti i kabllove optike dhe telekomunikimeve të PTK, menaxhohet nga njësia e PTK-së në Gjakovë të cila objektin kryesor postar dhe 2 njësi, atë në Junik dhe Deçan me objektet postare ku janë centralet e telefonisë fikse.
Përkundër shtriejes relativisht të telefonia fikse, kryesisht në pjesën urbane, numri i shfrytëzuesëve në amivisëri ka rënie të dukshme, derisa në entet, institucionet dhe kompanitë publike vazhdon të mbetet si një formë standarde dhe stabile e komunikimit.
Telefonia mobile :

Trendi global i shërbimeve telekomunikuese mobile po shkon drejtë teknologjisë 5G. Nevojat e qytetarëve për kapacitete më të mëdha në shërbimet mobile, kryesisht ne “data” edhe ne Kosovë, obligon operatorët që të implementojnë edhe ne Kosove teknologjine 5G. Për të implementuar projekte të ndryshme si: Smart Home, Internet of Things, është e doemosdoshme të implementohet teknologjia 5G.

4.7.2. Personat juridik

Shërbimet e Internetit:
Sipas të dhënave të ofruara nga operatoret, ofrimi i shërbimeve në nivel të ekonomive familjare është relativisht i mire duke përjashtuar disa vendbanime apo qytetar të cilët jetojnë në vise me të thella rurale ku shërbimet janë më vështir të arritshme, ndërsa pjesa më e madhe e qytetareve mbi 85% gëzojnë qasje në shërbime të cilat i ofrojnë operatoret e poshtë përmendur.

Shërbimet dhe mbulueshmëria e Tv digjital dhe Fix

Operatorët e licensuar i ofrojnë këto shërbime kryesisht në zonat urbane dhe ne disa zona rurale ku përqendrimi i qytetarëve/banesave është më i madh. Ndërsa në zonat e largëta dhe më pak të banueshme këta operatorë nuk ofrojnë shërbime.Në këto zona shërbimet ofrohen nga operatorë local, shpeshherë të palicensuar dhe me kualitet jo të kënaqshëm të shërbimit.

[40] *Sistemi telekomunikimit, 266,….”Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030*

Bazuar në të dhënat zyrtare të ASK, mbulueshmëria apo ofrimi i shërbimeve të internetit dhe IPTV për ekonomit familjare është relativisht i mirë dhe pjesa më e madhe e qytetarëve me mbi 85% kanë qasje në shërbimet të cilat i ofrojnë operatorët ekonomik.

Tabela 53. Operatorët kabllor

Nr.	Institucioni	Transmetimi	Adresa elektronike
1	Art Motion	Kabllor	
2	IPKO	Kabllor	
3	Kujtesa	Kabllor-transmetruesi Zatriq	
4	Fiber Link	Kabllor-optik	
5.	PTK		

Grafiku 17. Ofrimi i shërbimeve sipas ekonomive familjare



Harta.21. Infrastruktura telekomunikuese në Komunën e Gjakovës



Harta 22. Infrastruktura Telekomunikuese në Qytetin e Gjakoves



4.7.3. Qendrat telekomunikuese, transmetuese dhe repetitorët[41]

Tabela 54. Lokacionet e qendrave telekomunikuese,BTS transmetues dhe repetitorët të PTK-së

	Gjakovë		Deqan		Junik	
Qendra Komunikuese	A	Objekti PTK				
"			B	Objekti PTK		
"					C	Objekti PTK
BTS - Transetues	1	Ish.NP "Modeli"				
"	2	SHA "Metaliku"				
"	3	Lagja Orize				
"	4	Kodra Çabratit				
"	5	Fsh.Cermjan				
"	6	Fsh. Kralan				
"	7	Fsh. Hereq				
"			8	Fsh. Lumbardh		
Repetitor	9	Fsh.Bec				
"	10	Fsh.Marmull				

[41] Burimi: *Post Telekomi i Kosovës*

“	11	Fsh. Damjan				
“	12	Fsh. Ponoshec				
“	13	Rr”Wesley Clark”				
“	14	Rr” Gj.N.Kazazi”				
“	15	Blloku i Ri				
“	16	Fsh.Hereq				
“	17	SHA ”Metaliku”				
“	18	Rr”A.P.Tepelena”				
“			19	Fsh. Gllogjan		
“	20	Fsh. Kralan				
“	21	Objekti PTK-së				
“			22	Objekti i PTK-së		
“	23	Ish.NP ”Modeli”				
“	24	Kodra Çabratit				
“					25	Objekti i PTK-së
“	26	Fsh. Cermjan				
VOIP	a	Objekti PTK-së				
			b	Objekti PTK-së		
					c	Objekti PTK-së
	d	Kodra Çabratit				
	e	Fsh. Bishtazhin				

Harta 23. Qendrat komunikuese, BTS dhe repetitorët



4.7.4. TV dhe radiostacionet

Tabela 55. Tv & radiostacionet

Transmetuesi	Indeksi	Frekuenca	Statusi	Adresa	Tel	Email
TV – Syri vizion	T021	Ch.33	Lokal	Pallati Kulturës	0390/322722 044/188968	lajmet@syri_vision.tv www.syri-vizion.tv
Radio Gjakova	R032	100	Lokal	P.Kulturës "A.Vokshi"	0390/322383 044/123377	radiogjakova@yahoo.com www.radiogjakova.info
RTK			Nacional			
RTV 21			Nacional			
Klan TV			Nacional			
KTV			Nacional			

- ✓ Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve tjera kabllore dhe
- ✓ Radio-televizionet nëpërmjet antenave satelitore,

4.8. SISTEMET HIDROTEKNIKE

4.8.1. Objektet për furnizim me ujë[42]

Objektet e furnizimit me ujë në kuadër të sistemit hidroteknik :

- Porta hyrëse e KRU "Gjakova" (Diga e lumbardhit)
- Kanali derivues Lumbardh deri në Liqenin e Radoniqit
- Diga në liqenin "Radoniqi"
- Stacioni i Filtrave
- Rezervoarët për grumbullimin e ujit
- Infrastruktura e ujësjellësit
- Rezervuarët akumuluese ne qytet: Bjeshka e Botushës, Shkoza dhe Piskota
- Vendgrumbullimet dhe burimet e ujit

4.8.2. Kompania Rajonale e ujërave dhe burimet alternative

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Gjakovës bëhet nga Liqeni i Radoniqit, i cili ka kapacitet prej 117 milion m^3, dhe përmes kompanisë rajonale "Gjakova" dhe nga puset në zonat rurale. Aktualisht KRU,,Gjakova" sh.a, e cila është ofruesi i vetëm me ujë të pijshëm në komunën e Gjakovës, ofron shërbime të ujit të pijshëm për qytetin e Gjakovës dhe 88 vendbanime, ndërsa 3 vendbanime (Zylfaj, Goden dhe Qerret) nuk ka rrjet të ujësjellësit, ky shërbim ofrohet 24 orë pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme tjera (reduktime të energjisë) në stacionin e pompave dhe tubacionet – rrjetin shpërndarës të ujësjellësit.
Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Gjakova është: **1,124,821.332 m** apo **1,124.8** kilometra, të regjistruara në ArcMAP. Ndërsa në Komunën e Gjakovës kemi gjetësin e rrjetit me furnizim me ujë 822,831 m, apo 822,8 km si në tabelën në vijim:

[42] *Rrjeti i Ujësjellësit f.77,78 – Plani Zhvillimor KOmunal Gjakovë 2022-2030*

Zona aktuale e shërbimit të KRU Gjakova është përafërsisht 220 km² dhe përfshin Komunat e Gjakovës dhe fshatrat përreth, Rahovecit dhe fshatrat përreth dhe 15 fshatrat brenda kufirit administrativ të Komunës së Prizrenit, që është një pjesë e rëndësishme e Pellgut ujor të "Drinit të Bardhë" i vendosur në Kosovë. Kapacitetet aktuale të prodhimit me të cilat furnizohet e tërë zona e shërbimit janë 1097 l/sec

Tabela 56. Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Gjakovës

Burimet e ujit	**Kapaciteti i prodhimit**		**Kapaciteti i shfrytëzuar i prodhimit m³/ditë**
	Vëllimi i kaptimit m³/vit	Kapaciteti i shfrytëzimit m³/vit	
Liqeni i Radoniqit	31,536,000	17,300,000	47,397.26
Burimi Damjan	1,200,000	48,000	131,506
Burimi Gërqinë	800,000	31,200	85,479
Burimi Reka e Keqe	2,210,000	372,300	2,020.00
Prodhimi total:	35,746,000	17,751,500	266,402

Konsumatorët - KRU Gjakova, i ka të kategorizuar shfrytëzuesit e ujit / konsumatorët (shih tabelën nr.6), por edhe në Komunën e Gjakovës i kemi tri lloje të shfrytëzuesve të ujit apo konsumatorëve si: konsumatorë shtëpiak (amvisërisë), konsumatorë komercial-industrial dhe konsumatorë institucional (publik), (shih tabelën nr.7).

Kategoria	Numri i Konsumatorëve
Konsumatorët Shtëpiak	25,024
Konsumatorët Komercial- Industrial	3,210
Konsumatorët Institucional	244
Total Konsumator	28,478

Tabela 57. Numri i konsumatorëve sipas kategorisë komuna e Gjakovës

Burimet Alternative

Prej burimeve më të njohura janë: Burimi i ftohtë në fsh.Rracaj, Kroi i Brekocit, Përroni i zi, Burimi i Mulliqit, Gurra e Damjanit, Burimi i "Potokut" Molliqit, Burimi i Kusarit dhe Përroi i Fisit në Qerret. Këto burime kryesisht gjenden në pjesën jug-perëndimore të komunës, gjegjësisht në zonën e Rekës së keqe dhe zonës së Hasit përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë.

Qasja e banorëve në këto objekte është e drejtpërdrejtë, pasi që kemi të bëjë me puse shtëpiake apo burime alternative të afërta me vendbanimin dhe të përhershme me ujë. Meqenëse numri i burimeve të ujit (304), puseve (70), shpellave me ujë (3) dhe objekteve tjera natyrore është shumë i madh dhe i shpërndarë në aspektin hapësinor gjeografik, vendndodhja e tyre është i paraqitur në hartat ushtarake të objekteve të ujit Gjakova-1 dhe Gjakova-2, në përpjesëtim 1:50.000 në bashkangjitur këtij Plani.

4.8.3.Sistemi i distribuimit të ujit për pije[43]

Pjesa më e madhe e territorit të komunës së Gjakovës furnizohet me ujë të pijshëm nga Hidrosistemi i Radoniqit, i cili sistem mbulon ¾ e territorit të komunës (përveç regjionit të Rekës së Keqe i cili furnizohet nga burimet dhe puset natyrore) duke nënkuptuar edhe vet qytetin e Gjakovës, të Rahovecit dhe pjesëve periferike të komunës së Prizrenit. Gjithashtu, nga i njëjti sistem bëhet edhe ujitja e 8.070 ha (me rënie të lirë = 5.418 ha, ndërsa me pompa = 2.652 ha) në sektorin shoqëror dhe privat.

[43] *Raporti i KRUGJ/2024*

Furnizimi i popullatës bëhet përmes filtrimit të ujit të pijshëm nga stacioni i filtrave me kapacitet mesatar prej 950 l/sec, e në raste të veçanta kapaciteti i saj maksimal është 1050L/sec.
Aktualisht liqeni ka një mbushje mesatare prej 450.90 NNm (V=90.792.633m^3) që garanton furnizim stabil dhe kualitativ të banorëve me ujë të pijshëm, meqenëse uji i nënshtrohet analizave dhe kontrolleve të rregullta kimiko-biologjike pranë këtij stacioni.
Kompleksi i Hidrosistemit Radoniqi, përveç basenit, digës dhe stacionit të filtrave në përbërjen e saj posedon edhe rezervuarë të ujit në zona të ndryshme të territorit të komunës dhe jashtë saj, duke mundësuar furnizimin e territorit të cekur më lartë qoftë në formën e rënies së lirë ashtu edhe me përdorimin e pompave thithëse. Hidrosistemi i Radoniqit posedon me një rrjet relativisht të gjerë të gypave të ujësjellësit që në total përfshinë 553.388,5m'.

Tabela 5 - Uji i prodhuar, faturuar, UPF dhe humbjet gjatë vitit 2024, krahasuar me 2023 dhe BP 2024

Treguesit	Viti 2024	Viti 2023	Ndryshimi	%	Viti 2024	PB 2024	Ndryshimi	%
Prodhimi m^3	16,202,875	15,726,213	476,662	2.94%	16,202,875	15,992,891	209,984	1.30%
Faturimi m^3	8,434,845	8,211,566	223,279	2.65%	8,434,845	8,549,808	-114,963	-1.36%
Pa faturuar m^3	7,768,030	7,514,647	253,383	3.26%	7,768,030	7,443,083	324,947	4.18%
% humbjes	47.94%	47.78%	0.16%		47.94%	46.54%	1.40%	

Diagrami - Uji i prodhuar, faturuar, UPF dhe humbjet 2024, krahasuar me 2023 dhe PB 2024



Grafiku 18. Prodhimi i ujit 2023/2024

Harta 24.. Rrjeti i ujësjellësit në komunën e Gjakovës





Harta 25. Mbulueshmëria shërbimeve të kanalizimit

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Gjakova është: 1,124,821.332 m apo 1,124.8 kilometra, të regjistruara në ArcMAP. Ndërsa në Komunën e Gjakovës kemi gjetësin e rrjetit me furnizim me ujë 822,831 m, apo 822,8 km si në tabelën në vijim:

Tabela 58. Lloji i materialit të tubacioneve dhe gjatësia e tyre

Lloji i gypit	AC	PE	PVC	Zn/Çelik	GRP	Totali (m)
Gjatësia (m)	80,150	467,088	8,881	12,374	20,611	589,104
Përqindja %	13.61	79.29	1.51	2.1	3.49	100

- Sistemi ujitjes

Këtë sistem hidroteknik e përbën infrastruktura e ujitjes nga KRU ”Radoniqi”, e cila përbën bazën e ujitjes së tokave bujqësore në territorin e komunës së Gjakovës dhe të Rahovecit.

Tabela 59. Ujitja e sipërfaqeve bujqësore

Shfrytëzimi ujit	Ujitje me rënie të lirë në ‘ha	Ujitje me pompa në ‘ha	Gjithsej ujitje në ‘ha
Sektori privat	3.846	1.046	4.992
Sektori shoqëror	1.572	1.506	3.078
Gjithsejtë:	5.418	2.652	8.070

4.8.4. Monitorimi i ujërave për pije

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike.Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësorë konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHP është institucion i ngarkuar me përgjegjësi ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimine ujërave të pijshëm. IKSHP siguron se uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendorë për parametrat mikrobiologjikdhe fiziko-kimik. Gjatë vitit 2024 janë marr 3.989 mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim tëtestimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, në të cilën 99.68 %të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara. Ndërsa në vitin 2023 janë marrë 4.229 mostra të ujit nga rubinetet e me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik në të cilën 99.68%të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara.

*Tabela 7. Analizat e Ujit nga ISHP-Gjakovë, Prizren, Rahovec dhe laboratori në stacionin e filtrave, gjatë muajve **Janar-Dhjetor 2024,** krahasuar me muajt e njëjtë të **vitit 2023**:*

Janar-Dhjetor 2024	2024	2023	Ndryshimi
Bakteriologjike	1,033	1,034	-1
Fiziko Kimike	2,956	3,195	-239
Totali:	3,989	4,229	-240

Burimi: Raporti i KRUGJ

4.8.5. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor[44]

Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në Komunën e Gjakovës akoma vazhdon të jetë problematikë e pazgjidhur në tërësi, ngase ka burime dhe afektime të shumta dhe të ndryshme, të cilat kërkojnë mbikqyrje dhe kontrollë më të veqantë institucionale por edhe vetëdijësim qytetarë.

Ndotësit kryesor janë mbeturinat e ndryshme(ilegale) dhe hedhja e tyre në përrocka, lumenjë dhe në ambiente të hapura, shkarkimi i ujërave të zeza, hedhja e inerteve, mbeturrinave industriale, mbeturinave të gjeneruara nga subjektet medicinale, kimikatet e ndryshme etj. Mbeturinat të cilat gjenerohen nga jeta e përditshme e qytetarëve, janë me sasi të madhe dhe paraqesin rrezikshmëri të lartë, sidomos nëse nuk deponohen apo nuk trajtohen si duhet dhe me kohë, në kontakt me ujërat mbitokësorë dhe nëntokësorë, afektojnë sasi të mëdha të ujërave dhe ambientit.

Në dekadën e fundit, Komuna e Gjakovës ka realizuar një sërë projekte infrastrukturore në kuadër të rregullimit të ambientit, në veçanti në rregullimin e shtretërve të lumenjëve përgjatë lumit Krena dhe Llukac që përshkojnë pjesën urbane të qytetit. Punimet janë realizuar konformë standardeve të kohës, ku përveç zvogëlimit të gjasave dhe apo minimizimit të pasojave të shkaktuara nga vërshimet eventuale, krahas saj është ndërtuar infrastruktura e shkarkimin të ujërave të zeza (2 kolektor kryesor në qytet dhe impianti në lumin Erenik Zidi Sadik Agës) dhe kufizimi i mundësive për hudhjen ilegale të mbeturinave. Me këto investime si dhe ndërtrimin dhe funksionalizimin e impiantit të urave të zeza në masë të konsiderueshme është zvogëluar ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

KRM "Çabrati" përgjegjëse për grumbullimin dhe bartjen tyre në stacionin trnasfer me një mbulueshmëri mjaftë të mirë në tërë teritrorine komunës së Gjakovës. Kjo kompani ofron shërbime për tri kategori të konsumatorëve: Ekonomitë familjare, Bizneset dhe Institucionet.

Komuna e Gjakovës nuk ka deponi të përhershme për grumbullim të mbeturinave, mbeturinat e grumbulluara transportohen në deponin regjionale në Landovicë në Komunën e Prizrenit e cila ka një sipërfaqe prej 25 ha.

Harta 26. Mbulueshmëria e vendbanimeve me shërbim për grumbullim të mbeturinave



[44] *Grumbullimi dhe Menaxhimi i Mbeturinave, f. 98,269, Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030*

Tabela 60. Menaxhimi i mbeturinave rrjeti i shërbimeve

Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit, 2020				
Kategoria #	**Rrjeti i shërbimit**			
	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i kontejnerëve (nr.)	Vëllimi i kontejnerëve (m³)	Dist. mes. ndërmjet kont. (m)
Gjakovë km/muaj	1,702.88	449	1.1 m³	
Gjakovë km / mesatare ditore	326	817	240 l	

Ndotësit e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor mund të jenë shumë të ndryshëm dhe të ndikojnë në cilësinë e ujit. Ja disa kategori dhe shembuj konkretë:

1. **Mbeturinat shtëpiake-** Ne do shoqeri civilizuese rendesi te vecant i kushtohet problematikes së deponimit dhe riciklimit te mbeturinave gje qe edhe ne komunën e Gjakovës kjo çështje ka filluar të trajtohet më seriozisht. Karakteristke e të gjitha llojeve te mbeturinave eshte se hedhen jashtë vendeve të caktuara dmth.jashte vendeve te destinuara si kontenjeret, jashtë deponive të përcaktuara caktuara,hudhen ne rruge,lumenje etj dhe krijojne vatra potencijale te epidemive dhe semundjeve tjera ngjitese,ndotje te ambientit,shkaktimin e vërshimeve etj.

2. **Mbeturinat kimike-industriale -** Komuna e Gjakovës ka në territorin e saj të identifikuara disa "deponi" me mbeturina kimike-indus-triale me sasinë e deponuar që tejkalojnë 5 ton për deponi. Lokacionet ku ndodhen këto mbeturina përfshijnë:

- New Co Jatex (ish Ndërmarrja JATEX), mbeturina me origjinë nga prodhimi i tekstilit,
- New Co Miniera Devë, mbeturina me origjinë minerare,
- Metaliku, mbeturina me origjinë nga procesimi i metaleve, dhe
- New Co Emin Duraku -Devolli, mbeturina me origjinë nga procesimi i tekstilit,

3. Mbeturinat shtëpiake- Ne do shoqeri civilizuese rendesi te vecant i kushtohet problematikes së deponimit dhe riciklimit te mbeturinave gje qe edhe ne komunën e Gjakovës kjo çështje ka filluar të trajtohet më seriozisht. Karakteristke e të gjitha llojeve te mbeturinave eshte se hedhen jashtë vendeve të caktuara dmth.jashte vendeve te destinuara si kontenjeret, jashtë deponive të përcaktuara caktuara,hudhen ne rruge,lumenje etj dhe krijojne vatra potencijale te epidemive dhe semundjeve tjera ngjitese,ndotje te ambientit,shkaktimin e vërshimeve etj.

4. Mbeturinat Medicinale - Në komunën e Gjakovës respektivisht në spitalin rajonal është i instaluar impianti për trajtimin e mbetjeve medicinale me kapacitet të trajtimit 1,500-1,800 kg/ditë i cili në rrethana normale do të mjaftonte për menaxhimin e të gjitha mbeturinave medicinale. Megjithatë për shkak të mos menaxhimit të duhur të impiantit dhe problemeve teknike ai punon me kapacitet simbolik (10 kg/ditë) apo edhe me ndërprerje të plotë.

5. Ndotësit biologjikë- bakteret dhe viruset: Mund të vijnë nga ujërat e zeza ose nga sistemi i menaxhimit të mbetjeve.

6. Ndotës të origjinës bujqësore - Erosioni i tokës mund të sjellë sediment në ujëra sipërfaqësor, të ujërave në kanalet e kullimit, kanale të ujitjes që përmbajnë kimikate dhe preparate të ndryshme për kultivimin e kulturave bujqësore. Këto dukuri më tepër janë prezentë në sipërfaqet bujqësore pranë shtretërve të lumenjëve që gravitojnë në komunën e Gjakovës

Tabela 61. Koha e dekompozimit të materieve[45]

MATERIA	KOHA E DEKOMPOZIMIT
Mbeturinat e molles etj.	2 muaj
Lekura e bananes	1 muaj
Gazeta	6 jave
Kartpeceta	4 jave
Sintetike	500 vjet
Stofi e Leshi	8-10 muaj
Shkrepse	6 muaj
Bishtat e cigares	1 vit
Chewing-gum	5 vjet
Kanace alumini	10 vjet
Qese plastike	100-1000 vjet
Shishe plastike	100 - 1000 vjet
Cakmak	100 vjet
Pampers e Salvieta	200 vjet
Karta telefoni	1000 vjet
Shishe qelqi	e papercaktuar
Kuti kartoni	2 muaj
Tetrapak	3 muaj

[45] http://www.mjedis.tv/koha-dekompozimit.html

4.8.6. Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit

Masat që duhet ndërmarrë për parandalimin e ndotjës së ujërave janë të shumta, por do tëadresohen disa që janë më kryesore:

- Hartimi i Planit lokal për parandalimin e ndotjës së burimeve ujore;
- Të identifikohen të gjithë ndotësit potencial të ujërave;
- Për shkelsit e ligjit për mbrotjën e ujërave të marren masat për parandalimin dhe penalizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse ;
- Mbrojtja e burimeve ujore dhe vendosja e zonave mbrojtëse.
- Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të ndotura;
- Trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet normative vendore;
- Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale vetëm ne raste kurnuk e dëmton eko-sistemin ujor telumenjve dhe respektimin e minimumit biologjik;
- Shmangie nga çfardo lloj shkarkimi të pesticideve, vajrave dhe kemikateve të rrezikshme në ujëra;
- Ndalimi i hudhjes së mbeturinave afër çdo burimi të ujërave, etj;

4.8.7. Rekomandimet

- Implementimi i infrastrukturës ligjore të ujërave;
- Kompletimi dhe modernizimi i sistemit për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- Nevoja për investime kapitale në infrastukturën për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Rritja e kapaciteteve dhe avansimi i sistemit të ujësjellësve;
- Përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit për trajtimin e ujërave urbane dhe industriale;
- Masat për parandalimin e humbjës së ujërave në rrjet;
- Hulumtime në fushën e ujërave, s idomos resurseve ujore nëntokësore;
- Sensibilizimi dhe vetëdijesimi për ngritjen e kulturës qytetare për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore;
- Ngritja e vetdijësimit në komunitetin e biznesit dhe ekonomive familjare për shfrytëzimin racional të ujërave;
- Vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave.

4.9. Sistemet e shpërndarjes së gasit dhe naftës

Komuna e Gjakovës nuk ka sistem të shpërndarjes së gasit dhe naftës

4.9.1. Pompat e derivateve

Në territorin e Komunës së Gjakovës, në qendren urbane dhe periferike si dhe në vendbanimet në pjesën rurale të komunës janë të evidentuar 27 subjekte me 31 pika pika të shitjes së karburanteve të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë shumica buzë akseve rrugore urbane dhe rurale. Edhe pse një numër i caktuar i këtyre pikave të shitjes nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe hapësinore për një veprimtari të tillë, duke marë për bazë shkallen e lartë të rrezikshmërisë që paraqesin e sidomos disa pika të cilat veprimtarinë e vet e ushtrojnë në vendbanime të dendura dhe afër objekteve shkollore apo objekteve me frekuentim të madh të njerëzve. Fatmirësisht, deri më tani nuk është evidentuar asnjë rast zjarri/eksplodim në këto pika të shitjes së karburanteve.

Tabela 62. Pikat e karburanteve [46]

Nr.	Emërtimi i biznesit	Titullari	Adresa	Lokacioni/ kordinatat	Kapaciteti i derivateve		
					Naftë/V	Benz/V	GLN/V
1.	BN BAKIJA SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Skënderbeu				
2.	D & Z SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Mejë				
3.	COM PETROLL SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Minatori				
4.	TOP Group SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Migjeni				
5.	Jetmir Be. Berisha B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Rogovë				
6.	Ex Fis SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Tirana				
7.	B-3 Benz SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Welsey Clark				
8.	Përparim Rexhepi	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Babaj Bokës				
9.	Gjergj Duzhmani	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Korenicë				
10.	Vëllezërit Neziraj SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Mulliq				
11.	Asllan Gjuraj B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Gërqinë				
12.	Valon Prenkaj B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Osek Pashë				
13.	Haki Fetaj B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe	Hereq				
14.	Henrik Krasniqi B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Meqë				

[46] Burimi: Drejtoria për Zhvillim Ekonmik 2026

15.	Anton Frrokaj B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Planqor				
16.	Anton Rrukaj B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Osek Pashë				
17.	N.T.SH. "MULI PETROL"	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Gërqinë				
18.	IP - KOS SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Gasper Karaqi				
19.	Habib Morina B.I.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Skenderbeu				
20.	Hib Petrol SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Zona Industriale-Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë,				
21.	Petrol Company - SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Tirana & Gasper Karaqi				
22.	AL-Petrol SH.P.K. ***2 Njësi***	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Tirana & Gasper Karaqi				
23.	Molika Gas SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumic	Tahir Zemaj				
24.	Niki – S SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumicë	Wesley Clark				
25.	Ex Fis SH.P.K. ***3 njësi***	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumicë	Wesly Clark Gasper Karaqi				
26.	Slovenia Petrol SH.P.K.	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumicë	Gaspër Karaqi				
27.	SHELL-COMPANY SH.P.K. ***2 Njësi***	Pomp e derivateve te shitjes me pakic dhe shumicë	Tirana Gaspër Karaqi				

4.9.2. Depozitat e derivateve /kapacitete

Në komunën e Gjakovës nuk ka objekte aktive për depozitimin e sasive kontingjente të derivateve dhe të shpërndarjes së tyre në destinacionet tjera.

Kreu i V-të

5. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË

Njajshëm mekomunat tjera, edhe Komuna e Gjakovës nuk bën përjashtim ndaj ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri, qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme, andaj edhe objektet e rëndësisë së veqantë kanë rol dhe rëndësi jetike në paqë dhe në rrethana të krijuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

5.1. Objektet e sigurisë

Tabela 63. Ndërtesave të sigurisë publike në Gjakovë

#	Institucioni	Lokacioni		
1.	Policia Rajonale dhe Stacioni Policor	Gjakovë		
2.	Nënstacioni i Policor	Ponoshec		
3.	Ndërtesa e doganave të Kosovës	Qafë Morinë		
4.	Ndërtesa e doganave të Kosovës	Qafë Prushë		
5.	Qendra Operative Rajonale Emergjente-112	Gjakovë.rr.Bardhyl Qaushi nr.		
6.	Ndërtesa Njësisë Zjarrfikëse	Rr Bardhyl Qaushi		
7.	Inspektorati i Parandalimit	Rr Bardhyl Qaushi		

Harta 27. Objektet e Sigurisë Publike

5.2. Objektet komunale dhe qeveritare

Tabela 64. Objektet Komunale dhe Institucionet qeveritare në Komunën e Gjakovës

#	Institucioni	Lokacioni	Koordinatat	Shënim
1.	Objektet e Administratës komunale	Gjakovë, Zyrat e Vendit		
2.	QKMF, QMF	Gjakovë, në fshatra		
3.	Objektet energjentike	KEDS Distribucioni, "M.Teutë" Ngrohtorja e Qytetit - Rezine		
4.	Objektet e postës dhe telekomunikacionit	Post Telekomi i Kosovës IPKO,KUJTESA,ART MOTION FIBERLINK		
5.	Objektet e furnizimit me ujë	KRU "Gjakova, rr. Uçk Diga e "Radoniqit" Impianti i ujërave të zeza Z.S. Agës Rezerovaret e ujit të KRU		
5.	Objektet e menaxhimit të mbeturinave	KRU "Çabrati", rr.Mazllom Lakuci Auto parku –rr. Bardhyl Qaushi		
6.	Objektet e edukimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, Konvikti i nxënësve/studentëve	Shih tabelën.nr. 71,72,73,74		
7.	Spitali,ISHP,IMP	Gjakovë	Niv.Qeveritar	
8.	Objektet universitare dhe kolegjet	Universiteti "Fehmi Agani" Kolegji Universum rr. Uçk		
9.	Objektet Sportive	Shih: harta e Komunës		
10.	Objektet Kulturore	Shih: harta e Komunës		
11	Gjykata dhe Prokuroria	Gjakovë, rr. Tranzite		
12.	Stacioni i autobusëve	Gjakovë rr.Uçk		
13.	Aeroporti ushatarak	Fsh. Lug Bunar		
14.	Qendra për Punësim	rr. "Normalja e Gjakovës"		
15.	Qendra për Aftësim e trajnim Profesional	rr. "Marin Barleti"		
16.	Administrata Tatimore e Kosovës	"Nëna Terezë"		
17.	Departamenti i Pensioneve – Dega në Gjakovë	Rr. "Beqir Kastrati", Gakovë		

5.3. Institucionet dhe shërbimet financiare

Në komunën e Gjakovës ka shërbime bankare, postare, gjithashtu janë evidente edhe një sërë kompani të sigurimeve. Operojnë shum filiala të bankave si: Administrata Tatimore-Dega në Gjakovë, Raiffeisen Bank, Teb Bank, BKT, ProCredit Bank, NLB, Banka Private e Biznesit, Finca etj.

Kreu i VI-të

LLOJET, INTENZITETI, DHE NDIKIMET E FATKEQËSIVE NATYRORE NË TERITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS

6.0. LLOJET E FATKEQËSIVE

Si çdo shoqëri civile, edhe Komuna e Gjakovës është e lidhur me fatkeqësitë e natyrës si dhe me aksidente dhe katastrofa të ndryshme. Kjo për faktin, se kjo komunë gjatë periudhave të ndryshme kohore në vazhdimësi iu është nënshtruar kërcënimeve të natyrës dhe ndikimeve tjera jonatyrore, me pasoja në popullatën, botën bimore e shtazore, në infrastrukturë, të mira materiale, mjedis, trashëgiminë kulturore etj.

Ndryshimet klimatike në përgjithësi, veçanërisht frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit dhe luhatjet e temperaturave që parashikohen të ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, po ndikojnë edhe tek ne, duke krijuar klimë me cënueshmëri më të lartë, duke përfshirë, ndër të tjera: zjarre në pyje, thatësira, reshje të dendura të shiut dhe shtrëngata shiu, breshër, borë, acar, orteqe (edhe pse borë e acar në dekadën e fundit ka më pak), erëra të fuqishme, vërshime, zjarre (urbane, malore, fushore), epidemitë/pandemitë, rrëshqitje të tokës, valë të të nxehtit, tërmete dhe fatkeqësi e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore, etj;

Niveli lokal dhe akterët tjerë institucional që veprojnë në Komunë si reagues të parë në fatkeqësi, kanë përgjegjësi dhe detyrim ligjor në zbatimin e masave për parandalimin apo zvëgëlimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të cilat masa nuk mund të arrihen për në analizë dhe vlerësim të shkallës së rrezikut që kërcënon komunën e Gjakovës.
Ndaj, fatkeqësitë e mëdha, pa marrë parasysh se a janë natyrore, teknike-teknologjike, apo si pasoj e veprimeve luftarake, terroriste ose të çfarëdo forme të jashtëzakonshme, për shkak të zhvillimit të pa kontrolluar të tyre, mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, të të mirave materiale, kulturore dhe të ambientit, duke mos zgjedhur as vendin dhe as kohën se ku do godasin.
Fatkeqësitë, varësisht nga shkaktari i tyre ndahen në: fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT);

Fatkeqësitë natyrore janë fenomene të cilat, varësisht nga efekti goditës mund të shkaktojnë humbje të çfarëdo natyre, qofshin ato meteorologjike apo gjeologjike
Fatkeqësi tjera nënkuptohen ato fatkeqësi tekniko-teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri apo përmes proceseve teknologjike /incidentet në objektet afariste, tregtare, zjarret urbane dhe malore, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidente në trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidentet nukleare si dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, veprimet luftarake dhe terroriste;[47]

6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimi fatkeqësive natyrore

Për shkak të llojllojshmërërisë së rreziqeve, në njërën anë, dhe pasojave të tyre, në anën tjetër, në analizën dhe vlerësimin e tyre, duhet të merren parasysh shumë aspekte të cilat janë të ndërlidhura mes veti, para se gjitha të shiqohen se cilat janë ato dukuri natyrore, civilizuese dhe fenomene të tjera, që ekzitojnë në komunën e Gjakovës dhe shkalla e propabilitetit të ndodhjes së dukurisë. Gjithashtu, të vlerësohet intensiteti i mundshëm i këtyre dukurive, shkalla e befasisë, gjegjësisht

[47] ”Analiza dhe Vlerësimi të Rrezikut- Kategorizimi dhe llojet Rreziqeve”, Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë , Tema - 2, sl.3,4 nëntor 2005

shpejtësia me të cilën zhvillohet rreziku, shkalla e rrezikshmërisë së qytetarëve, e pronës dhe ambientit.



Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve në procesin e planifikimit duhet të jepe përgjigje në disa pyetje të cilat lidhen me territorin e caktuar, si:[48]

- ✓ Çfarë mund të ndodhë,
- ✓ Sa shpesh mund të ndodhë një fatkeqësi,
- ✓ Dëmet që mund të shkaktohen,
- ✓ Ndikimet e dëmeve në komunitet, dhe
- ✓ Shkalla e cënueshmërisë së komunitetit ndaj rrezikut.

Që një analizë dhe vlerësim rreziku të jetë kredibil dhe koherent paraprakisht duhet të të bëhet:

- ➢ Identifikimi i rrezikut,
- ➢ Profilizimi i rrezikut,
- ➢ Ndërtimi i profilit të komunitetit
- ➢ Përcaktimi i shkallës së cënueshmërisë

[48] "Analiza dhe Vlerësimi i rreziqeve", njësia 3., f. 5,6,7,8,9 Kolegji Biznesi, 2011

- Ndërtimi dhe zbatimi i skenarëve

Secila nga fatkeqësitë natyrore dhe ato jonatyrore kanë natyralitetin e ndryshëm të ngjarjes, të shkasit dhe pasojes, ashtu që edhe identifikimi, analizimi, trajtimi dhe vlerësimi i tyre bëhet sipas specifikave dhe efekteve goditëse të tyre.
Kur të shikohet e ardhmja, për t'u përgatitur për pasiguritë, sygjerohet gjithmonë që të vështrohet e kaluara dhe të merren në konsideratë zhvillimet kronologjike nga e kaluara. Në kushtet bashkëkohore të ndryshimeve globale klimatike, të zhvillimit ekonomik e teknologjik, duke mos lënë anash edhe antagonizmat në shoqërinë tonë në tranzicion, mund të konkludohet se gjenerimi i rreziqeve është real dhe në rritje e sipër. Kështu që, shpesh është i pranishëm konstatimi se shek.XXI do të jetë shekulli i rreziqeve të shtuara në të gjitha format dhe trajtat e saj, dhe me rritjen e numrit dhe përmasave të rreziqeve, rritet edhe numri i personave të rrezikuar por edhe më tepër i dëmeve materiale dhe të ambientit.[49]
Komuna e Gjakovës, respektivisht Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në vazhdimësi ka bërë vlerësim të rreziqeve që kanë ndodhur në të kaluarën duke përdorur databazën e shënimeve vetanake dhe informacioneve tjera relevante në komunë dhe agjensionet tjera përkatëse, kryesisht për: vërshime, erëra të forta, zjarre pyjore-fushore, zjarre aksidentale në ekonomi, në amvisëri, dëme në infrastruktur, epidemiologjike (Covid 19, Gripi i shpezëve, etj), për ambient, ndotje radiologjike, mjetet e pashpërthyera mino-eksplozive, ndotjen radioaktive, dëmet e evidentuara në komunë nga tërmeti i v. 2019 me epiqendër në Durrës etj.
Në kontekst të kësaj, analiza dhe vlerësimi i rreziqeve në komunën e Gjakovës i harmonizon rezultatet dhe gjetjet nga mbledhja e të dhënave, së cilës i paraprinë një proces i gjërë i përpunimit analitik i tyre për dukuritë dhe rreziqet që kërcënojnë.

6.2. Përcaktimi i shkallës së rrezikshmërisë dhe prioritetizimi i fatkeqësive natyrore

Identifikimi dhe profilizimi e rrezikut, përcaktimi i shkallës së cënueshmërisë prezenton pjesën më të rëndësishme dhe më delikate në këtë proces, për vendosjen e prioriteteve për reagim emergjent.

Vlerësimi i autoriteteve lokale për rreziqet e fatkeqësive natyrore bazohet në analizën e plotë të rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje. Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme për tu përballë me pasojat e fatkeqësive natyrore., duke e marrë për bazë edhe Profilin e rrezikut(fletë-pune e profilit të rrezikut);
Hierarkia e vendosjes së prioriteteve në reagim është një veprim logjik dhe metodikë:

Prioriteti 1. Siguria e jetës - përfshirë zonat e rrezikshme, njerëzit në rrezik të lartë dhe situatat e mundshme të kërkim-shpëtimit , duke mos anashkaluar edhe mundësin që personeli reagues në rrethana të caktuara nuk mund të veproj nëse vet objektet dhe pajisjet e tyre janë të goditura,
Prioriteti 2. Shërbimet esenciale **–** të gjitha shërbimet publike vitale për funksionim normal të komunitetit,
Prioriteti 3. Infrastruktura kritike (infrastruktura energjetike, transportit dhe telekomunikimit, asetet reaguese etj).

Prioritetizimi i listës së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera është produkt matricës së probabilitetit /gjasave.
Matrica e probabiliteti/gjasave janë të bazuara në ***treguesit e probabilitetit/gjasave***:

- Probabiliteti dhe frekuenca e ndodhjes;

[49] Domenik Tesoirero ,"The risk assessment process", f. 16,17,18., Australia, 1998

- Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut;
- Pasojat ekonomike nga fatkeqësitë natyrore edhe fatkeqësitë tjera;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-infrastruktura kritike;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë;
- Matrica përmbledhëse e cila pasqyron stabilitetin shoqëror (3a dhe 3b/pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmet nga infrastruktura kritike dhe pasojave ekonomike);

Shkalla e cënueshmërisë apo indeksi i rrezikshmërisë vendoset në matriksin e rreziqeve duke krijuar një pasqyrë të përgjithshme dhe rangim të rrezeqeve dhe caktimin e prioritetit për reagim emergjent dhe të rimëkëmbjes dhe këthimit në normalitetet pas fatkeqësisë

6.3. Matriksi i rrezikut[50]

Për të realizuar shkallëzimin e rrezikut, thjeshtë shumëzohet gjasa me ashpërsinë:

Rreziku = Gjasa x Ashpërsia



Nivelet e fatkeqësive

1	I PAPËRFILSHHËM
2	I VOGËL
3	I MESËM
4	KRITIK
5	KATASTROFIK

Matrica pasqyron rrezikun e përgjithshëm

Matrica e rrezikut pasqyron gërshetimin apo korrelacionin e probabilitetit (gjasave) dhe pasojave, të nivelit të rrezikut e cila përbëhet nga dy boshte:

- ***boshti horizontal*** në të cilin paraqiten vlerat e gjasave (*e sigurtë/ gati e mundur/ e besueshme/ e pa besueshme/ e pamundur)*, ndërsa
- **boshti vertikal** në të cilin paraqiten vlerat e pasojave *(e papërfillshme/ e vogël/ e mesme/ kritike/ katastrofike);*

[50] "Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqëstë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera" – Dokument Udhëzues i AME/MPB/UNDP 2024

Efekti goditës në komunitet (shkalla e ashpërsisë), karakteristikat

Karakteristikat	Ashpërsia
• Vdekje të shumëllojshme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë. • Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	Katastrofike
• Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë. • Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E ashpër (kritike)
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 10 ditë. • Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E mesme
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 1 javë. • Më shumë se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E kufizuar
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet e trajtuara me ndihmën e parë. • Humbje e vogël e standardit të jetesës. • Ndërprerja e objekteve/shërbimeve kritike për 24 orë e më pak. • Më pak se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E ultë

Tabela nr Forma standarde e vlerësimit të rrezikut

Flet-pune e Profilit të Rrezikut	
Rreziku	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **Katastrofike:** Më shumë se 50% **Kritike:** 25 deri 50% **E kufizuar:** 10 deri 25% **E papërfillshme:** Më pak se 10%	
Frekuenca e ndodhjes: ▪ **Shumë e mundshme:** Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm. ▪ **E mundshme**: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme. ▪ **Ka gjasa:** Mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme. ▪ **I pa mundshëm:** Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.	**Modeli Sezonal:**
Zonat që mund të goditen më së shumti:	
Kohëzgjatja e mundshme:	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): ▪ Paralajmërim minimal (apo fare). ▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë. ▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë. ▪ Paralajmërim më shum se 24 orë.	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? ☐ Po ☐ Jo	

Pas llogaritjeve analitike të rrezikut sipas formulave dhe teknikave të prezentuara më lartë, jepet pasqyra reale e e rrezikut që lërznonrreziqeve. Nëse rreziqet, sipas llogaritjes janë të pranueshme (të nivelit të ulët) mund të kalohet në tjetrin, por nëse rreziku është i mesëm apo i lartë, atëherë duhet të ndërmarrin veprime për t'a sjellë në nivelin e pranueshëm. Ndërsa për rreziqet të kotuara prej 15-25 pikë, kërkohet veprim urgjent.

Tabela 65. *Rangimi i fatkeqësive natyrore sipas gjasave, modelit dhe shpeshtësisë*

#	**Lloji i rrezikut**	**Propabiliteti**	**Modeli dhe ketegorizimi**
1.	Zjarret pyjore fushore	100% vitin e ardhshëm	Sezonal, shumë i mundshëm
2.	Vërshimet	50-100% në vitin e ardhshëm	Sezonal, shumë i mundshëm
3.	Erërat e forta	50-100% në vitin e ardhshëm	Sezonal,i mundshëm
4.	Bora, ngricat dhe mjegullat	10-100% në vitin e ardhshëm	Sezonal,i mundshëm
5.	Erozionet	10-50% në vitin e ardhsëm	Sezonal,i mundshëm
6.	Rrëshqitjet e tokës	10-50% në vitin e ardhshëm	Jo sezonal, i mundshëm
7.	Thatësit e mëdha	10-100% në 10 vitet e ardhshëm	Sezonale, ka gjasa
8.	Epidemitë	10-100% në 10 vitet e ardhshëm	Jo sezonal, ka gjasa
9.	Tërmetet	1-10% në 10 vite, ose një shans në 100 v.	Jo sezonal, i pangjajshëm

Shënim: *Gjasat e ndodhjes, modeli dhe kategorizimi është bërë konform kritereve të dhëna nga doracaku i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent*

6.4. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore

Fatkeqësi natyrore konsiderohen ato fenomene natyrore të cilat jo rrallë arrijnë deri deri në nivele ekstreme, duke filluar nga ato me shpeshtësi më të madhe dhe me probabilitet të lartë të ndodhjes deri tek ato më ekstreme me pasoja të rënda dhe me probabilitet të ultë. Fatkeqësitë natyrore përbëjnë një listë të gjatë të fenomeneve natyrore, si: vërshimet, tërmetet, zjarret, rrëshqitjet e dheut dhe erozionet, ortekët, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësira, epidemitë dhe pandemitë, fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga natyra e dukuri tjera që ndikojnë në humbje të jetërave të njerëzve, të mirave materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Hovi i natyrës apo "marrëzia e njeriut" shpesh përfundojnë në një ngjarje fatkeqësie e cila mbingarkon kapacitetet ditore reaguese, dhe pavarësisht nivelit të pregaditjeve të planifikuara për tu përballur, nuk jemi imunë nga efektet negative të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera.

Analiza SWOT e përparësive dhe dobësive të ndikuara nga fatkeqësit natyrore[51]

Përparësitë	Dobësitë
• Pozita e favorshme fizike gjeografike. • Gjakova nuk ka qenë e goditur asnjëherë nga ndonjë termet apo ortek që ka pas dëme në njerëz apo dëme materiale. • Një pjesë e madhe e territorit të komunës është e mbuluar me pyje. • Nuk gjendet në zonën e pllakave tektonike që e rrezikohet nga tërmetet me shkallë te lartë të Rihterit. • Komuna e ka Vlerësimin e rrezikshmërisë në nivel lokal • Ka planin e reagimit emergjent • Ka planin e evakuimit • Ka planin operativ për reagim emergjent	• Shtretër të ngushtë të lumenj në qe shkaktojnë dëme ne infrastruktura dhe sipërfaqet bujqësore përgjatë fshatrave Dobilbarte-Rogovë, si dhe në regjionin e Rekës së Keqe, segmenti Smolicë – Brovinë • Problemet me infrastrukturën hidrike • Humbja e tokës bujqësore si rezultat i erozionit • Sipërfaqe te shpyllëzuara • Rrjeti i vjetër i përçuesve elektrik që mund të shkaktojnë zjarre. • Kontrolli mbi kompanitë që bëjnë nxjerrjen e zhavorrit. • Mungesa e Analizës mikro-seizmike për territorin e komunës së Gjakovës • Mungesa e hartave të mikrozonimit seizmik • Rrugët e ngushta për intervenimin e zjarrfikësve në disa zona urbane • Buxheti i limituar • Zjarrvënia e qëllimshme nga faktori njeri.
Mundësitë	**Rreziqet**
• Pastrimi i shtretërve të lumenjve. • Organizimi i trajnimeve, mbi vetëdijesimin e popullatës për rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë nga veprimtaria e erozionit, ortekut, rrëshqitjet e dheut zjarret etj. • Ndërtimi i bazenit të ujit për zonat ku janë të rrezikuara nga zjarret. • Pyllëzimi i hapësirave ku janë të afektuar nga zjarret, erozioni, rrëshqitjet e dheut • Ndërtimi i mureve mbrojtëse në lokacionet me rrezikshmëri nga rrëshqitjet e dheut. • Komuna të përkrah përdorimin e lëndëve djegëse me cilësore. • Të pajisen dhe mbështeten zjarrfikësit me pajisje adekuate për menaxhim te zjarreve. • Sigurimi i brezave mbrojtës për largpërçuesit elektrik në fshatrat malore për zvogëlimin e mundësisë së zjarreve. • Zgjerimi i rrugëve qytet dhe në vendet tjera për mundësin e lëvizjes së lirë të makinerive të zjarrfikësve në raste të zjarrit.	• Viktima në njerëz • Dëme materiale në ekonomi familjare, infratsrukturë të mira materiale. Mjedis etj. • Humbja e tokës bujqësore nga veprimtaria e erozionit, vërshimet. • Prerja dhe dëmtimi i pa kontrolluar pyjeve paraqet rrezik për paraqitjen e orteqeve dhe erozionit të thellë. • Bllokimi i rrugëve nga rrëshqitjet e dheut • Rritja e zonave të vërshuar, humbje e elementeve ushqimore të tokës • Rrezikimi i florës dhe faunës nga djegia e pyjeve • Rritja e dëmeve materiale nga vërshimet në • Rritje e pakënaqësisë te qytetarët;

[51] Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim- "Strategjia e Zhviliimit Ekonomik Lokal 2016"

6.4.1. VËRSHIMET

Territori i komunës së Gjakovës ka një shtrirje të bollshme në kuptimin e sasisë së ujërave të cilat përmblidhen në pellgun e Drinit të Bardhë, në kuadër të së cilit ekzistojnë një rrjet i tërë i lumenjve (dhe liqeni hidroakumules), që këtë komunë nga aspekti hidrografik e dallon shumë nga komunat tjera të Kosovës. Territori i komunës së Gjakovës i nënshtrohet zonës me të reshura intensive të shiut me një mesatare vjetore 300-400 lit/m^2, ndërsa kur kësaj i shtohet edhe masa relativisht e madhe e shkrirjes së borës, atëherë, është evidente se vërshimet janë dukuri mjaft e pranishme në territorin e komunës që reflektohen me pasoja të theksuara, sidomos gjatë sezonës vjeshtë-dimër. Falë konfiguracionit të terenit të përshtatshëm, ato manifestohen me intensitet më të ulët.[52]
Indeksi i vërshimeve është i **nivelit të ulët dhe mesatar**.

Si e tillë, komuna e Gjakovës është e ndjeshme ndaj vërshimeve, ku më shumë e ku më pak janë të prekura nga rreziku i vërshimeve që kryesisht ndodhin pas stuhive në zonat malore, shirave të vazhdueshme dhe inetsive në zonat fushore, shkrirjes së borës, të shoqëruara me mot të lig si dhe në rastet kur brigjet e lumenjve degradohen nga shfrytëzimi i pakontrolluar i rërës dhe hedhjes së mbeturinave. Në komunën e Gjakovës zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave të lumenjëve (rreziku nga vërshimi i Drinit të Bardhë Lumi Erenik, Lumi Krena dhe Lumi Trakaniq kjo si rezultat i degradimit t]ë shtretërve të lumenjëve dhe mungesës së argjinaturave mbrojtëse.
Faktorët kryesor që ndikojnë në shkallën e vërshimeve mund të jenë: ndërrimi i regjimit të ujërave të lumenjve nga eksploatimi i pakontrolluar i inertëve në shtratërit dhe brigjet e lumenjëve, hudha hja e mbeturinave në shtratin dhe uzurpimet e brigjeve të lumit, shkatërrimi i pyjeve, ndërtimi në zonat e rrezikuara nga përmbytjet, mos ndërtimi i objekteve mbrojtëse, mos mirëmbajtja e objekteve ekzistuese etj.. Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë lumenjve Drini i Bardhë, Erenik dhe Krena. Këto zona janë: Shqiponjë, Kralan, Rakovinë, Cërmjan, Meqë, Doblibarë, Bordosanë, Rrezinë-Marmull, Rogovë, Ponoshec, Shishmon-Duzhnje, Korenicë, Devë, Guskë, Mejë, Moglicë, Raqë, Bishtazhin, Gjakovë me paralagjet Bërkoc, Dardani dhe fushë gropa e Skivjanit.

Kurba e nivelit të ujit të Drinit të Bardhë në v.2022, Vjetari Hidrometeoroligjik AMM-MMPH



[52] Dr. Nesim Vala , "Pozita dhe karakteristikat gjeografike të komunës së Gjakovës"- doracak për nevojat e Drejtorisë komunale për mbrojtje dhe shpëtim", prill 2009, Gjakovë

6.4.2. Identifikimi i rreziqeve dhe vendbanimet më të atakuara nga vërshimet

Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet është proces i cili duhet të fillojë që nga përcaktimi apo qartësimi i përmbajtjes së ekipit apo strukturës profesionale me qëllim të identifikimit të tyre. Vetë procesi i identifikimit të rrezikut nga vërshimet është një aktivitet profesional dhe i spektrit multidisiplinar e cila ngërthen në vete një mori aspektesh dhe të fushave që mund të prekin dhe cenojnë: jetën e njeriut, sistemet e ndryshme, infrastrukturën, ekonominë, mjedisin, trashëgiminë kulturore, etj.

Harta 28. Lokacionet e vërshimeve në zonën urbane



Tabela 66. Lokacionet që vërshohen në pjesën urbane dhe periferike të Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës		Pellgu lumor "Drini i Bardhë" – ujëra atmosferik					
Lokacioni i vërshimeve		Lumi/përroi	Sipëfaqe bujqësore	Shtëpi/ oborre	Infrsatruktur	Biznes	Trashëgëmi/ objekte fetare
1	Dardani	Ujërat atmosf. nga fushëgropa e Skivanjit		50		8	-
2	Carrapotok 'Fehmi Agani"	Trakaniq		8	Trafo Gjakova-1 dhe 2 ura	-	-
3	Pika e Zezë- "Wesley Clark"	Trakaniq-ujëra atmosferik	-	30	1 (rrugë)	10-15	-
4	Ish stacioni i veterinës Rr "Hysen Mehmeti"	Trakaniq		12		-	-
5	Ura Taliqit-Martirët Dervishdana	Krena	-	15	-	1	-
6	Brekoc- "Shote Galica	Erenik	-	15-20	-	-	-
7	rr.S.Shehu-A.Korenica	Krena	-	-	-	-	-
8	Unaza mbrendshme- Ura Moglicë - Ura Tabakut	Erenik			2 (rrugë 1, urë 1)	-	-

Shënim: *Poziconi 7 dhe 8 është në fazën testuese pas punimeve të realizuara në rregullimin e shtratit të lumit Krena dhe Erenik*

Harta 29. e vërshimeve në pjesën rurale të komunës së Gjakovë



Tabela 67. e përmbytjeve nga vërshimet në pjesën rurale

Komuna e Gjakovës		Pellgu lumor "Drini i Bardhë"					
Lokacioni i vërshimeve		Lumi/përroi	Sipërfaqe bujqësore	Shtëpi/ oborre	Infrsatruktur	Biznes	Trashëgëmi/ objekte fetare
1	Segmenti Rakovinë-Rogovë	Drini i Bardhë	60	-	-	-	-
2	Dujakë	Krena	10	6	Rrugë fshati	-	-
3	Skivjan	Krena	8	-	Rrugë fshati	-	-
4	Osek Hilë	Krena	5	-	Rrugë regjionale	-	-
5	Bishtazhin	Erenik	3	-	-	1	-
6	Moglicë	Erenik	5	10	-	-	-
7	Meje	Trava	2	-	-	-	-
9	Rracaj	Trava	5	7	-	-	-
10	Duzhnje	Erenik	8	5	-	-	1
11	Segmenti Smolicë-Brovinë	Erenik	20	-	-	-	-
12	Botush	Gusha	-	6	-	-	-

Këto vërshime/përmbytjet determinohen nga një mori faktorësh ndër të cilët dallojmë[53]:

- ✓ Shtretërit relativisht të cekët të lumenjve Krena dhe Llukac që reflektojnë me vërshime në pjesët urbane dhe Ereniku e Drini Bardhë si faktor potencial shkaktimit të vërshimeve për pjesët periferike dhe rurale të komunës së Gjakovës;
- ✓ Mosrregullimi i infrastrukturës së shtretërve të lumenjve;
- ✓ Degradimi i shtretërve të lumenjve - gërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara i resurseve natyrore – rërës dhe masës drunore në shtratin dhe përgjatë shtratit të lumenjve, duke inicuar vërshime, erozion të brigjeve të lumenjve dhe ndërrimin e drejtimit të lumenjve;
- ✓ Punimet e paautorizuara në dhe rreth shtretërve të lumenjëve me ç'rast paraqitet dukuria e dëmtimit të tubacioneve të ujit që për pasojë ka ngritjen e nivelit të lumenjve dhe përmbytjen e vendbanimeve të caktuara;
- ✓ Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjve;
- ✓ Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve, sidomos në pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.;
- ✓ Mosfunksionimi normal dhe mirëmbajtja jo e rregullt e infrastrukturës së rrjetit të ujërave atmosferikë dhe fekale,
- ✓ Mungesës së kontroleve rigoroze dhe zbatimit të rrept të rregulloreve në sankcionimin e personave fizik dhe juridik të cilët me veprimet e tyre të paligjshme, drejtpërdrejtë ndikojnë në rritjen e rrezikut nga vërshimet dhe dëmet e shkaktuaraetj.

Komuna e Gjakovës, sidomos në këto 10 vitet fundit ka realizuar një sërë projekte mjedisore, duke krijuar mes tjerash, një standard të avancuar të cilat medoemos do të ndikojnë në parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave eventuale nga vërshimet.

Me rregullimin e shtratit të lumit "Krena" i cili përshkon pjesën urbane të komunës në gjatësi prej 3.6 km si dhe një pjesë të shtratit të lumit Trakaniq, janë eliminuar disa lokacione potenciale për vërshime dhe erozionit të brigjeve të saj.

[53] Raport për Komitetin për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Gjakovës- DMSH, 16/11/2018, f..2

6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshime

Kushtet natyrore të Komunës së Gjakovës janë të tilla, ku pjesët e rrafshta të territorit janë të përshtatshme dhe me potencial për toka bujqësore dhe shtrirjen e vendbanimeve, vendosjen e industrisë, zhvillimin e infrastrukturës, ndërsa pjesët me lartësi më të madhe mbidetare qe shtrihen më në periferi, kushtëzon rrjedhjen e shpejt të ujërave dhe me kapacitete shpesh maksimale të ujë-rrjedhave dhe pellgjeve lumore. Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që mund të dëmtojnë zona të mëdha të deltave lumore të lumenjve dhe të shkaktojnë vërshime rrëke në përrenj më të vegjël. Për më tepër, për shkak të ndryshimit të klimës, ndikimet e ashpra të vërshimeve mund të priten edhe në komunën tonë në të ardhmen.

Drini i Bardhë zakonisht përmbytë sipërfaqet bujqësore përgjatë rrjedhës së saj, derisa lumi Erenik përveç përmbytjes së sipërfaqeve bujqësore kryesisht në regjionin e Rekës së Keqe, përmbytë edhe një periferike të në jugperëndim të Gjakovës. Ndërsa lumi Krena dhe Trakaniq kryesisht kanë ndikim në shkaktimin e vërshimeve të shpejta urbane dhe në pjesët periferike të qytetit.

Karakteristikë e këtyre vërshimeve është se ato kanë ndodhur në vazhdimësi dhe sistematikisht pothuajse në të njëjtat lokacione të prezentuara në hartat e shënuara më lartë, derisa ato urbane, sidomos kur kemi të bëjmë me reshjet atmosferike ato janë shfaqur në mënyrë asimetrike varësisht nga gjendja infrastrukturës së e rrjetit të ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza e veçanarësht kanaleve për shkarkimin e ujërave të tepërta. Kryesisht këto vërshime janë sezonale me mundësi të ndodhjes së paku 1 herë në vit, janë të shpejta, lumenjtë arrijnë koutat maximale për një interval të shkurtë kohor mes intervalit 24-48 orë, derisa kjo kohë shkurtohet kur krahas reshjeve ka edhe shkrierje të borës.
Për shumë arësye (ngrohja globale, shpyllëzimi i pyjeve, ndërhyrjet e faktorit njeri, etj), lumenjë gravitojnë në territorin e komunës, nga viti në vit janë gjithnjë më rrëmbyeshim dhe agresivë duke shkaktuar dëme të konsiderueshme sidomos gjatë nëntorit 2021 dhe janar-shkurtë/2022.

<u>Pasojat e mundshme nga vërshimet</u>

Rreziqet e mundshme nga vërshimet janë shumëdimensionale dhe në masë të madhe çrregullojnë funksionimin normal të jetës dhe punës në mjediset ku paraqiten. Pasojat e mundshme nga vërshimet mund të jenë:

- Viktima në njerëz, sidomos, rrezikimi i kategorive të caktuara të popullatës (të moshuar, nënat me fëmijë, fëmijë persona me aftësi të kufizuara handikept etj);
- Dëmet në infrastrukturë : rrugë, ura, rrjeti elektrik dhe telefonik, digat etj., që për pasojë kanë ndërprerjen apo vështirësimin e qarkullimit të personave dhe mallrave si dhe funksionimin e sistemit të telekomunikimit, ndërprerjen apo furnizimin e reduktuar me energji elektrike, mungesa apo reduktimet me furnizim me ujë të

pijshëm dhe një mori problemesh që lidhen me funksionimin normal të jetesës në çdo kuptim;

- Përmbytja dhe dëmtimi i shtëpive të banimit dhe objekteve komerciale , sidomos të atyre të ndërtuara me standard të dobët,
- Dëmet e shkaktuara në pajisjet elektro-shtëpiake, të të mirave materiale dhe dëmeve tjera në ekonomi nga vërshimet e bodrumeve dhe kateve përdhese,
- Mundësia e shpërthimit të epidemive dhe dukurive tjera të dëmshme për shëndetin,
- Dëmet në agrokulturë dhe produktet tjera bujqësore,
- Dëme dhe efekte tjera anësore dhe të paparashikuara për ambientin dhe segmente tjera.

Në bazë të të të dhënave të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Raporteve të Komisionit Komunal për Vlerësimin e dëmeve, rezulton së pasojat nga vërshimet nga viti në vit janë gjithnjë e më të mëdha duke afektuar të gjitha kategoritë, duke përfshirë ekonomit familjare, bisneset, infrastrukturën, bujqësinë, ambientin etj, gjë që e dëshmon evdienca në vijim:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

REFERENC-Ë, DT:	01 / Zyrtare / 2026 datë 25.02.2026
PËR/ZA/TO:	Z. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës së Gjakovës
Cc:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	Devoll Kerleshi - Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e dëmeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi dëmet nga vërshimet e dt. 05-08 Janar 2026

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Komisioni Komunal i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me datë 25.02.2026 nxjerr këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare në biznese dhe në kulturat bujqësore - bletari në territorin e Komunës së Gjakovës në muajin Janar të vitit 2026, vlerësimi i dëmeve ka filluar që nga data 12/01/2026, pas vlerësimit në teren për secilën kërkesë, nxjerrë pasqyrën e dëmeve më sa vijon:

Nr.	Profili i dëmit	Numri i rasteve	Vlera e dëmit
1.	Dëme në ekonomi familjare	236	2,276,476.93 €
2.	Dëmet në Biznese	17	299,537.24 €
3.	Dëmet në kulturat bujqësore - bletari	16	223,836.44 €
	Totali :		2,799,850.61 €

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

REFERENC-Ë, DT:	12/Zyrtare , dt. 12.10.2022
PËR/ZA/TO:	Z. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës së Gjakovës
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Direkt
NGA/OD/FROM:	Blerta Qelaj Daci - Kryesuese e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi dëmet nga vërshimet e dt. 16-17 Shtator 2022

Mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës Nr.01-112/02-21539 të datës 19.09.2022 për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve në ekonomitë familjare dhe në biznese, të shkaktuara nga reshjet e shiut në teritorin e Komunës së Gjakovës, Komisioni në përbërje prej 5 antarësh, hartoi këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare dhe në biznese në teritorin e Komunës së Gjakovës, Komisioni punën e tij e ka zhvilluar nga data 19/09/2022 - 12/10/2022, dhe në finalizimin e tij prezenton pasqyrën e dëmeve më sa vijon:

#	Profili i dëmit	Numri i rasteve	Vlera e dëmit
1.	Ekonomi familjare	197	305,742.00 €
2.	Dëmet në Biznese	45	1,152,092.00 €
	TOTALI :		**1,457,834.00 €**

Shënim: dokumentacioni i të dhënave individuale për secilin rast veç e veç është i arhivuar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Komisioni:

1. Blerta Qelaj Daci, Kryesuese e Komisionit
2. Sharr Mullaxhela, anëtar
3. Devoll Kërleshi, anëtar
4. Armend Behluli, anëtar
5. Selami Tuzi, anëtar

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

REFERENC-Ë, DT:	Zyrtare , dt. 28.01.2021
PËR/ZA/TO:	Ardian Gjini – Kryetar i Komunës së Gjakovës
Ce:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Direkt
NGA/OD/FROM:	Blerta Qela – Kryesuese e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi dëmet nga vërshimet e dt. 30-31 Dhjetor 2020 dhe 07-12/01.2021

Mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës Nr.01-112/01-1635 të datës 20.01.2021 për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet nga reshjet e shiut dhe të borës në teritorin e Komunës së Gjakovës, Komisioni në përbërje prej 6 antarësh, hartoi këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe të bores në teritorin e Komunës së Gjakovës, Komisioni punën e tij e ka zhvilluar nga data 20-28/01/2021, dhe në finalizimin e tij prezenton pasqyrën e dëmeve më sa vijon:

#	Profili i dëmit	Numri i rasteve	Vlera e dëmit
1.	Ekonomi familjare	163	217,608.00 €
2.	Dëmet në Bujqësi	11	158,160.50 €
3.	Dëmet në infrastrukturë (rrugë dhe ura)	6	115,000,00 €
4.	Dëmet në Biznesë	9	74,192.00 €
	TOTALI :		**564,960.50 €**

Shënim: dokumentacioni i të dhënave individuale për secilin rast veç e veç është i arhivuar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Komisioni:
1. Blerta Qela, Kryesuese e Komiosionit
2. Sharr Mullaxhela, anëtar
3. Taulant Bakalli, anëtar
4. Pjetër Marku, anëtar
5. Armend Behluli, anëtar
6. Selami Tuzi, anëtar

Dëmet nga vërshimet në bujqësi [54]	
Viti	Vlera në Euro/€
2022	302,123.04
2026	223,836.44
Gjithsejtë:	**525,959.48**

[54] Burimi: DBPZHR Raporti dëmeve nga vërshimet 2022/2026

6.4.4. Kushtet hidro-klimatolologjike[55]

Territori i komunës së Gjakovës në kuptimin klimatik i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme në përgjithësi në nivel vendi. Veçoritë klimatike ndryshojnë varësisht nga elementet klimatike si: diellosja (insolacioni), temperatura, reshjet, shtypja atmosferike, erërat, etj. Edhe komuna e jonë sikur në gjithë vendin, me disa dallime të vogla klimatike shënojmë vlerat ekstreme pozitive të temperaturave në komunë..

Për shkak të ndryshimeve klimatike, ngjarjeve ekstreme të motit të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet, mund të rriten në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomi familjare, infrastrukturë biznes dhe mjedis.

4.5 St. automatik Gjakovë - Të dhënat klimatologjike

Të dhënat klimatologjike: 2022
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 23' 24.01"
Lartësia mbidetare e st.: 410 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 25' 32.02"

Muaji	Temperaturat (°C)				Temperatura extreme (°C)						Shtypja e ajrit (hPa)
	7	14	21	Tmes	Tmin	Tmax	Min	Dita	Max	Dita	Mes
I	-2.5	5.7	-0.1	0.9	-	-	-	-	-	-	972.0
II	1.5	9.8	3.8	4.9	-	-	-	-	-	-	969.7
III	1.9	10.7	4.1	5.1	-	-	-	-	-	-	973.8
IV	9.4	16.0	9.9	11.1	-	-	-	-	-	-	964.5
V	16.4	24.8	15.5	17.6	-	-	-	-	-	-	968.7
VI	21.6	28.3	19.9	22.1	-	-	-	-	-	-	966.8
VII	22.7	30.9	20.6	23.4	-	-	-	-	-	-	968.4
VIII	21.1	29.9	20.7	22.7	-	-	-	-	-	-	965.4
IX	14.8	22.3	15.3	16.8	-	-	-	-	-	-	966.5
X	9.0	20.3	11.0	12.8	-	-	-	-	-	-	974.6
XI	6.6	12.8	7.8	8.9	-	-	-	-	-	-	968.4
XII	4.0	8.0	4.4	5.2	-	-	-	-	-	-	970.7
Viti	10.6	18.3	11.1	12.7	-	-	-	-	-	-	969.2

Muaji	Lagështia e ajrit (%)				RD (h)	Mbulueshmëria me re (0-10)				Reshje shiu (mm)			Bora (cm)	
	7	14	21	Mes	Σ	7	14	21	Mes	Σ	Max	Dita	Tot	Ere
I	82	61	79	75	-	-	-	-	-	0.0	0.0	02/01+	-	-
II	82	59	77	73	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/02+	-	-
III	71	43	65	61	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/03+	-	-
IV	74	53	72	68	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/04+	-	-
V	76	49	79	71	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/05+	-	-
VI	77	54	83	75	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/06+	-	-
VII	70	43	77	68	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/07+	-	-
VIII	81	48	81	73	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/08+	-	-
IX	92	62	88	83	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/09+	-	-
X	98	63	93	87	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/10+	-	-
XI	97	78	94	91	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/11+	-	-
XII	98	87	97	95	-	-	-	-	-	0.0	0.0	01/12+	-	-
Viti	83	58	82	76	-	-	-	-	-	0.0	0.0	02/01+	-	-

Muaji	Ditë me												
	Temperaturat (°C)						Shpejtësia e erës (m/s)		Mbulueshmëria me re (0-10)		Reshje shiu (mm)		
	Tn ≤ -10	Tn < 0	Tn ≥ 20	Tx < 0	Tx ≥ 25	Tx ≥ 30	> 6	> 8	< 2	> 8	≥ 0.1	≥ 1	≥ 10
I	-	-	-	-	-	-	15	9	-	-	0	0	0
II	-	-	-	-	-	-	14	8	-	-	0	0	0
III	-	-	-	-	-	-	17	5	-	-	0	0	0
IV	-	-	-	-	-	-	18	10	-	-	0	0	0
V	-	-	-	-	-	-	11	2	-	-	0	0	0
VI	-	-	-	-	-	-	9	4	-	-	0	0	0
VII	-	-	-	-	-	-	7	4	-	-	0	0	0
VIII	-	-	-	-	-	-	15	7	-	-	0	0	0
IX	-	-	-	-	-	-	16	8	-	-	0	0	0
X	-	-	-	-	-	-	3	1	-	-	0	0	0
XI	-	-	-	-	-	-	9	5	-	-	0	0	0
XII	-	-	-	-	-	-	9	4	-	-	0	0	0
Viti	-	-	-	-	-	-	143	67	-	-	0	0	0

[55] Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, -"Tabelë e të dhënave statistikore për komunën e Gjakovës", Prishtinë/2025

Treguesit hidrometeorologjik

- **Sasitë e të reshurave:** në rajonin e Gjakovës – sillen rreth 754.8 mm, ndërsa, gjatë vegjetacionit arrijnë 342.9 mm.
- **Lagështia mesatare e ajrit** gjatë vitit është 70,2%. Në periudhën Verë-Vjeshtë lagështia është dukshëm më e madhe për 17,5% në krahasim me periudhën Dimër-Verë
- **Vranësirat mesatare vjetore** janë 58% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60,5 (16,6%) në vit, ndërsa e ditëve të vranëta janë 119,3 ditë (32,6%).
- **Era:** Në komunën e Gjakovës është e theksuar në drejtimin Jug – Perëndim, të cilat erëra kohë pas kohe arrijnë shpejtësinë 4-11 metra në sekondë.

4.58 St.automatik Gjakovë/Radoniq - Trëndafili i erës

Trëndafili i erës: 2023
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 25' 51.05"
Lartësia mbidetare e st.: 470 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 28' 13.75"



Calm: Wind speed ≤ 0.2 m/s

Foto 7. Drejtimi dhe shpejtësia i erës

Të dhënat statistikore për muajt kritik për vërshime

Lartësia mesatare vjetore e të reshurave atmosferike është 959,3 mm. Në dimër sasia mesatare e të reshurave atmosferike është 332.4 mm, ndërsa në verë 118.4 mm, në vjeshtë 270.0 mm, dhe pranverë 238.6 mm. Sasia mesatare e të reshurave. atmosferike në periudhën vegjetative (prill-shtator) është 331.2 mm. Maksimumi i të reshurave na paraqitet në dhjetor me 372.6 mm dhe minimumi në muajin gusht me sasi prej 4.0 mm. Prandaj në lokalitetin e Gjakovës paraqiten dy maksimume të të reshurave atmosferike që mund të cilësohen si kritik në kuptimin e shkaktimit të vërshimeve, njëri në shkurtë dhe tjetri në dhjetor. Në kontekst të kësaj kemi edhe dy minimumet e të reshurave, njëri në qershor dhe tjetri në korrik.[56]

[56] Dr. Nesim Vala , ”Pozita dhe karakteristikat gjeografike të komunës së Gjakovës”- Doracak për nevojat e Drejtorisë komunale për mbrojtje dhe shpëtim”, prill 2009, Gjakovë

5.7 Gjakovë / Radoniq

Reshjet (mm): 2022
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 26' 26.21"
Lartësia mbidetare e st.: 439 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 28' 14.92"

Dita	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1	0.0	0.0	0.0	32.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0
2	0.0	0.0	0.0	22.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	2.1	0.0	5.9
3	0.0	0.0	0.0	6.3	26.2	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	0.0	0.0
4	0.0	0.0	0.0	1.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.5	0.0	0.0	5.7	0.0	0.0	1.3
6	0.0	13.5	13.5	0.0	0.0	0.2	12.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
7	0.0	10.9	10.9	0.7	0.0	2.5	0.0	0.0	0.0	0.0	4.1	3.6
8	0.0	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	5.4
9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.1	8.9	0.3	0.0	0.0	0.0	12.3
10	0.0	0.0	2.7	0.0	0.0	1.7	0.8	0.0	10.1	0.0	0.0	3.1
11	46.3	0.0	2.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	2.0	0.0	0.0	7.3
12	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.3	0.5	2.2	0.0	4.1
13	7.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.0
14	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.1	0.0	0.5	0.0	0.5
15	0.0	0.0	0.0	0.0	5.8	0.0	0.0	0.0	0.0	3.0	0.0	51.2
16	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4.8
17	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	0.0	20.3	0.0	0.0	4.7
18	0.0	0.0	0.0	12.4	0.0	0.1	0.0	0.0	22.4	0.0	0.0	19.3
19	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
20	0.0	6.1	0.0	0.3	0.0	0.0	10.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
21	0.0	0.0	0.0	26.6	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	140.0	0.0
22	6.8	6.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	5.0	0.0	0.0	17.2	0.0
23	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	12.6	0.0	0.0	0.0	0.0	31.5	0.0
24	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	11.3	0.0	4.8	0.0	0.0	9.7	0.1
25	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0
26	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
27	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.5	2.3	23.5	0.0	0.0	0.1
28	0.0	4.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	6.0	0.0	0.0	0.2
29	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.9	0.0	0.0	0.0
30	0.0		0.0	0.0	4.6	0.0	0.0	2.9	4.1	0.0	0.0	0.0
31	0.0		2.3		0.0		0.0	2.5		0.0		0.0
Σ (797.1)	60.5	41.9	31.7	102.3	36.6	32.3	34.9	21.8	98.9	7.8	202.5	125.9
Min	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Max	46.3	13.5	13.5	32.1	26.2	12.6	12.8	5.0	23.5	3.0	140.0	51.2
Dita (91 d)	3	5	6	8	3	10	6	11	13	4	5	17

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës – Tabela e reshjeve mesatare mujore në vit për Komunën e Gjakovës IHK/, Prishtinë

6.4.5. Realizimi i projekteve me impaktë në parandalimin e vërshimeve

Me qëllim të parandalimit të vërshimeve dhe zvogëlimit të pasojave të shkaktuara nga to, Komuna e Gjakovës në vazhdimësi ka investuar dhe është angazhuar për realizimin e projekteve për qëllimet e shënuara më lartë, si:

1. Rregullimi i shtratit të lumit Krena që përshkon pjesën urbane të qytetit, deri sa aktualisht në proces është rregullimi i tij në pjesët periferike, atë në drejtim të IMN dhe tjera në drejtim të Spitalit;
2. Ndërtimi i urës sipas standardeve të larta mbi lumin Krena në pjesën problematike prapa Jatex Co, te kryqëzimi i rrugës Ahmet Korenica;
3. Rregullimi i shtratit të lumit Llukac në segmentin qendror të saj, ndërsa planifikohet që gjatë vitit fiskal 2016 të përfundohen segmenti në drejtim të veriut dhe pjesa tjetër në jug-përendim deri në derdhjen e saj në lumin Erenik;
4. Rehabilitimi brigjeve dhe thellimi i shtratit të lumit Erenik, segmenenti nga ura Tabakut deri te ura e Moglicës;
5. Rregullimi i shtratit të përrockës Gusha në fshatin Botush;
6. Rregullimi sukcesiv i infrastrukturor në i kompleksit të banimit në krahun e majt të rrugës Wesley Clark tek Pika e Zezë;
7. Rregullimi i kolektorëve, rrjetit të kanalizimit dhe uj[rave atmosferik për eliminimin e "fytave të ngushtë" për parandalimin e vërshimeve të karakterit urban;
8. Ndërtimi i mureve të larta mbrojtjëse për parandalimin e erozionit në të dy krahët e lumit Krena përgjatë rrugës segmenti rr. Bajram Curri-Bregu i Perjucit;
9. Zgjerimi dhe rehabilitimi i brigjeve të shtratit të lumit Krena në Fshatin Skivjan;
10. Futja e përrockës "Bujena" në tubacione në mes të fshatit Molliq (150-200 m);
11. Shtrirja e tubacioneve në pikat kritike në aksin rrugor fsh.Ujz-Rogovë;
12. Ndërhyrje dhe intervenime tjera emergjente me qëllim të shmangjes së rrezikut dhe funksionimin e esencial të komunitetit dje institucioneve;

Foto nga ndërhyrjet emergjente

6.4.6. Masat parandaluese dhe rekomandimet

Grupi punues për hartimin e dokumentit të Vlerësimit të rrezikut ka propozuar këto masa preventive me qëllimit të parandalimit të vërshimeve në territorin e komunës:

Masat parandaluese

- Rritja e kontrollit mbi ndërtimet e egra të objekteve të banimit në shtretërit dhe brigjet e lumit;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale, kanaleve të hapura të ujitjes etj. që kalojnë edhe nëpër qytet, shtretërve të lumenjve, urave, etj;
- Ndalimi i mbeturinave dhe inerteve të ndryshme në lumenj, kanale dhe bllokimi i hapjeve të urave;
- Ndalimi dhe kontrolli i gërmimeve dhe eksploatimeve të pa kontrolluara të resurseve natyrore , meqërast ndërron edhe kahja e rrjedhës së ujit e më pastaj dalja nga shtrati;
- Mirëmbajtja e lumenjve nga organet kompetente;
- Zgjërimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë ngastrat pranë;
- Hapja e kanaleve anësore(të kullimit) dhe të rrugëve nga ndërtimet e paligjshme të pronarëve privat, etj.

Rekomandime

- Marrja e masave për rregullimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar i lëndëve inerte nga shtretërit e lumenjve në Kosovë;
- Marrja e masave nga organet e nivelit lokal në menaxhimin adekuat të mbeturinave në shtretërit e lumenjëve;
- Marrja e masave në mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale;
- Të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional veçënarisht në nivelin Komunal, kompanitë e furnizimit dhe shkarkimit të ujërave, lidhur me parandalimin, mbrojtjen nga vërshimet;
- Senzibilizimi dhe vetëdijesimi qytetarë lidhur me shkaqet e dhe pasojat e vërshimeve, si dhe
- Masa tjera që ndikojnë pozitivisht për tu mbrojtur nga ndikimet e veprimeve të dëmshme të ujërave.etj.

6.4.7. Analizë e vlerësimit vendbanimeve më të ndieshme nga vërshimet

1. VËRSHIM DARDANI

Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Rreziku	Vërshim	
Modeli	Sezonal	
Zona e goditur:	Lagjja “Dardania” Urban – 1	

HISTORIKU

Vërshimi në këtë zonë shkaktohet nga ngritja e nivelit të ujit në kanalin ekzistues (800m') i cili përshkon të dy anët e rrugës regjionale Gjakovë-Deçan. Pikë kritike në këtë zonë paraqet kanali nën-rrugor (tek fabrika e lëngjeve në pjesën veriore në dalje të qytetit) i cili përveç që nuk plotëson kriteret tekniko ndërtimore për pranimin e sasive më të mëdha të ujit, në të shumtën e rasteve krijon fyt të ngushtë (barrierë) si pasojë e hedhjes së mbeturinave të llojeve të ndryshme duke e ngushtuar profilin e syrit të kanalit. Uji nga ky kanal i ndërtuar nga beton armeja, del nga korita e saj vetëm në raste të të reshurave intensive të pandërprera më shumë se 48 orë, çka nënkupton se vërshimet janë momentale dhe gjendja në normalitet rikthehet për më pak se 1 javë pas ndërprerjes së të reshurave. Në kontekst, vërshimet janë sipërfaqësore duke përmbytyr oborret dhe bodrumet e shtëpive dhe disa objekteve biznesi në të dy krahët e rrugës magjistrale.

PROFILI I RREZIKUT

- **Frekuenca e ndodhjes:** shumë i mundshëm 50-100% vitin e ardhshëm
- **Kohëzgjatja e mundshme:** 24-48 orë
- **Shpejtësia e mësymjes:** Paralajmërimi: 12-24 orë
- **Sistemi paralajmërimit:** IHMK
- **A ekziston analiza e dobësive (cënueshmërisë):** PO
- **Ndikimi:** i vogël
- Data vlerësimit: janar/2021

PASOJAT E MUNDSHME

- Një numër i kufizuar i familjeve të goditur nga vërshimi pa fatalitete dhe pa kërkesa për hospitalizim dhe trajtim medicinal,
- Pa kërkesa për zhvendosje të përkohshme të banorëve,
- Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Kontaminim i thjeshtë i ujit,efekti i lokalizuar shpejt,
- Funksionim normal i komunitetit.

CËNUESHMËRIA NGA GODITJA

Banorë	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmije	Pleq	Të mirat materiale	Infrastrukt. Kritike	Objekte te rëndësisë së veçantë	Biznese	Dëmet Ekonomike (Kostoja)
230	46		112	118	68	21	- Pajisje të amvisërisë -shtroj dhe orendi - Ushqim -Vetura	Ujesjellesi Rryma Kanalizimi Sisteme etj Furre buke	Shkolla "Selman Riza"	8	

ShKALLA E RREZIKUT



Prioriteti i reagimit sipas shkallës së ashpërsisë

5	Prioritet i shumë i lartë – (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur– (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1) nuk kërkohet veprim

2. VËRSHIM- CARRAPOTOK

Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Rreziku	Vërshim	
Modeli	Sezonal	
Zona e goditur:	Segmenti "Sadri Zeneli-Fehmi Agani- Hysen Mehmeti	

HISTORIKU

Teritori që vërshohet në këtë lokacion shtrihet në mes dy urave të lumit Trakaniq segmentit rrugor Sadri Zeneli-Fehmi Agani" deri te ura në rrugën Hysen Mehmeti. Ky lokacion vërshohet si pasoj e rritjes së nivelit të ujit të lumit Trakaniq. Ndodhë që situata emergjente përkeqësohet shkak të shkarkimit të ujërave nga të reshurat atmosferike dhe shkrierja e bores nga Rezinat me mësymje në drejtim të Bodrumit të Verës-Pompa"Niki-S" duke marrë formës e një "lumi të përkohshëm" me derdhje në shtratin e lumit Trakaniq në afërsi të TS Gjakova-1. Vërshimet godasin 20 shtëpi banimi, nga të cilat 12 prej tyre i takojnë kategorisë së venbanimit joformal të banuar me komunitet RAE me pozicion posht urës së këtij lumi në rr.Hysen Mehmeti.

Në këtë pikë Vërshimet janë momentale, ndërsa nga reshjet intensive shendërrohet në një lumë u me rrjedhë të shpejtë erozive dhe bartëse duke krijuar barriera sidomos nga masat drunore, mbeturinave dhe gjësendeve të hudhura të cilat drejtëpërdrejtë intensifikojnë përmasat në zonën e vërshimit.

ërshimet janë Ato janë të shpejta dhe ato kryesisht vërshojnë bodrumet dhe përdhesat e shtëpive të shëqëruara me dëme materiale në amvisëri, si dhe të 2 bizneseve skaj rrugës magjistrale Prishtinë-Gjakovë.

PROFILI I RREZIKUT

- **Frekuenca e ndodhjes:** Shumë i mundshëm 50-100% vitin e ardhshëm
- **Kohëzgjatja e mundshme:** 24-48 orë
- **Shpejtësia e mësymjes:** Paralajmërimi: 12-24 orë
- **Sistemi paralajmërimit:** IHMK

- **A ekziston analiza e dobësive (cënueshmërisë):** PO
- **Ndikimi:** i vogël
- Data vlerësimit: shkurtë/2022

PASOJAT

- Numër i kufizuar i njerëzve të goditur, disa seriozisht të hospitalizuar kërkohet trajtim mjekësor,
- .Zhvendosje e lokalizuar e numrit të vogël të njerëzve nga deri në 10 ditë,
- Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Kontaminim i thjeshtë,efekti i lokalizuar shpejt.funksionim normal i komunitetit
- Rrezikimi i jetës së njerëzve (kalimtarëve) në momentin e arritjes së pikës kritike të nivelit të ujit (3m/l)
- Vërshimet e oborreve, bodrumeve dhe kateve përdhese (në nivel me tokë)
- Degradimi i shtratit të lumit dhe grumbullimi i mbeturinave

Banorë	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmije	Pleq	Të mirat materiale	Infrastrukt. Kritike	Objekte te rëndësisë së veçantë	Biznese	Dëmet Ekonomike (Kostoja)
126	28		**62**	**64**	**39**	**16**	- Pajisje të amvisërisë -shtroj dhe orendi -dysheme, fasad		TS Gjakova 1	2	

SHKALLA E RREZIKUT

Pasojat \ Gjasat	1 E sigurt	2 Gati e mundur	3 E besushme	4 E pabesueshme	5 E pamundur
5 Katastrofike					
4 Kritike					
3 E mesme					
2 E vogel	X				
1 E papërfillshme					

Prioriteti i reagimit sipas shkallës së ashpërsisë

5	Prioritet i shumë i lartë – (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur– (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1) nuk kërkohet veprim

3. VËRSHIM – PIKA E ZEZË

Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Rreziku	Vërshim	
Modeli	Sezonal	
Zona e goditur	Pika e Zezë – rr"Wesley Clark"	

HISTORIKU
Nga aspekti i analizës dhe vlerësimit të rrezikut, ky lokacion trajtohet si zonë problematike e cila kryesisht është e ndikuar mungesa e rregullimit të mirëfilltë urbanistik dhe parregullësive dhe anomalive ndërtimore të cilat kryesisht kanë ardhë si pasoj e veprimeve arbitrare ndërtimorenga ana e pronarëve të këtyre parcelave. Kjo është shoqëruar edhe me infrastrukturës përkatëse (mungesa e rrjetit të kanalizimit,të ujërave atmosferik,,rrugëve mbrenda lokacionit etj). Kemi të bëjmë një fluks të madh ndërtimesh për një periudhë relativisht të shkurtë kohore, qofshin ato individuale, kolektive apo komerciale, me ç'rast për shkak të mosrespektimit të kushteve të përgjithshme urbanistike e ndërtimore komuniteti i kësaj lagjeje ballafaqohet me efektin e vetvërshimit (boomerang). Bllokimi i tubacionit nën rrugën magjistrale Gjakovë-Prishtinë (rreth 200m nga kthesa e Pikës së zezë) dhe eliminimi i kanalit të hapur përgjatë e këtij vendbanimi përmes të cilit bëhej shkarkimi i ujërave atmosferik nga fushat e Rezinës e deri tek Hotel President-Restorant Kalaja tutje në lumin Trakaniq ka ndikuar në përkeqësimin e situatës emergjente në këtë lokacion. Vërshimet janë sistematike shumë të mundshme, pothuaj se çdo vit, të shoqëruara me dëme të kufizuara materiale në amvisëri dhe në një objekt afarist-restorant. Nuk ka nevoj për veprime evakuimi

PROFILI I RREZIKUT	
◻ **Frekuenca e ndodhjes:** Shumë i mundshëm 50-100% vitin e ardhshëm ◻ **Kohëzgjatja e mundshme:** 24-48 orë ◻ **Shpejtësia e mësymjes:** Paralajmërimi: 12-24 orë ◻ **Sistemi paralajmërimit:** IHMK	◻ **A ekziston analiza e dobësive (cënueshmërisë):** PO ◻ **Ndikimi:** i ngritur ◻ Data vlerësimit: 12/2022

PASOJAT
- Një numër i kufizuar i familjeve të goditur nga vërshimi pa fatalitete dhe pa kërkesa për hospitalizim dhe trajtim medicinal, - Pa kërkesa për zhvendosje të përkohshme të banorëve, - Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal, - Kontaminim i thjeshtë i ujit,efekti i lokalizuar shpejt, - Funksionim normal i komunitetit

CËNUESHMËRIA NGA GODITJA

Banorë	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmije	Pleq	Të mirat materiale	Infrastrukt. Kritike	Objekte te rëndësisë së veçantë	Biznese	Dëmet Ekonomike (Kostoja)
144	32		71	73	45	18	- Pajisje të amvisërisë -shtroj dhe orendi -dysheme, fasad		TS Gjakova 1	2	

RREZIKU I PËRGJITHSHËM

Gjasat

		1	2	3	4	5
Katastrofike	5					
Kritike	4					
E mesme	3					
E vogel	2	X				
E papërfillshme	1					

Pasojat

1 E sigurt
2 Gati e mundur
3 E besushme
4 E pabesueshme
5 E pamundur

Prioriteti i reagimit sipas shkallës së ashpërsisë

5	Prioritet i shumë i lartë – (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur– (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1) nuk kërkohet veprim

3. VËRSHIM LAGJA GECË-JUSUF

Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Rreziku	Vërshim	
Modeli	Sezonal	
Zona e goditur	Lagja Gecë – Lagja Jusuf	

HISTORIKU

Vërshimet në lokacionin prej urës së Taliqit gjegjësisht segmenti "Konferenca e Bunjajt-Dëshmorët e "Ponoshecit" në drejtim të spitalit rajonal "Isa Grezda" shkaktohen si pasoj e ngritjes së nivelit të ujit në shtratin e lumit "Krena". Efekti i vërshimeve është i menjihershëm dhe goditë shtëpitë e banimit të vijës së parë pranë brigjeve të lumit dhe kryesisht ndodhin kur reshjet janë intensive dhe mbi 24 orë pandërprerë. Ky segment i lumit i takon pjesës së parregulluar të shtratit të lumit "Krena" brigjet e së cilës janë janë mjaftë të cekëta, me ndërtime në afërsi dhe hudhje të mbeturinave e inerteve, me ç'rast shkaktohen vërshohime sipëfaqësore të oborreve dhe bodrumet e rreth 20 shtëpive të vijës së parë në të dy krahët e rrjedhës së lumit me gjatësi 350-400 m'. Në këtë gjatësi ekzistojnë 3 ura (1 monumentale, 1 standarde për qarkullim dhe 1 vetëm për kalimin e këmbësorëve. Ndërtimet në këtë zonë janë standarde me material të fortë dhe rreziku nga shembja është relativisht e vogël ndërsa rreziku për jetë mund të paraqitet tek ura e improvizuar. Vërshimet në këtë pjesë të shtratit "Krena" janë momentale, dhe me ndërprerjen e të reshurave pas 12 orë bie niveli i ujit e më këtë edhe shkalla e rrezikut. Në këtë zonë është reaguar me procedura të rregullta rutinore dhe pa evakuim të banorëve. Dëmet janë kryesisht janë në paisje dhe gjësende tjera shtëpiake.

PROFILI I RREZIKUT

- **Frekuenca e ndodhjes:** Shumë i mundshëm 50-100% vitin e ardhshëm
- **Kohëzgjatja e mundshme:** 24-48 orë
- **Shpejtësia e mësymjes:** Paralajmërimi: 12-24 orë
- **Sistemi paralajmërimit:** IHMK
- **A ekziston analiza e dobësive (cënueshmërisë):** PO
- **Ndikimi:** i ngritur
- Data vlerësimit: 12/2022

PASOJAT

- Një numër i kufizuar i familjeve të goditur nga vërshimi pa fatalitete dhe pa kërkesa për hospitalizim dhe trajtim medicinal,
- Pa kërkesa për zhvendosje të përkohshme të banorëve,
- Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Kontaminim i thjeshtë i ujit,efekti i lokalizuar shpejt,
- Funksionim normal i komunitetit

CËNUESHMËRIA NGA GODITJA

Banorë	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmije	Pleq	Të mirat materiale	Infrastrukt. Kritike	Objekte te rëndësisë së veçantë	Biznese	Dëmet Ekonomike (Kostoja)
110	20		57	53	35	9	- Pajisje të amvisërisë -shtroj dhe orendi -dysheme, fasad			2	

RREZIKU I PËRGJITHSHËM



Prioriteti i reagimit

5	Prioritet shum i lartë– (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur – (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)

VËRSHIM – BREKOC I ULËT

Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Rreziku	Vërshim	
Modeli	Sezonal	
Zona e goditur	Brekoc- segmenti Ura Tabakut-rr.”Shote Galica”	

HISTORIKU
Për shkak të rritjes së nivelit ujit, daljes nga shtrati dhe devijimit të rrjedhës së lumit “Erenik” , segmenti Shote Galica-Ura e Tabakut përmbytë një pjesë të konsiderueshme dhe kompakte të këtijë vendbanimi joformal i cili shtrihet te ish Seperacionit të KNI”Dukagjini”, kryesisht i banuar nga komuniteti RAE. Përveç kushteve hidrometerologjike, faktor determinues i kësaj përmbytjeje janë ndërtime ilegale dhe sistematike të cilat janë shtrirë gradualisht në afërsi të drejtëpërdrejtë me bregun e lumit, duke e kategorizuar këtë lokacion ndër pikat me kritike në komunë me me rrezik të lartë për jetën, të të mirave materiale dhe të mjedisit. Ashpërsia dhe agresiviteti potencial i vërshimit nga viti në vit është në ngritje progresive, gjë që kërkon vëmendjen dhe ndërhyrjen e autoriteve komunale me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme. Komuna e Gjakovës në 10 vitet e fundit disa herë ka ndërmarrë masën e evakuimit të banorëve të kësaj zone dhe strehimin të përkohshëm të tyre. Koha e nevojshme për rehabilitimin e lokacionit dhe këthimin në normalitet të funksioneve vitale është mbi 30 ditë. Viktima në njerëz nuk ka patur, janë rrënuar 6-7 objekte banimi, kryesisht provizore/montazh të ngritura nga druri llamarina dhe material tjetër i dobët, të cilat janë rindërtuar me material të fortë. Aktualisht vërshohen 17shtëpi, derisa potencialisht mbesin të rrezikuar edhe 30 të tjera në distancë në 100-150 m nga bregu i lumit

PROFILI I RREZIKUT	
◻ **Frekuenca e ndodhjes:** Shumë i mundshëm 50-100% vitin e ardhshëm ◻ **Kohëzgjatja e mundshme:** 24-72 orë ◻ **Shpejtësia e mësymjes:** Paralajmërimi: 12-24 orë ◻ **Sistemi paralajmërimit:** IHMK	◻ **A ekziston analiza e dobësive (cënueshmërisë):** PO ◻ **Ndikimi:** i mesëm ◻ Data vlerësimit: janar/2021

ASHPËRSIA
- Një numër i kufizuar i familjeve të goditur nga vërshimi pa fatalitete, kërkesa për hospitalizim dhe trajtim medicinal, - Lëndimet dhe sëmundjet mund të përfundojnë me paaftësi të përhershme - Me kërkesa për zhvendosje të përkohshme të banorëve, - Ndërprerje të plotë shërbimeve së paku për 15 ditë - Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal, - Kontaminim i ujit, lokalizimi i efektit deri në 15 ditë, - Ndërpreje të funksioneve vitale të komunitetit 15-30 ditë.

CËNUESHMËRIA NGA GODITJA

Banorë	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmije	Pleq	Të mirat materiale	Infrastrukt. Kritike	Objekte te rëndësisë së veçantë	Biznese	Dëmet Ekonomike (Kostoja)
145	17	1	70	75	52	11	- Pajisje të amvisërisë -shtroj dhe orendi -dysheme, fasad			2	

RREZIKU I PËRGJITHSHËM

Gjasat

Pasojat	1	2	3	4	5
Katastrofike 5					
Kritike 4					
E mesme 3			X		
E vogel 2					
E papërfillshme 1					
	E sigurt	Gati e mundur	E besushme	E pabesueshme	E pamundur

Prioriteti i reagimit sipas shkallës së ashpërsisë

5	Prioritet shum i lartë– (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur – (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)

6.5. ZJARRET

Sipas rregullores nr. 25/2020 për "Metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë", trajtimi i zjarreve bëhet në dy kategori dhe ate: si fatkeqësi/fenomene natyrore dhe si fatkeqësi të shkaktuara nga faktori njeri (zjarre të qëllimshme, të pa qëllimshme apo si fatkeqësi të shkaktuara nga proceset teknologjike e aksidentale). Zjarri është fatkeqësi e pa kontrolluar e cila mund të kërcënojë seriozisht jetën e njeriut, të shkaktojë dëme materiale e mjedisore.

6.5.1. Karakteristikat e terenit dhe vatrave potenciale të zjarreve

Në regjionin e Gjakovës zjarret kryesisht kanë ndodhur në zonat e bjeshkëve, kryesisht në pyjet halore dhe të tjera shpesh duke rrezikuar përhapjen drejtë fshatrave malore dhe në drejtim të vendbanimeve që shtrihen në hapësirat e ulëta që përkufizohen me zonën malore. Derisa në pjesën e vendbanimeve rreziqet nga zjarri kryesisht vijnë nga rrjeti dhe instalimet e vjetruara elektrike, nga pakujdesia, djegiet e lëndës drusore për ngrohje dhe përdorimit të materieve agresive pro-pan-butani. Zjarret pyjore pothuajse janë bërë fenomen i "rregullt" në çdo vit kalendarik së paku dy here vit, kryesisht janë të shkaktuara nga faktori njeri, para së gjithash nga pakujdesia ose të qëllimshëm. Dëmet janë relativisht të mëdha në masë drunore dhe florë e faunë.[57]

Sipërfaqet pyjore përbëjnë 43% të territorit të komunës së Gjakovës, pjesa më e madhe e tyre shtrihet në jug-perëndim të komunës dhe vazhdon përgjatë kufirit me Shqipërinë. Territori i komunës së Gjakovës përfshinë gjithsej 23,6247 ha sipërfaqe pyjore, prej të cilave 5,898 ha, janë në pronësi private dhe 17,435 ha, janë pronë publike. Masa drunore në pyjet ekzistuese në territorin e komunës për nga përbërja është kryesisht fletore gjetherënëse e përdorshme për ngrohje, dhe masa tjetër drunore më e vogël përbën drunjtë halor për qëllime tekniko - industriale (Pisha).

Reliefi i komunës si pjesë integrale e vargmaleve në Kosovë, është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre te jashtme të cilat kanë modeluar atë, që lidhet me ngritjet periferike të maleve të Komunës së Gjakovës të cilat kryesisht gravitojnë përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë.

Harta 30. Reliefi i komunës së Gjakovës (Hipsometria e terenit)



[57] Dr. Behxhet Shala " Ndikimi në Mjedisë " – faqe 12., Prishtinë , qershor 2009

Shkaqet e zjarreve në komunën e Gjakovës kanë karakter:

- ✓ Antropogjen (nga pakujdesia apo të qëllimshme),
- ✓ Djegia e hamulloreve dhe kullotave (zjarrëvënie e qëllimshme);
- ✓ Zjarrëvënie e qëllimshme në pyjeve për interesa (perfitime) personale apo vese pirromanie;
- ✓ Zjarre të shkaktuara nga natyra (rrufeja apo temperaturat e larta,shumë të rralla apo të pa mundshme).



Zonat më të atakuara nga zjarret janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, kurse zjarret fushore i ekzpozohen zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barishtave.

Në bazë të parametrave të deritashëm dhe shpeshtësisë së rënies së zjarreve dhe funkcionalitetit në pikëpamje palnifikuese dhe reaguese sipëfraqet pyjore i kemi ndarë në 5 zona kritike me karakteristika afërsisht të njejta të vlerësimit dhe të reagimit emergjent. Zonat që shtrihen përgjatë kufirit me Shqipërin (Koshare,Qerreti dhe Hasi) përveç se kan konfiguracion tejet të vështirë për shkak të thellësisë për çasje në vendngjarje, disa nga to konsiderohen jo plotësisht të sigurta nga mjetet e pashpërthyera mino-eksplozive.

Vatrat potenciale të zjarreve në komunë janë: [58]

1. **Zona e Majës së Lartë**- sipërfaqet pyjore segmenti: Koshare – Botushë - Molliq – Brovinë;
2. **Zona e Qerretit**- e cila përfshinë brezin kufitare më Republikën e Shqipërisë segmentin: Qafë Morinë-Babaj Bokës (Morinë-Ponoshec-Popoc-Shishman-Babaj Bokës) ;
3. **Zona e Pashtrikut**- segmenti: Fsh.Devë–Demjan (drejtimi: Devë-Zhub-Kusar-Prush-Zylfaj-Lipovec-Gërqinë-Demjan) ;
4. **Zona Lugu i Carragojës** – që përfshin segmenti Meje-Ramoc-Nec-Rracaj-Sheremet-Bobrosh-Nivokazë;
5. **Zona e Dushkajës**- e cila përfshin teritoret e pyllëzuar në fshatrat Bec-Cërmjan, Gërgoc, Shqiponjë-Kralan;

[58] Agjensioni Pyjor i Kosovës – Njësia në Gjakovë

Harta 31. Zonat e rrezikuara nga zjarri dhe koha për intervenim në pikat më të skajshme



6.5.2. Kushtet klimatike dhe ndikimi në shkaktimin e zjarreve

Teritori i komunes ne kuptimin klimatik i nenshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane me c'rast krijohet nje jostabilitet ne reshjet e shiut dhe lageshtise se ajrit dhe tokes ne kete hapsire, qe gjate sezones se veres në periudhën qershor-shtator ndikohet me thatësia dhe temperature të larta të cilat vlerat më të mëdha mesatare mujore arrijnë në korrik +22.2,0°C dhe gusht me 21,7°C, me tempretarura maximale ditore deri në 40°C.[59]



[59] IHK- Temperaturat e ajrit – Stacioni automatik Gjakovë

Si pasoj e thatesise ekstreme ne kete sezone per pasoj kemi ndezjen e teritoreve te pyllëzuara, sipërfaqe fushore,shkurreve dhe dushkajave me c'rast medeomos gelltiteten teritore te medha me mase pyjore për një kohë të shkurtë. Asnjë dëmtues pylli nuk mund t'i sjellë dëme më të konsidrueshëme pyllit në krahasim me zjarrin. Këtu nuk duhet perjashtuar zjarrin e shkaktuar nga faktori njeri qofte nga pakujdesia apo me qellim.

4.26 St. automatik Gjakovë - Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit (°C): 2022
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 23' 24.01"
Lartësia mbidetare e st.: 410 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 25' 32.02"

Dita	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1	2.0	1.7	1.4	11.5	12.9	21.9	26.5	22.4	21.5	15.9	12.2	5.1
2	5.7	2.1	2.6	8.8	11.3	23.2	25.1	23.2	18.0	16.6	11.7	5.4
3	7.1	2.3	2.5	5.1	10.6	23.4	26.4	23.5	18.7	13.2	11.3	5.9
4	7.9	0.3	3.9	5.1	12.8	22.0	27.5	24.5	19.3	11.0	11.2	5.7
5	13.1	3.3	2.6	7.6	14.8	23.9	24.4	24.6	19.6	11.0	13.1	5.8
6	9.8	6.8	1.4	11.4	14.4	21.3	22.5	25.2	19.4	11.1	12.0	6.0
7	1.2	5.8	1.4	12.1	16.5	20.9	21.9	25.6	20.6	13.6	11.7	6.5
8	1.5	1.7	0.2	14.1	15.6	20.0	18.2	26.4	-	12.7	9.5	7.4
9	2.2	3.4	0.2	15.0	16.1	17.1	16.7	25.7	-	13.3	5.5	11.2
10	0.4	3.8	-0.7	6.3	16.6	18.0	19.4	21.4	22.1	13.8	6.7	12.9
11	1.1	5.1	-1.1	7.7	16.7	20.3	18.6	22.0	17.7	13.9	9.5	9.5
12	-1.0	4.8	-1.9	9.2	18.8	20.3	18.5	21.3	16.4	15.1	8.6	4.3
13	-4.8	3.7	0.6	12.5	19.9	21.6	19.7	20.0	15.8	14.6	10.2	1.0
14	-4.3	4.2	3.4	14.0	19.1	21.1	21.4	19.8	18.4	12.7	9.2	1.1
15	-0.3	6.9	5.5	14.6	19.0	20.0	23.7	22.0	22.7	11.7	9.5	5.0
16	-0.3	5.8	9.4	14.4	19.7	20.5	24.0	21.5	19.6	11.3	10.3	10.7
17	0.1	7.1	6.5	7.3	20.8	18.6	24.5	23.7	18.8	12.5	13.5	12.6
18	2.8	7.2	5.1	6.2	15.8	20.2	22.4	25.4	13.4	9.7	11.2	4.8
19	-1.4	10.3	3.3	8.0	14.8	20.9	22.3	27.4	12.9	10.0	13.3	1.1
20	1.6	10.5	3.1	4.9	16.3	22.1	23.5	22.5	13.1	11.5	11.2	-1.2
21	-0.6	9.1	4.1	6.4	19.2	25.1	23.9	20.3	11.4	8.8	6.7	-0.7
22	-3.8	6.0	7.8	12.5	18.1	23.2	25.9	21.6	11.4	11.5	4.5	-0.9
23	-3.0	6.0	9.9	14.6	16.0	23.6	27.4	20.5	10.5	14.0	8.8	0.0
24	-3.7	5.4	9.8	16.1	22.5	23.4	26.2	22.0	12.0	14.5	7.5	2.1
25	-6.6	4.3	9.9	16.3	24.7	24.9	24.9	22.3	14.0	14.8	6.0	4.1
26	-2.0	4.7	9.1	15.3	24.4	23.8	26.5	22.4	15.0	14.5	4.6	2.1
27	0.4	3.1	10.6	15.9	21.8	25.2	25.9	22.2	16.5	13.4	4.6	9.1
28	1.1	2.3	11.1	14.3	21.5	25.8	24.4	22.8	16.0	13.1	4.3	6.5
29	0.8		12.8	12.8	14.9	25.3	24.9	21.0	16.3	12.0	4.3	5.2
30	-0.5		11.4	14.5	18.9	25.5	25.6	20.3	18.2	12.1	4.6	6.5
31	1.9		12.0		21.1		22.9	20.9		13.0		7.7
Mes	0.9	4.9	5.1	11.1	17.6	22.1	23.4	22.7	16.8	12.8	8.9	5.2
Min	-6.6	0.3	-1.9	4.9	10.6	17.1	16.7	19.8	10.5	8.8	4.3	-1.2
Dita	25	4	12	20	3	9	9	14	23	21	28	20
Max	13.1	10.5	12.8	16.3	24.7	25.8	27.5	27.4	22.7	16.6	13.5	12.9
Dita	5	20	29	25	25	28	4	19	15	2	17	10
Std	4.3	2.6	4.4	3.8	3.6	2.3	2.9	2.0	3.4	1.8	3.0	3.9

Zjarre pyjore me permasa me te mëdha ne kemi pasur ne zonen e Qerretit dhe te Dushkajes e Hasit gjate sezones verore 2007 me ç'rast jane djegur 659 ha., ku demet ne pyje kan arrijtë vlerën 182,352.00 € masë drunore ne këmbë e cila masë nëse shëndërrohet për qëllime komerciale trefishohet. Ndërsa gjatë viteve vijuese ka pasë zjarre pyjore pothuaj se gjatë çdo sezone verorre, por ato kanë qenë dukshëm me përmasa më të vogla, në kohëzgjatje 1 ose 2 ditore dhe hapësirë më të kufizuar duke bërë që ato të jenë nën kontrol dhe të menaxhueshme me kapacitete reaguese vetanake. Nder shkaqet me te shpeshta te zjarreve malore, pervecç temperaturave te larta ka ndikuar papergjegjesia e faktorit me shkaktimi e zjarreve nga pakujdesia apo me qellim.

6.5.3. Zjarret pyjore-fushore, urbane dhe zjarret teknike-teknologjike

Karakteristikat e përgjithshme të zjarreve pyjore dhe fushore

- Zjarret pyjore dhe fushore janë fatkeqësi që shkaktojnë dëme të mëdha të sipërfaqeve të tëra drusore të llojeve dhe vlerave të ndryshme, shkakton dëme në faunë si dhe dëme ekologjike/mjedisore e që mvarësisht nga përmasat dhe pasojat, përcaktohet edhe niveli/shkalla e rrezikshmërisë;

- Zjarret e shkaktuara në sipërfaqe të mëdha në pyjeve ose shkurre ku përfshihen edhe zona të banuara (vendbanime), mund të shkaktojnë cenueshmëri /rrezikshmëri të lartë për njerëzit brenda zonës, pasurisë së tyre, për pyjet dhe mjedisin brenda zonës së caktuar;

- Zonat më të atakuara nga zjarret fushore dhe malore janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, si dhe fshatrat e zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave;

- Shkaktarët e paraqitjes së këtyre kryesore të zjarreve kryesisht vijnë nga njerëzit(duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të pa-kontrolluara, zjarret aksidentale dhe zjarrvëniet e qëllimshme, etj.)

Pasojat/dëmet:[60]

- Humbje e materialit drusor dhe kullosor,
- Humbje e prodhimeve tjera pyjore,
- Dëmtim të fondit të gjuetisë,
- Dëmtim dhe shqetësim i faunës së egër (Zona Majës së Lartë-Qerreti dhe Pashtriku),
- Dëmtim të pejsazhit natyror dhe përkeqësim të klimës lokale,
- Ndikim në rritjen e fenomenit të erozionit

Rreziqet anësore të zjarreve pyjore në infrastrukturë dhe objekte ekonomike

- Linja 400 kV në drejtim të Shqipërisë- në fsh. Ponoshec (në afërsi te ish fermës së shpezëve)
- Linja 220 kV drejtimi Prizren-Firzë
- Rrjeti i shpërndarjes në vendbanimet e thella rurale
- Stacioni i filtrave i HS Radoniqi
- Transmetuesit dhe repetitorët (Suka e Cërmjanit, Kralan, Planej-Ponoshec, etj.)
- Qumshtorja “Golaj” – Sheremet
- Objekte të gastronomisë (Regjioni i Rekës së Keqe dhe i Hasit)

[60] Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit 2024, Mbrojtja e Pyjeve dhe Parqeve Kombëtare p.6

6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia dhe kohëzgjatja e paraqitjes së zjarreve

Fletë pune e profilit të rrezikut për zjarre Pyjore dhe fushore (2019-2024)	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **Katastrofike**: ☐ më shumë se 50% **Kritike**: ☐ 25 deri 50% **E kufizuar**: ☒ **10 deri 25%** **E papërfillshme**: ☐ më pak se 10%	
Frekuenca e ndodhjes: **Shumë e mundshme: mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm;** **E mundshme**: mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm; ose së paku një rast në 10 vitet e ardhshme; **Ka gjasa**: mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një rast në 100 vitet e ardhshme; **I pa mundshëm**: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.	**Modeli Sezonal:** ☐ **Pranverë;** ☒ **Verë;** ☐ Vjeshtë ; ☐ Dimër;
Zonat e goditura: Zona e Majës së Lartë, Qerreti, Lugu Carrogojës, zona Hasit dhe zona Dushkajës	
Kohëzgjatja: Zona e Koshares dhe Qerretit 1-10 ditë, Zona e Hasit 1-3 ditë, Lugu i Carragojës 1-3 ditë dhe Zona e Dushkajës 1-3	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):	
Paralajmërim minimal (apo fare); - Paralajmrim 12 deri 24 orë; Paralajmërim 6 deri 12 orë; - Paralajmërim më shumë se 24 orë;	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: - Rojet e pyjeve dhe stafi profesional teknik i Pylltarisë - Qytetarët - QOE Rajonale 112/Gjakovë, Nacionale AME /112, etj;	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? ☐ **Po** SWOT Analiza e përparësive dhe dobësive, mundësive dhe rreziqeve ☐ **Jo;**	

RREZIKU I PËRGJITHSHËM



Prioriteti i reagimit

5	Prioritet shum i lartë– (rrezik nr. 15 – 25)
4	Prioritet i lartë – (rrezik nr. 10 – 12)
3	Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9)
2	Prioritet i ngritur – (rrezik nr. 2 – 4)
1	Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)

6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga zjarri

Zjarret më intensive në territorin e komunës së Gjakovë janë shfaqur në korrik/gusht të vitit 2007 në zonën e Qerretit rreth brezit kufitarë me Shqipërinë, në gjatësi 9-11 km të përsëritshme 3 periudha, secila në kohëzgjatje 10-12 ditë. Dëmet në sipërfaqet pyjore,, masën drunore, florë dhe faun kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha.

Zjarre pyjore dhe fushore të përmasave të mëdha/alarmante në Komunën e Gjakovës ka pasur gjatë verës së vitit 2007, por në përmasa shqetësuese ka pasur edhe në 10 vitet e fundit, të cilat kanë përfshirë lokacionet në pyje dhe fushore:

Tabela 68. Tabela i intervenimeve të zjarrfikësve në 10 vitet e fundit

Viti:	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i interven. të ERE	367	234	457	344	199	379	572	384	495	522

Grafikoni 19. Trendi i zjarreve në 10 vitet e fundit



Tabela 65 Struktura e zjarreve në Komunën e Gjakovës (2020-2024) [61]

REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Punëve të Brendshme
Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave / Komuna e __ Gjakove
Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit
Stacioni i Zjarrfikëjes Rr._Skenderbeu tel kujdestar **193**
Tel.zyrtar:_____ Email: kaquni@hotmail.com, tel 048-998-900, 044-998-9(

PASQYTRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE: 2020-2024

VITI	Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarrë në Autom.	Gjith.
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjea	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Paisjet shpërndarse	Gjeneratora	Të tjea	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqsore	Të tjera	Automjete motorrike	
2020	19	1	4	0	18	3	99	5		7	3	9			100	42	2		7	319
2021	36	3	7	1	21	11	86	15		6	28	30			133	173			22	572
2022	16	6	5		18	7	75	8		2	32	15		1	92	88	2	2	15	384
2023	18	3	2	1	13	6	60	9	1	3	18	17	1	5	62	245	3	7	2	476
2024	23	5	5		9	10	53	11		2	18	24		1	94	242	5	7	13	522
Gjithsejt	112	18	23	2	79	37	373	48	1	20	99	95	1	7	481	790	12	16	59	2273

<u>Masat parandaluese të zjarreve pyjore dhe fushore</u>

Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale bazuar në Planin emergjent formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve. Në këtë kontekst masat që duhet ndërmarrë janë:

- Inspektimi për parandalim të zjarr vënieve të qëllimshme në zonat pyjore dhe tokat bujqësore;
- Respektimi i kushteve të ndërtimit të përcaktuara me kornizën ligjore për mbrojtje nga zjarri;
- Sigurimi i elaborateve për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për të gjitha projektet e ndërtimit për të gjitha kategoritë konform ligjeve përkatëse;
- Planifikimi i tampon zonave pyjore dhe sipërfaqeve tjera të cilat janë të ndjeshme nga zjarri si dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar kalimin e zjarrit nga njëra anë në tjetrën;
- Hapja e shtigjeve dhe sigurimi i çasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri në zonat më të thella malore;

6.5.6. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

- ✓ Komuna është përgjegjëse për marrjen dhe avansimin e masave për mbrojtje nga zjarri në territorin e saj, si dhe për zbatimin e diapozitivit ligjor që rregullojnë fushën e mbrojtjes nga zjarri në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.
- ✓ Në kuadër të planifikimit hapësinor, me qëllim të zbatimit të masave të mbrojtjes nga zjarri, kërkohen kushte të veçanta ndërtimi, sidomos me rastin e ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv, objekteve publike, tregtare,

[61] Raporti i Njësisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Gjakovë/2025

hoteleve, kinemave, teatrove, bibliotekave, postelekomit, spitaleve, pallateve koncerteve e sportive si dhe objekteve tjera publike, Evakuim të njerëzve në rast të shpërthimit të zjarrit me ndërtimin e shkallëve për evakuim (daljet emergjente),

- ✓ Pajisje përkatëse për alarm dhe fikje të zjarrit (hidrantët, aparatura kundër zjarrit, rrufepritësit etj.)
- ✓ Qasje të pa penguar të njësive reaguese për mbrojtje zjarri.

Masat që duhet ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes nga zjarri në sektorin e ndërtimit:

- Analiza profesionale dhe vlerësimi profesional i ekspertëve përkatës të fushës për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri është pjesë përbërëse e Planeve Komunale Zhvillimore(PZHK) si dhe planeve Urbanistike. Në këto plane është e paparë zbatimi i dispozitave ligjore si: Ligji i Ndërtimit, Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, akteve nënligjore përkatëse, normave teknike, si dhe standardeve(kodeve) ndërkombëtare të pranuara.
- Në kuadër të projekteve të ndërtimit (objekteve specifike) dhe atyre që zhvillojnë(deponojnë) aktivitet me materie të rrezikshme apo paraqesin rrezikshmëri të lartë, pjesë e projektit duhet të jetë edhe elaborati për mbrojtje nga zjarri.

Pjesa urbane e qytetit tonë, kohëve të fundit ka një zgjerim dhe ndërtim të hovshëm, sidomos me objekte shumë-kate për banim, me objekte private-publike dhe parqe industriale , ku një pjesë dërmuese e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin kënaqshëm kërkesat dhe nevojat për mbrojtje nga zjarri, siç janë:

- Mungesa e qasjes së NJPZSh-ve me automjete të zjarrfikjes në objekte banimi;
- Mungesa e sistemit të lajmërimit dhe alarmit;
- Mungesa e rrugëve (hapësirave) për grumbullim dhe evakuim;
- Atestimi i qëndrueshmërisë së konstruksionit të objekteve ndaj zjarrit;
- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë dhe në ndërtesë,
- Mungesa e daljeve emergjente,
- Mungesa e hidrantëve në objektet e lartcekura (hidrant jo-funksionale); etj.

Masat parandaluese:

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë për zjarret :

- ✓ Komunikimi me publikun, vetëdijesimi publik;
- ✓ Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve;
- ✓ Hapja e rrugëve malore për intervenim;
- ✓ Zbatimi i masave ndëshkimore për zjarrvënësit;
- ✓ Masat parandaluese për zjarret industriale;
- ✓ Ngritjen e Njësisë Profesionale të Zjarrfikësve në Industri dhe subjekte që operojnë me materie agresive;
- ✓ Pajisja me hidrant në të gjitha hapësirat e nevojshme;
- ✓ Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimi automatik;
- ✓ Atestimi i këtyre sistemeve;
- ✓ Sistemet pneumatike ;
- ✓ Jetësimi i një sistemi vrojtues dhe sinjalizues.

Rekomandimet:

- Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente lokale (PREL);
- Hartimi e procedurave standarde operative (PSO) për reagim emergjent;
- Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për koordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
- Identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioriteteve për menaxhimin e zjarreve ;
- Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
- Ngritja e kapaciteteve (resurseve) teknike dhe standardizimi i tyre;
- Të ngritet infrastruktura rrugore (me qëllim të reagimit më të lehtë me mjete motorrike) në pyje dhe të sigurohen burimet ujore, sa më afër vatrave potenciale të zjarreve për furnizim;
- Të bëhet sanimi dhe gjenerimi i sipërfaqeve pyjore, pas zjarreve të shkaktuara;
- Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret(sipërfaqet e djegura, masa drusore, bimët aromatike, bimët mjekuese dhe dëmet ekologjike) në vlerë valutore Euro;
- Arritja e memorandumeve të mirëkuptimit me qëllim të ofrimit të ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit me
- komunat fqinje, sektorin privat dhe OJQ humanitare, në rast se paraqitet nevoja;

Trafiku 20. Faktori Lang-ut, balansi reshje - temperatur në periudhën kritike të zjarreve[62]



[62] AME/MPB Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera/2016, f.33

6.6. TËRMETET

6.6.1. Karaketristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik

Tërmeti pasqyron përplasjen/luhatjen e pllakave të tokës si pasojë e lirimit të energjisë së brendshme të tokës. Teritori i Kosovës, rrjedhimisht edhe teritori i Komunës së Gjakovës me shtrierje në pjesën qendrore të rrafshit të Dukagjinit, në aspektin sizmotektonik përfaqëson një teren mjaftë aktiv, në të cilën mund të priten tërmete katastrofike me karakter autokton.

Nga tri zona sizmogjene në Kosovë, komuna e Gjakovës bie në zonën:

Prizren – Pejë X magnitud maximale M = 6.6 shkallë Rihter[63]



Harta 32. A/B Harta sizmike-magnituda maximale

Të dhënat për tërmetet nga e kaluara, dëshmojnë qartë se dukuria e tërmeteve katastrofike në disa pjesë të territorit të Kosovës ka qenë evidente shumë herët, kështu ndër tërmetet historike përmendim atë të vitit 1456, i cili goditi Prizrenin me intensitet IX ballë MSK-64, pastaj në vitin 1662, rrethi i Pejës është goditur nga një tërmet me intensitet VIII ballë MSK-64.[64]

Në periudhën më të re, rrespektivisht 1978, 1985, 2002 në Gjilan, dhe i fundit në nëntor/2019 ka pasur tërmete, të cilat kanë pasur origjinë autoktone sizmologjike nga Kopaoniku dhe Adriatiku, dridhjet e te cilit kanë qenë evidente edhe në komunën e Gjakovës, me 0 viktima në njerëz dhe pa dëme të theksuara,…. përveç plasaritjeve të disa shtëpive (7) në zonën e Dushkajës.

Nga pikëpamja sizmologjike territori i Komunes së Gjakovës paraqet aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe ka gjasa të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete të forta. Karakteristikë e veçant e një mori tërmetesh që kanë ndodhë në komunën tone, është se ato përgjithësisht kanë pasur karakter autokton, me janë vatra të cekëta, të cilat gjenerohen në afërsi të kores së tokës, ku maksimumi i thellësisë së vatrave mund të jetë 15 - 20 km nën

[63] AME/MPB- Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyore dhe Fatkeqësitë Tjera në Kosovë, 2016

[64] Dr. Izet Shehu - " Menaxhimi i Programeve Preventive në Emergjenca "-, Kolegji Biznesi 2011 ,Prishtinë 2011 f. 64,65,67

nëntokë. Studimet e sizmicitetit varen shumë nga informacioni që disponohet nga plotësia dhe besueshmëria e të dhënave mbi tërmetet që paraqiten në katalogun e tërmeteve. Ngjarjet sizmike tregojnë se brenda 20 viteve të fundit vendi ynë është goditur me tri tërmete me magnitude mesatare, me madhësi 4.8 -5.7 , me viktima njerëzore dhe dëme materiale.

6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Tërmetet janë dridhje të shkurta të tokës, të pa parashikuara dhe pa mundësi paralajmërimi, ndaj, mund të konkludohet se i tërë teritori i komunës së Gjakovës mund të jetë i rrezikuar nga tërmeti, por që ashpërsia e pasojave eventuale do të jetë më e madhe në:

- Zonat me densitet të lartë të popullatës dhe ndërtime të larta (pjesa urbane: qytet-jasht qytet);
- Zonat të caktuara me ndërtime të dobëta në aspektin e kualitetit të materialit ndërtimor (kryesisht objektet e banimit në pjesën e vjetër të qytetit me shtrierje nga lumi Krena në drejtim të Kodrës së Çabratit);
- Zonat me densitet mesatarë të popullatësi dhe të ulët kryesisht me objekte e vjetra banimi në zonat e ulëta dhe të thella rurale me efekt të ulët ose të mesëm të goditjes, si dhe
- Zonat e pa studjuara në aspektin fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë së tokës .

Harta 33. Dendësia, ndërtimet dhe rreziku nga tërmeti



Grafiku 21. Trendi i indërtimeve të larta



6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara

<u>Flukset e rreziqeve nga tërmetet:</u>

- Shembja e objekteve banesore dhe atyre publike,
- Dëmet në infrastruktur dhe transport,
- Ç'rregullimet në ambient (rrjedhat e ujit, rrëshqitjet të terenit
- Efektet sekondare (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e produkteve toksike etj.)

Faktorët e përkeqësimit:

- Reshjet atmosferike, erërat dhe ndryshimi i temperaturave janë faktor përkeqësues, si në mundësinë e dridhjeve të mëvonshme, po ashtu edhe në përkeqësimin dhe krijimin e kushteve të vështirësuara për reagim dhe përkujdesje për banorët e goditur;
- Ndërtimi pa kritere dhe cilësia jo adekuate e strukturave ndërtimore në komunë i bënë të ndjeshme vendbanimet e saj.

Profili i rrezikut nga tërmeti	
Rreziku: Tërmetet.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Kritike.	
Frekuenca e ndodhjes: Ka gjasa.	**Modeli: jo sezonal** Gjasat e përsëritjes së tërmeteve me magnit MW=5.0, 5.5, 6.0 dhe 6.5 janë përkatësisht 14.2, 69.8 dhe 502.4 vite; një tërmet me MW përsëritet mesatarisht çdo 2446 vite. Nga pikëpamja e propabilitetit, çdo vit në Kosovë m të pritet një tërmet me magnitudë deri në 5.0 probabilitet 27.8%; çdo 50 vite pritet një tërmet MW=6.0 me probabilitet 51.2%; çdo shekull, probabilitet 76.2% pritet një tërmet me magnitudë
Zonat që mund të goditen më së shumti: - Zona sizmogjene Prizren-Pejë,	
Kohëzgjatja e mundshme: E çastit (2-10 Sek.).	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): **Pa paralajmërim.**	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Nuk ka.	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? ☐ Po ☐ **Jo**	

Sa i përket vlerësimit të gjasave të ndodhjes së tërmetit, në bazë të statistiakve dhe rrethanat nga e kaluara, ky lloj rreziku natyror, kualifikohet si fenomen me gjasa për të ndodhur, por në rast se një gjë i till ndodhë në kuotën 6.6 ° Rihter+, pasojat do të jenë të paparshikueshme në të gjitha aspektet, dhe do të cilësohet me efekt kritik. Meqenëse pasojat për jetën, pronën dhe ambientin janë të pa parashikuara, ky rrezik automatikisht tejkalon kompetencat e komunës dhe do të trajtohet si mega rrezik që gjithsesi kërkon asistencën nivelit Qendror, në raste të caktuara edhe të Bashkësisë Ndërkombëtare.

6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit

Si rezultat i burimeve nga shërbimet sizmologjike në vend dhe rajon, sidomos nga Instituti Sizmologjik i Kosovës, egzistojnë të dhëna më të plota për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës që nga periudha kohore, nga vitet 1900 kurse të dhënat/informacionet e mëhershme janë mjaft të pakta. Këto tërmete që kanë prekur teritorin e kosovës, ku më shumë e ku më pak kanë goditur edhe komunën tonë.. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur vendin tonë , në 20 vitet e fundit mund të përmendim[65]:





Harta 34/a. Kategorizimi rrezikut të zonave nga tërmeti *Harta 34/b Shpeshtësia e ndodhjes së tërmeteve sipas intensitetit*

1. Tërmeti i Gjilanit 24.04.2002, **Mag.5.7, intensiteti VIII**
2. Tërmeti i Istogut 10.03.2010, **Mag.5.2, intensiteti VII**
3. Tërmeti i Vushtrrisë 18.11.2013, **Mag.4.8, intensiteti VI$_{1\backslash 2}$**

Tabela 69. Disa nga tërmetet më të forta që kanë goditur teritorin e Kosovës ndër vite

Location of earth.	Magnitude	Intensity
Prizreni 1456	MS=6.1	VIII1/2
Peja 1662	MW=6.0	VIII1/2
Ferizaj-Viti 1921	M l=6.1	IX

[65] AME/MPB-USAID – Dokument Udhëzues për Vlerësimin i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Prishtinë 2024

Viti.1921	Ml = 5.4;	VIII
Gjilan 1921	Ml = 5.0;	VIII
Kaçanik-Viti 1921	Ml = 5.6	VIII
Gjakova 1922	Ml = 5.3	VII1/2
Prizren 1945	Ml = 5.0	VII
Klina 1947	Ml = 5.2	VIII
Kopaonik 1980	MW=5.7	VIII
Gjilani 2002	MW=5.7	VII-VIII
Istog 2010	Ml = 5.2	VII
Vushtrri 2013	Ml=4.8	VI

6.6.5. Pasojat e tërmeteve

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Dhjetëra vdekje, qindra lëndime të rënda dhe trauma.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim / dëmtim i pasurisë publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit: rrugor, të ujësjellësit dhe kanalizimit, energjetik, telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisi së veçant	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë publike dhe private .	E ashpër
Ambienti	Dëmtim / degradim i mjedisit për shkak të derdhjeve të ndryshme, gazrave dhe tymit, kontaminim i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës pjellore, ushqimit dhe kafshëve.	E ashpër
Trashëgimia kulturore		E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

Të vetmin Raport të cilin Komuna e Gjakovës e ka hartuar është ai i nëntorit/2019 lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në objektet e banimit në regjionin e Dushkajës, tërmet me epiqendër në detin Adriatik në afërsi të Durrësit.

Raport mbi dëmet nga tërmeti

Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve nga tërmeti e ka bërë shikimin vizual të objekteve në fjalë dhe ka dhënë vlerësimet bazuar në gjendjen ekzistuese të hasur në vend por nuk ka ekzaminuar asnjë element strukturor të këtyre objekteve.
Gjithashtu për rastet e më sipërme janë bërë edhe fotografi të cilat në një mënyrë pasqyrojnë gjendjen reale të konstatuar në vend. Të njëjtat janë pjesë përbërëse të këtij Raporti

Pasqyra e vlerësimit të dëmeve

Nr	Pronari	Vendbanimi	Kosto e dëmeve (€)
1	Besnik Halilaj	Bec	50.000,00
2	Katrina Syla	Zhdrellë	1.500,00
3	Egzon Emëllahu	Bec	7.000,00
4	Naser Kalimashi	Kodrali	3.000,00
5	Luigj Hajdaraj	Bardhaniq	6.000,00
6	Agim Tafa	Vraniq	3.000,00
7	Abdullah Rudi	Gjakovë	30.000,00
		Totali	**100.500,00 €**

Gjakovë,
15.01.2020

1. Elvane Qarkaxhija
2. Lulzim Haxhiu
3. Riza Morina
4. Lekë Stublla

Raporti iu dorëzohet:
- Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit

6.6.6. Ndikimet sizmike dhe planifikimi urbanistik

Në ditët tona, kur ka shumë ndërtime, zona me rrezik të lartë mund të rezultojnë në shumë lokacione, që karakterizohen nga troje të dobëta, të paqëndrueshme (të shkrifëta, lymra, torfa, troje të ngopura me ujë, troje në terrene të rrëshqitshëm dhe me pjerrësi të madhe, etj.), të cilat e rrisin ndjeshëm efektin seizmik edhe kur ndodhin tërmete të "vegjël" në madhësi.

Zhvillimi që ka marrë hovë, sidomos aktiviteti ndërtimor në komunën e Gjakovës shtron për detyrë që analizat seizmike të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare me qëllim që të mos të ndodhin efekte negative e në mënyrë të drejtpërdrejtë të mos kemi dëmtim dhe shkatërrim të strukturave ku ne banojmë, punojmë e ushtrojmë pjesën më të madhe të aktivitetit tonë jetësor. Në shumicën e rasteve nuk janë rrespektuar firmat e autoriteteve seizimike të Kosovës, por nuk përjashtohet rasti që edhe Komuna të mos respektojnë rregullat dhe kërkesat e Ligjit aktual të urbanistikës në fuqi në lidhje me studimet inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologo-inxhinierike, që janë të detyruara për godinat e banimit me më shumë se 5 kate[66]**.** Në kontekst të kësaj, specijalistët ngrenë alarmin për mungesën e studimeve gjeologjike për ndërtimet, sepse në gjeologji nuk ka thënie: " Këtu mund të ndërtohet, e këtu, jo....., por mënyra e ndërtimit dallon dhe kostoja ndryshon"[67].
Për fat keq Komuna e Gjakovës, sikur edhe komunat tjera në Kosovë, nuk posedonë me harta të mikrozonimit sizmik, dhe është detyrë urgjente që ato harta sizmike të përpilohen dhe konformë kësaj të hartohen kushte të reja teknike që ofrojnë qëndrueshmëri optimale në rast të tërmeteve.

6.6.7. Masat parandaluese:

Ndërmarrja e masave parandaluese me qëllim të zvogëlimit/zbutjes së rrezikut sizmik janë e vetmja mënyrë efektive për t'u mbrojtur nga tërmetet:

- Rregullat për ndërtime seizmike;
- Ligje dhe rregullore bashkëkohore për ndërtimet sipas Eurokode 8;
- Mbikqyrjen strikte të zbatimit të rregulloreve;
- Kontrollet periodike të hartave sizmike;
- Implementimi I studimit të mikro-zonimit sizmik për secilin qytet (Zona urbane);

Për të rritur sigurinë sizmike, mund të ndërmerren disa masa specifike dhe aspekte të rendësishme:

<u>Konstruksioni i ndërtesave</u>:

- Përdorimi i materiale dhe teknikave të ndërtimit që përmirësojnë qëndrueshmërinë;
- Zbatimi i kodeve të ndërtimit që parashikojnë masat sizmike;

<u>Forcimi i strukturave ekzistuese</u>:

- Rishikimi dhe statika e ndërtesave të vjetra që nuk përmbushin standardet sizmike;

[66] " Ligji për Ndërtimin " Nr. 2004/15,- Kuvendi i Kosovës, Maj/2004
[67] Entela Resuli "Analizë sociale mbi kriteret e ndërtimeve" – Gaz. Shekulli , 08/nëntor, 2011

- Përdorimi i teknologjive moderne si shtesa në bazamentet e ndërtesave;

Edukimi dhe trajnimi:

- Organizimi dhe trajnimi për inxhinierët dhe dhe arqitektët mbi dizajnimin sizmik ;
- Informimi i publikut për masat e mbrojtjes poersonale dhe kolektive gjatë një tërmeti;

Planifikimi i emergjencave:

- Hartimi i planeve të emergjencës për tu përballur me situatat sizmike;
- Mbajtja e trajnimeve dhe ushtrimeve për testimin e këtyre planeve

Infrastruktura publike:

- Sigurimi që urat, rrugët dhe sistemet e transportit të jenë të qëndrueshme ndaj tërmeteve;
- Modernizimi i objekteve publike dhe shërcimeve kritike (vitale).

Monitorimi dhe hulumtimi

- Mbështetje dhe kërikime në kuptimin e përcaktimit të mënyrave për përmirësimin e qëndrueshmërisë sizmike;
- Implementimi i të gjitha masave të shënuara më lartë kërkon bashkëpunim mes komunës së Gjakovës dhe qeverisë dhe agjensioneve përkatëse, të profesionistëve të fushave përkatëse dhe komunitetit lokal për të siguruar ambient të sigurte ndaj rreziqeve sizmike.

Konkludim

Në tërë teritorin e Republikës së Kosovës ekziston rreziku i tërmeteve, ndaj edhe komuna e Gjakovës nuk përjashtohet nga një rrezik i tillë, për faktin se gjendet në mes të zonës sizmogjene Pejë-Prizren me një dendësi relativisht të madhe të populatës në rrafshin e Dukagjinit. Teritori i komunës së Gjakovës mund të ket pasoja kritike si: vdekje dhe lëndime, shkatërrime të mëdha të ndërtimeve dhe infratsrukturës, ndërprepreje të funksioneve vitale për jetë, ndërprerje komunikacioni, bllokim rrugësh etj. Gjithashtu, numri I të rrezikuarëve si pasoj e rreziqeve sekundare, si: eksplodimet, zjarret, vërshimet dhe epidemitë.

Vlerësimi i rrezikut sizmik në Kosovë, krijon bazat për një politikë moderne në zbutjen e pasojave nga tërmetet, ndërsa rezultatet e fituara mund të përdoren nga autoritetet kombëtare dhe lokale, si dhe nga organizatat dhe individët që interesohen për planifikimin dhe administrimin e territorit, projektimin e strukturave rezistence ndaj tërmeteve, etj, duke mundësuar integrimin e shkallës së sotme të njohjes dhe reagimin ndaj nevojave në ndryshim të komunitetit të përdoruesëve.

Rekomandime

Me qëllim të përmirësimit të rezultateve mbi rrezikun sizmik rekomandojmë:

- Rivlerësimin e magnitudës së tërmeteve historike që kanë goditur territorin e Kosovës;
- Një vlerësim më të bazuar të parametrave të sizmicitetit, duke përmirësuar bazën e të dhënave të tërmeteve që kanë goditur Kosovën dhe rajonet fqinje;
- Një model sizmotektonik rajonal, që lidh sizmicitetin e vrojtuar me thyerjet tektonike aktive, mekanizmin e tyre të prishjes, etj.;

- Modele më të sakta për prognozimin e parametrave të lëkundjes së truallit, të bazuar në regjistrimet rajonale të lëkundjeve të forta, në Kosovë dhe në rajonet fqinje;
- Hartimi i një programi studimor disa-vjeçar për rishikim dhe saktësim të mëtejshëm të hipoqendrave të tërmeteve të Kosovës

6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET

6.7.1. Karakteristikat e terenit dhe zonat potenciale të rrëshqitjes dhe erozionit

Rajoni i Dukagjinit karakterizohet me një llojllojshmëri shumë të theksuar litostratigrafike dhe ka një përbërje të ndërlikuar tektonike të terrenit. Këtu janë të shprehura proceset e theksuara bashkëvepruese gjeologjike, të sjelljes së materialeve nga shpatina me formimin e sipërfaqeve të shpëlarjes së shpejtuar dhe të gërryerjeve, rrëkeve dhe me dukuri të shumta të rrëshqitjeve dhe të shembjeve të dheut, të bartjes së materialeve sterile.

Rrëshqitja e tokës në Komunën e Gjakovës si në shumë komuna tjera në Kosovë është shkaktuar nga aktiviteti njerëzor si: gërmimi i shpatit dhe ngarkimit (psh. ndërtimi i rrugëve dhe ndërtesave, gërmimet minerare dhe guroret), ndryshimet në përdorimin e tokës (p.sh. shpyllëzimi),tharja e shpejtë e rezervuarëve, kullimi etj, ose nga çdo kombinim i proceseve natyrale ose njerëzore[68].
Rrëshqitjet janë të shprehura në sezonin pranveror-mars dhe prill, sezonin vjeshtor -tetor, nëntor dhe dhjetor si dhe sezonin dimëror -janar dhe shkurt.

Foto: Rrëshqitje të tokës dhe erozion

[68] Mejdisi dhe Sipërfaqet me Rrezikshmëri, PZHK kap.2.7 dhe 3.6

6.7.2. Intensiteti dhe shpeshtësia e paraqitjes

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili i rrezikut	
Rreziku: Rrëshqitjet.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): E ulët	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme.	**Modeli sezonal: Pranveror** –Mars dhe Prill. **Vjeshtor** – Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. **Dimëror** – Janar dhe Shkurt.
Zonat që mund të goditen më së shumti: Zona përendimore përrethë brezit kufitarSegmenti Botush-Demjan, Zona lindore Jabllanicë-Rakovinë-Rogovë (rrëshqitje dhe erozione)	
Kohëzgjatja e mundshme: Relativisht e shkurt 1-3 ditë; **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit):** Pa paralajmërim	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Numri Integruar 112.	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po X Jo ☐	

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ulët
Pasuria	Shkatërrime/ dëmtime të objekteve të banimit, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, etj.	E kufizuar
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrjetit elektrik dhe telekomunikimit, etj.	E mesme
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim / dëmtim i objekteve shkollore, QMF, objekteve qeveritare, etj.	E ulët
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese.	E ulët
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E mesme
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të kultit.	E ulët
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E ulët
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ulët

Për identifikimin e zonave dhe vlerësimin e rrezikshmërisë nga rrëshqitjet dhe erozioni, grupi punues ka marrë për bazë parametrat që ndikojnë në paraqitjen e këtyre fenomeneve, si:

- përbërjen gjeologjike dhe gjeomorfologjike të tokës, pjerrtësin e terenit, kushtet klimatolologjike-hidrologjike dhe bimësin;
- Faktorët e aktivizimit: sasia e ujit në shtratin e lumenjëve, përqindjen e ujit në masivin gjeologjik, heqja/dëmtimi i mbrojtëseve anësore (bimësisë dhe eksploatimi i rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjëve;
- Vlerësimi i rrëshqitjeve dhe erozionit: përbërja gjeologjike e truallit, tipologjia dhe shpejtësia e lëvizjes së materialit, këndi i pjerrtësisë, thellësia dhe vëllimi i masës së rrëshqitur, shkaktarët dhe faktorët e aktivizimit.

Rreziku i përgjithshëm





6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe erozioni [69]

<u>Rrëshqitjet</u>: Zona me ndjeshmëri më të madhe nga rrëshqitjet e tokës në territorin e komunës është pjesa jugore dhe veri përendimore e territorit të komunës Botush-Brovinë-Devë-Moglicë-Kusar-Pjetërshan-Lipovec-Gërqinë-Demjan, dhe pjesa veri-lindore Jabllanicë-Rakovinë-Meqë. Karakteristikë e përgjithshme e rrëshqitjeve është se ato ndodhin në territor të mjaftë të kufizuar, me intensitet relativisht të ulët dhe interval të shkurtë kohor në 1-3 ditë. Në bazë të evidencës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, përveç rrezikimit të disa shtëpive të banimit në këto zona, dhe bllokimit të përkohshëm të rrugëve lokale në viset rurale, funksionet tjera vitale të komunitetit nuk janë të rrezikuara.

[69] Raporte, analiza dhe materiale të arhivuara në DMSH

Erozioni: Si fenomen natyror kryesisht paraqitet në pjesën përgjatë rrjedhës së lumenjve Drini i Bardhë segmenti Kramovik-Rogovë duke degraduar toka bujqësore dhe rrezikim të infrastrukturës kritike më saktësisht të 2 urave në rrugën magjistrale, ura mbi lumin Drini Bardhë në Kramovik dhe ajo e Rogovës, si dhe ura np fsh. Shishman në lumin "Erenik". Poashtu, përgjatë lumit "Erenik" rrezikohen disa shtëpi në në afërsi te ura e Tabakut në Rrype, prapa Kishës së Shën Palit si dhe degradimi i tokave bujqësore segmenti Smolicë-Brovinë, dhe përgjatë lumit segmente në segmentin Kramoviku-Rogovë përgjatë lumit "Drini I Bradh". Shpyllëzimi, degradimi i shtretërve të lumenjëve dhe shtrirja urbane në disa lokacione kanë ndikuar në ngritjen graduale të shkalles së erozionit në territorin e komunës.

Harta 35. Zonat me ndjeshmëri ndaj erozionit



6.7.4. Përshkrimi i kushteve klimatike dhe struktura gjeologjike të tokës

Hapësirat territoriale në komunën e Gjakovës të cilat janë më të pasura me fitodiversitet janë ato në drejtim të Pashtrikut dhe pjesa e Bjeshkëve të Nemuna. Rëndësia e kësaj mbulese bimore të lartë përmendur qëndron në faktet se ato kanë rëndësi shkencore (si relikte, endemike, klimazonale), disa kanë vlera ekonomike (për kullosë, për ushqim, për mjekësi, për ndërtimtari), disa janë me rëndësi për ruajtjen e tokës (dheut) nga erozioni

Duke u mbështetur në ndërtimin litologjik, tektonik, morfologjik, klimatik, hidrologjik etj., mund të konkludohet se disa pjesë pjesë të territorit të komunës janë të përfshira nga një numër i proceseve ekzodinamike, kryesisht të përfaqësuara nga rrëshqitjet dhe shembjet të terrenit me intensitet të ulët.

Në kompleksin e dukurive shpatore një vend të rëndësishëm në modelimin e relievit të Kosovës luajnë edhe rrëshqitjet në përmasa të ndryshme, të cilat në disa raste kalojnë në shembje të fuqishme, veçanërisht gjatë rrëpirave tektonike. Rrëshqitjet gjatë kontakteve tektonike të shkëmbinjve magmatik me ata terrigjen janë mjaft të zhvilluara, pra gjatë brezit të shkatërrimit duke përfshirë kryesisht materialet copëzore koluvo-proluviale dhe ato deluviale të kores së tjetërsimit. Këto materiale të grumbulluara rrëzë rrëpirave të shkëputjeve dhe atyre komplekse gjatë evolucionit morfotektonik dhe morfoklimatik të tyre, karakterizohen nga një gjendje e paqëndrueshme, e nxitur edhe nga rrjedhjet ujore të shumta falë shkallës së papërshkueshmërisë së tyre.
Dukuritë e jo stabilitetit të terrenit, të cilat kryesisht paraqiten në format e rrëshqitjeve në shpatet e Bjeshkëve të Nemura dhe mallet e Sharrit.

6.7.5. Sipërfaqet e përfshira[70]

Tabela 70. Erozionet e tokës ndër vite

Fatkeqësitë natyrore ne komune dhe të Erozioni, 2020-2023								
	Sipërfaqja e afektuar (ha)				Trendët e rritjes/ zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2019- 2020	2021- 2022	2022- 2023	2023- 2024
Komuna Gjakovës	5	6	5	7	1	1	2	1

Tabela 71. Rrëshqitjet ndër vite

Fatkeqësitë natyrore ne komune dhe Kosove- Rrëshqitjet, 2020-2023								
	Sipërfaqja e afektuar (ha)				Trendët e rritjes/zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2019- 2020	2021- 2022	2022- 2023	2023- 2024
Komuna Gjakovës	8	8	9	9	1	1	2	1

6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet

Duke marë për bazë kushtet fiziko-gjeologjike, përbërjen litologjike të kores së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët e tjerë, të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe të erozionit të tokës, është vlerësuar se një dukuri e tillë nuk eshtë e theksuar në përmasa të mëdha në komunën e Gjakovës. Megjithatë, viteve të fundit, ka ndodhje të fenomeneve të tilla për shkak të ndërrimeve klimatike. Kategoria me erozion shum i fortë është me e theksuar sidomos në përendimore rrethe brezit kufitar gjithashtu në fshatin ku ka pasur rrëshqitje të dheut dhe janë të rrezikuara disa ekonomi familjare, komuna duhet të marr masa parandaluese.

Këtu janë disa prej pasojave kryesore të këtyre fenomeneve natyrore:

1. <u>Dëme ndaj jetës dhe pronës:</u>

Rrëshqitjet e dheut: Mund të shkaktojnë dëme të mëdha ndaj ndërtesave, rrugëve, infrastrukturës dhe jetës njerëzore. Shtëpitë që janë të vendosura në zona të pasigurta mund të shkatërrohen plotësisht, duke shkaktuar humbje të jetëve dhe dëme ekonomike të mëdha.

Erozioni i tokës: Mund të shkatërrojë parcela bujqësore, duke reduktuar mundësitë e prodhimit bujqësor dhe duke

[70] Mejdisi dhe Sipërfaqet me Rrezikshmëri, PZHK/2022-2030,/Komuna Gjakovë

shkaktuar humbje të rëndësishme të pasurive natyrore.

2. Përkeqësimi i infrastrukturës:

Rrëshqitjet dhe erozioni mund të shkatërrojnë rrugët, urat dhe rrjetet e tjera të infrastrukturës, duke vështirësuar transportin dhe qasjen në zona të caktuara.

Shkatërrimi i sistemeve ujësjellës dhe kanalizimeve: Erozioni mund të ndikojë negativisht në sisteme të tilla, duke shkaktuar probleme me furnizimin me ujë dhe pastrimin e ujërave të ndotura.

3. Shkatërrimi i pasurive natyrore dhe monumenteve historike:

Shkatërrimi i monumenteve dhe objekteve historike: Rrëshqitjet dhe erozioni mund të shkaktojnë dëme të mëdha në monumentet kulturore dhe historike, siç janë kështjellat, objektet fetare, dhe vendet arkeologjike.

Në përfundim, pasojat e rrëshqitjeve dhe erozionit janë shumëdimensionale dhe kërkojnë masa parandaluese dhe ndërhyrje urgjente për të mbrojtur jetën e njerëzve, pasuritë natyrore dhe infrastrukturën.

Harta 36. Koncpeti i mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri



Masat parandaluese

Me qëllim të pengimit të krijimit të ndodhjeve të vërshimeve, rrëshqitjeve dhe erozionit në territorin e komunës së Gjakovës, përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe të përrojeve të cilët përshkojnë këtë territor, e me qëllim të parandalimit të situate emergjente, mbrojtjes së tokave bujqësore, mbrojtjes së ambientit dhe shëndetit të banorëve dhe pronës së tyre, duhet të ndërmerren këto masa preventive:

- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion më të lartë;
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja;
- Të parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës me anë të pyllëzimit dhe melorimit të zonave të degraduara bujqësore;
- Rregullimi dhe shtretërve të lumenjëve konform standardeve që garanton stabilitetin e rrjedhës së lumit duke parandaluar erozionin e mundshëm të tokës, akseve rrugore, urave dhe mbrojtjen e sipërfaqeve bujqësore;
- Mirëmbajtja e tokave bujqësore me mekanizma modern;
- Zhvillimi i një sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Mbjelljen e drunjtëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi për të kufizuar erozionin në lumenjtë kryesor;
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe krijimi i brezave të gjelbërtë atyre të degraduara;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjëve nga bimësia dhe ndalimi i hudhjes së mbeturinave dhe materialit tjetër që mbartin rrymat e ujit;
- Ndërtimi i pendave dhe argjinaturave dhe renovimi i tyre për parandalimin e gërryerjes së shtratit të lumenjëve;
- Parandalimi i degradimit të shtretërve të lumenjëve nga veprimet arbitrare të faktorit njeri, para së gjitha i shfrytëzimit të pakontrolluar të zhavorrit, gërmimeve të shpatijeve me pjerrtësi dhe ndërtimeve në afërsi të brigjeve të lumit;
- Mbushja e pjerrtësisë së brigjeve të lumenjëve me materiale rrethanore dhe artificiale;

Të gjitha veprimet dhe masat antierozive duhet ti nënshtrohen Udhëzimit Administrativ mbi Normat teknike të Planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli 2 paragrafi 2 dhe 1.2.1.)

6.8. RESHJET E BORËS, NGRICAT DHE MJEGULLAT

6.8.1. Karakteristikat e terenit dhe zonave potenciale të bores dhe orteqeve

Edhe pse gjatë dekadës të fundit reshjet e borës janë gjithnjë e më të pakta, për shkak të karakteristikave të terenit dhe kushteve klimatike dhe meteorologjike, ka gjasa reale të priten reshje të dendura të bores sasia e cilës mund të ndryshoj nga vendi në vend, varësisht nga lëvizjet e masave ajrore. Zonat e thella rurale të komunës së Gjakovës janë më të ndikuara nga reshjet e dendura të bores për shkak të vështirësisë apo bllokimit të qarkullimit.



6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes dhe temperaturat ekstreme

Periudha e borës në komunën e Gjakovës zgjatë mesatarisht prej nëntorit deri në prill. Dendësia më e madhe me të reshura në formë bore është në muajin janar me mesatare prej 6.5 ditë gjatë muajit,ndërsa dendësia mesatare vjetore e ditëve me borë është 21.3 ditë. Sipërfaqja e teritorit të komunës është përafërsisht 42.4 ditë e mbuluar me shtresë bore (duke përfshirë edhe zonat e thella malore), respektivisht 11.6% të ditëve të një viti**.**

Duke u bazuar në pozitën gjeografike dhe klimatike , territori i komunës së Gjakovës karakterizohet me temperatura te ulëta gjatë sezonës së dimrit, kështu që dimrat shoqërohen me të reshura relativisht të mëdha të borës për rrethanat kosovare, dhe me temperatura të ulëta deri në -20°C. Reshjet e borës shpesh arrijnë limitin 1. metër në qytet, ndërsa në zonat e thella rurale edhe mbi 1 metër[71].

Në qoftë se merret në konsideratë edhe mundësia formimit te akullit, atëherë është evidente bllokimi dhe vështirësimi i qarkullimit rrugor i njerëzve dhe mallrave e në mënyre edhe me te theksuar nëpër fshatrat e zonave të thella siç është zona kufitare rreth fshatrave Prush e Goden ne anën e Hasit, apo fsh.Bec-Cërmjan-Gërgoc-Zhabel-Shqiponje-Kralan, në zonën e Dushkajës., si dhe drejtimi Botush-Koshare në Rekë të Keqe.

Bora, përveç se krijon vështirësi në qarkullimin rrugor, ajo në masë të madhe ndikon edhe në dëmtimin e shtyllave dhe largëpërçuesëve të rrjetit elektrik, që si dukuri për komunën e Gjakovës për shkak të reshurave të shumta, është shumë prezente me mundësi që ato të ndodhin kudo,dmth.pa një identifikim të qartë të lokacionit. Nga fenomeni i borës kemi raste të dëmtimit të konstruksionit të shtëpive (sidomos tek ndërtimet e vjetra me material të dobët), dëmtimit të objekteve të improvizuara si: depo të ndryshme, anekse të pa standardizuara të objekteve, shtalla bagëtish, paslloma për vendosjen e ushqimit të kafshëve, ahure etj. të cilat paraqiten sidomos në pjesët rurale të komunës. Andaj,vëmendja dhe gatishmëria për intervenime duhet të jetë e orientuar në këtë drejtim.

Profili i cënueshmërisë së komunitetit

Profili i rrezikut	
Rreziku: Rrëshqitjet.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **E ulët**	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme.	**Modeli sezonal:** **Dimëror** – Nëntor-Dhjetor-janar-shkurt- mars
Zonat që mund të goditen më së shumti: I gjithë territori i komunës	
Kohëzgjatja e mundshme: Relativisht e shkurt 1-3 ditë; **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit):** Me paralajmërim	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: **IHMK** Numri Integruar 112.	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po X Jo ☐	

[71] Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, -"Indekset hidrometeorologjike në Kosovë 2010-2020", Prishtinë 2012

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ulët
Pasuria	Shkatërrime/ dëmtime të objekteve të banimit,rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,etj.	E ulët
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrjetit elektrik dhe telekomunikimit, etj.	E ulët
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim / dëmtim i objekteve shkollore, QMF, objekteve qeveritare, etj.	E ulët
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese.	E ulët
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E ulët
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të kultit.	E ulët
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E ulët
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ulët

Para fillimit të sezonës së dimrit, Komuna e Gjakovës përpilon "Planin për pastrimin e rrugëve nga bora dhe akulli", përcakton prioritetet në hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Në pjesën urbane të qytetit mirëmbahen 40 km' rrugë, ndërsa në ato rurale 178.5 km'(Dushkaja 59 km',Hasi 62.5km',Reka e Keqe 57 km'[72].

Prioriteti për pastrim dhe mirëmbajtje përcaktohet sipas rëndësisë dhe vitalitetit të objektit i domosdoshëm për funksionimin normal të jetës dhe punës, si rrugët që shpienë në:

- Institucionet administrative dhe publike,
- Institucionet edukativo-arsimore të të gjitha niveleve,
- Institucionet medicinale dhe veterinare,
- Subjektet ekonomiko-komerciale dhe të biznesit,
- Qendrat e komunikacionit rrugor të të gjitha kategorive,
- Institucionet dhe objektet kulturore-sportive etj.

Komuna e Gjakovës është përgjegjëse për mirëmbajtjen e lokale të rrugëve, ndërsa Ministria e Infrastrukturës për rrugët magjistrale dhe rajonale që përshkojnë teritorin e komunës.

6.8.3. Pasojat nga bora

Vështirësitë më të mëdha në rrugë ka pasur në qarkullimin e automjeteve, e në të cilën ka pasur edhe aksidente të vazhdueshme, është rruga rajonale Prizren - Brezovicë, pjesa e rrugës prej 30 km që ka vështirësi të vazhdueshme si pasojë e rënies së borës dhe e ngricave në rrugë. Në këtë segment rrugor ka pjerrtësi dhe ka hije të vazhdueshme për shkak se është terren malor, ku gjatë dimrit shfaqen këto probleme të qarkullimit të automjeteve. Pasojat mund të jene në humjen e jetës së njerëzve në aksidente eventuale andaj kërkohet mirembatje të vazhdueshme.

[72] Drejtoria Komunale për Shërbime Publike, Gjakovë – Plani operativ vjetor për pastrimin e rrugëve për sezonën vjeshtë-dimër

Në kushte të reshjeve intesive të borës dhe tejkalimit të parashikimeve të motit, mund të shfaqen pasoja të përkohshme në:

- Lëndime të këmbësorëve dhe aksidente të shumta komunikacioni;
- Vështirësi ose ndërprerje e përkohshme e qarkullimit rrugor në pjesën urbane, e sidomos në drejtim të zonave të thella ruarle;
- Probleme në furnizim me energji si pasoj e dëmtimit të rrjetit elektrik (shtyllave dhe përçues);
- Vështirësi në furnizimin e qytetarëve me artikuj të konsumit ditor;
- Pengesa dhe vështirësi të qarkullimit të kategorive të cenueshme të popullatës, vijimit të nxënësve në shkolla, vështirësi në destinacione si: objektet, entet dhe isntitucionet publike e private, në ndërmarrje, biznese etj.
- Pregaditja dhe mirëmbajtja dimërore të rrugëve lokale përmes opertaratorit ekonomik të kontraktuar,
- Aktivizimin e Shtabit Komunal për mobilizimin e gjitha kapaciteteve njerëzore e teknike

6.8.4. Ngricat dhe mjegullat dezorijentuese

Dimërat në këtë lokalitet nga viti në vit bëhen më të ndryshueshëm sa i përket acarit dhe kohëzgjatjes së tyre. Ngricat më të mëdha paraqiten gjatë muajve nëntor- dhjetor-janar-shkurtë, me mesatare 42.4 ditë të mbuluara me borë dhe me 63,3 ditë me mëngjese nën -°C. Ndryshimet më të mëdha shprehen në muajin shkurtë, sepse diferenca e temperaturave të ulëta dhe të larta mund të arrijë deri në 10.8 ° C.[73]

Ngricat më tepër ndikojnë në vështirësimin e qarkullimit të automjeteve, sidomos rrezikohet siguria në komunikacion,veçanërisht sidomos në pikat më kritike të infrastrukturës rrugore:
Ngricat gjithsesi ndikojnë edhe në dëmtimin (çarjen) e rrugëve të asfaltuara dhe nga ngrirja-shkrierja e masës së tokës vende-vende paraqitet edhe erozion-shëmbje që implikon marrjen e masave të kufizuara për ngritjen e murit mbrojtës (rruga magjistrale Gjakovë-Prishtinë në afërsi të fsh.Bec).

Mjegullat dezorijentuese - gjithashtu paraqet rrezik për komunikacionin rrugor dhe ajror (aeroporti ushtarak Italian në fsh Lug Bunar), me gjatësi kohore relativisht të papërcaktuar, të shfaqura kryesisht gjatë sezonës vjeshtë-dimër. Mjegullat shfaqen pothuajse në tërë teritorin e komunës, derisa dendësia, intenziteti dhe pasojat janë mëtë theksuara në segmentet rrugore përgjatë lumit Drini i Bardhë, sidomos në aksin rrugorë Klinë-Gjakovë-Prizren dhe Gjakovë-Deçan. Përveç shkaqeve tjera, mjegullat ndikojnë drejtpërdrejtë në ngritjen e shkallës së rrezikut në komunikacionit rrugor me frekuentim të lartë e me efekte zingjirore dhe me fatalitete (nëntor 2011, në aksin rrugor Gjakovë-Klinë, afër kodrës së Becit[74], si pasoj e mjegullës në një rast ku kanë humbur jetën 5 persona në aksident komunikacioni, si një prej rasteve më të rënda).

[73] http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/kosovo/climate.html,, Zona klimatike e Dukagjinit, KPMM, Prishtinë, 2012
[74] Stacioni Policor në Gjakovë – Raport Policor, Gjakovë, nëntor 2011

6.9. BRESHËRI

6.9.1. Karakteristikat e terenit dhe zonat e prekura nga breshëri

Breshëri është freshje atmosferike që formohet me lëvizjet e shpejtë vertikale të ajrit dhe ftohjen e shpejtë të saj, duke krijuar pika të kristalta të akullta. Stuhitë e breshërit, që zakonisht ndodhin në përiudhën mes pranverës së hershme e vjeshtës së vonë, gjithashtu janë karakteristikë e klimës së Gjakovës. Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa sekondash e deri në një orë. Më së shpeshti zgjatë 10-15 minuta. Temperaturat e ulëta janë faktor i rendësishem meteorologjik, që ka ndikim të madh në klimën e këtij territori. Temperaturat e ulëta, në vjeshtën e hershme dhe pranverën e vonë, lënë pasoja të rënda, posaqërisht në rritjen e frutave dhe në kultivimin e perimeve.

6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik

Shpeshtësia e paraqitjes është mes ***pranverës së hershme dhe vjeshtës së vonë***, mund të jene të rrezikuara të gjitha vendbanimet e komunës së Gjakovë, por dëmet me të mëdha shkaktohen tek sipërfaqet bujqësore.
Dëmet më të mëdha nga stuhi breshëri janë evidentuar në vitin 2023 ku shuma e përgjithshme ka arrijtë vlerën në ***239,538.39*** **euro**, ndërsa në v. 2025 nga rrufeja janë shkaktuar dëme ***5,600.00 €***[75]

6.9.3. Pasojat nga breshëri [76]

Duke iu referuar historikut më të ri të këtij fenomeni në teritorin e komunës, breshëri në vazhdimësi ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në bujqësi, me çrast janë evidentuar lokacionet e goditura dhe periudha e ndodhjes, lloji dhe sasi kulturave bujqësore të dëmtuara.

[75] Burimi: Raporti DBPZHR Raporti i dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe rrufeja, 2023 dhe/2025

[76] *GFA Consulting Gruop BE –Mbështetje insitucionale Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë të Kosovës nr.2008, 162-152, &,* Early Risk Management Planning, www.fta.dot.gov/grants/12840_9649.html

6.9.4. Masat parandaluese

Rifunksionalizimi i stacioneve për mbrojtje nga breshëri

Në vendin tonë bujqësia përjeton dëme të mëdha nga breshëri, sepse kryesisht paraqitet duke filluar nga gjysma e muajit maj e deri tek fundi i muajit gusht, përkatësisht në atë periudhë kur për kulturat bujqësore është më i dëmshmi. Në fakt, shumica e kulturave janë të ekspozuara ndaj breshëritë në periudhën e tyre vegjetative. Rënia e breshëritë në aspektin kohor është shumë e shkurtë, por mjaftojnë vetëm pak minuta sa për tu shkatërruar të gjitha të lashtat e bujqve. Në klasifikimin e rasteve të siguruara në sigurimin e prodhimtarisë bimore ky rrezik vendoset në vendin e parë për shkak të shpeshtësisë së ndodhjes dhe ashpërsisë së pasojave. Breshëri bimëve u shkakton lëndime mekanike, ose ndryshe bënë shkatërrimin e indeve bimore dhe atë me shkëputjen e organeve të caktuara, thyerje, qarje dhe me rënie. Breshëri po ashtu në raste të caktuara mund të shkaktoj në bimë paraqitjen e sëmundjeve bimore dhe atë atyre sëmundjeve të cilat për zhvillimin e tyre kërkojnë dëmtimin e indeve bimore. Dëmet nga këto sëmundje bimore gjithashtu llogariten dëme nga breshëri. Në fakt breshëri është një formë e reshjeve, i cili në bie nga retë në formën e molekulave të ngjeshura sferike apo copëzave të akullit më së shpeshti të diametrit prej 5 dhe 50 mm, dhe bie nga qielli Procesi i krijimit të kokrrave të akullta zhvillohet në atë mënyrë që ajri i nxehtë dhe i lagësht ngritët lartë dhe ftohet, pastaj rreth bërthamave të përshtatshme bëhet sublimimi i avullit të ujit në kristale të akullit. Këto kristale e rritin madhësinë dhe peshën e tyre dhe fillojnë të bien në tokë. Të gjitha këto zhvillohet në retë e fatkeqësisë të cilat të bartura nga rrymat e ajrit kalojnë nga një zonë në tjetrën. Shpejtësia e lëvizjes së reve është midis 50 dhe 100 km/h, ndërsa drejtimi i lëvizjes më së shpeshti në vijë të drejtë edhe pse nën ndikimin e erërave të forta mund të shmangën nga kjo vijë dhe të shkapërderdhen. Në këtë rrugëtim lëviz breshëri dhe lë pas vete dëme të quajtura dëme breshëri. Gjerësia e gjurmëve më së shpeshti i përgjigjet gjerësisë së resë së fatkeqësisë dhe sillet nga disa qindra metra deri në dhjeta kilometra.

Gjatësia e gjurmëve i përgjigjet gjatësisë së rrugëtimit të resë, ndërsa kjo varet nga ndryshimi i dy zonave në shtypjen e ajrit. Gjatësia e gjurmës është dy herë më e madhe se gjerësia dhe është nga disa kilometra e deri në disa qindra kilometra. Drejtimi i ardhjes së fatkeqësive me breshër përcaktohet nga ndikimi i përgjithshëm i kushteve atmosferike dhe klimatike. Bazuar në atë që u cek më sipër mund të konkludohet se pavarësisht madhësisë së sipërfaqes së përfshirë, breshëri prapë se prapë është dukuri lokale. Shkalla e rrezikut nga breshëri pasqyrohet përmes numrit më të madh të elementeve:

- Dendësisë së kokrrës për njësi të sipërfaqes;
- Madhësisë së kokrrës;
- Kohëzgjatja e fatkeqësisë;
- Shpeshtësisë së rënies;
- Kohëzgjatjes së rënies së breshëritë

Dendësia, madhësia dhe kohëzgjatja e fatkeqësisë quhet intensiteti i breshëritë. Shpeshtësia e rënies së breshëritë pasqyrohet me numrin e rasteve të ndodhjes së breshëritë (numri i ditëve me breshër) në një vend apo në një zonë gjatë një viti. Periudha breshërore është intervali kohor nga ndodhja e parë dhe e fundit e breshëritë gjatë vitit.

<u>Masat preventive mbrojtëse nga breshëri</u>

Përpjekjet për të zbutjen e dëmeve nga stuhitë e breshëritë janë: rregullat e ndërtimit dhe kampanjat për rritjen e vetëdijesimit dhe edukimit të publikut. Përmirësimi i sistemeve të shërbimeve meteorologjike të paralajmërimit, si dhe modernizimi i sistemit të vëzhgimit, të cilat do të përmirësojnë parashikimin e kushteve meteorologjike nga të cilat mund

të shkaktohen stuhitë dhe stuhitë e breshëritë. Njëra prej metodave kryesore të mbrojtjes nga breshëri është gjithsesi mbrojtja raketore kundër breshëritë.

Mbrojtja raketore kundër breshërit:

Çdo qendër radarike duhet të ketë stacione kundër breshëritë, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të rregullt në territorin e qendrës për mbrojtje sa më të suksesshme nga breshëri.

Stacionet kundër breshëritë duhet të shpërndahen nëpër fshatra. Ato duhet të lidhen përmes radio komunikimit më Qendrën 24 orë në ditë. Në bazë të dhënave të vëzhgimit radarik, personeli I qendrës merr vendimin për shkallën e urgjencës gjegjësisht gatishmërisë së njerëzve nëpër stacione. Në rast të mundësive reale që retë me akull kërcënojnë territorin nën përgjegjësinë e një qendre shkallë e lartë e gatishmërisë të çdo anëtari veç e veç dhe komplet ekipit të qendrës dhe stacioneve shpejt. Raketat me të cilat disponojnë stacionet kundër breshëritë janë të një largësie të vogël dhe të mesme. Qëllimi i raketës kundër breshëritë është që në renë me breshër të futet një numër i mjaftueshëm bërthamash nga të cilat do të kryhet shkrirja e pikëzave me të cilat është e mbushur reja, si dhe të kryhet shkatërrimi i vorbullës në re duke penguar krijimin e kokrrave të mëdha të breshëritë. Si bërthamë kondenzuese shërben jodi i argjent jodit Bërthama me pikëzat e shkrira të ujit duke rënë nëpër ajrin e nxehtë në afërsi të sipërfaqes tokësore shkrihen në mënyrë të rregullt dhe në tokë bien si shi.

Raketa lëshohet në ajër nga gjuajtës special, të cilët në të vërtetë janë një tub i thjeshtë hekuri të futur në tokë vertikalisht. Në lartësi prej 1.000 metrash raketa eksplodon me një shpërthim të fortë. Kristaleve të argjendojodidit ju duhet një çerek ore pas eksplodimit që të arrijnë deri në majën e resë me breshër dhe veprimi i tyre pason pas 15-20 minutash, kur zakonisht fillon të bjerë shi. Madhësia e sipërfaqes që mbrohet nga breshëri zakonisht përfshin 10000 – 15000 hektarë.

6.10. ORTEQET

Rreziku nga orteqet ka një profil të ulët krahasuar me pasqyrën e rreziqeve të përgjithshme në komunë dhe nuk ka ndonjë ndikim serioz. Orteqet janë dukuri e cila paraqitet në terrenet e thepisura > 45°. Në teritorin e Gjakovës, përveç mundësisë së ç'faqjes së orteqeve në zonën e Koshare (pa pasoja) dhe pjesërishtnë atë të Pashtrikut, derisa në pjesët tjera të teritorit të komunës kjo dukuri nuk ka qenë prezente, dhe nuk ndikon në funksionimin normal të komunitetit.[77]

[77] Dr. Nesim Vala , "Pozita dhe karakteristikat gjeografike të komunës së Gjakovës"- Doracak për nevojat e Drejtorisë komunale për mbrojtje dhe shpëtim", prill 2009, Gjakovë

Harta 37. Zonat me ndjeshmëri ndaj orteqev

6.11. ERËRAT DHE STUHITË

Erërat e forta dhe stuhitë ndodhin nga lëvizjet e ajrit në atmosferë si pasoj e ndryshimit të temepraturave mes shtresave të ajrit në mënyrë horizontale, kryesisht në drejtim të tokës. Rreziku nga erërat dhe stuhitë përcaktohet nga kufijtë e shpejtësisë së saj dhe konfiguracioni i terenit, me ç'rast terenet e rrafshta dhe pa pengesa natyrore janë më të atakuara nga goditjet.

6.11.1. Karakteristikat e terenit dhe parametrat e luhatjeve të ajrit[78]

Erërat në Komunën e Gjakovës më tepër janë të kushtëzuara nga konfiguracioni i relievit, gjegjësisht nga afërsia e masivëve malore të përbëra prej shumë Qafave malore (Qafa e Prushit, Qafa Stobercit, Qafa e Dobrunës, Qafa e Morinës si dhe lugina e Drinit të Bardhë me grykën deri te fshati Vërnicë

Në lokalitetin e Gjakovës, era me shpejtësi më të madhe vjetore është ajo e drejtimit jugëpërendimor (SW) me vlerë 3,8 m/sec. Shpejtësia maximale e erërave për këtë lokalitet janë të drejtimit jugpërendimorë me vlerë 18,9 m/sec. Më së tepërmi paraqiten në periudhën pranverore (mars-prill) dhe në vjeshtë sidomos në muajin nëntorë.

Erërat e forta dhe tufanët me përmasa shkatërruese për këtë lokalitet janë dukuri e rrallë.

Zonë më e ndikuar nga stuhitë dhe erërat e forta janë terrenet e hapura, sidomos pjesët periferike të qytetit të cilat janë të pajisura me objekte dhe infrastrukturë tjetër urbane si mundësi permanente të jenë zona kritike në këtë kuptim (si: Dardania, Rezina, Blloku i Ri, Orize). Erërat e forta janë prezente edhe viset rurale me intezitet të ndryshëm, por që dëmet më tepër janë të reflektuara në infrastrukturën elektroenergjetike, ndërsa në segmentet tjera janë të papërfillshme.

Situatat meteorologjike, në origjinën e tyre kanë një jostabilitet të fuqishëm të atmosferës. Ky lloj i fenomenit duket mjaft i shpeshtë në Kosovë, sidomos këto vitet e fundit, që korrespondon me periudhat e ngrohjës së klimës në mes të qershorit dhe të shtatorit.





A/B Skema e presionit atmosferik

[78] Dr. Nesim Vala " Pozita dhe karakteristikat gjeografike të Gjakovës" – doracak ,Gjakovë, prill 2009 f.9,10,11

4.58 St. automatik Gjakovë - Shpejtësia max. e erës

Shpejtësia max. e erës (m/s): 2022
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 23' 24.01"
Lartësia mbidetare e st.: 410 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 25' 32.02"

Dita	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1	3.3	6.3	7.6	10.3	7.0	4.5	3.7	6.2	6.3	3.6	2.4	6.0
2	3.7	4.3	5.0	12.5	8.0	5.9	8.1	5.8	4.8	4.4	3.3	2.8
3	8.2	10.8	4.2	9.4	4.8	4.0	4.5	7.3	3.6	6.4	2.0	1.8
4	12.5	2.4	5.8	4.4	2.6	4.8	4.1	4.8	9.3	6.7	8.1	2.2
5	13.7	3.2	7.1	3.5	3.1	4.8	8.8	3.6	5.5	5.7	6.4	1.9
6	9.7	5.9	6.5	3.7	5.0	5.9	5.1	5.5	4.1	2.3	8.7	2.6
7	2.6	13.5	3.3	8.4	5.2	4.1	4.2	8.4	4.0	4.7	2.9	3.2
8	1.6	11.9	8.0	11.4	4.1	12.2	5.3	6.5	-	2.8	2.4	2.8
9	2.9	3.4	7.1	11.9	7.9	6.2	4.2	9.3	-	4.0	2.1	11.5
10	6.7	2.3	6.1	8.0	5.6	8.3	4.6	5.8	7.1	3.1	2.1	10.2
11	9.4	3.8	7.7	8.0	2.3	8.7	5.7	5.2	4.5	4.8	4.6	8.8
12	7.2	6.2	7.4	4.9	4.3	7.5	4.5	7.9	4.2	3.9	6.5	5.2
13	6.2	4.5	4.2	4.5	2.6	4.2	4.7	4.7	4.5	4.5	5.8	6.1
14	3.4	5.8	3.1	4.3	6.5	5.8	4.5	5.6	5.0	8.5	2.0	2.8
15	5.7	3.9	5.7	3.4	3.1	4.0	2.8	3.9	12.2	5.0	4.6	3.6
16	2.6	3.0	9.5	9.9	3.0	3.6	5.3	9.3	9.2	2.8	6.0	6.7
17	3.2	11.9	5.0	8.5	7.8	6.9	5.3	3.5	8.6	5.1	9.8	10.1
18	6.8	4.4	6.9	6.3	7.8	7.5	5.5	3.8	9.4	3.1	5.8	7.0
19	4.6	11.4	8.0	7.2	6.1	5.2	5.5	4.9	10.5	2.6	8.5	5.3
20	11.0	6.6	8.2	7.6	3.1	7.7	5.6	8.0	5.6	5.1	8.6	3.6
21	8.3	12.0	9.7	2.5	2.9	5.1	4.0	5.1	7.8	2.6	4.3	2.3
22	9.7	8.4	8.0	6.6	5.5	5.1	3.8	9.3	6.4	4.3	4.1	2.4
23	5.3	5.9	8.2	7.1	3.9	5.2	2.9	14.1	5.2	4.4	7.2	1.9
24	8.3	6.8	3.3	9.0	7.3	3.6	7.2	7.1	7.2	3.3	3.4	2.8
25	2.9	2.9	4.7	10.5	8.8	8.9	4.0	7.0	6.3	3.1	4.3	2.7
26	2.9	7.6	3.5	3.9	5.7	3.7	4.4	5.1	3.7	3.2	5.3	3.4
27	2.6	8.8	3.5	6.5	4.0	3.7	8.4	5.1	10.5	3.9	4.7	6.1
28	6.2	6.8	5.0	5.1	8.2	4.3	7.2	6.9	9.4	4.7	6.3	3.9
29	6.5		7.7	5.0	5.9	4.1	3.6	8.1	6.1	2.9	5.1	2.3
30	4.0		10.7	4.7	7.5	4.1	9.2	9.0	7.7	2.2	5.9	7.2
31	3.9		5.7		6.0		6.3	5.4		2.3		3.0
Mes	6.0	6.6	6.3	7.0	5.3	5.7	5.3	6.5	6.7	4.1	5.1	4.6
Min	1.6	2.3	3.1	2.5	2.3	3.6	2.8	3.5	3.6	2.2	2.0	1.8
Dita	8	10	14	21	11	16+	15	17	3	30	3+	3
Max	13.7	13.5	10.7	12.5	8.8	12.2	9.2	14.1	12.2	8.5	9.8	11.5
Dita	5	7	30	2	25	8	30	23	15	14	17	9
Std	3.2	3.3	2.1	2.8	2.0	2.0	1.7	2.2	2.4	1.4	2.2	2.7

6.11.2. Zonat me rrezikshmëri dhe struktura e goditjes

Në rastet eventuale të përfshirjes së territorit të komunës së Gjakovës. nga stuhitë e erërave të fuqishme, mund të përfshihet i gjithë territori i komunës dhe mund të jenë të rrezikuar të gjithë banorët e komunës se Gjakovës.

Teritori i komunës i nënshtrohet ndikimeve të ajrit dhe si rezultat i saj janë shkaktuar dëmtime të konsiderueshme material dhe viktima në njerëz.

Ndikimi i stuhive dhe goditjeve tjera të ajrit rrezikon më tepër territoret e hapura ku shpejtësia e erës mund të arrijë mbi 100 km/ore me ç'rast janë të paevitueshme shkaktimi i dëmeve të kësaj natyre.

Nga përvojat e dekadës së fundit, pasojat në rend të parë reflektohen në rrezikimin e sigurisë së qytetarëve, dëmtimin e shtyllave elektrike dhe rrjetit të saj, rrjetin e telefonisë fikse dhe mobile, shpluarja e pullazeve, dëmtimi i shtëpive nga materiali i dobët si dhe "fluturimi" i gjësendeve të forta e metalike të pa përforcuara me rrezikshmëri për jetën e qytetarëve dhe kalimtarëve të rastit etj. Stuhitë, përveç pasojave të cekura më lartë mund të shkaktohen edhe dëme të intensiteteve të ndryshme në bujqësi, sidomos në periudhën vegjetative.

Situatë më serioze ka ekzistuar në korrik të vitit 2002, ku si pasoja e stuhisë së madhe janë dëmtuar strehët metalike të banesave, "fluturimi" i kontejnerëve dhe objekteve tjera, me c'rast kanë humbur jetën 2 persona në rrugën transite të qytetit, ndërsa shumë të tjerë kan qenë me lëndime të lehta dhe të rënda trupore. Dëmet materiale kanë qenë relativisht të mëdha dhe kryesisht tek objektet të improvizuara, kontejner, mbulesa metalike dhe nga druri, dëmtime të gjëra të lëvizshme dhe të palëvizshme etj. Nga atëherë (v.2002), nuk ka patur stuhi të përmasave të tilla, por që nga erërat e forta janë shkaktuar dëme kryesisht në objekte të vjetra banimi, shtalla të kafshëve dhe të ushqimit, në kulturat bujqësore, në sera, dhe në infrastrukturën elektroenergjetike (v.2011, dëme të raportuara në vlerë 300.000€ në bujqësi -Zona e Dushkajës, 2015, 2016, 2020 dhe viteve pasuese por shum më të të kufizuara për nga intensiteti dhe pasojat[79]). Me ndryshimet globale klimatike që janë duke ndodhur, sidomos tani më të shprehura në dekadën e fundit, nuk përjashtohet mundësia që ato të ndodhin edhe më shpesh dhe me pasoja të paparashikuara. Nisur nga përvojat e kaluara, intensiteti erërave ishin afatshkurtëra maksimum deri në 12/orë, derisa për shkak natyrës së goditjes, për reagim emergjent kërkohej ndërhyrja e ekipeve të specializuara.

Harta 38. Goditjet e erërave në teritorin e komunës së Gjakovës



[79] Komuna e Gjakovës – "Raporti i Komisionit për Vlerësimin e dëmeve në Bujqësi"- korrik/2011,2015,2016,2020,2022, DMSH/ Qendra Operative Emergjente-112, Databaza eklektronike e rasteve të lajmëruara

Flet-pune e Profilit të Rrezikut	
Rreziku	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **Katastrofike:** Më shumë se 50% **Kritike:** 25 deri 50% **E kufizuar:** 10 deri 25% **E papërfillshme:** Më pak se 10%	
Frekuenca e ndodhjes: ▪ **E mundshme**: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.	**Modeli Sezonal:** **Pranverë- mars-prill** **Vjeshtë: nëntor**
Zonat që mund të goditen më së shumti: ▪ Qafë Prush-Qafë Morinë (territori-vendbanimet që shtrihen në rrafshinat dhe terrenet e hapëta posht bokave-grykave) ▪ Lugina e Drinit të Bardhë me grykën deri te fshati Vërnicë (territori dhe vendbanimet me ndikim edhe në regjionin e Rekës së Mirë) ▪ Pjesa urbane (Dardania, Rezina, Blloku i Ri, Orize)	
Kohëzgjatja e mundshme: disa minuta deri në disa orë	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): ▪ Paralajmërim minimal (apo fare).	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: IHMK, Qendra e Thirrjeve-112,	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? ☐ **Po** ☐ Jo	

Efekti goditës në komunitet (shkalla e ashpërsisë), karakteristikat

Karakteristikat	Ashpërsia
• Vdekje të shumëllojshme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë. • Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E Ulët
• Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë. • Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E Ulët
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 10 ditë. • Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E Ulët
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. • Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 1 javë. • Më shumë se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E Ulët
• Lëndimet dhe/apo sëmundjet e trajtuara me ndihmën e parë. • Humbje e vogël e standardit të jetesës. • Ndërprerja e objekteve/shërbimeve kritike për 24 orë e më pak. • Më pak se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.	E Kufizuar

6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e forta dhe stuhitë

Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini i Bardhë. Klima është mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.

Efektet e këtyre fatkeqësive natyrore janë të shumta, bëhet fjalë për:

- Shkuljen e drunjve,
- Rrëzimin e kulmeve,
- Lëvizjen dhe hudhjen e objekteve të ngurta (mobile të kopshtit, kontejnerëve dhe gjësendeve tjera),
- Shkatërrimin e pjesshëm të rrjetit elektrik dhe të telefonisë,
- Çrregullimin e transportit (rrugor, ajro, hekurudhor),
- Aksidentet e komunikacionit,
- Zvogëlimin, madje paralizimin e aktiviteteve socio-ekonomike,
- Vdekjet ose lëndimet nga goditjet ose nga rëniet e objekteve,
- Goditjet me fatalitet, dhe
- Vdekjet ose lëndimet nga rënia.

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

REFERENC-Ë:	12-14/16, dt.14.01.2016
PËR/ZA/TO:	Bordin e Drejtorëve – Komuna e Gjakovës
Cc:	Mimoza Kusari-Lila – Kryetare e Komunës së Gjakovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ndue Muqaj – Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
NGA/OD/FROM:	Komisioni Komunal për Vlerësimin e dëmeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi dëmet e shkaktuara

Në bazë të Vendimin të Kryetares së Komunës së Gjakovës 01 nr. 112-85837 te datës 01.12.2015, për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, respektivisht lidhur me dëmet nga erërat e forta që kanë goditur teritorin e komunës së Gjakovës me datë 11/12, janar/2016, Komisioni në përbërje prej 4 antarësh, hartoi këtë:

RAPORT MBI DËMET

Komisioni për Vlerësimin e dëmeve aktivitetin e tij në teren e ka zhvilluar me dt. 12,13 dhe 14 janar/2016, me çrast objekt shqyrtimi ishin e rastet e dëmeve të lajmëruara të personave fizik dhe juridik në organet komunale të administratës.

#	Profili i dëmit	Numri i objekteve të dëmtuara	Vlera e dëmit
1.	Dëmet në infratsrukturën publike	4	61.000 €
2.	Dëmet në biznese	3	27.800 €
3.	Dëmet në bujqësi (sera)	6	26.170 €
4.	Dëmet në objekte familjare	11	28.340 €
	TOTALI :	**24**	**143.310 €**

Shënim: dokumentacioni i të dhënave individuale për secilin rast veç e veç është i arhivuar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Komisioni:
1. Dipl.ing. Elvane Qarkagjija
2. Zyrt.emerg. Brahim Qarri
3. Dipl.ing. Nexhib Qehaja
4. Dipl.ing. Agron Zorra

Masat parandaluese

Masat parandaluese janë të rëndësishme për të minimizuar rreziqet që sjellin erërat e fuqishme dhe stuhitë, duke siguruar mbrojtjen e individëve dhe pasurive. Ato janë:

- Monitorimi dhe Parashikimi, Sisteme të Monitorimit: Përdorimi i teknologjisë për të ndjekur kushtet meteorologjike dhe për të identifikuar stuhitë në zhvillim;
- Parashikimet e Motit: Informimi i publikut për stuhitë e mundshme dhe erërat e fuqishme përmes paralajmërimeve të hershme;
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi-Kampanjat e Edukimit: Inkurajimi i komunitetit për të njohur rrezikun dhe përgatitjet që duhet të bëjnë dhe planifikimi familjar për përballje me stuhinë;

- Infrastrukturë e Qëndrueshme, Ndërtimi i Qëndrueshëm: Përdorimi i materialeve të forta dhe teknikave të ndërtimit që rezistojnë ndaj erërave të fuqishme;
- Mbrojtja e Infrastruktures: Rregullimi i pemëve dhe strukturave për të parandaluar dëmtimet nga erërat;
- Masa të Sigurisë për Individët, Strehimi: Identifikimi i vendeve të sigurta për t'u strehuar gjatë stuhive, siç janë bodrumet ose ndërtesat e forta. Mjetet e Sigurisë: Sigurimi i mjeteve si drita, ushqim, ujë dhe ilaçe për periudha emergjente;
- Planifikimi i kultivimit të të kulturave bujqësore në zona më pak të cenueshme nga erërat e sidomos pemët frutore me trungje të gjata të cilat janë më të ekspozuara dhe përforcimi i tyre me hunjë;

6.12. THATËSITË

Për thatësirat nuk ekziston ndonjë definicion unik, pasi që kjo është dukuri e ngadaltë, me fillim dhe mbarim të paqartë. Është më së e vërtetë se ç'farëdo forme e thatësisë është pasoj e mungesës së shiut si pasoj ç'rregullimeve të përgjithshme të qarkullimit atmosferik.

Fenomeni thatësi është fatkeqësi e madhe atmosferike dhe për dallim nga fatkeqësitë tjera atmosferike (breshëri, rrebeshet, ngricat e gjata pranverore, etj.) të cilat zakonisht përfshijnë rajone më të vogla, territore më të vogla që kanë ndikim dëmtues të kufizuar, thatësira përfshinë rajone të mëdha, deri në nivel vendi e më gjerë. Pasojat e paraqitjes së thatësisë janë shumë të mëdha, sepse zvogëlohet në masë të madhe prodhimtaria e të lashtave, me ç'rast rrezikohet të ushqyerit e njerëzve dhe kafshëve.

6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e reshjeve atmosferike

Kosova, rrjedhimisht edhe Komuna e Gjakovës ka prierje për thatësira. Thatësirë më e madhe ka ndodhur kohëve të fundit në v.2008, në fillim të v.20214 dhe së fundmi gjatë vitit hidrologjik 2018/2019[80].

Në Komunën e Gjakovës, thatësitë janë dukuri e kohëpaskohshme dhe paraqitet kryesisht gjatë verës, nganjëherë edhe gjatë pranverës dhe vjeshtës në periudha të shkurta kohore. Për shkak të hidrografisë dhe infrastrukturës hidrike të

[80] Raportet dhe të dhënat e arhivuara në DMSH

komunës, pasojat e thatësisë janë me efekt të kufizuar, dhe jo të formatit ekstrem. Rrallë ndodhë që të jenë të përvjetshme, ndërsa thatësi me përmasa më të gjëra mund të paraqiten në çdo 5-10 vjete.

Nëse për një kohë të caktuar gjatë sezonit të vegjetacionit nuk ka shi, kur krahas kësaj, edhe temperatura e ajrit dhe tokës është e lartë, thuhet se ka thatësirë dhe që po mbretëron kohë e thatë. Mirëpo një karakteristikë e tillë e paraqitjes së thatësirës nuk është e plot, sepse shiu nuk është i vetmi tregues, por duhet të merret parasysh edhe raporti midis kohës pa shi dhe bimëve, pasi jo të gjitha bimët harxhojnë sasi të njëjta të ujit në fazat e caktuara të rritjes së tyre. Prandaj, nëse për një kohë të caktuar nuk bie shi, atëherë për disa bimë ndodh thatësira ndërsa për disa të tjera nuk llogaritet thatësirë, ndaj, rrjedhimisht dëmet janë të pjesshme[81].

Tabela nr. Kategoria e kushteve të lagështisë bazuar në SPI

Simbolet	Kushtet e lagështisë	Vlera
ExcD	Thatësirë e jashtëzakonshme	$SPI \leq -2.326$
ExD	Thatësirë ekstreme	$-2.326 < SPI \leq -1.645$
SD	Thatësirë e rëndë	$-1.645 < SPI \leq -1.282$
MoD	Thatësirë e moderuar	$-1.282 < SPI \leq -0.935$
MiD	Thatësirë e vogël	$-0.935 < SPI \leq -0.524$
N	Afër normales	$-0.524 < SPI < +0.524$
SIM	Rritje e lehtë e lagështisë	$+0.524 \leq SPI < +0.935$
MoIM	Rritje e moderuar e lagështisë	$+0.935 \leq SPI < +1.282$
CIM	Rritje e konsiderueshme e lagështisë	$+1.282 \leq SPI < +1.645$
ExW	Jashtëzakonisht lagshtë	$+1.645 \leq SPI < +2.326$
ExcW	Lagështi e jashtëzakonshme	$SPI \geq +2.326$

Burimi: Vjetari Statistikor i IHK/2022,f.26

6.12.2. Dëmet dhe pasojat

Thatësitë dhe temperaturat e larta ndikojnë në zvogëlimin e furnizimit të banorëve me ujë të pijes, ku për shkak të konzumit të madhë gjatë stinës së verës ekziston mundësia e reduktimeve që për pasoj kanë mundësin e ç'faqjes së sëmundjeve epidemiologjike. Sipas të dhënave nga Enti Epidemiologjik në dy dekadat e fundit nuk kemi patur pasoja epidemiologjike si pasoj e mungesës së ujit në komunë.

Në Komunës e Gjakovës, regjioni i Hasit është më i atakuar nga fenomeni i thatësisë për shkak të konfiguracionit të terenit, depozitave të kufizuara të ujit dhe vështirësive në furnizimin me ujë nga rrjetit të sistemit të KRU "Gjakova", ndërsa pjesërisht edhe regjioni i Dushkajës.

Thatësia, përveç ndikimit në zjarre dhe dëmeve të shkaktuara në pyje, ndikim dominant e ka edhe në prodhimtarin e kulturave bujqësore sidomos në zvoglimin e rendimenteve në lavërtari, pemtari, perimtari, vreshtari etj, me ç'rast në zonat ku nuk ka ujitje (zonat malore) rendimenti është për 60 % më i vogël[82].

Tek ne shpesh shfaqet dukuria se nëse vetëm për një kohë të shkurt nuk bie shi bimët menjëherë fillojnë të vuajnë nga

[81] Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtimi-Vlerësimi i Rreziqeve në teritorin e komunësë së Gjakovës, v.2009
[82] https://www.researchgate.net/profile/Zef-Gjeta/publication/377782181_Buletini_i_shkencave_bujqesore/links/65b8c3f71e1ec12eff610b03/Buletini-i-shkencave-bujqesore.pdf

mungesa e tij. Kjo shfaqet për arsye se llojet më të shpërndara të tokës kanë karakteristika të dëmshme ujore, përkatësisht regjim ujor të keq.
Ekzistojnë kryesisht dy lloje të thatësisë, ato tokësore dhe ajrore të cilat ndikojnë dukshëm në rendimentin e kulturave bujqësore. Rreziku më i madh për bimët është kur ndodhin në të njëjtën kohë edhe thatësira tokësor edhe ajo ajrore, ose nëse gjatë kohës pa shi mbretëron vapë e madhe dhe ajër i thatë dhe krahas kësaj fryjnë edhe erëra të thata dhe të nxehta, atëherë thatësira për një kohë të shkurtë mund t'i shkaktoj të lashtave dëme jashtëzakonisht të mëdha, sidomos për për grurin në fazën e e tij të pjekjes qumshtore.

6.12.3. Rezervat ujore[83]

Tabela 72. Burimet, kapacitetit dhe shfrytëzimi i ujit

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodhimit		Kapaciteti i shfrytëzuar i prodhimit m³/ditë
	Vëllimi i kaptimit m³/vit	Kapaciteti i shfrytëzimit m³/vit	
Liqeni i Radoniqit	31,536,000	17,300,000	47,397.26
Burimi Damjan	1,200,000	48,000	131,506
Burimi Gërqinë	800,000	31,200	85,479
Burimi Reka e Keqe	2,210,000	372,300	2,020.00
Prodhimi total:	**35,746,000**	**17,751,500**	**266,402**

Bazeni i Radoniqit paraqet akumulimin, njëherit dhe depozitën më të madhe ujore në territorin e komunës së Gjakovës me 17,300.000 m³/ujë për furnizimin e banorëve me ujë të pijes dhe për për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore. Përmes këtij sistemi furnizohen ¾ e banorëve të komunës së Gjakovës, derisa vendbanimet e Rekës së Keqe përmes furnizimit nga depozitat e ujit nga bjeshka e Junikut. Vetëm në 3 vendbanime (Zylfaj, Goden dhe Qerret) nuk ka rrjet të ujësjellësit. Përmes këtij sistemi furnizohet edhe komuna e Rahovecit dhe 15 venbdanime që gravitojnë mbrenda kufirit administrativ të Komunës së Prizrenit që është pjesë e rëndësishme e Pellgut të "Drinit të Bardhë".

Në kuadër të KRU "Gjakova" përveç furnizimit me ujë të pijes, bëhet ujitja e 8.070 ha sipërfaqeve bujqësore të sektorit publik dhe privat, duke përfshirë edhe një pjesë të komunës së Rahovecit dhe pjesërisht të komunës së Prizrenit. Me këtë rerzervë ujore dhe sistem të distribuimit të ujit për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore s i dhe pendave dhe kanaleve të ujitjes të ngritura nga Komuna e Gjakovës duke shfrytëzuar ujin e lumit Erenik, Krena, Llukac dhe Drini i Bardhë dhe të përrockave, dukshëm janë zvogëluar gjasat për thatësi e të niveleve të larta në komunë.

<u>Burimet Alternative</u>

Prej burimeve më të njohura janë: Burimi i ftohtë në fsh.Rracaj, Kroi i Brekocit, Përroni i zi, Burimi i Mulliqit, Gurra eDamjanit, Burimi i "Potokut" Molliqit, Burimi i Kusarit dhe Përroi i Fisit në Qerret. Këto burime kryesisht gjenden në pjesën jug-perëndimore të komunës, gjegjësisht në zonën e Rekës së keqe dhe zonës së Hasit përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë.

[83] Plani Zhvillimor Komunal Gjakovë 2022-2030

Harta 39. Rrjeti i sistemit të ujit së tokave bujqësore



Qasja e banorëve në këto objekte është e drejtpërdrejtë, pasi që kemi të bëjë me puse shtëpiake apo burime alternative të afërta me vendbanimin dhe të përhershme me ujë. Meqenëse numri i burimeve të ujit (304), puseve (70), shpellave me ujë (3) dhe objekteve tjera natyrore është shumë i madh dhe i shpërndarë në aspektin hapësinor gjeografik, vendndodhja e tyre është i paraqitur në hartat ushtarake të objekteve të ujit Gjakova-1 dhe Gjakova-2, në përpjesëtim 1:50.000 në

Masat preventive për mbrojtje nga thatësitë[84]

Në përballje me thatësinë nuk kemi mundësi që të ndikojmë në sasinë e të reshurave atmosferike, e as në intezitetin e tyre gjatë vitit. Megjithatë, kemi mundësinë që përmes masave të caktuara agroteknike të zbusim pasojat e dëmeve nga thatësitë, por jo edhe shmangjen e tyre në tërësi Pra, kemi mundësinë që përmes rrugëve të tërthorta me sukses të luftojmë kundër thatësisë dhe të arrijmë rezultate më të mëdha të të korrave. Ekzistojnë kryesisht katër grupe të masave agroteknike për të luftuar thatësitë, e këto janë:

1. Masat agroteknike – për përmes së cilave toka aftësohet për të thithë dhe mbajtë një sasi të madhe të ujit nga mbetjet atmosferike;
2. Krijimi i strukturës së tokës - Për të përmirësuar dhe rritur pjellorinë ë tokave me veti fizike të dobëta dhe në

[84]https://www.google.com/search?q=Masat+agroteknike+per+zbutjen+e+pasojave+nga+thatesit+ne+bujqesi&oq=Masat+agroteknike+per+zbutjen+e+pasojave+nga+thatesit+ne+bujqesi&gs_lcrp=EgZjaHJvbWUyBgg

mënyrë që kjo tokë në mënyrë normale të sigurojë kulturat me ujë , është e nevojshme të bëhet përmirësimi i tyre (meliorimi). Kjo mund të arrihet nëse në këto toka krijohet një strukturë stabile dhe jetëgjatë krimbure. Dhe kjo strukturë mund të arrihet nëse në mënyrë të rregullt zbatohen dy masa të rëndësishme agro teknike:

a) **Humifikimi -** Sigurimi i tokës me një sasi të mjaftueshme të materies organike mund të arrihet në dy mënyra:

- **Mënyra më e zakonshme -** është mbushja me një sasie të konsiderueshme të plehut të kafshëve, që pastaj në mënyrë të suksesshme mund të përdorët i ashtuquajturi plehërimi i gjelbër. Kjo konsiston në atë se mund të kultivohen lloje të bimëve të cilat në kohën e rritjes së tyre më të madhe dhe zhvillimit, rrotullohen dhe pastaj lëvrohen;
- **Mënyra tjetër** e sigurimit të tokës me materie organike, gjegjësisht humus të butë, përmes kultivimit i barishtave të përziera shumëvjeçare, dhe bishtakëve në rotacion kulture. Ky është I ashtuquajturi Rotacion Kulture barishtore. Këto bimë ndikojnë në krijimin e strukturës së tokës në dy mënyra: përmes degëzimeve të tyre dejoreve dhe të dejeve, të cilat I fusin në mënyrë të dendur në thellësi të konsiderueshme , kështu që në këtë mënyrë përmes rrugëve mekanike veprojnë në shkriftësinë dhe imtësimin e tokës, vdekja e organeve nëntokësorë të këtyre bimëve si dhe pjesëve bimore mbi tokësorë, pasurojnë tokën me një sasi të madhe të humusit të butë I cili përzihet në mënyrë shumë të imtë me masën tokësore.

b) **Kalcifikimi** – pasurimi i tokës me gëlqere duke ja shtuar ate artificialisht. Ky veprim shkencërisht quhet gëlqerosje gjegjësisht kalcifikim i tokës. Për këtë qëllim mund të përdoren materie të ndryshme të cilat përmbajnë Kalcium-gëlqere. Materiet më të përshtatshme janë: gurët gëlqeror, gëlqere (e pashuar) e gjallë dhe gëlqerja e ngopur duke ngritur nivelet e lagështisë duke penguar tharjen e ujit më në thellësi (1-2 m), ku rendësi ka lëvrimi I thellë.

c) **Plehërimi -** është mbulimi i tokës me materie të ndryshme plehëruese me qëllim të sigurimit bimëve me materie ushqyese. Me plehërim vendoset pjelloria e tokës dhe rritet rendimenti I bimëve. Me plehërim mund të arrihen edhe shumë përfitime tjera në raport me tokën dhe kulturat.. Njëri prej përfitimeve të mëdha është plehërimi i tokës dhe kulturave mund të ndihmojë dukshëm në luftën kundër thatësisë, duke thithur dhe akumuluar sasi të mjaftueshme të lagështisë në tokë.

6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË



6.13.1. Karakteristikat e terenit dhe zonat potenciale[85]

Territori i komunës paraqet zonë endemo-epidemike për shumë sëmundje me shpërthime të kohë pas kohshme të epidemive të vogla apo të mëdha të sëmundjeve ngjitëse si: sëmundjet e zorrëve, tifoja bdominale,dizenteria,barkëqitjet infektive, dhe zoonozat si tularemia,bruceloza, ethet Q, ethet hemoragjike.

Këto sëmundje edhe në kushtet normale paraqesin problem shëndetësor dhe social-ekonomik.
Në kuptimin epidemiologjik, vërshimet te një pjesë e teritorit shkakton ndotjen e objekteve individuale për furnizim me ujë(bunarët dhe burimet) me ç'rast për pasoj ka sëmundjet e zorrëve me mundësi të së tyre në formë epidemike. Në këtë drejtim zonat më të rrezikuara janë fshatrat pran lumenjve si: Ujzi, Bishtazhini, Dujaka, Dobrixha dhe Brekoci.

Sëmundjet tjera që paraqesin problem në komunë janë zoozonat të cilat shpeshherë paraqiten në forma epidemike.Regjionet më të rrezikuara nga zoonozat janë: Hasi nga bruceloza, Reka e Keqe nga tularemia dhe ethet hemorragjike me sindrom renal, dhe regjioni i Dushkajës nga ethet hemorragjike Krime-Kongo. Këto sëmundje fitojnë në peshë në situata emergjente, sidomos gjatë: vërshimeve, zjarreve, thatësisë, tërmeteve, kur mundësia e shndërrimit të tyre në epidemi është shumë e madhe dhe mundësit e menaxhimit të tyre vështirësohen.

Me paraqitjen e pandemisë së fundit me përmasa botërore në v.2020 të Covid/19 është dëshmuar se asnjë pjesë e pjesë e globit nuk mund të jetë imune ndaj epidemive.

6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

- Zona urbane me dendësi të lartë të banorëve,
- Lagjet me kushte të dobëta higjienike,
- Vendbanime ku ka mungesë të aksesit në shërbime shëndetësore,
- Zonat ku ka lëvizje të madhe njerëzish, tregje apo pika grumbullimi.

6.13.3. Shkaktarët e epidemive dhe pandemive

1. **Patogjenët (mikroorganizmat shkaktarë):**
   - **Viruset** — shumë pandemitë janë shkaktuar nga viruse, si gripi (influenza), HIV, koronaviruset (p.sh. SARS-CoV-2 që shkakton COVID-19);
   - **Bakteret** — disa epidemi janë shkaktuar nga bakteret si tuberkulozi, kolera, dizenteria**;**
   - **Parazitët** — disa sëmundje si malaria janë shkaktuar nga parazitë.

2. **Mutacionet dhe variantet e reja të patogjenëve:**

   - Ndryshimet gjenetike që i bëjnë patogjenët më ngjitës ose më rezistent ndaj trajtimit

3. **Përhapja nga kafshët tek njerëzit (zoonozat):**

   - Shumë sëmundje infektive kalojnë nga kafshët në njerëz (p.sh. gripi i shpendëve, Ebola, COVID-19).

[85] Burimi i të dhënave: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale 2025, Komuna Gjakovë

4. **Kushtet mjedisore dhe klimatike:**

Ndryshimet klimatike dhe kushtet mjedisore mund të ndikojnë në përhapjen e patogjenëve dhe transmetuesve të tyre (p.sh., mushkonjat që përhapin malarien).

5. **Shëndeti publik i dobët dhe kushtet higjienike:**

- Mungesa e ujit të pastër, mbeturinat e papastra, kushtet e këqija të jetesës favorizojnë përhapjen e sëmundjeve.

6. **Lëvizjet e mëdha të popullsisë:**

- Migrimet, udhëtimet ndërkombëtare dhe grumbullimet njerëzore favorizojnë shpërndarjen e sëmundjeve.

7. **Kufizimet në sistemet shëndetësore:**

- Sisteme të dobëta shëndetësore nuk arrijnë të identifikojnë dhe trajtojnë shpejt sëmundjet, duke lejuar përhapjen e tyre.

8. **Kundërshtimi ndaj vaksinave dhe masave parandaluese:**

- Mungesa e vaksinimit dhe mosrespektimi i masave mbrojtëse e bëjnë më të vështirë kontrollin e sëmundjeve.

6.13.4. Sëmundjet ngjitëse[86]

Gripi pandemik :

- Gripi i shpendëve (Avian inlfuenza H5N1 dhe H7N9 , Gripi i ri (derrave H1N1),
- Sëmundjet bio terroriste (Ethet hemorragjike, Bruceloza, Tularemia),
- Epidemitë e papritura,
- Helmimet masive me ujë dhe ushqim

GRIPI PANDEMIK- Gripi tanimë është sëmundje sezonale. Zakonisht fillon nga muaji Tetor e vazhdon deri në muajin Maj të vitit pasues (nga java e 40 deri në javën 20 të vitit pasues). Përhapet me rrugë aerogjene nga personi i sëmurë në personin e shëndoshë, andaj numri i personave të infektuar në rast epidemie mund të jetë i madh. Sipas ekspertëve virusi i Gripit konsiderohet të jetë mutacion i 4 nëntipave të virusit A. Virusi përhapet me rruge aerogjene gjatë kollitjes, teshtitjes si dhe gjatë kontaktit me gjësendet e kontaminuara. Burim i infeksionit është njeriu i sëmurë. Me rëndësi është se infeksioni bartet direkt nga njeriu, por edhe nga kafshët (derrat) apo edhe shpezët e sëmura tek njeriu i shëndoshë. Varësisht nga lloji i virusit që është në qarkullim, sëmundja mund të merr karakter epidemie apo pandemie.

Deri më sot janë regjistruar tri pandemi të mëdha në botë:

- Gripi spanjoll i vitit 1918/19,
- Gripi aziatik i viteve 1957-1958,

[86] Agjensioni i Menaxhimit të Emergjencave/MPB-Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Prishtinë 2016

- Gripi i Hong Kongut i viteve 1968-1969,
- Covid – 19 (SARS-CoV-2)

Duke u bazuar në përvojën historike dhe karakteristikat biologjike të virusit të gripit, një pandemi tjetër globale është e pa evitueshme. Andaj përgatitja dhe përgjigja epidemiologjike mundëson parandalimin e valës goditëse apo së paku shtyrjen e shpërthimit masiv të pandemisë. Pasojat pas shpërthimit pandemik do të ndihen si në aspektin human, ashtu edhe në atë ekonomik.

Në fillim të qershorit kur janë regjistruar rastet e infeksionit me virusin H1N1 në shumë vende të botës, OBSH ka shpallur pandeminë e Gripit të ri duke theksuar se tani më virusi është i rrezikshëm.

Rasti i parë i konfirmuar i Gripit të ri H1N1 në Kosovë është regjistruar në korrik të vitit 2009. Nga korriku i vitit 2009 gjer më 15 nëntor 2009, janë regjistruar 39 raste të konfirmuara të gripit (janë përfshirë edhe 3 rastet nga vendet e banuara me popullatë serbe).

Faktorët e përkeqësimit

Duke marrë parasysh se infeksioni mund të merr përmasa pandemie (përfshin shumë shtete) faktorë i përkeqësimit është grumbullimi në vende publike dhe lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin dhe kontrolli jo i rregullt veterinar i fermave ekzistuese

Karakterizimi i flukseve

Numri më i madh i rasteve pritet të jetë gjatë fundit të vjeshtës dhe gjatë dimrit edhe pse nga paraqitja e rastit të parë e gjer më tani, sëmundja është paraqitur edhe gjatë muajve të verës.

SËMUNDJET BIO-TERRORISTE

Ethet hemoragjike – Krime Kongo

Prej vitit 2015 e deri në vitin 2024 në komunën e Gjakovës ështo regjistruar vetëm 1 rast i konfirmuar i Etheve Hemorragjike - Krime Kongo, gjë që dëshmon se kjo sëmundje në dekadën e fundit është shumë më e rrallë.

EHKK është sëmundje ngjitëse virale që karakterizohet me sindrome të theksuar hemorragjike (gjakderdhje), shfaqet në vatra natyrore, pas pickimit të këpushave (rriqrave) gjatë sezonës pranverë-vjeshtë.

Ethet Hemorragjike – Krime Kongo, është sëmundje e rëndë ngjitëse e shkaktuar nga virusi me të njëjtin emër. Sëmundja radhitet ndër sëmundjet ngjitëse më vrastare të kohës pas Eboles dhe së fundmi të Covid-19. Sëmundja përhapet me rriqra të familjes Hyaloma (e njohur me emrin Hyaloma Marginatum), si dhe me gjakun e personave të prekur nga kjo sëmundje. Një karakteristikë e këtyre rriqrave është se pickojnë pa dhembje, e durojnë urinë me muaj deri në tre vite dhe e bartin infeksionin në mënyrë transovariale (prej gjenerate në gjeneratë). EHKK është karakteristike për vendet me klime të butë, blegtori të zhvilluar, vise me shkurre që në tërësi i përgjigjet Kosovës Qendrore, duke përfshirë komunat e: Malishevës, Rahovecit, Therandës, Klinës, Drenasit, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Skenderajt.

Faktorët e përkeqësimit

Nuk ka dilemë se Krime Kongo është problem madhor i shëndetësisë kosovare e sidomos i shëndetësisë publike. Prej vitit 1989 kjo sëmundje fatale regjistrohet në mënyrë sporadike në pjesët e Kosovës Qendrore dhe Jug – Perëndimore, ku

përfshihet një pjesë e territorit të komunës, kryesisht regjioni i Hasit dhe vendbanimeve përgjatë brigjeve të lumit "Drini i Bardhë".

Periudha e rrezikut

Sëmundja karakterizohet me paraqitje sezonale, zakonisht gjatë muajve të pranverës dhe verës. Numri më i lartë i rasteve të sëmundjes zakonisht lajmërohet prej qershorit deri në shtator, kur dendësia dhe aktiviteti biologjik i rriqrave është jashtëzakonisht i shprehur. Rastet e sëmundjes fillojnë të paraqiten që nga muaji maj.

Bruceloza

Bruceloza është sëmundje ngjitëse sistemike që shkaktohet nga bakteria e gjinisë Brucella. Sëmundja karakterizohet me rrjedhe akute apo të fshehtë, temperaturë intermitente me kohëzgjatje të ndryshme. Kjo sëmundja është zoonoze, e cila kryesisht haset tek kafshët shtëpiake (dhitë, gjedhet, delet, derrat dhe kuajt). Sëmundja konsiderohet jo kontagjioze pasi nuk mund të bartet nga njeriu në njeri, por bartet nga kafsha e sëmurë në njeri. Të dhënat shkencore për këtë sëmundje datojnë që nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Sëmundja për herë të parë është përshkruar me 1800 në ishullin Malte. Sëmundja është e përhapur në tërë botën. Shkalla e përhapjes është në lidhje të drejtpërdrejt me zhvillimin e blegtorisë dhe aplikimin e masave parandaluese. Situata epizotike dhe epidemike përkeqësohet dukshëm gjatë viteve '90. Në Kosovë, Në periudhën e pasluftës rast rast me përmasa më të mëdha me bruceloz është regjistruar në fshatën Rogovë ku janë groposur mbi 50 dele dhe 5 gjedhe, dhe disa raste të rralla sporadike për lajmëruara nga fermeret dhe trajtuar nga organet kompetente.

Faktorët e përkeqësimit

Faktori i përkeqësimit është kontrolli jo i rregullt veterinar i fermave ekzistuese, si dhe amvisërive që mbajnë këto shtazë shtëpiake. Shitblerja e pakontrolluar e shtazëve, mishit, qumështit dhe produkteve të tyre, si dhe përpunimi joadekuat i këtyre prodhimeve.

Karakterizimi i flukseve

Sëmundja ka karakter sezonal edhe pse regjistrohet gjatë tërë vitit.

Tularemia

Duke marrë parasysh se sëmundja ka karakter endemik në Kosovë rreziku i paraqitjes së sëmundjes është permanent, sidomos kur dihet fakti se shumë lehtë mund të përdoret për qëllime bio terroriste.

Tularemia është sëmundje kryesisht e kafshëve, posaçërisht e brejtësve. Në kushte natyrore sëmundja shfaqet te më shumë se njëzet lloje kafshësh të egra dhe shtëpiake. Sëmundja bartet në njerëz përmes ujit/ushqimit të kontaminuar, ajrit të ndotur dhe me rriqra. Sëmundja prek të gjitha grup-moshat. Për herë të parë sëmundja është përshkruar në vitin 1653 në Norvegji. Tularemia nuk ka qenë asnjëherë e pranishme në Kosovë më herët, qoftë me tablo klinike të qartë apo në formë atipike. Rastet e para të sëmundjes në Kosovë janë paraqitur në Rajonin e Gjakovës, fshatin Brovinë në vitin 2000. Përderisa, sëmundja në fillim kishte shtrirje në Rrafshin e Dukagjinit, në vitet pasuese ishte përfshirë Rrafshi i Kosovës. Kështu sot tularemia ka përfshirë gjithë territorin e Kosovës[38].

Gjerë më tani në Kosovë janë lajmëruar dy valë të epidemisë ajo e vitit 1999-2000 me 245 raste dhe ajo e vitit 2000-2001 me 338 raste. Në vitet pasuese rastet e sëmundjes ishin sporadike, por megjithatë konsiderohet si numër i lartë, 784 raste me shkallë mesatare të smundshmërisë 6.7 të sëmurë në 100 000 banorë. Në fund të vitit 2014 janë shtuar rastet e

tularemisë,(të raportuara 105 raste me shkallë të sëmundshmërisë 5.8 në 100 000 banorë). Si zonë endemike me këtë sëmundje, ka pasur raste sporadike në mes dy valëve të epidemisë.

Karakterizimi I flukseve

Sëmundja ka kryesisht karakter sezonal. Më tepër lajmërohet në vjeshtë, dimër dhe fillimin e pranverës, por, nuk përjashtohet mundësia e paraqitjes së rasteve gjatë tërë vitit.

Harta 40. Zonat e rrezikuara me EHKK (Krime-Kongo)



Harta 41 Zonat e rrezikuara me Bruceloz dhe Tularemi

Tabela 73. Epidemitë e regjistruara (periudha 10 vjeçare 2015-2024)[87]

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L
2		VITI										
3	Sëmundjet ngjitëse	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Totali
4	Syndroma Meningjeale	9	3	3	4	3	0	3	9	10	8	52
5	Syndroma Dizenterike	2	9	3	0	0	0	0	0	0	0	14
6	Intoxicatio Alimentaris	218	226	185	169	99	0	0	14	23	24	958
7	Hepatiti akut A	10	10	15	7	1	2	0	1	0	1	47
8	Hepatiti akut B	7	8	1	6	1	0	0	0	5	3	31
9	Hepatiti akut C	6	3	0	0	1	0	0	0	0	0	10
10	Hepatiti fulminant	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
11	Salmonelosis	3	28	2	1	5	0	0	2	0	1	42
12	Gastroenterocolitis Acuta	0	0	0	0	8	25	0	10	13	35	91
13	Diarrea akute	2912	3384	3662	3215	2327	340	26	1798	1874	1793	21331
14	Rotavirus	0	0	0	0	0	0	0	16	0	6	22
15	Adenovirus	0	0		0	0	0	0	0	0	2	2
16	Shigeloza	0	0	0	0	3	0	0	0	1	0	4
17	E.Coli patogjene	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
18	Tifo abdominale	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
19	Parotiti epidemik	23	8	15	0	0	0	0	0	0	0	46
20	Morbilli	0	0	4	18	0	0	0	0	0	0	22
21	Lymphadenitis acuta	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	2
22	Leptospirosis	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0	3
23	Borreliosis	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
24	Toxoplasmoza	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
25	Parazitozat	0	0	0	0	23	10	0	10	4	0	47
26	Sëmundjet tjera ngjites	130	96	72	40	64	8	0	7	30	57	504
27	ARI	912	556	317	474	308	429	56	176	141	235	3604
28	SARI	3	14	0	2	1	0	0	0	6	0	26
29	ILI	1069	2251	896	1682	1517	440	258	670	1480	1898	12161
30	AH3N2	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	3
31	AH1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1
32	Influenca A e papërcaktuar	0	0	0	4	12	0	2	1	3	2	24
33	Influenca B	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1
34	RSV	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
35	Covid-19	0	0	0	0	0	2116	5964	5263	125	141	13609
36	Variqella	169	292	236	273	305	1	29	128	143	108	1684
37	Pertusis	0	1	5	1	0	0	0	0	0	2	9
38	Ethet Ekzantematike	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
39	Malarie	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
40	Status post ictus ixodes	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
41	EHKK	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
42	EHSV	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	2
43	Ethet Q	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1
44	IST	0	0	8	51	35	44	0	4	1	2	145
45	HIV	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
46	TB	0	0	0	0	0	0	0	0	16	29	45
47	Status post morsum vulnus viperi	0	3	1	0	0	0	0	0	0	0	4
48	Totali	5475	6900	5427	5950	4716	3416	6338	8112	3876	4349	54559

2015-2024 | Sëmundjet ngjitëse-Gjakovë

[87] Instituti Rajonal i Shëndetit Publik, Gjakovë 2025

Profili i rrezikut	
Rreziku: Rreziqet epidemiologjike.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Kritike: 25 deri 50%.	
Shpeshtësia e ndodhjes: Shumë e mundshme:	**Modeli sezonal:** Verë /dimër.
Zonat që mund të goditen më së shumti: Tërë territori.	
Kohëzgjatja e mundshme: Permanente. **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (afatet e mundshme të kohës së paralajmërimit):** Më shumë se 24 orë. **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:** Nuk ka.	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po ☐ Jo ☐	

Cënueshmëria nga goditjet në factorët kyq të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje / helmime masive (për shkak të kontaminimit të ujërave, tokës dhe ambientit).	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private (shpenzime të mëdha në parandalimin e përhapjes së epidemive).	E ashpër
Infrastruktura vitale	Kontaminim i rrjetit të ujësjellësit, të puseve, burimeve tjera.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Kontaminim i ujërave (në ndërtesa të administratës, banka, zyra, objekte shkollore, objekte qeveritare, dyqane, qendra tregtare, restorante, etj).	E ashpër
Dëmet ekonomike	Kontaminim i infrastrukturës vitale, pasurisë, infrastrukturës teknike, etj.	E ashpër
Ambienti	Degradim i mjedisit (për shkak të kontaminimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore).	E ashpër
Trashëgimia kulturore		E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtim/kontaminim i mjeteve dhe pajisjeve të njësive reaguese emergjente.	E mesme

6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë;

Kur kemi pandemi dhe situatë epidemiologjike, pasojat mund të jenë shumëdimensionale dhe ndikojnë në shëndetin publik, ekonomi, shoqëri dhe më gjerë. Ja disa nga pasojat kryesore:

Pasojat e pandemisë dhe situatës epidemiologjike:

1. **Shëndeti publik:**
   - Rritje e numrit të të sëmurëve dhe të vdekurve.
   - Mbingarkesë e sistemit shëndetësor (spitalet dhe mjekët nuk mund të përballojnë të gjithë pacientët).
   - Rënia e aksesit në shërbime të tjera shëndetësore për shkak të përqendrimit në sëmundjen në fjalë.
   - Rritje e problemeve psikologjike dhe stresi te popullsia.
2. **Ekonomia:**
   - Mbyllja e bizneseve, veçanërisht atyre të vogla dhe sektorëve të turizmit, transportit dhe shitjes me pakicë.
   - Humbje të vendeve të punës dhe rritje të papunësisë.
   - Ulje të prodhimit ekonomik dhe të ardhurave për shtetin.
   - Rritje të borxhit publik për shkak të shpenzimeve të mëdha për menaxhimin e krizës.
3. **Shoqëria:**
   - Ndryshime në mënyrën e jetesës dhe punës (mësimi online, puna nga shtëpia).
   - Rritje të pabarazive sociale dhe ekonomike.
   - Ndikim negativ në edukimin e fëmijëve dhe rinisë.
   - Ndërprerje të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale.
   -
4. **Psikologjia dhe mentaliteti:**
   - Frikë, ankth dhe stres te individët.
   - Rritje e rasteve të depresionit dhe çrregullimeve të tjera mendore.
   - Ndjenja izolimi dhe vetmie.
5. **Politika dhe qeverisja:**
   - Rritje e tensioneve politike për shkak të mënyrës së menaxhimit të krizës.
   - Kufizime të të drejtave civile (p.sh. lëvizja, tubimet).

Në përgjithësi, pandemia dhe situata epidemiologjike sjellin sfida të mëdha që kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar, politika të qëndrueshme dhe ndërgjegjësim të lartë për të minimizuar pasojat.

6.13.6. Vlerësimet e bazuara dhe analizat e shërbimeve kompetente

Vlerësimet e bazuara dhe analizat e shërbimeve kompetente në fushën e shëndetit publik dhe menaxhimit të pandemive/epidemitë janë procese që përdoren për të kuptuar situatën epidemiologjike, për të marrë vendime të informuara dhe për të planifikuar ndërhyrje efektive.

- **Vlerësimet e bazuara dhe analizat e shërbimeve kompetente -** janë analiza që bazohen në të dhëna shkencore dhe statistika të sakta për të kuptuar gjendjen e një situate epidemiologjike;
- **Analizat e shërbimeve kompetente** kryhen nga institucione të specializuara si Instituti i Shëndetit Publik, OBSH, qendra të kontrollit dhe parandalimit të sëmundjeve, që kanë ekspertizën për të interpretuar të dhënat epidemiologjike dhe për të rekomanduar masat parandaluese.

Qëllimet kryesore te këtyre analizave jane:

1**. Monitorimi i përhapjes së sëmundjes** – Kuptimi i numrit të rasteve, zonave të prekura dhe shpejtësisë së përhapjes;

2. **Vlerësimi i rrezikut** – Sa serioze është situata dhe kush janë grupet më të rrezikuara;
3. **Identifikimi i burimeve të infektimit** – Ku dhe si po përhapet sëmundja;
4. **Ndikimi në shëndetin publik dhe sistemin shëndetësor** – Sa burime duhen mobilizuar dhe si do të ndikojë në spitalet dhe stafin mjekësor;
5. **Efektiviteti i masave parandaluese** – Si po funksionojnë distancimi, maskat, vaksinat etj.;
6. **Parashikimi i zhvillimit të situatës** – Modelimi i skenarëve të mundshëm për të planifikuar reagimin.

6.13.7. Bartësitë dhe përgjegjësitë e aktiviteteve dhe masat parandaluese

Cdo aktor ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në parandalimin dhe menaxhimin e pandemive dhe epidemive, dhe bashkëpunimi midis tyre është kyç për suksesin e përgjithshëm.

Bartësit kryesorë dhe përgjegjësitë e tyre janë :

1. Autoritetet shëndetësore kombëtare (Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik);
2. Shërbimet shëndetësore (spitale, klinika, qendra shëndetësore);
3. Qeveria dhe autoritet locale;
4. Mediat dhe Ojq e ndryshme etj

Masat parandaluese kryesore:

- **Higjiena personale**: Larja e duarve, përdorimi i dezinfektantëve, mbajtja e pastërtisë,
- **Përdorimi i maskave mbrojtëse**: Sidomos në ambiente të mbyllura dhe në grumbullime,
- **Distancimi fizik/social**: Mbajtja e një distance të sigurt midis individëve,
- **Testimi dhe gjurmimi i kontakteve**: Identifikimi dhe izolimi i rasteve për të ndalur përhapjen,
- **Karantina dhe izolimi**: Për ata që janë të infektuar ose kanë pasur kontakt me persona të sëmurë,
- **Vaksinimi**: Si masë kryesore për parandalimin e sëmundjeve infektive,
- **Fushata informuese**: Edukimi i popullsisë për rëndësinë e masave dhe simptomat e sëmundjes.

K r e u VII

7. FATKEQËSITË TJERA



7.1. VLERËIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË TJERA

7.1.1. Vendi, lloji dhe madhësia e objekteve për deponoimin, përdorimin dhe prodhimin e materieve të rrezikshme

Komuna e Gjakovës ka në territorin e saj ka të identifikuara disa "deponi" me materie të rrezikshme kimike-industriale me sasinë e deponuar që tejkalojnë 5 ton për deponi. Lokacionet ku ndodhen këto mbeturina përfshijnë[88]:

- New Co Jatex (ish Ndërmarrja JATEX), mbeturina me origjinë nga prodhimi i tekstilit,
- New Co Miniera Devë, mbeturina me origjinë minerare,
- Metaliku, mbeturina me origjinë nga procesimi i metaleve, dhe
- New Co Emin Duraku -Devolli, mbeturina me origjinë nga procesimi i tekstilit.

Përkundër faktit se Ligji mbi Mbeturinat dhe Udhëzimi Administrativ përkatës për Kompetencat e Zotëruesit të Mbeturinave, precizon obligimet e akterëve mbi menaxhimin e mbeturinave industriale dhe kimike, megjithatë këto vend-deponi të mbeturinave në mënyrën si trajtohen paraqesin rrezik për mjedisin përreth dhe shëndetin publik. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2012-2021, në kaptinën investive të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, përfshinë ndër projektet me prioritet për pastrimin e mbeturinave nga procesimi i tekstilit të ish kombinatit Emin Duraku dhe ndërmarrjen JATEX (Plani lokal i menaxhimit të mbeturinave).

Në komunën e Gjakovës nuk ka objekte në të cilat bëhet prodhimi i materieve të rrezikshme.

7.1.2. Numri, lloji dhe cënueshmëria e trafikut rrugor, hekurudhor e ajror

Aksidentet e mjeteve dhe automjeteve që transportojnë materie të rrezikshme kanë si efekt primar të menjëhershëm dhe që vërehet lehtë (zjarrin, eksplodimin, derdhjen) dhe efektet sekondare (përhapjen ajrore të avujve toksik ndotjen e ujërave dhe të tokës).

Në transportin rrugor të materieve të rrezikshme dallojmë dy llojetë aksidenteve:

- Aksidente të llojit "C" - janë aksidente gjatë të cilave materiet e rrezikshme mbesin neutrale,

[88] Deponimi i Materieve të Rrezikshme- PZHK Gjakovë 2022-2030

- Aksidente të llojit "M" - janë aksidente të cilat karakterizohen me ndryshime të pa riparueshme të materies së rrezikshme, me plehërimin e materies ose të humbjes së ngarkesës, apo edhe me eksplodimin ose ndezjen e materies së rrezikshme.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Zhvillim Ekonnomik në teritorin e komunës së Gjakovës operojnë 33 pika të karburanteve ose 1 pikë karburanti për 800 automjete (nga gjithsejtë 25,800). Transportimi i materieve të rrezikshme zhvillohet kryesisht nëpër rrugët magjistrale dhe rajonale që gravitojnë në komunën tonë.
Cënueshmërua dhe burim permanent i rrezikut në trafikun rrugor janë kamionët cisternë dhe kamionët e rrafshët, si dhe të gjithë kontejnerët transportues.

Faktorët e përkeqësimit në transportim rrugor të materieve të rrezikshme janë:
Toksiciteti – prodhimi i shkendijave në cisternat e gazit që digjet, avujt të komprimuar në fuqi (bure), apo të përzierjes së disa produkteve si rezultat i ndezjes së papritur të shkëndijave ose të municioneve;
Zjarri – i cili mund të shkaktohet nga ngrohja jonormale e një pjese të automjetit, goditjes fizike dhe prodhim shkëndijave zjarri, ndezja aksidentale e materies së rrezikshme që rrjedhë, eksplodim në afërsi të afërsi të automjetit, etj;
Eksplodimi – si pasoj e një rrjedhe të produktit toksik apo si rezultat i djegjes dhe I përhapjes në një distance përtej vendit të incidentit; dhe
Ndotja e ujit dhe tokës – rrjedhja e materies së transportuar, me ç'rast uji është jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe ai e përshpejton përhapjen e ndotjes në distance të mëdha.

Shkaqet:
- Menaxhimi jo i duhur i materieve të rrezikshme,
- Deponimi joadekuat e materieve të rrezikshme,
- Mungesa e mbikqyrjes dhe kontrollit,
- Përdorimi i papërgjegjeshëm i substancave të rrezikshme.

Pasojat:
- Në njerëz (vdekje, lëndime, djegje, helmime, etj),
- Dëme në të mirat materiale,
- Dëme në infrastrukturën vitale,
- Ndotja e ambientit (tokës, ujit, ajrit),
- Ndikimi në florë e faun.

Profili i rrezikut	
Rreziku: Transporti i materieve të rrezikshme.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Kritike.	
Shpeshtësia e ndodhjes: ▪ Shumë e mundshme.	**Modeli sezonal:** Gjatë transportit në stinët me të reshura, zjarreve urbane, tërmeteve, trazirave civile, demonstratave, etj.

Zonat që mund të goditen më së shumti: Rrjeti transportues dhe vendbanimet në afërsi.
Kohëzgjatja e mundshme: 3-6 orë. **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (afatet e mundshme të kohës së paralajmërimit):** Paralajmërim minimal (apo fare). **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:** Numri i integruar 112.
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po x Jo ☐

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/lëndime(djegie, helmime, për shkak të ndeshjeve, rrokullisjeve, kontaminimit dhe zjarreve) që rezultojnë në paaftësi.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit: rrugor , ujësjellësit, kanalizimit energjisë telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim i ndërtesave të administratës, objekteve shkollore, qendrave tregtare, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i mjeteve të transportit dhe infrastrukturës rrgore	E ashpër
Ambienti	Shkatërrim/degradim i mjedisit (për shkak të derdhjeve të karburanteve të ndryshme, tymit nga zjarret, kontaminimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me materie të rrezikshme).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Dëmtim i vogël i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

7.1.3.. Llojet e materieve të rrezikshme

Materiet e rrezikshme janë substanca që për nga përbërja fizike - kimike ose për nga natyra e reaksioneve mund të paraqesin rrezik për njeriun, të mirat materiale ose ambientin. Ato mund të jetë materie që digjen, toksike, eksplozive, gërryese (korrozive) ose radioaktive. Për shkak të karakteristikave ose kushteve të tyre gjatë transportimit për disa materie , bartja e është e ndaluar nga ADR[89], ose lejohen të transportohen në kushte të posaçme: paketime, kontejner ose automjetete të standardizuara të licencuara.

Ekzistojnë 9 lloje të materieve të rrezikshme që quhen ADR klas:

1. Substancat dhe artikujt Eksplozive;
2. Gazrat;
3. Likuidet ndezëse;
4. Materiet tjera të ngrurta ndezëse F+, shumë ndezëse dhe toksike;
5. Substancat oksiduese dhe peroksidet organike;
6. Matreiet toksike dhe infektuese +TI, ndezëse dhe rrezik për ambientin;
7. Substancat radioaktive;
8. Substancat korozive; dhe
9. Substanca të rrezikshme të llojllojshme- materie që lirojnë gazëra toksik, ekotoksik, që dëmtojnë materialet tjera (materiale të magnetizuara, azbesti, oksidi i karbonit IV, ditinati i zinkut etj.)

Piktogramet ADRP



[89] Marrëveshja Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallërave të Rrezikshme , shtator 1987

7.1.4. Distanca nga zonat e banuara

Edhe pse shumica e subjekteve te cilat mirren me kete veprimtari, nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri dhe eksplodimet kanë të plotësuar kriteret e parapara mbrojtëse-teknike dhe të trajnimit profesional të personelit ,përkundër kësaj, disa prej tyre e veçanërisht ato të ngritura në disa lokacione të qytetit janë objekte që prezantojnë rrezikshmëri të lartë meqenëse dendësia e banorëve dhe objekteve individuale dhe kolektive janë në perimetrin e zonës së rrezikut të lartë.

7.1.5. Përqendrimi i materieve të rrezikshme dhe të dëmshme

Ky lloj rreziku eshte potencijal ne ndermarrjet dhe kompanit te cilet merren me shitjen dhe transportin e derivateve dhe gasit, ose në ndermarrjet qe përdorin këtë energji në procesin e prodhimit. Aktualisht nuk kemi të evidentuar ndërmarrje e cila si lëndë të parë përdor gasin apo materie tjera agresive në procesin teknologjik të prodhimit, gjë që nuk reflekton rrezik në këtë drejtim.

I vetmi objekt ekonomik i cili merret me prodhimin dhe përpunimin e acetilenit dhe propan-butanit ishte "Deva-Gas" (2x100 m³) në periferi të qytetit (Zidi i S.Agës) i ndërtuar sipas standardeve të kërkuara dhe si i till në rast të ndojnë avarie apo eksplodimi eventual nuk rrezikon banorët dhe infrastrukturën, si dhe depozitat e Sh.a.Metaliku (6x150 m³) të ndërtuara në vitet e '80-ta. Mirëpo, pas procesit të Privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore knë këto dy lokacione nuk është duke aktivitetet afarist në fushën e prodhimit dhe depozimit të materieve të rrezikshme agresive.

Harta 42. Pompat në zonën urbane



Harta 43. Pompat në pjesën rurale

7.1.6. Lloji i materieve të rrezikshme/dëmshme në qarkullim

Të gjitha mjetet transportuese të materieve të rrezikshme të cilat marrin pjesë në komunikacion paraqesin një rrezik potencial. Rreziku mund të jetë edhe më i madhë nëse transportohet mallë i cili mund të jetë materie kimike, eksploziv ose ndonjë gazë helmues.

Aksidentet të cilat ndohin gjatë transportit janë të pa parashikuara dhe për këtë arësye edhe pasojat janë të paparashikuara. Lokacionet më të rrezikuara janë në qendrat industriale dhe afër transportit rrugor. Në këto raste specifike duhet me kujdes të zgjidhen mjete të përshtatshme të pajisura me shenjat specifike të që sinjalizojnë llojin e

transportit me rreikshmër, që garanton sigurinë e transportit rrugor, që edhe nëse me gjasë ndodhë ndonjë avari ose incident pasojat të jenë minimale. Për transportin e substancave të rrezikshme duhet marrë për bazë kompatibilitetin e transportit dhe densitetin e trafikut rrugor dhe sinalistikën përkatëse të transportit.

7.1.7. Rrjedhjet e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë /tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta

Në teritorin e komunës nuk ka shtrierje infrastrukturore nëntokësore dhe mbitokësore/tubacione që përçojnë materie të rrezikshme nëpër lokacione me specifika të veçanta.

7.2. FATKEQËSITË NË INFRASTRUKTURËN E FURNIZIMIT ME UJË

7.2.1.. Rreziku nga shpërthimi i pendave hidroakumuluese

Rrezik real të përmasave më të mëdha për një pjesë të territorit të komunës së Gjakovës paraqet dëmtimi/shpërthimi i pendës hidroakumuluese në liqenin e Radoniqit që operon në kuadër të KRU 'Gjakova".

Liqeni i Radoniqit është një liqe artificial që shtrihet në verilindje të komunës së Gjakovës Radoniqi me 5,96 km², më saktësisht fillon mu në vijën administrative me komunën e Deçanit nga fshati Ratish i rrethuar me fshatrat Palabardh, Novosell, Dobrixhë, Cërmjan dhe Bec, me shtrierje kah juglindja e teritorit të komunës. Është i ndërtuar në një lartësi mbidetare prej 416 m l/md, që mundëson pozitë ideale për grumbullimin e ujit në bazen dhe furnizimin me rënje të lirë në sipërfaqen më të madhe të saj. Ky liqe artificial shtrihet në sipërfaqe prej 612 ha të mbuluar me ujë, me në kapacitet prej 117mil/m³, furnizimi me ujë të pijes të pjesës më të madhe të popullatës së komunës së Gjakovës, Rahovecit dhe një pjese të komunës së Prizrenit, me kapacitet furnizimi për 200.000 banorë dhe sistem për ujitje në sipërfaqe 8.070 ha tokë pjellore, kryesisht me platform të rënjes së lirë, por edhe përmes pompava thithëse në disa zona rurale.

Furnizimi i liqenit me ujë bëhet nga Lumbardhi e Deçanit përmes kanalit derivues në gjatësi prej 9.300 m' dhe zakonisht mbushjet fillojnë nga përfundimi të sezonës verore duke vazhduar deri në muajin maj, kur arrin koutat maximale. Liqeni ka mbushje mesatare prej 450.90 NNm (V=90.792.633 m³/ujë[90]

[90] Burimi: KRU "Gjakova"

Përveç pendës, strukturë tjetër me peshë të madhe për furnizimin e banorëve me ujë të pijes është Stacioni i filtrave me kapacitet prej 1.050 lit ujë/sec. dhe rezervoarëve në lokalitetet: Qerim, Palabardh, Lipovec, Demjan, Dol dhe Kusar .

Tabela 74 Lokaciont dhe kapacitetet e rezervoarëve

	Lokaliteti i rezervuarëve	Numri i rezervuarëve	Kapaciteti m^3	Totali
1	Qerim	2	5.000	10.000
2	Palabardh	1	600	600
3	Lipovec	2	250	500
4	Damjan	2	200	400
5	Dol	1	200	200
6	Kusar	1	150	150
	Gjithsejtë:			**11.850**

7.2.2. Pasojat nga shpërthimi i pendës hidroakumuluese

Penda në liqenin e "Radoniqit", në gjatësi prej L=770m, dhe thellësia 61m', e ndërtuar me forma të kombinuara të: reliefit, beton armesë dhe gurëve të mëdhenj shkëmborë të patretshëm ndaj ujit, të mbështjellur me rrjeta masive metalike, e bënë atë ndër më të sigurtat në vend.

Duke qenë objekt me rendësi vitale, gjatë luftës së vitit 1999, nyjet komunikuese në perimetrin e ngushtë të pendës (në distancë 100-200 m) kan qenë cak i granatimeve të ish UJ ndaj UÇK-së e gjithashtu edhe të forcave të NATO-s ndaj UJ, duke e ç'fytëzuar këtë objekt strategjik si mburoj taktike, pasi që është llogaritur se ky lokacion nuk do të granatohet për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë që ka penda në rast të dëmtimit të saj. Përveç dëmeve kolaterale dëmtime serioze të drejtpërdrejta në bazamenti dhe struktures e digës nuk ka pas.

Ndaj, duke e identifikuar dhe cilësuar si një rrezik të dukshëm dhe real, dëmtimi/shpërthimi i së cilës dë të kishte pasoja katastrofale për një pjesë të teritorit të komunës së Gjakovës dhe Rahovecit në të gjitha aspektet

Dëmtimi/shpërthimi pendës mund të shkaktohet si pasoj e:

1. Tërmetet
2. Veprimeve luftarake;
3. Akteve subverzive-terroriste;

Tabela 75. Përmbytja e vendbanimeve dhe dinamika e valës vërshuese

		Vendbanimi	Distanca nga diga në metra	Koha e arritjes së valës së ujit	Nr.banorëve për evakuim
1		Zhdrellë	1400	1min, 20sek	211
2		Bec	5100	5min, 40 sek	956
3		Vraniq	8000	10min	183
4		Doblibare	12800	16min, 40sek	538
5.		Bordosan	15900	19min,30sec	215
6		Ratkoc (Rahovec)	10000	20min	-
7		Radoste (Rahovec)	16000	32min	-
8		Gexhe (Rahovec)	23800	40min	-
9		Bishtazhin		50min	317
				Gjithsejtë:	**2.420**

Burimi: KRU Radoniqi Elaborati teknik i zones vërshuese" Skema e zonës së përmbytjeve sipas projektit të ndërtimit

Harta 44. Zona e përmbytjes (teritori i përfshirë nga vala vërshuese)[91]



Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili i rrezikut	
Rreziku: Shpërthim i pendës.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Katastrofike	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme.	**Modeli sezonal:** Gjatë tërë vitit.
Zonat që mund të goditen më së shumti: Zdrellë, Bec, Vraniq, Doblibare, Bordosan, Ratkoc,Radoste, Gexhe dhe Bishtazhin	
Kohëzgjatja e Mundshme: Orë/Ditë. **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):** Pa paralajmërim ose paralajmërim minimal. **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:** Nuk ka.	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po ☐ Jo x	

[91] KRU "Gjakova" Elaborati Teknik 1978 – Zona e Përmbytjes

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekjetë shumllojshme,lëndime të rënda, përmbytje masive.	**Katastrofike**
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë private dhe publike.	**Katastrofike**
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtimirrjetitenergjetikdhetelekomunikimit ujësjellësit dhe kanalizimit, infrastruktura rrugore , etj.	**Katastrofike**
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të: shkollave, ambulanyave, depove ushqimore, trafostacioneve, etj.	**Katastrofike**
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i përgjithshëm i zonës së goditur.	**Katastrofike**
Ambienti	Shkatërrim / dëmtim i mjedisit.	**Katastrofike**
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i trashëgimisë kulturore, në objekte dhe arkeologji.	**Katastrofike**
Shërbimet shtetërore	Dëmtim /paralizim i infrastrukturës shtetërore(zyret e vendit)	**Katastrofike**
Shërbimet emergjente	Shkatërrim/ dëmtim i pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	**Katastrofike**

7.2.3. Raporti vlerësues i matjeve dhe gjendjes së trupi të pendës

Përmes Shërbimit gjeodezik të KRU ”Gjakova” matjet gjeomekanike të pendës bëhen rregullisht dy (2) herë në vit. Matja e parë bëhet në muajin Maj kur bazeni është me kapacitet të plotë (456,00 NNm V=117.792.633m^3) të ujit dhe në muajin Shtator kur uji arrin nivelin më të ulët si pasojë e shpenzimit më të madh gjatë muajve të verës.

Gjendja momentale e digës bazuar në matjet gjeodezike dhe gjeomekanike tregon se trupi i pendës është në kufijtë e lejuar sipas projektit dhe deformimet e saj janë në kufijtë e lejuar.
Vet konstrukti i digës së ndërtuar ka përmbajtje të qëndrueshme ndërtimore e cila sipas vlerësimeve të ekspertëve-projektuesve të kësaj dige mund të përballojë lëvizje sizmike të tokës me magnitud.max 6.6° Rihter.

Fluksi i rrezikut
Dallojmë 2 flukse të rrezikut kryesor:

- Shpërthimin i plotë ose i pjesshëm i trupit të pendës,
- Zbrazje e kontrolluar dhe e qëllimshme e ujit nga liqeni

Në situata emergjente të valës vërshuese nga dëmtimi të Digës detyrimisht ndërmerren masa urgjente për zbrazjen e liqenit përmes daljes nga tereni për ujitje sipas diagramit, si vijon:

Grafiku 22. Diagrami kohor i zbrazjes së liqenit[92]



Shënim: Sipas projektit ekzistojnë kotat e shpëtimit për banorët të cilët duhet të evakuohen në rast të rrezikut nga përmbytjet si pasoj e pëlcitjes apo shkatërrimit të pendës. Secili fshat është i njohur me kotat e sigurisë, por problem paraqet sistemi digjital i alarmimit të popullatës me sirena alarmimi përmes senzorëve të shtëpisë sizmike që paralajmëron dhe alarmon në rast të lëvizjeve të digës me potencial serioz dëmtimi. Kompletimi i këtij sistemi deri në pikën më të skajshme të vendbanimeve në perimetrin e valës vërshuese duhet të jetë top prioritet si masë preventive për evakuimin preventiv të banorëve të rrezikuar.

Vendosja / Implementimi i masave të kontrollit:

Monitorimi dhe përmirësimi

Monitorimi dhe përmirësimi i pendave, në këtë rast të pendës së "Radoniqit" , kryesisht ndërlidhet me këto aspekte:

- Ndryshimet në sjelljen e trupit të digës dhe të bazamentit (deformimet, kullimet, erozioni i mbrendshëm, presioni i poreve etj.),
- Ngjarjet seizmike dhe ndryshimet në aktivitetin seizmik pranë digës,
- Lëvizjet e shpateve potencijalisht të paqëndrueshëm (shkarjet e vjetra dhe të reja),
- formacioneve shkëmbore duke paraqitur një kërcënim për digën , shkarkimet eventuale fundore, dhe strukturave hyrëse dhe shkarkuese)

[92] *KRU "Gjakova" Elaborati Teknik 1978- Zbrazja e bazenit*

Regjistrimi i vlerësimeve:
Pjesa më e madhe e pajisjeve origjinale të instaluara të monitorimit të sigurisë janë jashtë funkcionit të sigurisë për shumë vite dhe mbështetur në rrethanat aktuale do të kaloj një kohë e konsiderueshme deri sa të rehabilitohen, deri sa të të instalohen pajisjet e reja. Në këtë kontekst, ngritja e nivelit të sigurisë, nënkupton:

- Instalimin/avancimin e masave e kontrollit dhe monitorimit,
- Mbrojtjen nga rreziku i rënies së shkëmbinjëve rrethë shpateve të digës,
- përmiërsimin dhe garantimin e rrugëve hyrëse rrethë digës, kullës kontrolluese, stacionit të filtrimit dhe galerive të drenazhit,
- rishikimi i hidrologjisë së burimeve të furnizimit të liqenit, dhe
- punimet në pjesën e poshtme në eliminimin e sedimenteve të ngurta etj.

7.3. VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE, RADIOLOGJIKE, KIMIKE, BIOLOGJIKE

Hartimi i Vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë nukleare, radiologjike, kimike dhe biologjike, është në kompetencë ekskluzive të autoriteteve përkatëse të nivelit Qendror. Për faktin se gjatë sulmeve të Aleancës Veri Atlantike së v.1999 teritori i komunës është goditur me arsenal luftarak me uranium të varfëruar duke qenë njëherit zonë tejet e fortifikuar me mjete mino-eksplozive nga forcat serbe, Komisioni ka bërë një vlerësim vetanak në kontekst të zbatimit të obligimeve që nivelit lokal që dalin nga planet dhe programet e nivelit qendror.

7.3.1. Fatkeqësitë nukleare dhe radiologjike

Gjatë 78 ditëve të bombardimeve nga Aleanca Veri Atlantike (NATO) të v.1999, në teritorin e Kosovës janë kryer 112 sulme me uranium të varfëruar nga të cilat disa caqe janë goditur nga dy herë. Janë hudhur gjithsejtë 31.000 predha me nga 271 g., që përmbajnë gjithsejtë 8401 kg. të Uraniumit të Varfëruar, ku koncentrimi më i madhë i tyre ishte në teritorin e komunës së Gjakovës me shtrirje në drejtim të Deçanit dhe Prizrenit, rrethë brezit kufitar (shih hartën) [93]

[93] UNEP- Universiteti i Bristolit - "Programi i OKB për Hulumtime Radiologjike", Kosovë, nëntor/2008

Harta 45 *Teritori i ekspozuar me uranium të varfëruar*

Ekipi i UNEP-it (Programi i Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Ambientit) kishte vizituar gjithsejt 11 fusha në Kosovë, 5 në sektorin Italian dhe 6 në sektorin Gjerman të KFOR-it, ku për teritorin e komunës së Gjakovës dhe Deçanit (komunë fqinje), është me rëndësi të veçohen zonat në përgjegjësi të sektorit Italian:

1. Garnizoni i Gjakovës (garnizon i UJ),
2. Barakat e Irzniqit, (barakat ish AJ Deçan),
3. Bregu i Vranovcit: kodër afër këtij fshati Deçan,
4. Liqeni i Radoniqit: liqe artificial në veri të qytetit të Gjakovës.
5. Bandera/Pozhar: fshat afër bregut të lumit (Deqan).

Misioni 2 javor (5-17 nëntor 2008), i UNEP-it-Universiteti i Bristolit (Angli) kishte për detyrë të përcaktonte nëse përdorimi i Uraniumit të Varfëruar gjatë luftërave në Ballkan mund të kishte sjellë ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Në këto fusha u mblodhën mostra të dheut dhe të ujit. Mostrat e dheut janë nxjerë nga thellësitë dhe lokacionet e ndryshme., uji është marrë nga përrojet lumenjtë dhe puset e fermave. Janë marrë edhe mostra të ndryshme nga bari, drunjtë,frutat,dhe këpurdhat. Janë mbledhur gjithsejt 340 mostra: 247 mostra dheu, 45 mostra uji, 30 mostra të vegjetacionit, 10 teste të ndotjes, 5 mbështjellës, 7 penetratorë, dhe 1 fragment (pjesë penetratori).

Në Raportin Final të Universitetit të Bristolit është konstatuar se pjesa më e madhe e mostrave të dheut kishin uranium të koncetruar brenda koncetrimit normal të ambientit. (1-300 mg/kg). Izotopet e analizuara të uraniumit, tregojnë se uraniumi i varfëruar përmban: 0.2 % të Uraniumit 235. Uraniumi i varfëruar gjithashtu ka gjurmë të koncetrimit U236 dhe të plutoniumt 239PU dhe 240PU dhe ka indikacione se ky metal është prodhuar nga karburantet nukleare. Ky koncetrim, nganjëherë është më i ultë se 236U dhe plutoniumi, dhe vijon të jetë më shumë se 1% në kufi me radioaktivitetin e metalit 0.2% 235U.

Meqenëse është konkluduar se ne teritorin e komunës dhe rreth tij ka radioaktivitet,por pa përcaktim të shkallës së ndotjes,…..nisur nga shqetësimet e ngritura nga qytetarët dhe institucionet komunale është kërkuar nga Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamor për matjen e nivelit. Nga matjet e dozimetrike te ish-kazerma (afër Kishës Katolike) me datë 03.12.2015 ka rezultuar se dozat e e matuna radioaktive janë në nivel natyror. Poashtu edhe analizat e mostrave të ujit të mara nga Liqeni i Radoniqit kanë qenë kanë rezultuar në parametra të lejuar në aspektin radiologjik.
Agjensioni për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB) është konfirmuar se ka marr përsipër që në bashkëpunim me Institutin për Radioelemente (IRE) në Bruksel të bëjë analizat detale të dheut dhe të ujit në aspektin radiologjik.

7.3.2. Fatkeqësitë nga mjetet mino-eksplozive

Pozita gjeografike e Komunës së Gjakovës dhe përkufizimi i saj hapësinor me Republilkën e Shqipërisë ka ndikuar që brezi kufitar në veri dhe jugëpërendim të vendit, të jetë teritori më i fortifikuar në kuptimin e zhvillimit të operacioneve luftarake të nivelit taktik dhe operativ në luftën së fundit të v. 1999. Për shkak të minimit dhe pranisë së madhe të mjeteve të pashpërthyera mino-eksplizve, deminimi i teritorit ka qenë ndër prioritetet më kryesore për shkak të nivelit të lartë të rrezikut për jetën. Me përfundimin e luftës, shumë organizata si “Hendikep”, “Hallo Trust”, “Hendikos”,”DCA”,”ELS” etj, si dhe njësitë e specilaizuara të FSK-së kanë marrë pjesë deminimin e zonave të minuara dhe deaktivizimin e mjeteve të pashpërthyera mino-eksplozive, si: mina kundërkëmbsorike, antitank, bomba kaset etj.

Harta 46 e lokacioneve të të konfirmuara të pastruara nga minat[94]



Me publikimin e Planit Strategjik të Deminimit 2019-2024 të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Qendrën e Deminimit në Gjenevë është parashikuar që të largohen të gjitha minat nga teritori i Kosovës[95].

Kjo nënkupton që në teritorin e Komunës së Gjakovës ka gjasa që prania e mjeteve të pashpërthyera mino-eksplozive, të

[94] NATO/KFOR UNCLASSIFIED- KOSOVO MINES MAP/ DAKOVICA, UTM GRID Zone 34T WGS 84 sl.18,19

[95] Kompania e Deminimit e Regjimentit të MC(RMC) e FSK-së- nëntor 2011

vendosura nga forcat serbe, apo nga predhat e paeksploduara të hedhura nga forcat e NATO-s në vitin 1999**.**

Sipas evidences nga mjete e pashpërthyera mino-eksplozive kanë humbur jetën 9 veta ndërsa 28 kanë pësuar lendime me shkallë të lartë të paaftësisë (në kodrën e Çabratit në qytet, kan humbur jetën 2 persona dhe 4 janë pësuar lëndime që kanë shkaktuar paaftësi fizike[96]. Ky numër me gjsë mund të jet edhe më i madhë, kur kemi parasysh kalimet ilegale të kufirit, me c'rastë shumë shtetas të Shqiperisë kanë humbur jetën ose seriozisht janë lënduar, e për të cilët nuk disponohen me të dhëna të sakta. si: kundër-këmbesorike të të gjitha llojeve , mina antitank, bomba kasetë etj., ku prej përfundimit të luftës e gjërë më tani

Është evidente se dekada e fundit shënon rënie substanciale krahasuar me periudhën pas përfundimit të luftës së vitit 1999, të cilat aktivitete janë përputhje me uljen e shkallës së rrezikshmërisë në teritoret e prezentuara në hartë. Kjo argumentohet me faktin se nga 6 kompani të specijalizuara ndërkombëtare për deminim, me çështje të deminimit merren vetëm ekipet e specializuara të FSK conform planifikimeve operative në këtë drejtim,

7.4. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORIZMI

Hartohet në bazë të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, dokumenteve publike që i harton Ministria e Punëve të Brendshme apo Ministria e Mbrojtjes, bazuar në strukturën e përcaktuar, madhësinë dhe veprimet e forcave operative për veprim në fatkeqësi.

1. ***Implikimet e konflikteve të dhunshme dhe ndërlidhja me fatkeqësitë natyrore***

Konfliktet e dhunshme akoma më tepër përkeqësojnë fenomenet ekstreme natyrore, duke qenë në interaksion me rreziqet natyrore në forma të ndryshme:

- Ato shpesh paraqesin burim të ndjeshmërisë shoqërore,
- Zhvendosja e një numri të madhë të qytetarëve gjatë konflikteve të dhunshjme e të armatosura mund të sjell deri te rreziqet e reja (ekspozimi ndaj sëmundjeve të ndryshme dhe rreziqeve tjera të panjohura në pjesët rurale dhe urbane),
- Komunitetet të cilat janë të cënueshme nga fatkeqësit natyrore, gjatë konflikteve të dhunshme janë më të ndieshme edhe nga keqtrajtimet e ndryshme (lëndime, vdekje, dhunim dhe detyrime tjera),
- Konfliktet e dhunshme mund të pengojnë ose pamundësojnë ofrimin e ndihmës dhe rehabilitimin e zonave të goditura nga fatkeqësia. Krahas kësaj, këto konflikte ndikojnë në ridrejtimin e resurseve njerëzore dhe materiale të cilat do mund të ç'frytëzoheshin për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore,
- Gjatë konflikteve jo rrallë shkatërrohet infrastruktura kritike që mund të të nxitë ose të intensifikoj fatkeqësi natyrore (energjetika, sistemet e paralajmërimit për rrezikun nga fatkqësit natyrore dhe evakuimin e banorëve, sistemet e furnizimit me ujë, kanalet e ujitjitjes e shumë pasoja të tjera,
- Zbatimi i njohurive ekzistuese për minimizimin e rrezikut të shkaktuara nga dukuritë natyrore, gjatë konflikteve të dhunshme është pothuajse i pamundshëm.

[96] Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale- Sektori i viktimave, invalidëve të luftës dhe personave të pagjetur, Gjakovë 2012

- Disa strategji dhe politika të zhvillimit ekonomik mund të sjellin deri te ndjeshmëria e komunitetit ndaj dukurive ekstreme natyrore, dhe në mënyrë simultane mund të nxisin trazira sociale të intezitetit të ndryshëm.

2. *Veprimet kornizë të cilat duhet të ndërmerr komuna në situate të tilla*:

- Aktivizimi i mekanizmave të emergjencave civile në zvogëlimin e pasojave dhe rehabilitimin e gjendjes pas efektit të veprimeve luftarake dhe të terrorizimit;
- Ndërhyrjen e menjëhershme përmes ekipeve të kërkim-shpëtimit, ose zbatimi i masave për evakuimin me urgjencë e banorëve nga zonat e kërcnuara nga veprimet luftarake apo akteve terroriste.
- Masat dhe veprimet për shmangjen e kaosit në trafik dhe rendin publik;
- Mbrojtja e shëndetit publik dhe menaxhimi i shërbimeve esenciale në kushte të gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme ose të akteve terroriste;
- Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara dhe marrja e masave për rehabilitimin e gjendjes sipas prioritetve të përcaktuara me Plan.

7.5. VLERËSIMI PËR PASOJAT NË INFRASTRUKTURËN KRITIKE

Infrastruktura kritike është pronë e publike e njësive lokale dhe regjionale, personave juridik të cilët janë themelues të njësive lokale apo regjionale të qeverisjes, si dhe pronë private.

Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike që nënkupton emrin e përbashkët për rrjetin dhe sistemet vendimtare për funksionimin e jetës së popullsisë, në raste të dëmtimit apo shkatërrimit të saj, mund të ketë pasoja në lëkundje dhe kriza, mund të ketë pasoja për tërë territorin e komunës, regjione të caktuara ose për komunitetin. Në mes kësaj infrastrukture të larmishme ekziston një lidhje dhe ndërvarësi e ndërsjellë, kështu që problemet në një segment të caktuar në një pjese të kësaj infrastrukture ose në rrjetë, shumë lehtë mund të përhapen në sistemet dhe rrjetet tjera duke sjellë deri te ndërprerja e veprimtarive ose probleme, kështu në mënyrë të kombinuar do të shkaktojnë humbjen e jetërave dhe pasoja afatgjata në sistemin e qeverisjes, ekonomi, shëndetin publik, sigurinë publike, besimin e publikut, si dhe pasoja tjera për shoqërinë ose komunitetin.

Kjo infrastrukturë përfshin:

- Kapacitetet dhe infrastrukturën energjetike,
- Transporti dhe infratsruktura rrugore,
- Komunikimi dhe teknologjia informative - (telekomunikimin, mediat elektronike, softuerët, harduerët, sidomos internetin,
- Financat - (bankat, sigurimet dhe investimet),
- Objektet shëndetësore - (spitalet, ambulantat, transfuzioni i gjakut, laboratorët dhe farmacitë etj),
- Ushqimi - (prodhimin, shpërndarjen dhe industrin ushqimore),
- Uji – (diga, baseni, kanali derivues, përpunimi i ujit dhe rrjeti i distribuimit),
- Prodhimi, deponimi dhe transporti i materieve të rrezikshme,
- Administrata- (objektet, rrjetet informative, shërbimet kritike publike dhe resurset qenësore për komunitetin).

Gjatë vlerësimit të rrezikut nga ndonjë kërcënim në një vend të caktuar, duhet të kihet parasysh rrezikshmëria për infrastrukturën kritike, në mënyrë që të vlerësohet mundësia dhe aftësia e sigurimit të gjërave të nevojshme dhe shërbimet për sanimin e pasojave, mbrojtjen dhe shpëtimin e banorëve, si dhe normalizimin dhe funksionimin e vendbanimit të goditur.

Për shkak të ndërlikueshmërisë së vlerësimit të rreziqeve për Infrastrukturën kritike, varshmërisë dhe ndërlidhjes së tyre me infrastrukturën në nivel lokal e qendror, duhet të obligohen gjitha institucionet/ subjektet juridike, që secila veç e veç për llojin e infrastrukturës dhe vlerësimin e rreziqeve sipas përgjegjësive të tyre emergjente, konform Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

7.6. RREZIQET NË OBJEKTET KOLEKTIVE

Gjakova është e ndjeshme ndaj rreziqeve në ndërtesat kolektive sidomos tani në periudhën e pasluftës e cila mund të jetë pasoj ndërtimeve të shumta e pa kritere, sidomos deri me aprovimin të hartës zonale.

Gjendja aktuale

Komuna e Gjakovës, ngjajshëm si edhe komunat tjera në vend, gjendet në procesin e regjistrimit dhe legalizimit të objekteve kolektive.

Definimi i objekteve kolektive[97]

Objektet kolektive janë ndërtesa (godina) për banim me familje ose ndërtesat e ngritura që për destinim kanë afarizmin, por mund të përdoren edhe si zyra.

Një ndërtesë e lartësisë së madhe është një godinë ku në pjesën e poshtme të saj (përdhesë) gjendet hapësira që mund t'i hyjë në shërbim ekipeve reaguese për luftë kundër zjarrit në lartësi, përveç saj mund të shfrytëzohet edhe platoja para objektit (nëse ekziston), për objektet e larta:

- më shumë se 50 metra për ndërtesat e banimit,
- më shumë se 28 metra për ndërtesat tjera.

Ndërtesat që pranojnë publik të grupit të parë përmbledhin të gjitha objektet e kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. Ky klasifikim bëhet varësisht nga numri i paraparë për publikun që mund të pranohet në ndërtesën përkatëse.

Të dhënat në vijim përcaktojnë:

- Kategorinë e parë: numër më i madh se 1500 persona,
- Kategorinë e dytë: nga 701 deri në 1500 persona,
- Kategorinë e tretë: nga 301 deri në 700 persona,
- Kategorinë e katërt: deri në 300 persona, përveç objekteve që përfshihen në kategorinë e pestë.
- Kategorinë e pestë: përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat numri i publikut nuk arrin njërën nga shifrat e caktuara për llojin e ndërtesës,

[97] AME/MPB Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Ekstrakt f.65,65…

Objektet që pranojnë publik klasifikohen po ashtu edhe për nga lloji i shfrytëzimit të ndërtesës që paraqitet përmes një shkronje që tregon përdorimin për të cilin është ndërtuar, si:

L: Salla për audicion, konferenca, mbledhje, spektakle, për përdorim të shumëllojshëm.
M: Dyqane, qendra tregtare.
N: Restorante dhe shitje e pijeve
O: Hotele dhe pansione për familje.
P: Salla të vallëzimit dhe salla të lojërave.
R : Objekte për mësim-shkolla.
S : Biblioteka, qendra të dokumentacionit dhe të konsultimit të arkivave.
T : Salla të ekspozitave (për qëllime komerciale).
U: Objekte mjeksore.
V: Objekte të kultit.
Ë: Objekte të administratës, banka, zyra.
X: Objektet sportive të mbuluara.
Y: Muzetë.
PA: Objektet në qiell të hapur.
CTS: Tenda cirku, tenda dhe struktura udhëtuese
SG: Struktura fryrëse
PS: Vende të parkimit të mbuluar
GA: Stacione me çasje për publikun
EF: Objekte lëvizëse
REF: Strehim në male
OA: Hotele, restorante në lartësi të mëdha mbidetare

Shkaqet e rrezikut në ndërtesat kolektive janë:

- Zjarret,
- Tërmetet,
- Eskplodimet,
- Rrënimet/shembjet,
- Vërshimet, etj

Pasojat

Pasojat e këtyre fatkeqësive manifestohen me vdekje, rrënime ndërtesash, avari, zjarre, shkatërrime të infrastrukturës vitale dhe infrastrukturës teknike, dëmtimin e ambientit si dhe trashëgimisë kulturore.

Profili i rrezikut	
Rreziku: Objektet kolektive.	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): KRITIKE.	
Frekuenca e ndodhjes: Shumë e mundshme.	**Modeli sezonal:** Gjatë tërë vitit.

Zonat që mund të goditen më së shumti: Objektet kolektive.
Kohëzgjatja e mundshme: Zjarret dhe rreziqet tjera që i kërcënojnë këto objekte mund të zgjasin vetëm disa orë apo më së shumti një ditë, ndërsa rreziku nga vërshimet mund të zgjasë 3 - 4 ditë. **Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):** Paralajmërim 6 deri 12 orë (për vërshime), kurse për zjarre dhe tërmete pa paralajmërim. **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:** Numri i integruar 112.
A ekziston analiza e dobësive / cenueshmërisë? Po ☐ Jo X

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/lëndimeqërezultojnënëpaaftësitëpërhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave dhe pasurisë së tyre.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit të: ujësjellësit, kanalizimit, energjisë dhe telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave të Administratës, bankave, zyrave, objekteve shkollore, objekteve qeveritare.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër
Ambienti	Kontaminimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.	E mesme
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim /dëmtim i bibliotekave, arkivave, sallave të ekspozitave, objekteve të kultit, muzetë, etj.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve dhe mjeteve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

Skenarët:

- Zjarr/eksplodim në objekt banesore (Zjarr kompleks),
- Shembja e disa ndërtesave të larta (Tërmet),
- Lëvizjet e pakontrolluara të turmave (lëvizje nga paniku në objektet e rëndësishme),

7.7. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË

Komuna e Gjakovës ka një strukturë kompakte për reagim në situata emergjente e mbështetur në Ligjin për Vetëqevrisjen locale dhe Ligjin për Mbrojtjen e nga Fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera[98].

Kjo strukturë është mjaftë e harmonizuar, dhe varësisht nga niveli dhe përmasat e fatkeqësisë, njësitë komunale si forcë e parë reaguese mbështeten nga niveli i dytë dhe i tretë, sipas përbërjes:

[98] Rregullore (QRK) nr.28/2015 për Organizimin e Njësive të Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë

1. Shtabi Komunal për Emergjencë,
2. Policia e Kosovës- Stacioni Policor në Gjakovë,
3. Forcat e Sigurisë së Kosovës,
4. KFOR-i,
5. Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në koordinim me strukturat udhëheqëse Komunale dhe dikasteret e saj,
6. Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit,
7. Qendra Operative Emergjente-112,
8. Shërbimet medikale,
9. Shërbimet vitale publike: KRU" Gjakova, KRM " Çabrati", KEDS etj,
10. Kryqi i Kuq Komunal dhe OJQ tjera.

Foto 8. Struktura Komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë



7.7.1. Shtabi Komunal Emergjent

Kompetencat :

- Shtabi, është organi më i lartë vendim-marrës, në udhëheqjen dhe koordinimin e veprimeve dhe aktiviteteve për situata emergjente në komunë,
- Kryetari i komunës është Shef i Shtabit, apo personi i autorizuar nga ai,
- Shtabi mund të mblidhet edhe në përbërje të zgjeruar, varësisht nga problematika e situatës emergjente dhe veprimet intervenuese,
- Shtabi është i vetmi organ i autorizuar, për Shpalljen/Deklarimin e gjendjes emergjente civile në teritorin e komunës së Gjakovës,
- Është organ kompetent për vënien e bashkëpunimit, komunikimit dhe bashkërenditjes së veprimeve me strukturat e nivelit qendror në aspektin e emergjencës dhe sipas nevojës kërkon ndihmë në shfrytëzimimin e resurseve dhe kapaciteteve me të cilat posedon niveli qendror,
- Në rast të fatkeqësive të përmasave më të mëdha, përveç kontaktit me strukturat qendrore, bashkëpunon edhe me strukturat emergjente të komunave fqinje, dhe merrë obligimet që i takojnë në kuadër të këtijë bashkëpunimi.

Obligimet dhe përgjegjësitë :

- Udhëheqë dhe vënë në lëvizje të gjitha subjektet e involvuara në situata emergjente dhe mbikqyrë realizimin e punëve dhe detyrave të cilat zhvillojnë ekipet e reagimit emergjent në teren.
- Bënë caktimin e prioriteteve dhe koordinimin sa më efikas të subjekteve involvuese të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rast të fatkeqësive: natyrore, teknologjike, sociale etj.
- Krijon kushte për veprime të shpejta në kohë dhe hapsirë me qëllim që të shpëtohen jetërat e njerëzve dhe të të mirave materiale , gjithashtu edhe në marrjen e veprimeve për t'a filluar stabilizimin e gjendjes,
- Sipas dinamikës , bazuar në principin e reciprocitetit, shkëmben informacione dhe të dhëna tjera me ineteres të veçant, me entet dhe institucionet e specijalizuara në nivel të Kosovës siç është: enti seizmologjik, enti hidrometeorologjik, epidemiologjik etj.
- Cakton kriteret për Shpalljen/Deklarimin e gjendjes emergjente civile si dhe mekanizmat për funkcionimin racional të strukturave shtetërore dhe civile në komunë gjatë fatkeqësisë, dhe sipas nevojës ndërmerrë masat adekuate që situata të mos del jashtë kontrolit.

Gjendja e emergjencës civile mund të shpallet në një pjesë të teritorit apo në tërë shtrierjen e saj, dhe ate Shtabi e shpallë/deklaron kur me mundësit dhe burimet ekzistuese dhe procedurat e rregullta nuk mund të përballoheshin dot pasojat që do të shkaktoheshin nga fatkeqësit.

Për Deklarimin e gjendjes së emergjencës civile janë të nevojshme përcaktimi i disa kritereve dhe të dhënave:

a) përcaktimi i madhësisë së zonës së goditur,
b) shkalla e cënueshmërisë dhe ndikimi në ekuilibrin e funksionimit të jetës të komunitetit,
c) të dhënat e verifikuara nga subjektet relevante komunale dhe nga institutet përkatëse (për rastin konkret të fatkeqësis).

Për të gjitha masat dhe veprimet që ndërmerrë Shtabi komunal për menaxhim emergjent, paraprakisht çfrytëzon të gjitha materialet-dokumentët e Planit komunal për gadishmëri emergjente të hartuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

7.7.2. Policia e Kosovës

Policia e Kosovës me rastin e aksidenteve të mëdha (katastrofave) do të kryejnë:

- Sigurimin e kontrollit në vend të ngjarjes (zonën e incidentit),
- Sigurimin e lëvizjeve dhe trafikut në vendin e ngjarjes dhe për-rreth vendit te ngjarjes,
- Evakuimin e qytetarëve në rast shpërthimi-eksplodimi nga objektet,
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave me interes me subjektet tjera të involvuara në situata emergjente,
- Veprimet e hetuesisë në vendngjarje,
- Parandalimin e dukurive negative dhe vënien nën kontrol të situatës në rastet emergjente vjedhjet, kaosi, anarkia, abuzimet e ndryshme etj),
- Mbështetjen në sigurinë fizike të përsonelit komandues të incidentit.

7.7.3. Forca e Sigurisë së Kosovës

Forca e Siguri së së Kosovës (FSK) në rast të situatave emergjente do ti kryejnë gadi të gjitha detyrat e emergjencës dhe do të jenë bashkëveprues në këto raste, në situata kur menaxhimi i fatkeqësisë i tejkalon kapacitetet komunale. Kërkesa për mbështetje nga FSK bëhet përmes Shefit të Shtabit Komunal për Emergjencë dhe adresohet konform Sistemit të Integruar për Menaxhimin e Emergjencave.

Mes tjerash do të :

- Të sigurojnë shërbime në raste të shkatërrimeve,
- Të kryejnë shërbime të kerkim-shpëtimit në situata të ndryshme emergjente, dhe angazhimi i tyre në zvogëlimin e pasojave të shkaktuara,
- Të sigurojnë asistencën humanitare në regjione të izoluara,
- Të kryejnë shërbime Emergjente medikale,
- Zbatimin e detyrave të transportit në rast të këkeses,
- Deminimin e mjeteve të paeksploduara
- Ndihmë në zbatimin e evakuimeve, e detyra tjera të cilat paraqiten në situata emergjente.

KFOR-i – si reagues i nivelit të III-të në Kosovë, në situata emergjente mbështetë dhe asiston nivelin qendror dhe komunal në realizimin e detyrave specifike emergjente në kuadër të:

- Masave dhe veprimeve në aktivitetet e kërkim- shpëtimit,
- Masave dhe veprimeve në raste të evakuimit,
- Aktiviteteve në mbrojtjen kimike-biologjike dhe radiologjike,
- Aktivitetet në sferen e strehimit (ngritja e "qytetit tendë"),
- Hapja e koridorit- urës ajrore për ndihmë dhe transport etj.
- Veprimeve të deminimit, dhe
- Marrjes e masave dhe veprimeve tjera të natyrës emergjente në koherencë me kapacitetet dhe autorizimet që merrë nga vendi të cilit i përket.

7.7.4. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

- ✓ Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim është organ profesional i cili mirret me çështjet emergjente në komunë dhe si e till bënë planifikimin dhe marrjen e masave për parandalimin, zbutjen dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike e të tjera;
- ✓ Struktura e saj organizative dhe pregaditjet e planeve mbrojtëse mundësojnë mbulimin e të gjitha segmenteve me të cilat do të ballafaqohet shoqëria civile dhe strukturat shtetërore në komunë në rast të situatave emergjente;
- ✓ Në punën e saj të përditshme ajo i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës-Gjakovë ,e sipas resoreve edhe nivelit Qendror-Agjensionit për Menaxhim të emergjencave, ndërsa me shpalljen e emergjencave civile i përgjigjet dhe është komplet me tërë potencijalin e saj në shërbim të Shtabit Komunal për Emergjencë;
- ✓ Planifikimi efektiv që bëhet në kuadër të DMSH është në funkcion fillestar të menaxhimit i cili njëherit siguron udhëheqje të mirëfilltë dhe rekomandon metodën ekzekutimit (reagimit),përmes të cilave u ipet përgjigje shumë pyetjeve siç janë: detyrat, potencijali njerëzor, koordinimi reciprok, ndarja e përgjegjësive , ndarja e mjeteve gjatë emergjencave etj.;
- ✓ Në bazë të vlerësimeve të gjithanshme profesionale dhe konstatimeve faktike në teren dhe duke marrë për bazë kompetencat dhe funkcionet që ushtron kjo Drejtori i jep Komitetit Komunal për Emergjenc propozim për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në një pjesë apo në tërë teritorin e komunës.



7.7.5. Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zjarrfikja dhe shpëtimit në situata zjarreve pyjore, zjarreve dhe eksplodimeve në industri, biznese, ndërtesa kolektive dhe shtëpi banimi, infrastrukurë energjetike, të telekomunikimit, ente, institucione etj.,
- Pozicionimi dhe shuarja e zjarreve përgjat akseve rrugore dhe hapja e koridoreve dhe shtigjeve për intervenim deri ne zonën e incidentit,
- Të sigurojë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym, nëse ato nuk janë të paisura me mjete standarde (boca oksigjeni etj),
- Misione shpëtuese dhe të kërkim-shpëtimit në fatkeqësi natyrore dhe katastrofa tjera,
- Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje,
- Veprime të Evakuimit dhe Shpëtimit në rast zjarri dhe fatkeqësi tjera natyrore,
- Veprime të kërkim-shpëtimit në aksidente rrugore,
- Veprime të kërkim-shpëtimit në ujërat sipërfaqësor etj,
- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në zonën e incidentit në mungesë edhe bartjen e të lënduarëve në qendrën spitalore;
- Kryen edhe punë e detyra tjera sipas nevojës dhe situatës emergjente dhe lidhur me këto detyra i përgjigjet në vertikale shefit të Shtabit Emergjent dhe Drejtorit për DMSH**;**

Njësia profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit ka 55 zjarrfikës dhe operon 24/7 në 4 ndërrime me kapacitet prej 13 automjete funksionale.

7.7.6. Qendra Operative Emergjente-112

Sigurimi me kohë i të dhënave (informacioneve) kualitative për të ndërmarrë vendime dhe aksione drejtuese për të përballuar me situatat emergjente në komunë e me gjërë,

- Bënë grumbullimin, ruajtjen dhe distribuimin e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e rreziqeve për jetën e njerëzve, qenieve të gjalla, pronës dhe ambientit,
- Kontroli dhe komunikimet në operacionet emergjente,
- Koordinimi i ekipeve dhe pajisjeve emergjente,
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet, ekipet dhe personelin tjetër të involvuar në situatat emergjente,
- Mosfunkcionimi i ZAKE-112 rrezikon shfaqjen e defekteve serioze në menaxhimin e emergjencave në komune,
- Udhehiqet nga stafi i trajnuar 9 veta dhe punon 24/7 ditë të javës,

7.7.7. Shërbimet medikale emergjente

Detyrat e ekipeve për shërbime medicinale në situata emergjente:

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
- Trijazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacijentit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale,
- Marrja e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera,
- Asanimi i terenit-lokacionit të aksidentuar,
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funkcionim adekuatë në situata emergjente,
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,

7.8.8. Shërbimet publike

Per funkcionimin normal te jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së të mirave materiale ne situata të emergjencave civile, kontribut tejet te rendesishem japin sherbimet publike komunale, te cilat me organizimin dhe shkallen e tyre te gadishmerise vepruese, ndikojne drejtpërdrejtë në cilësinë e menaxhimit te emergjencave.

Ndermarrjet te cilat kryesisht prezentojnë shtyllën e infrastruktures së shërbimeve publike ne teritorin e komunes dhe kompanitë e sektorit privat qe kryesisht mirren me veprimtari transportuese, rrugore-ndërtimore dhe te pastrimit, në situata emergjente secila nga fusheveprimtaria e saj:

- Zbaton vendimet e Shtabit komunal per Menaxhim Emergjent dhe per aktivitetet e saja i pergjigjet ketij organi,
- Merrë pjese aktive ne punën e këtij Shtabit dhe jep propozimet konkrete për tejkalimin e gjendjes emergjente duke u bazuar ne profesionalizmin dhe pervojat nga fushe-veprimtaria e tyre,
- Me kohe bëjnë planifikimin e resurseve njerezore dhe teknike për funkcionim racional ne situata emergjente dhe lidhur me kete njohton SHKME mbi mundesit e tyre reale,
- Caktojne prioritetet ne kryerjen e sherbimeve te tyre, dhe në koordinimte SHKME vendos rezhimin e saj te kryerjes se sherbimeve.

7.7.9. Komuniteti i Biznesit

Rolet, përgjegjësitë dhe pjesëmarrja e sektorit privat gjatë Incidenteve të shkaktuara në komunë, ndryshon bazuar në natyrën e organizimit, llojit dhe efektit të incidentit.
Rolet e organizatave të sektorit privat janë më sa vijon:

- Organizatat e sektorit privat mund të shërbejnë si një partner aktiv në aktivitetet për gatishmëri dhe reagim emergjent ndaj një incidenti,

- Organizatat e sektorit privat sigurojnë resurse reaguese (të dhuruara apo me kompensim) gjatë një incidenti (përfshirë ekipet e specializuara,pajisjet dhe teknologjinë e avancuar) nëpërmjet planeve lokale emergjente publike-private, marrëveshjeve të ndihmës reciproke, apo kërkesave të veçanta nga qeveria dheiniciativat vullnetare të sektorit privat,

- Organizatat e sektorit-privat mund të goditen nga pasojat e incidentit drejtpërdrejti apo tërthorazi, duke përfshirë infrastrukturën kritike në pronësi private, resurset kryesore dhe ato organizata të cilat janë domethënëse për rimëkëmbje ekonomike nga incidentet e nivelit lokal,

- Pronarët⁄operatorët e objekteve me rregulla të veçanta apo me veprimtari të rrezikshme mund të bartin përgjegjësi sipas ligjit për t'u përgatitur për incidente, për t'i parandaluar ato dhe të reagojnë ndaj tyre kur të ndodhin.

- **Përgjegjësitë:** Organizatat e sektorit privat mbështesin Planin e Reagimit Komunal (vullnetarisht apo me bindje/detyrim sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi) duke shkëmbyer informacione me strukturat kompetente

- komunale, duke identifikuar rreziqet, duke bërë vlerësimin e pikave të dobëta dhe të mangësive, duke hartuar plane për reagim emergjent dhe vijimësi të veprimtarisë, duke ngritur gatishmërinë e përgjithshme të tyre, duke implementuar programe përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes dhe duke dhuruar ose siguruar të mira dhe shërbime përmes marrëveshjeve kontraktuese për të ndihmuar në reagim dhe rimëkëmbje nga incidentet në komunën e Gjakovës

7.7.10. Organizatat joqeveritare

Detyrat dhe obligimet e OJQ në situata emergjente kryesisht kanp të bëjnë me:

- Senzibilizimin e opinionit të mbrendshëm dhe të jashtëm lidhur me situatën emergjente,
- Informimi i drejtë lidhur masat dhe veprimet të cilat subjektet involvuese në situata emergjente ndërmarrin për tejkalimin e gjendjes së krijuar,
- Hartimi i projekteve të cilat janë në funkcion të përballimit të situatave emergjente në komunë,
- Krijimi i fondeve emergjente dhe thithja e donacioneve të ndryshme për plotësimin e nevojave akute,
- Pjesëmarrja aktive në furnizimin e qytëtarëve nga zonat e aksidentuara me artikujt dhe gjërat tjera elementare për jetesë,
- Pjesëmarrja aktive në lëminë e evakuimit dhe strehimit,
- Bëjnë kërkime për burime të metëjmë për nevoja emergjente,
- Bashkëpunimi i ngushtë reciprok i tyre me të gjitha subjektet involvuese në emergjenca,
- Hartimi i analizave, raporteve, bilanseve dhe përpunimi i treguesëve (indikatoreve) përmes të cilave përcillen rrjedhat në situata emergjente.

K r e u i VIII-të



8.1. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE-SPECIFIKE

8.1.1. Vlerësimet përfundimtare[99]

Për të siguruar gatishmërinë dhe efektivitetin e reagimit në përballje me fatkeqësitë eventuale natyrore, në kontekst të vlerësimit të masave që duhet të ndërmarrë, Komuna e Gjakovës ne prioritet duhet të trajtoj :

1. Vlerësimi i Masave të Mbrojtjes

Identifikimin e Masave: Përcaktimi i masave të nevojshme për mbrojtjen e banorëve dhe komunitetit, të të mirave materiale dhe ambientit).

Eficienca e Masave: Vlerësimi i efektivitetit të masave ekzistuese në parandalimin e fatkeqësive ose lehtësimin e pasojave.

2. Mundësitë Reale për Mbështetje

Analiza e Kapacitetit: Vlerësimi i infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme për të mbështetur masat e mbrojtjes (p.sh.,

[99] AME-UNDP – Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera", Prishtinë 2024

rrugët, qendrat e shpëtimit).

Pjesëmarrja e Komunitetit: Aktivizimi i qytetarëve dhe organizatave lokale në mbështetje të masave të mbrojtjes.

3. Vlerësimi i Resurseve Njerëzore

Numri dhe Kualifikimi i Personelit: Vlerësimi i numrit të punonjësve të trajnuar dhe të kualifikuar për të përballuar situata emergjente.

Formimi dhe Trajnimi: Identifikimi i nevojave për trajnime të mëtejshme dhe zhvillimin e kapaciteteve.

4. Vlerësimi i Resurseve Materiale

Inventari i Pajisjeve: Përcaktimi i pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për reagim (p.sh., automjete shpëtimi, pajisje të komunikimit).

Financimi: Analiza e burimeve financiare të nevojshme për të mbështetur operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit.

5. Planifikimi dhe Koordinimi

Plani i Reagimit: Hartimi i një plani të detajuar për reagim në situata emergjente, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e secilës agjenci.

Koordinimi: Sigurimi i një sistemi efektiv të komunikimit dhe koordinimit midis agjencive dhe organizatave të ndryshme.

6. Monitorimi dhe Rishikimi

Vlerësimi Pas-incident: Pas çdo fatkeqësie, analiza e performancës së masave dhe reagimit, për të identifikuar kapacitetet dhe dobësitë eventuale.

Përditësimi i Planeve: Rishikimi dhe përditësimi i masave të mbrojtjes dhe planit të reagimit në përputhje me mësimet e nxjerra. Këto vlerësime përbëjnë një hap të rëndësishëm në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv për mbrojtje dhe shpëtim, duke siguruar që resurset janë të përdorura në mënyrë optimale për të përballuar pasojat e Fatkeqësive Natyrore.

Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr 25/2020 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit për komunën e Gjakovës të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike kur e kërkon nevoja edhe më herët.

Hartimi i "Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga FNFT është i bazuar ne Ligjin 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera; Në grumbullimin e të dhënave për azhurnimin e Dokumentit janë shfrytëzuar burime nga: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), KEDS, Policia e Kosovës, stacioni i Prizrenit, Qendra për punë sociale, QKMF, KRU "Gjakova", Enti për punësim. Drejtoritë përkatëse të Komunës së Gjakovës, Plani Zhvillimor i Komunës, si dhe burime të tjera nga literatura të ndryshme. Dokumenti u hartua me ndihmën e grupit punues i caktuar nga Kryetari i komunës se Gjakovës, z. Ardian Gjini.

8.1.2. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave të reagimit emergjent

Vlerësimi i strukturës dhe madhësisë së forcave për reagim emergjent është një proces kyç për të siguruar gatishmërinë dhe efektivitetin e përgjigjes ndaj situatave emergjente. Ky vlerësim përfshin disa komponentë kryesorë:

1. Analiza e Rrezikut

Identifikimi i Rreziqeve: Njohja e llojeve të situatave emergjente (zjarre, përmbytje, tërmete, etj.).

Vlerësimi i Ndikimit: Kuptimi i ndikimit potencial të këtyre rreziqeve mbi komunitetet dhe infrastrukturën.

2. Struktura e Forcave

Organizata e Reagimit: Përcaktimi i strukturës organizative, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e secilës njësi (policia, zjarrfikësit, shërbimet mjekësore, etj.). Koordinimi: Krijimi i mekanizmave të koordinimit midis agjencive dhe organizatave të ndryshme që merren me emergjencat.

3. Madhësia e Forcave

Numri i Anëtarëve: Vlerësimi i numrit të nevojshëm të punonjësve për të përballuar situatat emergjente, duke marrë parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e rrezikut.

Specializimi: Përcaktimi i nevojave për trajnim të veçantë dhe ekspertizë në fusha të caktuara (p.sh., shpëtimi nga uji, ndihma mjekësore emergjente).

4. Kapaciteti dhe Burimet

Burimet Materiale: Vlerësimi i pajisjeve dhe mjeteve që nevojiten për reagim (automjete, pajisje komunikimi, mjete shpëtimi).

4. Trajnimi dhe Simulimet

Programet e Trajnimit: Zhvillimi i trajnimeve për stafin e reagimit dhe organizimin e ushtrimeve për të provuar gatishmërinë. Simulime të Situatave: Kryerja e stërvitjeve për të testuar dhe vlerësuar strukturën dhe procedurat e reagimit.

5. Pjesëmarrja e Komunitetit

Edukimi i Publikut: Ngritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi procedurat e emergjencës dhe mënyrat e ndihmës. Inkurajimi i Vullnetareve: Aktivizimi i qytetarëve në grupe vullnetarësh që mund të ndihmojnë në situata emergjente, Ky vlerësim ndihmon në ndërtimin e një sistemi të fortë dhe efektiv për reagim emergjent, duke siguruar që forcate janë të përgatitura dhe të gatshme për të përballuar çdo situatë që mund të ndodhë.

8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT

8.2.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT

Komuna e Gjakovës, në bazë të dokumentit të vlerësimit të rreziqeve (DVRR)), me Kornizën buxhetore 2027-2029 duhet të planifikoj mjete financiare me qëllim të realizimit të projekteve në funksion të masave për parandalimin dhe zvogëlimin të rreziqeve nga faktqësitë natyrore:

Tabela 75. Projektet e planifikuara per 3 vitet e ardhshme për ndërmarrjes se masave parandaluese dhe zvogëlim të rreziqeve nga FNTF

#	Objektivi	2026	2027	2028	Kosto e Ativitet. të pa plamifikuara	Përgjegjësia Institucionale	Rreziku
1.	Ngritja e Grupeve Vullnetare	x	x	x	3,000	Komuna e Gjakovës, AME	Mungesë vullnetarësh, mungesë eksperiencë në menaxhimin e vullnetarëve
2.	Trajnimi i Grupeve Vullnetare	x	x	x	5,000	Komuna e Gjakovës,AME	Mungesë Vullnetarësh; mungesë fondesh
3.	Trajnimi i Komunitetit	x	x	x	5,000	Komuna e Gjakovës,AME	Mungesë eksperience për trajnimin e komunitetit; mungesë përfshirje nga komuniteti;
4.	Fushata Informimi Komuniteti	x	x	x	3,000	Komuna e Gjakovës, AME, Mediat lokale	Mungesë bashkëpunimi me media lokale
5.	Fushata Ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve nga Fermeret	x	x	x	3,000	DBPZHR Gjakovë,Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	Mungesë bashkëpunimi nga fermerët; mungesë angazhimi në pastrimin e kanaleve;
6.	Fushata Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj zjarrit në pyje	x	x	x	3,000	DBPZHR Gjakovë,Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	Mungesë kapaciteti për menaxhimin e pyjeve; mungesë interesi nga komuniteti;
7.	Ngritja dhe mirëmbatja e databazës së GIS dhe trajnimi i Stafit	x	x	x	3,000	Komuna e Gjakovës	Mungesë infrastruktures (kompjuter/ programe); mungesë bashkëpunimi midis sektorëve
8.	Pastrimi dhe rregullimi i përrocjave- kanaleve (Gusha)	50,000	150,000		x	Gjakovë,Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal
9.	Rregullimi i shtretërve të lumenjëve **Krena** dhe **Llukac** dhe mbrojtja nga vërshimet	1,200.000 500,000	800,000 500,000		x	DBPZHR Gjakovë,Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	Mungesë fondesh
10.	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	200,000	200,000	200,000	x	Komuna e Gjakovës,	Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal
11.	Miërbajtja/sanimi i urave lokale me rrezikshmëri	50,000	50,000	50,000	x	Komuna e Gjakovës	Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal

12.	Studim sizmik për ndërtesat me moshë mbi 30 vjet		x	x	20,000	Komuna e Gjakovës, Instituti Gjeologjik i Kosovës	Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal
13.	Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë		x	x	5,000	Komuna e Gjakovës, Instituti Gjeologjik i Kosovës	Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal
14.	Studimi dhe Monitorim i Zonave me rrezik Rrëshqitje		x	x	5,000	Komuna e Gjakovës, Instituti Gjeologjik i Kosovës	Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal
15.	Ndërtimi i mureve mbojtëse (për tu shmangur erozionit)	x	x	x	1,500,000	Komuna e Gjakovës/MMPH	Mungesë fondesh
16.	Rehabilitimi dhe mirëmbatja e sistemit te kanalizimit dhe ujësjellësit	100,000	100,000	100,000	x	KRU Gjakova , Komuna e Gjakovës	
17.	Hartimi i Planeve të Evakuimit në ndërtesa të rëndësisë së veçantë dhe vendosja e sinjalistikës së nevojshme	x	x	x	30,000	Komuna e Gjakovës	Mungesë fondesh
18.	Plotësimi i nevojave me pajisje për rastet e emergjencave	x	x	x	50,000	Komuna e Gjakovës, AME	Mungesë fondesh
19.	Ngritja e Sistemit ë alarmimit – smart city	80,000	x	x	x	Komuna e Gjakovës, AME	Mungesë fondesh
20.	Intervenime Emergjente	34.000	50,000	50,000	X	Komuna e Gjakovës,	
	Totali:	**2,214,000**	**1,850,000**	**400,000**	**1.635,000**		

Të gjitha strukturat, të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat emergjente civile, duhet të jenë të pavarura në veprime, në mënyrë që të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është më se e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar mjete financiare të mjaftueshme për veprim. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta, kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë në dispozicion dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në situata emergjente, në mënyrë që të fillojë menjëherë veprimi.

Kostot financiare sekondare: Gjatë zhvillimit të situatës emergjente, problemet financiare rriten dhe bëhen afatgjata. Këtu përfshihen kostot për orë shtesë të përsonelit, kostot për sigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të specializuara dhe të mjeteve të transportit, si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve, asistencën mjekësore dhe ato humanitare në përgjithësi, për ata që janë të prekur nga situata emergjente. Këto shpenzime përbëjnë probleme afatgjata buxhetore dhe duhet të planifikohen.

Kostot financiare për rimekëmbje: Në të shumtën e rasteve, janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para rikthimit të fazës në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për:
Riparimin e ndërtesave_____, të infrastrukturës,_____, të ujit_____, të energjisë elektrike_____, dhe të strehimit_____ për të gjithë ata të cilët për një përiudhë më të gjatë kohore nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre. Për këto burime financiare buxhetore Qeveria në koordinim me Komunat duhet përpilojnë një kod të veçant buxhetor dhe të garantojnë mekanizma për përdorimin e këtyre mjeteve në mënyrë sa më të efektshme në situata emergjente.

8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike

Për territorin e komunës se Gjakovës ka nevoj të ngritën kapacitetet si:

a. Ekipi profesional, afër 150 persona; (Struktura për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë: NJPZSH, Njësitë Zjarrfikëse në Industri dhe Njësitë Vullnetare të Zjarrfikësve);
b. Identifikimi i kapaciteteve për nevoja elementare (shtretër, shatorre, batanije, pako higjenike, pako ushqimore, stufa për nxemje etj);
c. Momerandum bashkëpunimi me kompanitë vendore për aktivizimin e paisjeve teknike ne rastet emergjente (për hapjen e rrugëve, të kanaleve etj);
d. Makineritë e tjera te nevojshmem - afër 30 (Kamione, zjarrfikëse, dhe mjetet e tjera per transportin e njerëzve).

8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional

Pasi të krijohet ekipi për reagim emergjent (ERE), Komuna e Gjakovës,kërkon trajnim dhe çertifikim profesional nga AME-në.

8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre

Në bazë të Rregullores nr (QRK) 18/2015 per organizimin e Njësive të SMSHN, Komuna e Gjakovës në bazë të vlerësimit të rrezikut themelon bjësitë për intervenime të përgjithshme

8.2.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga Fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera

- Rregullimi i shtretërve te lumejve,
- Rritja e kapaciteteve humane dhe teknike për zjarrfikje dhe kërkim-shpëtim,
- Rritja e kapaciteteve shëndetësore në shëndet, aktivizimi i ekipeve reaguse emergjente në periudhën e thatësirave
- Realizimi i projekteve që ndikojnë në zvogëlim rreziqeve;

9. DISPOZITATAT PËRFINDIMATRE

Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr 25/2022 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit për komunën e Gjakovës të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike, sipas nevojës edhe më herët.

Hartimi i “Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga FNFT është i bazuar ne Ligjin 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera; Në grumbullimin e të dhënave për azhurnimin e Dokumentit janë shfrytëzuar burime nga: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), KEDS, Policia e Kosovës, stacioni i Prizrenit, Qendra për punë sociale, QKMF, KRU “Hidroregjioni jugor”, Enti për punësim. Drejtoritë përkatëse te Kuvendit Komunal Prizrenit, Plani Zhvillimor i Komunës, si dhe burime të tjera nga literatura të ndryshme. Dokumenti u hartua me ndihmën e grupit punues i caktuar nga Kryetari i Komunës se Gjakovës, z. Ardian Gjini.

10. REKOMANDIME

Në kuadër të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT për komunën e Gjakovës, grupi punues rekomandon, të:

1. Dokumenti i Vlerësimit të merret në konsideratë dhe për bazë gjatë hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
2. Hartojë programin (edukimin, trajnimin dhe vetëdijësimin qytetar) si dhe masat parandaluese për tri vitet e ardhshme;
3. Merret si bazë për analizimin e nevojave dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese;
4. Të hartojë skenarët dhe ushtrimin e tyre me qëllim të testimit të kapaciteteve reaguese humane dhe teknike;
5. Ndajë një fond për reagim emergjent bazuar në historikun e fatkeqësive për komunën e Gjakovës dhe vlerësimin e dëmeve dhe pasojave;

Regjistri i Ndryshimeve				
Nr	Datë	Kapitulli / faqe	Përmbajtja	Personat e autorizuar për ndryshim
1	Hartuar Maj 2026	Ky dokument përfshin kapituj në të cilët pasqyrohet rregullimi shtetëror, pozita gjeografike, karakteristikat, rreziqet natyrore (profilet e rreziqeve, grupet e cenueshme) vlerësimet përfundimtare, strukturat për mbrojtje, ndihmë shpëtim dhe hartat.		
2	Rishikimi i planifikuar 2028 Rishikim specifik-sipas nevojës	Është bërë rishikimi i plotë i të gjithë kapitujve të cilët janë plotësuar me shumë informacione që brenda kësaj periudhe kohore janë gjeneruar.	Rregullore (QRK) Nr. 25/2020 Rregullore (QRK) 18/2015 Plani i Punës-Komuna e Gjakovës	Duke u bazuar në Vendimin të Kryetarit të Komunës 01 nr.112/02-14739, është themeluar grupi punues për rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rreziqeve, bashkëngjitur edhe lista e anëtarëve/ zyrtarëve përgjigjës për dikasterët e caktuar të cilët kanë kontribuar me të dhëna dhe materiale për rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rreziqeve nga FNFT.

Regjistri i shpërndarjes

Grupi	Institucioni	Titulli i marrësit	Mënyra e dedikimit	
			Kopje e fortë	Elektronike

Bibliografi

1. *Asambleja e Përgjithshme e OKB-së - "Dekada Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore", tetor 1987 New York,*
2. *Akademia e Shkencave e Shqipërisë – "Kosova në Vështrim Enciklopedik", 1999 Tiranë,*
3. *Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit – "Gjendja e natyrës 2008-2009-2010", MMPH&UNDP, Prishtinë, 2010*
4. *Back Ulrih http://www.mcgraw-hill.co.uk/openup/chapters/0335217389.pdf,-,"Risk Society: Towards a New Modernity". 2012, London: Sage.*
5. *D. Handersenhttp://en.wikipedia.org/wiki/1972_outbreak_of_smallpox_in_Yugoslavia*
6. *Enti i Historisë së Kosovës " Kosova"- 1975, Prishtinë*
7. *http://www.mjedis.tv/koha-dekompozimit.html*
8. *http://www.radoniqi.com/mod.php?mid=17&cid=1*
9. *Kabo Dr. Mevlan, Gjeografija Fizike Krahinore I,II,III,-, botimet 1969 dhe 1970, Universiteti Shtetëror i Tiranës,*
10. *Krasniqi Dr. Mark , "Kosova Sot" – Referat në Senatin Belg, Prishtinë 1992*
11. *Krasniqi Prof. Pleurat, "Aspekte kulturore-historike të Gjakovës", Gjakovë, 2002*
12. *"Kultura dhe Arti i Qytetit të Gjakovë "- http://kk.rks-gov.net/gjakove/City-guide/Culture.aspx*
13. *Kuvendi i komunës Gjakovë – "Toponimia e Gjakovës me rrethinë", 2011 Gjakovë*
14. *Kuvendi i komunës Gjakovë – "Gjakova", buletin, 2005, Gjakovë*
15. *Kuvendi i komunës Gjakovë – "Plani zhvillimor urban dhe rural 2006-2015, prill,2008 Gjakovë*
16. *http://kosova.org/docs/city/02.pdf - Atlas i Rrugëve të Kosovës, korrik/2009*
17. *UNDP- "Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës" , 2011 Gjakovë*
18. *Forcat e Sigurisë së Kosovës – 03,prill/2012, "Dita Ndërkombëtare e Vetëdijësimit nga Rreziku i Minave"*

19. *http://www.kosovapress.com/?cid=1,92,145418*
20. *GFA Consulting Gruop BE –Mbështetje insitucionale Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë të Kosovës nr.2008, 162-152, &,* Early Risk Management Planning, www.fta.dot.gov/grants/12840_9649.html
21. http://corpsriskanalysisgateway.us/images/stage-damage.jpg
22. Florida Bill SB 844 - Violations/Probation/Community Control ...*apps.lobbytools.com/pub/index.cfm?type=bills&id=31038*
23. *Risk Identification* - Risk Assessment and Allocation for Highway ...*international.fhwa.dot.gov/riskassess/risk_hcm06_02.cfm*
24. [PDF] Emergency Planning ,*https://training.fema.gov/EMIËeb/doënloads/IS235.pdf*
25. IS235 PDF.pdf – [Intruduction]
26. Dokumenti për Politike dhe Strategji për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2022-2030,
27. *Nikolli Dr. Pal – " Gjeomorfologjia e Kosovës" – Universiteti i Tiranës, 2010 Tiranë*
28. *NATO/KFOR UNCLASSIFIED- KOSOVO MINES MAP/DAKOVICA, UTM GRID Zone 34T WGS 84*
29. *Monografi "Kosova dikur dhe sot", grupi i autorëve, Ekonomska Politika, shkurtë 1973 Beograd ,*
30. *Milovanović Dr. Branislav, "Opšta Geologija",- Ministarstvo Rudarstva FRNJ, Beograd*
31. *Pushka Dr. Asllan "Gjeografia për shkolla të mesme"- Fakulteti i shkemcave matematiko-natyrore, Universiteti i Prishtinës,1979 Prishtinë*
32. *Vala Dr. Nesim " Pozita dhe karakteristikat gjeografike të Gjakovës"- doracak, prill 2009 Gjakovë*
33. *36.Shehu Dr. Izet " Menaxhimi i Programeve Preventive në Emergjenca ", Kolegji Biznesi 2011, Prishtinë.*

VLERËSIMI
I RREZIQEVE NGA FATKEQSITË NATYRORE
DHE FATKEQËSITË TJERA

_____

Gjakovë
Prill / 2026